**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

**THËRRAS**

Mbledhjen e XVII-të (shtatëmbëdhjetë - mandati VII)-e *rregullt*, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **31 tetor 2022, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10;00**, me këtë,

**REND TË DITËS**

**1.** Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:
*30 qershor 2022*; *29 korrik 2022*; *12 shtator 2022* dhe *29 shtator 2022*

**2.** Informatë nga Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë

**3.** Propozim Rregullorja për Taksa Tarifa dhe Gjoba Komunale

**4.** Raporti Financiar i Komunës për periudhën janar – shtator 2022

**5.** Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës

**6.** Propozim vendimet për:
- *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: "Ushton Lumi" në Popovë-Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur (arsyeshmëria profesionale e MMPHI – AMMK / IKMN)*
- *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: "Trungu i Qarrit" (Quercus cerris ) në Fshatin Lupç i Poshtëm-Komuna e Podujevës, si Monument i Natyrës (Elaborat i arsyeshmërisë profesionale -MMPHI – AMMK / IKMN)*

**7.** Propozim vendimi për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës

**8.** Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023

**9.** Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (*pas dhënies së dorëheqjes të anëtares së Komitetit, respektivisht anëtares së Kuvendit znj.Adelinë Stublla*)

**10.** Të ndryshme

**Nr.prot.01-060/03-0089675/22**
**Podujevë, datë, 20 tetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal nga mbledhja e XII-të (dymbëdhjetë), mandati VII-të, mbajtur më 30 qershor 2022, dhe vazhduar më 15 korrik 2022, (për shkak të ndërprerjes në mungesë të kuorumit).**

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç; znj.Arjeta Abazi, znj.Donjetë Sheqiri, znj.Tringa Sfishta dhe z.Burim Hasani, që munguan.
Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës.
Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

## Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbar në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, i njoftoj rreth konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF përfshirë edhe dy pikat shtesë të rekomanduara për përfshirje në rend të ditës.
Ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën rreth rendit të ditës.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, lidhur me rendin e ditës do ta ngris një shqetësim se unë kam qenë pjesë e hartimit të planit të punës së kuvendit nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së dhe me të gjitha të metat dhe mangësitë që kanë qenë në hartimin, përpilimin dhe miratim e atij plani unë shohë se në këtë rend të ditës janë heqë dy pika mjaftë të rëndësishme siç ka qenë informata mbi gjendjen e arsimit dhe raporti i auditorit të jashtëm.
Informatën rreth gjendjes së arsimit ne me qëllim e patëm lënë të jetë në fund të muajit qershor për arsye se përfundon edhe viti shkollor dhe jemi dakorduar që të kemi informatë nga DKA-ja mirëpo megjithatë se çfarë ka ngjarë kohët e fundit me këtë drejtori nuk po e shohë assesi të arsyeshme që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.
**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, kjo pikë nuk është tërheqë nga rendi i ditës sepse ka qenë vetëm e planifikuar, prezent këtu e kemi edhe drejtorin e DKA-së i cili mund të na japë sqarime mirëpo ende s'ka përfunduar viti shkollor në shkollat fillore, më konkretisht fjalën ia kalojmë drejtorit të DKA-së.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, sipas planit të punës në mbledhjen e muajit korrik unë do të raportoj rreth gjendjes në arsim, nëse ka ndryshuar diçka unë nuk e di.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, sa i takon planit të punës që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të auditorit po jap një sqarim raporti final i auditorit ka ardhë të hënën prej zyrës së auditorit gjeneral dhe rrjedhimisht ne kemi mund të kalojmë këtë përmes KPF-së, por duke qenë se është një pikë mjaftë e rëndësishme kemi dashur të shkojmë në procedurë të rregullt në mënyrë që materiali asamblistëve t'i dërgohet 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes së asamblesë komunale

kështu që nuk ka pasë mundësi për 2 ose 3 ditë të dërgohet materiali se normalisht ne jemi varur nga zyra e auditorit gjeneral, e mira është që është raport pozitiv.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, propozoj që sot në kuadër të rendit të ditës të hyjnë edhe dy pika, pika e parë është rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës e cila ka muaj që i ka kaluar gjitha procedurat dhe është futur dikund në sirtarë dhe nuk e di se çfarë ka ndodhur me të dhe pse nuk po sillet në kuvend, janë disa rekomandime dhe disa çështje tjera të cilat brenda një ore mund të inkorporohen në rregullore.
Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale, rregulloren e kuvendit të komunës si dhe udhëzimin administrativ të MPL-së nr. 05/2020, propozoj që të futet si pikë e rendit të ditës formimi i komisioneve tjera, komiteteve tjera në kuadër të kuvendit komunal e që janë, komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komiteti për barazi gjinore dhe komiteti për zhvillim ekonomik.
Janë komitete të cilat po e prolongojnë punën e kuvendit dhe ne si asamblistë nuk mund të japim kontributin tonë pa këto komitete mirëpo mund të ketë edhe komitete tjera që mund të propozohen nga kolegët dhe me një fjalë propozoj që këto pika të hyjnë si pika të rendit të ditës e që s'kanë të bëjnë me çështje politike por me interes të përgjithshëm të qytetarëve.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, për faktin që z.Halil Kastrati përmes shoqatës së tij "Jetimat e Ballkanit", deri më tani në komunën tonë ka ndërtuar më shumë se 72 shtëpi për familjet në nevojë, andaj duke marrë parasysh faktin që një numër i komunave në nivel vendi në emër të ndihmave që ka bërë për ndërtimin e shtëpive për familjet në nevojë z.Halil Kastrati e kanë shpallë qytetar nderi, unë propozoj që si pikë të veçantë të rendit të ditës në këtë seancë të fillojmë procedurën për marrjen e vendimit për shpallje të z.Halil Kastrati qytetar nderi i Komunës së Podujevës sepse puna dhe angazhimi i tij i jashtëzakonshëm që ka bërë për komunën tonë meriton që këtë person ta kemi qytetar nderi të Komunës së Podujevës.
Vlera e gjithmbarshme e këtyre objekteve që janë ndërtuar në komunën tonë i kalon vlerat milionëshe prandaj mendoj se me këtë vendim që do ta merr kjo asamble e kuvendit besoj se i bëjmë nder veti por i bëjmë nder edhe qytetarëve por në veçanti një nder të madh ia bëjmë atyre të cilët kanë përfituar nga këto ndihma të mëdha të cilat i ka bë z.Halil Kastrati, ky person është duke bashkëpunuar me komunën tonë madje i kemi edhe disa projekte të cilat shpresojmë se së shpejti do të fillojnë në procesin e realizimit të tyre prandaj unë mendoj se është mirë që sot ta vejmë në rend të ditës çështjen e shpalljes z.Halil Kastrati qytetar nderi i Komunës së Podujevës.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, meqenëse kryetari po kërkon që të shpallet qytetar nderi z.Halil Kastrati natyrisht që ne e përkrahim këtë ide sepse është në të mirën e të gjithë neve por po më vjen shumë keq që ende qyteti i Podujevës nuk e ka asnjë rrugë dhe asnjë shesh me emrin e "Adem Demaçit", pra po më vjen shumë keq dhe po ndihem shumë i turpëruar që ne çdo herë po harrojmë figurat më madhore që kanë dhënë çdo gjë për këtë vend e sidomos për rajonin tonë e që ende për asnjë rrugë asnjë shesh komuna jonë nuk e ka marrë mundin as për pesë minuta të mendoj për këtë çështje edhe pse më duket se është bërë një kërkesë nga shoqatat e dal nga lufta dhe ka ardhë në adresë të komunës.
Është mirë që edhe në komunën tonë ta kemi një shesh së paku kur njerëzit vijnë ta vizitojnë Podujevën ta dinë se "Adem Demaçi" është Llapjan dhe është një ikonë kombëtare e që besoj se duhet ta përkrahim gjithë asamblistët këtë propozim prandaj nga drejtoria përkatëse kisha kërkuar ta ketë parasysh këtë dhe ta merr si iniciativë dhe në qoftë se nuk kemi mjete të mjaftueshme mundemi të gjitha bizneset së bashku të ndajmë mjete financiare dhe një vend ku ata vizitorë që vijnë e vizitojnë qytetin tonë ta kenë mundësinë ta shohin shtatoren e "Adem Demaçit", që i ndjeri ka qenë shtyllë kryesore të shtetit tonë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, desha t'i përgjigjem këshilltarit z.Ragip Fetahu për dy pyetjet të cilat i bëri apo për dy kërkesat e tij, ne si kuvend jemi të ngarkuar me pika të rendit të ditës dhe kjo ka qenë arsyeja pse formimi i komiteteve nuk ka hyrë si pikë e rendit të ditës, arsye kjo se ne edhe në mbledhjen e KPF-së

e pamë se dy pika nuk u miratuan që të kalojnë në kuvend me të vetmin arsyetimin se rendi i ditës po ngarkohet me shumë pika edhe këtë propozim ne e kemi në plan të punës dhe në seancën e ardhshme ne do t'i formojmë këto komitete.
Sa i përket Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës drejtoria e administratës është në përfundim e sipër dhe besoj se së shpejti këto dy pika të rendit të ditës do të procedohen në kuvend.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, i nderuari z.kryesues nuk janë pyetje por janë propozime që të hidhen në votim këto dy pika.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuar këshilltar z.Ragip Fetahu janë disa procedurat që duhet të ndiqen për tu proceduar si pika të rendit të ditës në kuvend këto propozime.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, është e drejtë e një asamblisti që të propozoj pika të rendit të ditës.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Administratës-DA, theksoi, dua t'ju njoftoj se ne si pjesë e ekzekutivit i kemi kryer të gjitha punët që varen nga ne, vetëm jemi duke e pritur një përgjigje nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
Për shkak të mungesës së dispozitave ligjore dhe nënligjore lidhur me rregullimin e procedurës për shkak të ndryshimit të strukturës së asamblesë kemi pyetur në qoftë se kjo draft rregullore mund të vije në asamble si pikë për miratim ashtu siç është ose duhet të fillohen procedurat edhe njëherë prej fillimit dhe të formohet komisioni dhe të mbahen edhe njëherë dëgjimet publike dhe të vendoset si draft rregullore, mirëpo deri në kthimin e një përgjigje nga ana e ministrisë ne nuk mund të marrim veprime tjera.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, e nderuara drejtoreshë kjo rregullore ka qenë e planifikuar që të kaloj në muajin maj dhe ne tani jemi në fund të muajit qershor dhe mendoj se këto justifikime të tilla unë nuk po i kuptoj andaj mendoj se propozimi im duhet të hyjë si pikë e rendit të ditës në qoftë se është në kundërshtim me rregullativën ligjore është MAPL-ja, që e jep vendimin përfundimtar dhe të kisha sugjeruar që të merresh me këtë çështje dhe t'i shikosh ato rekomandime që i kanë dhënë qytetarët e të njëjtat t'i inkorporosh në rregullore dhe të na e sjellësh rregulloren në kuvend.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, rekomandimet të cilat i kemi pranuar nga ana e qytetarëve nuk janë në përputhje me udhëzimin administrativ i cili përcakton se sa këshilla lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duhet të jenë për këto arsye ato rekomandime nuk mund të merren parasysh dhe rregullorja nuk mund të krijohet në bazë të tyre, për këtë arsye ne jemi në komunikim me ministrinë dhe së shpejti do të jetë si pikë e rendit të ditës.
**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, në lidhje me propozimin e këshilltarit z.Gazmend Islami për shtatoren në sheshin "Adem Demaçi", sigurisht që unë e mirëpres idenë dhe propozimin e tij mirëpo në planifikimet buxhetore që i kemi e kemi të pamundur që këtë vit të ndërmarrim diçka, aktualisht ne kemi bë një kërkesë të cilën ia kemi dërguar ministrisë për vendosjen e shtatores së legjendës së futbollit "Fadil Vokrri", pasi që paraprakisht ka një vendim të kuvendit komunal të vitit 2020 nëse nuk gaboj për vendosjen e shtatores.
Në këtë fazë po merremi me vendosjen e shtatore së legjendës së futbollit "Fadil Vokrri", mirëpo edhe ideje dhe propozimi juaj që në të kaluarën ka qenë edhe propozim i LVV-së është e mirëseardhur dhe besoj se ne mund të takohemi të diskutojmë dhe ta gjejmë një mënyrë se si ta realizojmë këtë sa më shpejt.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, vetëm desha të ndërlidhem me çështjen e propozimit të asamblistit z.Ragip Fetahu, është mirë që propozimi i tij të hidhet në votim, zakonisht nuk është e preferuar që të diskutohet për pikat e rendit të ditës përderisa hidhen në votim, hidhen propozimet në votim, kalojnë ose nuk kalojnë si pika të rendit të ditës, nëse kalojnë si pika të rendit të ditës jepen sqarimet ashtu siç i dha drejtoresha e DA-së dhe kalojnë si pika të rendit të ditës këtu nuk ka asgjë të keqe dhe se di pse po ndalemi tani në këtë fazë për të diskutuar për këtë çështje se a të hyjnë ose jo propozimet si pika të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të gjithë ne e dimë se pikat e rendit të ditës ne si kuvend i miratojmë pastaj këto vendime që i marrim ne kalojnë për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL, dhe nëse këto vendime pas vlerësimeve të ligjshmërisë kthehen si vlerësime negative atëherë ne si kuvend nuk dalim mirë.
Ne kemi rastin si kuvend kur kemi mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme dhe kemi marrë vendim për ndarjen e 70,000.oo€ për ndarjen e pakove ushqimore për familjet në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale mirëpo ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje pozitive nga ana e ministrisë përkatëse.
Ne mund të marrim ndonjë vendim që nuk është në përputhje me ligjin dhe nga MAPL-ja do të marrim vlerësim negativ të ligjshmërisë kështu që nuk është e nevojshme të shkelim ndonjë procedurë ligjore prandaj kjo është arsyeja sepse neve asgjë nuk na pengon miratimi i rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës por vetëm duhet t'i përfillim procedurat ligjore.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, e kam potencuar edhe në mbledhjen e KPF-së se është një praktikë që po vazhdon në kuvendin tonë kur dihet se kush e bënë rendin e ditës në bashkëpunim me kë dhe nuk janë larg zyrat mes katit të dytë dhe katit të tretë dhe ka qenë mirë para se të vije rendi i ditës të shqyrtohen gjitha kërkesat dhe nevojat për ta pasuruar ose për të qenë pjesë e rendit të ditës.
Kjo forma që është kah na ndodh ne pasi që ta marrim materialin të na vijnë edhe ka 5-6 ose 7-8 pika në një formë po bëjmë një anashkalim apo ndonjë shkelje, unë e di që ka momente të caktuara që puna apo urgjenca e një projekti e krijon një situatë që të bëhen lëshime këso fare mirëpo të thuhet sot po të përgjigjem unë ty për diçka që e ke në plan të punës së kuvendit, ne këtu nuk jemi për të bërë pyetje ty i nderuari kryesues e as me marrë përgjigje nga ti, kuptoje që ju jeni kryesues i seancës, kuptoje që propozimet tona dhe propozimet për çdo njërin që vijnë nga ne dhe për të gjitha këto vendos kuvendi.
Ju si kryesues në foltore mund të dilni dhe të flisni në cilësinë e këshilltarit por nuk mund të na jepni përgjigje për gjërat që nuk janë në domenin e juaj, më bëri përshtypje rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, është e vërtetë se ka qenë në planin e punës, ai plan i punës e dini qysh ka ardhë e qysh ka kaluar edhe atëherë është bë shumë mirë që dikush me shumicë votash ka arritur që ta kaloj pa e ditur që mund të sjellë probleme siç po ne sjellë edhe sot.
Propozimin e kolegut z.Ragip Fetahu sa unë e kuptova ishte që sot të jetë pikë e rendit të ditës vendimmarrja për rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, me gjithë respektin drejtoresha e DA-së u lëshua në diçka që kemi propozime që nuk mund t'i inkorporojmë sepse nuk i lejon udhëzimi administrativ që ato propozime t'i integrojmë si pjesë integrale e asaj rregulloreje.
Drejtoreshë propozimet nuk e ndryshojnë udhëzimin administrativ, propozimet çka do që janë në kundërshtim me udhëzimin administrativ hedhen si të pa baza me një shpjegim që nuk i lejon udhëzimi administrativ, sa i përket propozimit të kryetarit që të fillojnë procedurat për shpalljen qytetar nderi z.Halil Kastrati, për kontributin e tij për mirëqenien e familjeve në nevojë edhe ky propozim ka mund të vijë në procedurë të rregullt por si do qoftë është diçka që s'kërkon material dhe procedurat mund të fillojnë dhe me këtë po e përmbylli.
Ne si grup i këshilltarëve të LDK-së i mbështesim dy propozimet edhe pse s'kisha dashur që kjo praktikë të vazhdojë sepse duhet të ndalet e mos të ngarkohet rendi i ditës pa materiale përcjellëse se edhe ashtu siç e përmendi kryesuesi se kemi pasur takime me agjendë të ngarkuar prandaj nuk na ndalon askush që brenda muajit të mbahen 2 ose 3 seanca dhe dihet kufiri ligjor qysh i kemi seancat dhe pagesat se as nuk shtohen e as nuk hiqen dhe nuk na ndalon askush mbajtjen e dy seancave brenda një muaji, plani i punës së kuvendit qysh prej ditës së parë ka mbet vetëm diçka në letër se nuk i është përmbajt asgjë askush askujt.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, të gjithë e dimë se çdo asamblist ka të drejtë të propozoj pika të rendit të ditës, është mirë të shkohet sipas procedurave të rregullores dhe të marrim qëndrimin e partive politike përmes shefave të grupeve të tyre dhe kështu ai propozim mund të kaloj ose jo si pikë e rendit të ditës.
Ne grupi i këshilltarëve të PDK-së, e përkrahim fillimin e procedurave për shpalljen qytetar nderi humanistin z.Halil Kastrati, kurse sa i përket këtyre dy pikave tjera ne nuk jemi kundër por kisha dashur të kemi material dhe të jemi më të përgatitur përndryshe propozimin e kryetarit e përkrahim kurse për këto dy propozimet tjera nuk kemi informacion.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, sa i përket propozimit tim që e ceku parafolësi im z.Naim Çunaku, për shpalljen e z.Halil Kastrati qytetar nderi të Komunës së Podujevës është e vërtetë se ky propozim ka mundur të kaloj përmes procedurës së rregullt mirëpo për këtë procedurë nuk ka ndonjë material të veçantë andaj besoj se mund t'i fillojmë procedurat për kompletimin e lëndës deri në mbajtjen e mbledhjes solemne për shpalljen z.Halil Kastrati qytetar nderi të Komunës së Podujevës.
Sa i përket Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, ju jeni dëshmitar që me të vërtetë në këtë drejtim kemi mbetur keq sepse kemi disa kryetar të fshatrave të cilëve bukur gjatë iu ka skaduar mandati dhe ata janë në një situatë jo të favorshme lidhur me punët të cilat duhet t'i përfundojnë dhe do të ishte shumë e rëndësishme që ky proces të përfundoj sa më shpejt, në vazhdën e kësaj problematike unë dje kam zhvilluar një takim me zyrtarët e MAPL-së, dhe në atë takim kemi ardhë deri te disa përfundime për të cilat mendoj se është mirë të na jepet pak kohë që së bashku me Drejtorinë e Administratës t'i inkorporojmë disa gjëra të cilat janë të nevojshme t'i ndryshojmë.
Po u jap vetëm një shembull se si janë përfshi në një këshill lokal fshatrat që kanë numër të madh të banorëve me fshatra tjerë e që mendoj se kjo është një praktikë jo e duhur sepse fshatrat Gllamnik, Obrançë, Peran, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, duhet me qenë fshatra që kanë një këshill lokal e faktikisht kjo është e pa mundur, se si ka ndodhur mos përfshirja e tyre në një këshill lokal unë nuk e di por kur ne kemi filluar ta përgatisim draft rregulloren për ta sjellë në kuvend kanë dalë disa gjëra që praktikisht janë të pa mundura të realizohen sepse është problem zgjedhja e një kryetari të këshillit lokal të fshatrave që kanë numër të madh të banorëve, gjatë bisedimeve me zyrtarët e MAPL-së kam paraqitur këtë problem dhe nga ana e tyre kam marrë disa instruksione se si duhet të veprohet prandaj besoj se në një mbledhje të radhës të kuvendit qoftë mbledhje e rregullt apo e jashtëzakonshme ne mund ta përgatisim materialin me gjitha propozimet, përmirësimet që mund të bëhen mirëpo gjithherë duke respektuar numrin e përcaktuar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të përcaktuar sipas rregullatives ligjore në fuqi.
Besoj se për seancën e radhës të gjithë mund të përgatitemi dhe t'i dërgojmë materialet me kohë në mënyrë që ta analizoni edhe ju dhe në fund të vini me sugjerime, në qoftë se sot ne e fusim këtë propozim si pikë të rendit të ditës kam frikë se nga MAPL-ja do të marrim vlerësim të ligjshmërisë me gabime pastaj do të duhet të kthehemi edhe njëherë mbrapa për përmirësimin e tyre prandaj unë mendoj se së pari ne duhet të pasqyrojmë një përfshirje sa më reale të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane pastaj ta procedojmë këtë draft rregullore në kuvend për mbledhjen e radhës, nëse kuvendi mendon ndryshe atëherë mund ta procedojë draft rregulloren aktuale por ta dini se për themelimin e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane sipas kësaj draft rregulloreje do të paraqiten vështirësi në funksionimin praktik të tyre.
Kohë më parë ne organizimin e fshatrave e kemi pasë në bashkësi lokale dhe të gjitha ato fshatra që kanë qenë në një bashkësi lokale kanë pasë një shtrirje gjeografike mes veti por jo si në këtë formë të organizimit të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, sipas kësaj draft rregulloreje ta marrim shembull kemi këshillin lokal të fshatit Dyz me disa fshatra tjerë që nuk kanë lidhje gjeografike mes veti atëherë praktikisht ky këshill lokal nuk funksionon prandaj për themelimin e çdo

këshilli lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane ne duhet domosdoshmërisht ta përfillim shtrirjen gjeografike dhe lidhjen e tyre mes vete në mënyrë që me qenë pragmatikë dhe të kapshëm për qytetarin dhe që mund të zgjidhin probleme, por nëse ju mendoni se duhet të kaloj kjo draft rregullore atëherë le të kaloj por unë mendoj se është një draft rregullore e pa përgatitur dhe pas votimit të saj në këtë kuvend do ta shohim se praktikisht zbatimi i saj në terren është i pa mundur, prandaj i nderuari i këshilltar z.Ragip Fetahu dhe ju asamble e nderuar është mirë që të na jepet edhe pak kohë që t'i bëjmë edhe disa ndryshime të vogla aty ku është e mundshme dhe ta kemi draft rregulloren e përgatitur për seancën e radhës, kurse sa i përket pikave të rendit të ditës sipas planit të punës së kuvendit ato nuk janë statike mund të lëvizin nga pak po thuajse po lëvizin pikat e rendit të ditës në të gjitha nivelet the thuajse është e pa mundur t'i harmonizosh gjitha nivelet me gjitha periudha kohore.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, me gjithë respektin për mendimin e kryetarit mendoj prapë se kjo pikë e rendit të ditës duhet të hyjë pa tjetër për shkak se kanë kaluar të gjitha fazat dhe kjo rregullore ka kaluar përmes ekzekutivit dhe të gjitha çështjet e inkorporuar janë përmes ekzekutivit dhe kanë ardhë te ne .
Mendoj se është mirë kjo pikë të hyjë në rend dite dhe të diskutohet për të gjitha ato çështje të cilat po i potencon edhe kryetari me ndryshime të mundshme të kalohet kjo rregullore e mos të humbim kohë në mënyrë që në muajin shtator të fillojmë me procedura tjera.
**z.Haki Rudari**, theksoi, duke u bazuar në rregulloren e punës së kuvendit të datës 29.04.2010, neni 35 paragrafi 1 thotë grupet e këshilltarëve, këshilltarët dhe përfaqësuesit e trupave punuese të kuvendit përkatësisht komiteteve dhe komisioneve e kanë të drejtën të propozojnë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës me arsyetim të shkurt të propozimit të paraqitur, pra e kanë të drejtën e propozimit me arsyetim, neni 36 paragrafi 2 thotë, kuvendi vendos veç e veç për çdo propozim për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës, pastaj në paragrafin 3 të nenit 36 thuhet së pari sipas radhës së paraqitur shqyrtohen propozimet që ndonjë çështje e propozuar të hiqet nga rendi i ditës.
Fillimisht me rregullore nëse ka propozim duhet të votohet që të largohet nga rendi i ditës ndonjë pikë pastaj vjen propozimi për shtim të pikave të rendit të ditës, neni 37 paragrafi 1 thotë për propozimet lidhur me ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës nuk hapet debat por pas arsyetimeve të shkurta të propozuesit dhe sqarimeve të kryesuesit të kuvendit, përfaqësuesit të ekzekutivit apo propozuesit të çështjes konkrete kalohet në votim, unë në parim i mbështes propozimet e kolegut z.Ragip Fetahu por në të njëjtën kohë unë do të ndalem te formimi i komisioneve, është e paraparë me ligjin për vetëqeverisje lokale madje e kam të përgatitur edhe nenin, janë të parapara edhe me rregullore dhe udhëzimin e ri administrativ formimi i këtyre komiteteve.
Realisht jemi vonuar si kuvend komunal për formimin e këtyre komiteteve, duhet ta pranojmë se ne jemi në fund të muajit qershor, në të njëjtën kohë sa i përket rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës duhet të ndalemi pak më shumë dhe nuk duhet të ngutemi për arsye se në rregulloren që ne kemi pasur më herët kanë qenë 3-4 fshatra me një përfaqësues që realisht dhe praktikisht është problematikë që të zbatohet prandaj në këtë rast unë propozoj që të thirren përfaqësuesit apo shefat e grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike që janë të përfaqësuara në kuvend në mënyrë që formimi i komiteteve të përhershme mos të neglizhohet por të kalon për miratim së paku të jetë i përgatitur për seancën e ardhshme, duhet të merremi vesh për numrin e komiteteve, pastaj duhet të merremi vesh për ndarjen e tyre në bazë të përfaqësimit dhe fuqisë politike, numrin e mbledhje brenda një viti e që numri maksimal është 6 dhe pagesa që rregullohet në bazë të rregullores dhe ligjit për financat.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, te formimi i komiteteve të përhershme apo konsultative si trupa ndihmëse të kuvendit është e vërtetë se ne jemi vonuar më tepër se 6 muaj dhe është e vërtetë e madhe se ato trupa ndihmëse të kuvendit në rend të parë kishin me hy në punë dhe do ta lehtësonin punën e kuvendit.

Unë qysh në fillim kur e kemi pasë projekt buxhetin e kam tërheqë vërejtjen nga ajo foltore që ne as me kod buxhetor të kuvendit nuk kemi parapa mjete për formimin e atyre komiteteve, sot nga ajo që e potencoj kolegu z.Haki Rudari si të nevojshme dhe procedurat e formimit të komiteteve është një udhëzim administrativ që taksativisht e parasheh qysh formohen ato komitete, sot do të kishim mundur të marrim vetëm një vendim për themelimin e tyre ndërsa shefat e grupeve dhe ato procedurat tjera si të arrijmë deri te një bashkëpunim te të gjithë anëtarët e kuvendit mund të diskutohen me grupe të këshilltarëve në një takim të radhës, por vendimi duhet të merret paraprakisht për themelimin e atyre komiteteve.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, është një udhëzim administrativ nr.05/2020, i miratuar në fund të vitit 2020, në këtë udhëzim administrativ përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve tjera dhe përcaktohet shumë qartë si të zgjidhen ato, aty ndër të tjera thuhet se një komitet tjetër duhet t'i ketë maksimumi 5 anëtar, duhet të zgjidhet kryesuesi i secilit komitet dhe të vazhdohet tutje, këtu nuk ka ndonjë arsye ligjore që kjo çështje të mbetet për seancat tjera.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, unë nuk po marrë kohë shumë vetëm 30 sekonda, u kam sjellë nga një dhuratë këtyre qeveritarëve tanë që ta mbajnë në kornizë nga një fotografi të bukur, këto janë fotografitë që i kam bë dje te shkollat e mesme të komunës sonë, pra vetëm nga një fotografi po ua japë për kujtim duke filluar nga kryetari me koseret që i ka pasë ble shumë të shtrenjta.
Gjendje e mjerueshme dhe e turpshme të shkosh e të hysh në oborret e shkollave të mesme "Aleksandër Xhuvani" dhe "Fan S. Noli", nuk po flas politikisht, por le të shkon kryetari vet le të bënë një ekip dhe le ta sheh atë gjendje, unë rastësisht kam shkuar dje veç me shëtitë dhe çka kam parë aty, ndoshta jam i gatshëm një javë të shkojë e të punoj aty, kushdo le të vijë, qoftë edhe kryetari, unë pas tij do të shkoj vetëm mos me pa atë gjendje, sepse po të vijë ndokush në komunën tonë, ndonjë mik i imi apo kushdo qoftë dhe ta shohë atë gjendje vërtetë është e turpshme, kryetari duhet t'i di këto gjëra sepse kjo është pronë e jona dhe është e turpshme nëse shkon ndokush dhe e sheh atë gjendje.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës,** duke i'u përgjigjur parafolësit e sugjeroj të mos e keqpërdor foltoren sepse është duke u diskutuar për rendin e ditës.
**z.Gazmend Islami**, vazhdoi duke i'i përgjigjur Kryetarit të Komunës, në rregull ti je në rend dite, mirëpo unë e kam fjalën për momentin.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, kërkoj nga Kryesuesi të respektohet rregullorja e punës së kuvendit, dhe në këtë rast t'i ndërpritet fjala.
**z.Gazmend Islami**, duke i'u drejtuar Kryetarit vazhdoi, askush nuk mund të më ndaloj fjalën mua, ama bash hiç, nga ti dhe drejtori përkatës është poshtërsia më e madhe që mund t'ia bëni kësaj komune, mirëpo nëse ti vazhdon me sjellje të tilla duke i marr këto si personale, është punë e juaja.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuari këshilltar z.Gazmend Islami nuk ke nevojë me keqpërdor foltoren se ne jemi duke diskutuar për rendin e ditës dhe për këtë është pika të ndryshme.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, i nderuari kryesues e ndal debatin rreth kësaj çështje dhe i hedh propozimet në votim dhe cili propozim të kalon le të kaloj s'ka debat këtu.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë nëse nuk dëshiron askush ta marr fjalën e vë në votim propozimin e z.Ragip Fetahu për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 15 vota PËR, 14 vota KUNDËR dhe 1 votë e PËRMBAJTUR, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.*

**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, edhe një sqarim kërkoj nga këshilltari z.Ragip Fetahu, sa i përket rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, i nderuari kryesues propozimin e parë që e hedhe në votim është formimi i komiteteve tjera që u votua dhe kaloj, propozimi i dytë ishte për rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës e cila nuk ka kaluar ende në votim, tani presim që të vihet në votim.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës ne nuk mund ta hedhim në votim se ende procedura administrative nuk kanë përfunduar.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, unë nuk insistoj që pa tjetër të votohet kjo rregullore, me hyrjen e këtij propozimi në rend dite drejtoresha e Drejtorisë së Administratës duhet ta sjellë materialin, rregulloren, rekomandimet dhe me kalimin e saj ne do të diskutojmë për ndryshimet për të cilat propozon edhe kryetari dhe të gjithë ne dhe nuk po hyjmë domosdoshmërish ne në votim.
**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, i nderuari asamblist z.Ragip Fetahu sa i përket plotësim ndryshimeve të mundshme në këtë draft rregullore ne ato sot nuk mund t'i votojmë sepse kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat administrative që i takojnë një rregulloreje, ka dalë në dëgjim publik, dëgjimi publik është ai i cili i bënë ndryshimet dhe i sjellë propozimet pastaj merret një vendim tjetër dhe sot këtu duhet me qenë i qartë se çfarë po kërkoni që të votohet, a po kërkon të votohet rregullorja në tërësi apo po kërkon vendim, s'ka vendim këtu, të gjitha procedurat janë të përfunduara vetëm rregullorja pritet të votohet me disa rekomandime që duhet të vijnë prej MAPL-së.
Fillimisht duhet të qartësohet ajo se çka po doni të votohet sot vendim të rregullores, rregullore, apo këshilla të fshatrave sepse janë procedurat për themelimin e këshillave të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane parandaj këto nmuk mund të themelohen pa formimin e komisioneve shtesë, kur të merret vendimi përfundimtar për rregulloren atëherë bëhen komisionet që dalin prej kësaj trupe dhe ai komision merret pastaj me formimin e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, prandaj nga ta kemi të qartë se çka po votojmë e mandej të dalim shumë serioz para qytetarëve për punën që është duke u bërë për këtë rregullore.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, mendoj se jam shumë i qartë, thjeshtë ajo rregullore që ka ardhë prej ekzekutivit të hyjë sot si pikë e rendit të ditës dhe të gjitha rekomandimet e bëra gjatë gjitha fazave të inkorporohen në të nga drejtoresha e DA-së, unë nuk e di pse nuk është procedura mër herët kjo rregullore nbë kuvbend për votimt.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, prapë i nderuari këshilltar z.Ragip Fetahu nuk e keni qartësuar këtë çështje, ne s'kemi për çka të diskutojmë, çka doni të vihet në votim konkretisht.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, po e formuloj fjalinë edhe njëherë propozimi im ishte që rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës të hyjë si pikë e rendit të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 14 vota PËR, 11 vota KUNDËR dhe 3 vota të PËRMBAJTUR, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht dokumenti dhe materiali tjetër shtesë sipas draftit të fundit që nga Kuvendi i Komunës më 29 prill 2021 është përkrahur për diskutim publik.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, e kemi edhe propozimin e Kryetarit që të përfshihet në kuadër të rendit të ditës shpallja e z.Halil Kastrati “Qytetar Nderi” i Komunës së Podujevës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 27 vota PËR, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështetet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës propozimi i Kryetarit të Komunës për shpalljen e z.Halil Kastrati “Qytetar Nderi” i Komunës së Podujevës.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, tani e vë në votim rendin e ditës që të miratohet në tërësi, sipas thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa nga e cila janë rekomanduar edhe dy pika shtesë, dhe atë;
- Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë.
- Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini”, nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP, duke përfshirë edhe dy pikat shtesë të mbështetura nga shumica e anëtarëve të kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës, dhe atë; Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.(varësisht propozimeve që do të përkrahen gjatë shqyrtimit të kësaj pike). Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 24 vota PËR, asnjë votë kundër, dhe 3 vota të PËRMBAJTURA, miratohet në tërësi rendi i ditës, sipas thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa nga e cila janë rekomanduar edhe dy pika shtesë, dhe atë;*
*- Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë.*
*- Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP.*
*Si dhe duke përfshirë edhe dy pikat shtesë të mbështetura nga shumica e anëtarëve të Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës, dhe atë;*
*-Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.(varësisht propozimeve që do të përkrahen gjatë shqyrtimit të kësaj pike).*
*-Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës,(dokumenti dhe materiali tjetër shtesë sipas draftit të fundit që nga Kuvendi i Komunës më 29 prill 2021 është përkrahur për diskutim publik).*

*Rendi i ditës i miratuar në tërësi, si në vijim:*
1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës
2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në hapësirën e SHFMU “Xheladin Rekaliu” në Podujevë
3. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik:
   - *Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës “Ushton Lumi” në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës*
   - *Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës “Trungu i Qarrit” (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm*
4. Formimi i Komisionit për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.
5. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë
6. Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP.

7. Vendim për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës
8. Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.
9. Draft Rregullorja për organizmin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës
10. Të Ndryshme

## 1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth KAB 2023/2025, theksoi, KAB 2023/2025, është dokument strategjik i Komunës së Podujevës që paraqet të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për tri vitet e ardhshme duke përmbushur objektivat dhe synimet zhvillimore të cilat Komuna e Podujevës i ka në dokumentet tjera strategjike, KAB është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave përmes qarkores së parë buxhetore për komunat, me KAB shpjegohen dhe paraqiten prioritetet afatmesme të Komunës së Podujevës si dhe planifikimet buxhetore për arritjen e këtyre objektivave.
Objektivat strategjike të Komunës së Podujevës që kanë për synim zhvillimin social dhe ekonomik të komunës sonë janë; zhvillimi ekonomik, ngritja e nivelit të arsimit, zhvillimi i shëndetësisë duke u ofruar shërbime cilësore për qytetarët, zhvillimi urban i qytetit me infrastrukturë moderne, zhvillimi i kulturës dhe sportit, përmirësimi i mjedisit ambiental, zhvillimi i bujqësisë, zhvillimi i turizmit etj.
Për arritjen e këtyre objektivave është e domosdoshme mbështetja buxhetore, bazuar në qarkoren buxhetore për komuna për vitet 2023-2025, Komuna e Podujevës i ka këto limite buxhetore për vitin 2023 buxheti me vlerë është 27,406,566.oo€, për vitin 2024, buxheti me vlerë është 29,130,259.oo€, dhe për vitin 2025, buxheti me vlerë është 30,293, 093.oo€, pra në bazë të këtyre limiteve buxheti për vitin 2023, do të jetë 4,000,000.oo€ më i lartë se buxheti i viti 2022, dhe buxheti i vitit 2025 do të jetë afër 7,000,000.oo€, më i lartë nëse e krahasojmë me buxhetin aktual të viti 2022.
Buxheti për vitin 2023, do të jetë në bazë të kësaj strukture të planifikuar për paga do të jenë 12,969,636.oo€, për mallra 3,088,899.oo€, për shërbime komunale 468,000.oo€, për subvencione 1,600,050.oo€, dhe për kapitale 9,279,981.oo€, nga kjo rritje buxhetore prej 4,000,000.oo€, që është në total kemi rritje në të gjitha kategoritë ku ta zëmë te investimet kapitale kemi një rritje prej afër 2,000,000.oo€, gjithashtu edhe në rritje të subvencioneve dhe të mallrave dhe shërbimeve.
Komuna e Podujevës dhe qeverisja e saj komunale për dallim nga periudhat e kaluara iu kanë jap prioritet lëtyre fushave; arsimit, ekonomisë, shëndetësisë, projekteve të mëdha zhvillimore të infrastrukturës urbane, bujqësisë, kulturës dhe sportit etj. Prioritetet e qeverisjes më së miri shpjegohen me krahasime numerike nga vlera buxhetore e ndarë për fusha të caktuara në krahasim me periudhat paraprake, në fushën e arsimit për investime kapitale në vitin 2023, është buxhet i planifikuar në vlerë 1,600,600.oo€ për dallim nga viti 2021 ku ishin të planifikuara vetëm 97,582.oo€, pra është një dallim prej 17 here që është buxhet më i madh për investime kapitale në fushën e arsimit, këto mjete do të jenë të mjaftueshme për renovimin e shkollave ekzistuese, ndërtimin e objekteve të reja shkollore, projektin e digjitalizimit të shkollave ku çdo klasë mësimore do të pajiset me tabelë të mençur digjitale.
Në kategorinë e mallrave në fushën e arsimit janë të planifikuara 1,077 067.oo€, ku për dallim nga viti 2021 ku ishin vetëm 570,246.oo€, pra thuajse kemi dyfishim të buxhetit në kategorinë e mallrave, mjete buxhetore këto që do të mundësojnë furnizim me material të nevojshëm për një zhvillim normal dhe modern të procesit mësimor, në kategorinë e subvencioneve kemi dyfishim të mjeteve buxhetore nga 50,000.oo€, në 100,000.oo€, pra kemi dyfishim të buxhetit për bursa.

Në fushën e shëndetësisë ka investime të projekteve të ndryshme siç është përfundimi i objektit QMF-III në bashkëfinancim me Chatar Charity, furnizim me pajisje mjekësore, inventarizim të objekteve mjekësore, renovim të objekteve shëndetësore, gjithashtu në kategorinë e subvencioneve te fusha e shëndetësisë kemi një rritje prej 2.14 herë nga 70,000.oo€ në 150,000.oo€.
Në fushën e ekonomisë janë planifikuar 450,000.oo€ për investime kapitale për dallim nga 140,566.oo€, të cilat ishin më herët pra kemi rritje 3.2 herë, ndërsa në kategorinë e subvencioneve në DPZHE janë të planifikuara 300,000.oo€, për dallim nga vitet e kaluara ku nuk ka pasë fare mjete të planifikuara në kategorinë e subvencioneve në këtë program mjete këto të cilat do të përdoren për mbështetje të biznesit prodhues përkatësisht në mbështetje të kreditimit të biznesit prodhues në subvencionimin e normave të interesit, si dhe 100,000.oo€ të planifikuara për start-up, pra për biznese të të rinjve të cilat kanë ide dhe plane për inkuadrim në biznes.
Në fushën e bujqësisë janë të planifikuara 700,000.oo€, për subvencione për dallim nga 460,000.oo€, të cilat ishin në vitet paraprake, në fushën e kulturës rinisë dhe sportit janë të planbifikuara 200,000.oo€, për dallim nga vitet parapraka ta zëmë vitin 2021 kur ishin të planifikuara 40,000.oo€, pra kemi 5 herë më shumë buxhet dhe subvencione për sport dhe kulturë, kjo analizë numerike tregon fushat dhe prioritetet të cilat i parasheh ky KAB, të cilat mendojmë se janë prioritete të qëlluara për arsim, shëndetësi, kulturë, ekonomi, bujqësi dhe projektet infrastrukturore që janë kryesisht projekte të mëdha zhvillimore të komunës sonë.
Në këtë KAB janë planifikuar edh projekte të mëdha të infrastrukturës të cilat i japin komunës sonë një dimension tjetër të zhvillimit si ndërtimi i Rr.”Skenderbeu”, që është vazhdim i projektit, ndërtimi i Rr.”Xhemajl Mustafa”, ndërtimi i rrugës përgjatë lumit Llap deri në magjistralen Podujevë-Prishtinë, ndërtimi i unazës së qytetit, ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve ku për tri vite janë të planifikuara 2,150,000.oo€, ku do të përfundon ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza ku më herët është bërë nga qeveria Austriake, me këto mjete buxhetore planifikohet që problematika e trajtimit të ujërave të zeza në komunën tonë t’i jepet një zgjidhje përfundimtare.
Në ndërtimin e trotuareve përgjatë këtyre tri viteve do të investohen 1,600,000.ooo€, ndërtimin e hapësirave të reja publike për këto tri vite janë të planifikuara 2,600,000.oo€, gjithashtu përgjatë këtyre tri viteve do të investohet në çdo lokalitet dhe fshat në infrastrukturë rrugore dhe investime të tjera të nevojshme, pra ka një shpërndarje të drejtë gjeografike të investimeve, të nderuar prioritetet të cilat janë të vendosura në KAB si ekonomia, arsimi, shëndetësia, projektet madhore infrastrukturore, kultura, sporti, bujqësia, e bëjnë këtë dokument strategjik garantues për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të komunës sonë, duke ju ftuar ta mbështetni këtë KAB, njëkohësisht i presim kritikat dhe sygjerimet në mënyrë që në procesin e hartimit të buxhetit nëse është e nevojshme t’i bëjmë ndryshimet e nevojshme dhe të kërkuara.
**z.Qëndrim Softolli**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, së pari kisha kërkuar që problemet që i keni brenda grupit t’i sqaroni në zyrat e partisë dhe jo të ushtrohet dhunë dhe presion për votim apo mos votim për një çështje të caktuar, kur e njohim që kryetari dhunën e ka goxha specialitet dhe në seancën e radhës e ftoj ta merr me veti edhe bishtin e sakicës.
Korniza afatmesme buxhetore është dokumenti bazë mbi të cilin bëhet parashikimi i buxhetit të komunës për 3 vitet e ardhshme dhe llogaritet një ndër dokumentet më të rëndësishme që procedon kuvendi i komunës, në KAB planifikohen objektivat zhvillimore për periudhën 3 vjeçare të cilat kanë për qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Podujevës.
Fatkeqësisht dokumenti i cili ndër vite kritikohej nga opozita e asaj kohe e që tani është në pushtet sot na ka ardhë në kuvend shumë herë më i dobët se atëherë, një dokument me një parashikim buxhetor tejet të centralizuar në vetëm disa drejtori ndërsa në shumë prej tyre nuk buxhet të ndarë në kategorinë mallra dhe shërbime, p.sh Zyra e Kryetarit, Kuvendi Komunal, DBF, DA, zjarrfikësit nuk kanë planifikim për mallra

dhe shërbime, ky kuvend me 35 asamblistë nuk e ka të planifikuar asnjë cent qoftë për trajnime apo aktivitete tjera, Zyra e Kryetarit me gjithë atë staf nuk ka të planifikuar buxhet, nëse në këto institucione duhet material harxhues duhet të shkojnë në DA, për të kërkuar inicimin e procedurave dhe mbulimin e shpenzimeve.
Kjo nuk e thjeshtëzon qeverisjen dhe aktivitetin por e komplikon dhe i jep mundësi për kamuflazhe e justifikime në raste të dështimeve siç ndodhi në vitin e kaluar ku zyrtari i gjendjes civile u detyrua ta blejë vetë tonerin, objektivat të cilat i keni paraqitur në këtë dokument qartë shihen që janë copy-paste, pasi që nuk paraqesin asgjë konkrete, nuk ndërlidhen me aktivitete përmes të cilave synohet të përmbushen ato, nëse e shihni qeverisja e proklamuar si e ndryshimit nuk ka asgjë dalluese nga ato të më parshme është më konfuze dhe më e cekët në planifikime.
Lidhja e arsimit me ekonominë është një prej objektivave që kemi këtu, a ka mundësi të na tregoni se çfarë strategjie keni me ndjekë ose konkretisht çka keni plan ju si ekzekutiv me bë që të arrihet kjo, te zhvillimi i kulturës rinisë dhe sportit nuk kemi asnjë strategji zhvillimore për kundër faktit kemi stagnim të buxhetit në tri vitet e ardhshme dhe të gjithë e dimë se sa është interesimi për të ikur jashtë vendit dhe qasja e qeverisjes së ndryshimit ndaj tyre është e pa ndryshueshme, a ka drejtoria e rinisë strategji për fuqizimin e rinisë, a janë funksionale dhe sa po mbështeten institucionet rinore, çka po ndodhë me qendrën e kulturës dhe qendrën rinore si po ndahen subvencionet, çka po ndodh në teatrin e qytetit tema këto që ishin shumë aktuale gjatë kohës kur LVV ishte në opozitë.
Zhvillimi i bujqësisë është paraqitur një prej objektivave, kurse te DBPZHR asnjë ndryshim nuk është bë në këtë drejtori kur e dimë se është sektori më i madh socio ekonomik në Llap dhe e dimë që kërkesat dhe nevojat e fermerëve po ndryshojnë nga viti në vit, a po bëhet një plan konkret për t'i mbështetur fermerët që çdo vit po pësojnë nga fatkeqësitë natyrore e ju nuk e keni paraparë asnjë cent buxhet për këtë kompensim të dëmeve.
Te zhvillimi ekonomik nuk kemi asnjë plan konkret dhe prapë për të ndahet një buxhet tejet i ulët, po bëhet përpjekje që përmes donatorëve të krijohet mbështetje por çfarë po ndërmerret në aspektin e mbështetjes së të rinjve me biznese plane në mënyrë që të stimulohen e të punojnë dhe të veprojnë në Podujevë, apo prapë do ta lëmë këtë çështje në mëshirën e donatorëve, te planifikimi i të hyrave kemi një planifikim prej 60,000.oo€, nga të hyrat nga Gjykata, ato i planifikon Ministria e Drejtësisë e jo komuna, ato mjete i kthehen komunës si të hyra indirekte sikur gjobat e trafikut ose agjencioni i pyjeve, me këto mund të dukeni mirë në letër por njerëzve duhet t'i tregohet realiteti.
Një pikë tjetër e cila merr vëmendje është kodi i shërbimeve kontraktuese afër gjysmë milioni për tre vitet e ardhshme, në secilën drejtori kemi ndarje të konsiderueshme buxhetore për këtë kod por nuk dimë se çka saktë përmban prandaj kisha kërkuar nga drejtori që për secilën drejtori të na tregoj se ku saktësisht do të shpenzohen këto mjete apo janë lënë të tilla për tu bërë rrush e kumbulla ku të kërkohet nga situata elektorale dhe partiake, si në modë i kemi aktualisht specialistët e fushave që janë specialista të partisë, te infrastruktura dhe shërbimet publike kemi një buxhet të parashikuar prej 2.3 milion euro, për vitin 2023, kurse të gjitha këto mjete janë të koncentruara në vetëm 11 projekte me emërtime të përgjithshme ku mundësia për manipulime me futje të projekteve është shumë e madhe.
Si është e mundur që specifikimi ka qenë një ndër arsyet kryesore pse nuk janë votuar tradicionalisht kornizat afatmesme buxhetore nga LVV-ja, përderisa drejtori i DSHPMSH-së, i qeverisjes së kaluar kishte paraqitur 41 projekte konkrete ndërsa drejtori aktual i po të njëjtës drejtori i ka përkufizuar me 11 sosh, do të thotë ndryshimi po ndodh ama për të keq apo ndoshta kërkesat e komunës janë vetëm në ato 11 projekte, te DKA-ja, kemi kodin blerje të mallrave në shumë prej 200,000.oo€, a keni mundësi të na tregoni saktë se çfarë mallrash keni planifikuar të blini me gjithë këto mjete apo për shkak të performancës së mirë në punësime pa konkurs dhe kontrollit të madh të shkollave deri te notimi i nxënësve këto mjete ia keni besuar t'ia bëjë drejtori i DKA-së, para se t'i investoni këto mjete ju lutem bëjeni një kontroll në

oborret e shkollave dhe shiheni mirëmbajtjen e tyre, shihni këndet e lojërave ku ditë më parë u futen mijëra euro e që janë të rrethuar me goma të skaduara, shiheni bazën ligjore kur dhe si lejohen të përdoren këto goma në të cilat tani çdo ditë lozin fëmijët tanë.
Krejt në fund te DKRS, kemi një buxhet prej 200,000.oo€, për terrene sportive, a ka mundësi ta dimë sa janë funksionale terrenet aktuale, cila është mirëmbajtja e tyre dhe ku jemi me ato që kanë mbetur në gjysmë, do ishte mirë që para se të fillojnë projektet e reja të bëhet një raport për këto ekzistueset, mbi të gjitha pretendimet se me qeverisjen tuaj do të kalojmë nga projektet e asfaltit dhe zhavorrit në projektet zhvillimore e bashkëkohore kjo bie poshtë sepse kjo kornizë bazën e ka kryesisht në projekte në asfalt e në kode të pa caktuara dhe nuk përmban asgjë dalluese në aspekt pozitiv, për më tepër ka shkuar mbrapa duke u bërë më e ngurtë dhe shumë më e centralizuar prandaj ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk e përkrahim këtë kornizë.
**znj.Adelinë Stublla**, në emër të grupit të LVV-së, theksoi, KAB për periudhën kohore 2023-2025, është dokument bazik në nivel të lartë strategjik të nivelit komunal që paraqet caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe për gjatë kësaj periudhe ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës në qytet, infrastrukturës në fshat, ngritja e nivelit të arsimit, zhvillimit të shëndetësisë duke krijuar kushte dhe shërbime cilësore për pacientët, zhvillimin e kulturës rinisë dhe sportit pra vit pas vitesh ka ngritje buxhetore për realizimin e projekteve për të mirën e qytetarëve, andaj ne i grup i këshilltarëve tëi LVV-së e përkrahim dhe e mbështesim këtë dokument të rëndësishëm.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, KAB për periudhën kohore 2023-2025, është dokumenti i cili i pasqyron të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe objektivat e qeverisjes komunale, është në linjë me qarkoren e Ministrisë së Financave, ne të gjithë e dimë se për vitin 2022, prioritet i është dhënë arsimit dhe shëndetësisë kurse për vitin 2023 prioritet përveç arsimit dhe shëndetësisë është edhe bujqësia, KAB është obligim ligjor që të miratohet nga kuvendi komunal dhe ne si grup i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim andaj i mbetet ekzekutivit të punoj drejtë dhe mirë.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, jemi sot këtu në mbledhjen në të cilën do të propozohet KAB që të gjithë u pajtuam se është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që miraton kuvendi komunal, unë nuk do të ndalem në detaje të kësaj kornize pasi që për disa detaje foli parafolësi im z.Qendrim Softolli e për disa të tjera keni pasë mundësi edhe vet t'i shikoni sepse analiza e numrave nuk kërkon ndonjë ekspertizë të madhe mirëpo do të ndalem në analizën e përgjithshme të kësaj kornize në atë se çfarë rëndësie dhe kuptimi ka, në defektet që ajo ka në realizueshmërinë e sajë dhe në mungesën dhe sugjerimet që ne do t'i japim, te rëndësia dhe kuptimi i KAB-it, e dimë se buxheti dhe kjo kornizë janë një projeksion janë një plan në të cilin parashihen të hyrat në njërën anë dhe në anën tjetër janë shpenzimet dhe investimet kapitale dhe si e tillë kjo kornizë duhet të ketë një harmonizim me objektivat, me synimet dhe me planin zhvillimor të komunës sonë, gjithashtu duhet të jetë specifikë e kësaj kornize dhe çdo kornize buxhetore se ajo duhet të hartohet nga ekspertë të fushës mirëpo duhet të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme për të gjithë qytetarët tanë dhe qytetarët për të cilët dedikohet ajo.
Korniza Afatmesme e Buxhetit është një orientim dhe një pasqyrim i asaj se kah do të shkoj komuna jonë dhe për këtë arsye është mjaftë e rëndësishme që ajo të jetë thjeshtë e qasshme e kuptueshme nga të gjithë qytetarët tanë, te defektet e KAB-it, unë do të ndalem te mos harmonizimi, mos specifikimi dhe mos detajizimi, te mos harmonizimi veç e thash më parë është një kornizë që duhet të mbështetet dhe të bazohet e të harmonizohet me synimin afatgjatë të komunës me misionin e saj me objektivat e saj dhe me planin zhvillimor të saj, te mos specifikimi disa nga pikat u përmenden nga parafolësi im z.Qendrim Softolli por edhe unë do t'i theksoi në parim si defekte të kësaj kornize që janë mos specifikimi i kodeve buxhetore të parapara në këtë kornizë siç janë asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik, te mos detajizimi kisha me u ndal te pika që u theksua më herët në disa kode të këtij KAB-i, kemi, shembull, gjysmë milioni që janë paraparë për shërbime kontraktuale e që duhet të jenë të detajizuara se

për çfarë qëllimesh dhe arsyesh do të dedikohen këto mjete që nuk janë në një vlerë të vogël që brenda një viti kalendarik janë parapaarë gjysmë milioni euro.
Sa i përket shërbimeve publike kemi 2.3 milion euro shpenzime dhe janë të grumbulluara të gjitha në 11 kode, ky është një mos specifikim, mos detajizim, që lë shumë për të dëshiruar dhe shumë për të diskutuar, te realizueshmëria, deri më tani janë realizuar vetëm 9% e të gjitha investimeve kapitale kur dihet se jemi në fund të 6 mujorit të parë dhe si praktikë nga e kaluara është që deri në 6 mujorin e parë zhvillohet pjesa më e madhe e aktiviteteve të punëve dhe kryhen afërsisht deri në 60% të projekteve apo të investimeve kapitale, po ashtu është e rëndësishme që të kemi edhe informata për qytetarët tanë se cilët tenderë janë realizuar deri më tani, cilët tender janë në OSHP dhe sa janë realizuar deri në 6 mujorin e parë të këtij viti, janë qytetarët ata që na kanë zgjedhë dhe duhet të jenë të informuar më detajisht për këto çështje të rëndësishme të komunës sonë.
Së fundmi pikë të cilën do ta diskutoj pa dashur të marrë kohë dhe të hyj në detaje janë mungesa të sugjerimeve, diçka që më ka ra në sy është uji i pijshëm që ka qenë një nga premtimet kryesore elektorale të partisë suaj dhe meqenëse nuk është në kompetencë direkt dhe duhet të merren parasysh mungesat e shumta të ujit në pjesët e qytetit dhe në shumicën e fshatrave, si pikë tjetër që është vrenjtur se ka mungesë të buxhetit në zyrën e kryetarit dhe zyrën e kuvendit komunal, si dhe shqetësim tjetër që do ta ngrisë është edhe subvencionimi i kompanive që ka qenë njëri nga premtimet elektorale dhe nuk kemi ndonjë pikë të veçantë nëse e zëmë subvencionimin e kompanive prodhuese apo kompanive të IT-ve, që janë kompani shumë me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë qoftë asaj komunale apo asaj në nivel vendi.
Si përfundim kisha kërkuar që dokumentet dhe planet e tilla që janë esenciale shumë të rëndësishme që tregojnë orientim zhvillimor se kah po shkon komuna jonë për vitet e ardhshme të merren me më seriozitet dhe më afër, më detajisht, më specifikisht për çdo kod që përmbajnë këto dokumente për arsye se kemi të bëjmë me paranë e taksa paguesve tanë dhe kemi të bëjmë me mirëqenien e tyre.
**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, si pjestare e komunitetit të të rinjve të cilët përbëjnë po thuajse gjysmën e popullsisë edhe adresimi im natyrish prek këto fusha. Një ndër objektet më të rëndësishme për organizimin e jetës rinore dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme është qendra rinore edhe pse ky projekt në vitin 2020, pritej vetëm të fillonte ishte caktuar lokacioni dhe ishte përzgjedhur projekti. Sot ne jemi në muajin qershor të vitit 2022, dhe nuk është bërë as edhe një hap të paktën publik drejt fillimi të këtij projekti. Ndërsa dihet që objekti ekzistues i qendrës rinore për momentin është në gjendje shumë të rëndë, janë paraparë investime në infrastrukturë sportive pa adresë. A do të shikohet funksionaliteti i objekteve sportive ekzistuese, nevojat e komunitetit apo meqenëse janë pa adresë do të shkojnë sipas qejfit dhe preferencave tuaja.
**z.Bahri Blakçori**, theksoi, KAB i prezantuar para nesh nga drejtori i DBF-së, mendoj se është një buxhet i planifikuar mirë dhe mbi të gjitha gjithëpërfshirës duke marrë për bazë nevojat specifike të qytetarëve, është transparent sepse ka të bëjë me lejimin e qasjes së publikut në të gjitha fazat e buxhetimit duke përfshirë fazën e planifikimit por edhe të realizimit të buxhetit të komunës, gjithashtu propozim buxheti në fjalë është hartuar në atë mënyrë që t'i mbuloj kërkesat dhe prioritete e përcaktuara me planin zhvillimor. Me këtë buxhet siç u potencua kemi rritje të konsiderueshme të investimeve në arsim dhe kuptohet sa më shumë investime për shkollat tona e aq më shumë krijohen mjedise të shëndetshme, tërheqëse dhe miqësore për një mësimdhënie dhe një mësimnxënie sa më cilësore dhe bashkohore, rritje të konsiderueshme të investimeve përveç arsimit kemi edhe në shëndetësi dhe bujqësi kategori këto të domosdoshme për një mirëqenie më të mirë për qytetarët tanë andaj edhe ne e përkrahim një propozim të tillë duke siguruar që me vëmendje do e përcjellim realizimin e projekteve me interes për qytetarët tanë.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, KAB është dokument i rëndësisë së veçantë për qytetarët dhe duhet të vijë nga qytetarët për fat të keq për kundër që për kohë relativisht të gjatë është trumbetuar nga LVV që po mbahen pak takime dhe po organizohet keq hartimi i KAB-it, sa ata ishin në opozitë kur tani janë në pushtet ndodh

e njëjta gjë, mos më keq, komuna më e madhe me territor në Republikën e Kosovës mban vetëm katër takime të lodhëta me qytetarët për KAB-in duke mos harruar premtimin publik të disa anëtarëve të kuvendit nga partia në pushtet që do të marrin pjesë në takime për hartimin e KAB-it, prapë s’ka lidhje e rëndësishme është me përfundu këtë obligim procedural, pjesëmarrja e qytetarëve ka rëndësi vetëm në zgjedhje e për konsistencë mos të flasim, vetëvendosja dhe konsistenca janë hidhëruar mes veti qe një kohë relativisht të gjatë.
Kur shfleton KAB-in dhe sheh objektivat e Komunës së Podujevës, njëra ndër to përmirësimi i infrastrukturës në qytet dhe fshatra të kujton kohen sa elergjik kanë qenë në asfalt e kanalizim, kisha dashur të dëgjoj edhe prej drejtorit të DSHMS-së, se si do ta përmbushë objektivin e rritjes së mirëqenies sociale në kohën kur ajo po cenohet më së shumti, përkrahja e bizneseve që të ulet papunësia është një tjetër objektiv që me siguri drejtori i DPZHE do ta arrijë pasi pikërisht për këtë besoj e ka ndryshuar dikasterin që e drejton dhe në fund thuhet se këto objektiva përputhen me ato të qeverisë së Kosovës, unë nuk besoj që ne duhet ta lejojmë t’i ndodh Podujevës ajo ça është duke i ndodh Kosovës, duhet përshëndetur projekti i DSHPMSH, për furnizim me drunjë dekorativ, mirëpo po ashtu konsideroj që është shumë e nevojshme të rritet shuma për largimin e deponive ilegale nga 40,000.oo€, sa parashihen tani.
Te investimet kapitale të DKA-së, është shumë e nevojshme para së gjithash të bëhet një studim fizibiliteti lidhur me ndërtimin e shkollave të reja, duke marrë para sysh nivelin e migrimit rrezikojmë që brenda pak viteve këto shkolla t’i kthejmë në muze, DPZHE ka të parapara 250,000.oo€ për ndërtimin e parkut industrial mirëpo sa kam informacion me një njoftim për kontratë të llojit të shërbimeve të datës 28.02.2022, komuna ka hapur tender për studimi e fizibilitetit të këtij parku të cilin pas një jave e ka anuluar me arsyetimin se nuk ka pasur të interesuar, dua ta di nga drejtori se deri ku ka shkuar ky proces sepse besoj që komuna ka hapësirë ku t’i orientoj këto mjete nëse për park nuk jemi gati, meqë korniza është dokumenti fillestar orientues dhe deri në miratimin e buxhetit ka hapësirë të mjaftueshme unë dhe LDK do t’i japim imputet tona që të inkorporojmë projektet e realizueshme dhe të arsyeshme financiarisht që lehtësojnë jetën e qytetarit dhe ndajnë buxhetin e përbashkët që kemi.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, një bujqësi e aftë për të siguruar në vazhdimësi ushqim dhe resurse të tjera për një popullsi gjithnjë në rritje është thelbësore për ekzistencën e njerëzimit dhe për çdo veprimtari humane por përmbushja e këtyre nevojave të sotme dhe të ardhshme po komprometohet gjithnjë e më shumë nga një sër praktikash dhe faktorësh si; intensifikimi bujqësor, punimi jo i përshtatshëm i tokës, përdorimi abuziv i lëndëve ushqyese, ndotja etj.
Ekzistojnë një sër praktikash që mund të aplikohen në bujqësinë e qëndrueshme dhe në sistemet e qëndrueshme të ushqimit siç janë, fermerët mund të përdorin metoda që mbrojnë shëndetin e tokës reduktojnë përdorimin e ujit dhe ulin nivelin e ndotjes në fermë, konsumatorët dhe tregtarët mund të përzgjedhin ushqime të prodhuara ndërmjet metodave që mbrojnë shëndetin që janë miqësore me mjedisin apo që fuqizojnë ekonominë lokale, kërkuesit shkencor në fushën e bujqësisë së qëndrueshme mund të kryqëzojnë linjat e tyre disiplinore duke ndërthurur biologjinë, ekonominë, inxhinierinë, kiminë, zhvillimin e komunitetit dhe shumë të tjera.
Aktualisht bujqësia përfshin pyjet qumështin, kultivimin e frutave, shpezëve, bletarinë, kërpudha etj, sot përpunimi i marketingut dhe shpërndarja e të mbjellave dhe produkteve blegtorale të gjitha njihen si pjesë e bujqësisë aktuale, kështu bujqësia mund të quhet prodhim, përpunim, promovim dhe shpërndarje e produkteve bujqësore, bujqësia luan një rol kritik në gjithë jetën e një ekonomie të caktuar, bujqësia është shtylla kurrizore e një sistemi ekonomik të një vendi të caktuar përveç sigurimit të ushqimit dhe lëndës së parë bujqësia gjithashtu ofron mundësi punësimi për një numër të popullsisë.
Fusha e Llapit shtrihet në dy anët e lumit Llap dhe ka një reliev të rrafshët me pjerrtësi të vogël në drejtim të lumit Llap dhe fushës së Kosovës pjesa më e madhe e saj është midis 500 deri 615 metra lartësi mbi

nivelin e detit, fusha e Llapit është një krahinë bujqësore në të cilën lavërtaria, blegtoria e më pak pylltaria përbëjnë veprimtaritë kryesore ekonomike të saj.
Qeverisja komunale e LVV-së duke e ditur rëndësinë që e ka bujqësia në përgjithësi për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, ka rritur buxhetin për 300,000.oo€, në vitin 2022, është realizuar projekti për ndarjen e nga një mëshqerre të racës simental për 108 fermer, këto kafshë të kuqe me të bardhë janë shumë të kërkuara për shkak të zhvillimit dhe rritjes së shpejtë të tyre, prodhim dhe cilësi të shkëlqyer të qumështit nga i cili prodhohet gjalpë dhe djathë i cilësisë së lartë si dhe sasisë së madhe të mishit me cilësi shumë të lartë.
Pritet të ndahen 50 sera me nga 96m$^2$ dhe 152 sera me nga 50m$^2$, moto kultivatorë me frezë shpërndarëse plehu, spërkatëse me kardan, kositëse bari, frezë dheu, mbledhëse bari lule dielli, makina mjelëse dhe lakto frizë, projektet në vazhdim që do të realizohen në këtë vit do të jenë ndarje e 1400 fidane të mjedrave për 40 fermer dhe nga 5 copë bletë për 140 kultivues të bletëve.
Në kornizën buxhetore për vitin 2023-2025, qeverisja komunale e udhëhequr nga LVV, i ka kushtuar një rëndësi të madhe zhvillimit të mëtutjeshëm të bujqësisë duke planifikuar që ta rrisë buxhetin për subvencionim të bujqve në këtë periudhë afatmesme ku për vitin 2023, është planifikuar të ndahen 700,000.ooo€, për vitin 2024 janë planifikuar të ndahen 7000,000.ooo€, kurse për vitin 2025 është planifikuar që të ndahen 8000,000.oo€, krahasuar me vitet paraprake për vitin 2023-2024, kemi rritje prej 300,000.oo€, për vit kurse për vitin 2025, kemi rritje prej 400,000.oo€ për vit.
Unë mendoj se në planifikimin e strategjive të ardhshme duhet të investohet më së shumti në kooperimin e bujqve në komunën tonë në mënyrë që të kemi një prodhim të qëndrueshëm të produkteve bujqësore e sidomos të prodhimit të grurit për të siguruar bukën për popullatën dhe mos të jemi të varur nga tregjet e huaja, sa është e rëndësishme t'i kushtohet kujdes si nga qeverisja lokale dhe ajo qendrore bujqësisë e kemi mësuar nga pasojat e pandemisë ku erdh deri te mbyllja e tërësishme e kufijve ndërmjet shteteve dhe bllokimi i importit dhe transportit të të gjitha produkteve, ende më shumë rëndësinë e bujqësisë dhe sigurimin e bukës e vuri në pah pushtimi i Ukrainës nga Rusia që ishte njëra ndër eksportueset më të mëdha të grurit në botë e që me bllokimin e porteve nga ku eksportohej gruri po vihet në pikëpyetje sigurimi i bukës për shumë vende të botës.
Në këtë pranverë në Kosovë në përgjithësi por edhe në Podujevë pati dëme shumë të mëdha nga fatkeqësitë natyrore konkretisht nga breshëri në produktet bujqësore, mendimi im për vitet në vazhdim është shumë e rëndësishme që në zonat e caktuara të subvencionohet sistemi kundër breshëritë, gjithashtu është e nevojshme të ngritën pendat dhe kanalet për ujitjen e tokave për një prodhim sa më cilësor dhe sasior të produkteve bujqësore për zhvillimin e ekonomisë bujqësore në vend por edhe në eksport.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, unë isha pjesë e dëgjimit publik në fshatin Lluzhan më datë 13.06.2022, pavarësisht për dallim nga viti 2022, për vitin 2023 është pa që janë të përfshira disa investime në rajonin e fshatit Lluzhan por unë kam një pyetje për drejtorinë DPUMM-së, z. Leutrim Krasniqi se ky sigurisht e din se ku gjendet fshati Sallabajë se është shumë afër, mua më intereson pse për vitin 2023, nuk është paraparë asnjë investim për fshatin Sallabajë sikurse ka ndodhur edhe në vitin 2022, pra për dy vite radhazi nuk kemi asnjë investim në këtë fshat.
Një pyetje po ashtu kam për drejtorin e DKA-së, se a është paraparë dhe kur do të bëhet ndërtimi i shkollës së re në fshatin Lluzhan pasi që e dimë se me zgjerimin e rrugës magjistrale Podujevë-Prishtinë, kjo rrugë do t'i afrohet shkollës aktuale dhe paraqet rrezik për nxënësit, deri sa të rregullohet shkolla e re a është paraparë të ndërtohet parketi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Lluzhanit që është në gjendje të mjerueshme, një pyetje për fund e kam edhe për drejtorin e DKRS-së, më intereson ta di se a është paraparë rregullimi i një fushe sportive për rajonin e Lluzhanit të paktën një i tillë si ai i fshatit Kërpimeh.

**z.Ardi Hasani,** theskoi, më lejoni që fjalimin tim të parë t'ia nis me një fakt shumë domethënës për qytetin tonë qeveria Kurti për vitin e ardhshëm për Komunën e Podujevës i ka nda hiç më pak se 4,000,000.oo€, më shumë se vitet e kaluara prej tyre 2,000,000.oo€ do të jenë buxhet për investime kapitale më shumë se sa vitet që po i lëmë pas.
Kjo rritje e buxhetit jep mundësi që dora e komunës dhe e shtetit përmes projekteve kapitale dhe zhvillimore të shtrihet në çdo cep të qytetit të Podujevës, si banor i Podujevës, si një i ri Llapjan më bën të ndihem mirë krahas faktit që rritja e buxhetit dhe investimeve në DKRS dërgon sinjal të qartë se si në nivelin lokal dhe atë qendror rinia është prioritet dhe se të rinjtë gjejnë mbështetje nga institucionet lokale dhe qendrore, ndërsa 689,000.oo€, do të jetë buxheti për vitin 2023, në DKRS, nga të cilat 200,000.oo€ do të jenë subvencione për t'i mbështetur të rinjtë e Podujevës për projektet dhe aktivitetet kulturore e sportive që aq shumë i kanë munguar qytetit tonë.
Fokus për rininë llapjane përveç nga ana e nivelit lokal vërehet edhe nga ai qendror, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit do të realizoj projekte të mëdha në Komunën e Podujevës të cilat do të ndikojnë dukshëm në shtimin e aktiviteteve të rinisë në komunën tonë siç janë ato ndërtimi i pishinës gjysmë olimpike, qendra rinore, ndërtimi i palestrës sportive, ndërtimi i fushave të hapura dhe të tjera do të jenë disa nga projektet e qeverisë Kurti dhe Bulliq që po realizohen në Komunën tonë, me qeverisje e LVV-së, si në nivelin lokal dhe atë qendror rinia do të jetë prioritet për të mbështetur e shtyllë për ta zhvilluar komunën dhe shtetin e Kosovës.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, po mendojnë opozita që ne shohim gjithë vetëm zi e nuk shohim edhe bardh por ne mendojmë se ka drejtori që janë duke shkëlqyer në këtë qeverisje. Duhet ta ceki se gjatë kohë së aplikimi për subvencione çka më ka ra në sy te DBPZHR, se ka një punë të stërngarkuar andaj mendoj se duhet të gjinden forma se si t'iu lehtësohet puna kur bëhet aplikimi për ndarje të subvencioneve sepse unë për dy javë rresht e kam përcjellë ardhjen e bujqve dhe fermerëve për aplikim dhe punëtorët që ishin aty është dashur që fermerët t'i ulin afër kompjuterit dhe t'i gjejnë parcelat e tyre e këtë punë shumë lehtë me dy monitor të mëdhenj mund t'ua lehtësojmë punën punëtorëve, prandaj unë e përgëzoj DBPZHR-së, për punën që është duke e bë, gjithashtu edhe te DSHMS, kam pa një impuls pozitiv që është për tu përshëndetur ka edhe anë pozitive nuk do të thotë se shohim gjithçka zi por atë që është e keqe duhet ta themi.
Unë kam lexuar për projekt buxhetin dhe kam pa se ka mungesë te DKRS-ja, kisha propozuar i nderuari drejtor që të paramendoni ndërtimin e së paku 10 fushave të vogla sportive që nuk kushtojnë më shumë se 20,000.oo€, gjitha kalkulimet që i kam bë ku me këtë rast mund të mblidhet rinia dhe t'i largojmë rinin thjeshtë nga kafe baret e shumta në mënyrë që atyre t'ju mundësojmë që të angazhohen në sport, një kalkulim i thjeshtë prej 200,000.oo€ nëse për 3 vite radhazi e bëjmë një ndarje, klasifikim, kam kontaktuar kompani që mund ta bëjnë këtë pra është diçka e mundshme që lejohet nga buxheti.
Sa i përket DHMS-së dhe DBPZHR-së mendoj se këtyre drejtorive duhet t'iu shtohet buxheti se kanë shumë punë dhe është mirë që pozita se këtu kur po i dëgjoj duke folur jo qeverisja qendrore jo lokale po ma humbin dispononim andaj thjeshtë njerëzit më të mirë që i kemi në këtë kuvend qofshin nga LVV-ja, PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, t'i japin mendimet e tyre dhe pozita është mirë që t'i merr mendimet e ekspertëve që vijnë nga opozita se qyteti është i joni.
Sa më shumë që punohet është në të mirën tonë pra të qytetarëve dhe nuk qëndron ajo se tani pozita duhet të ndihet superiore por duhet të marrë ekspert edhe nga LDK-ja, dhe t'i merr mendimet e tyre, e jo të vazhdohet me kryeneçësi, me idiotizëm, me nënçmim duke e fyer njëri tjetrin, mirëpo më herët nuk e pata asnjë qëllim politik ose një ndjenë ose diçka që desha ta fyej pozitën por unë u ndjeva keq për një punë që e pash të keqe, kështu që unë thash se jam i gatshëm të vij e të punoj një javë pa pagesë dhe s'ka kurrfarë problemi por qytetin tim e dua më shumë se Kryetarin Bulliqi dhe se të gjithë, atdheu im, Dumnica, Podujeva janë vendlindja ime dhe dua t'i shohë mirë prandaj drejtori i DBF-së duhet që çdo cent ta

kalkuloj dhe ta merr parasysh faktin që te sporti, bujqësia dhe shëndetësia dhe arsimi e sidomos te bujqësia të ketë më shumë buxhet se po shohim tani që patëm dëme nga vërshimet dhe nuk kemi asnjë fond që t'ju ndihmojmë bujqve.
Në fshatin Përpellac nuk ka rrymë, ka fermer që kanë filluar punën atje por nuk ka rrymë prandaj të gjendet një modalitet dhe t'ju mundësojmë fermerëve që të kenë rrymë në fshatin Përpellac.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pasi që këshilltari z.Gazmend Islami vjen prej fshatit Dumnicë dua t'ia them një thënie të një bashkë vendasi të tij të z.Sali Hoxha, që patë thënë se ne shqiptarët nuk duhet të nisemi nga ai parimi të munda më munde por të ndihmova më ndihmove edhe nga ju nuk kisha dashur çdo herë të dëgjojë fjalë se të munda e më munde se nuk jemi këtu veç të shtyhemi e ta mundim njëri tjetrin.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, po filloj fjalimin tim me një kërkesë direkte që për faktin e keq nuk e gjeta askund në këtë dokument andaj kërkoj që në këtë kornizë investimi me vlerë 100,000.oo€, në stadiumin "Zahir Pajaziti", për klubin e Llapit për sukseset e tij që na ka bërë krenar të gjithëve të bëhet investimi në stadium. Po ashtu sportistë Llapjan sot po transferohen në liga të Evropës andaj kjo skuadër meriton që komuna të investoj në stadiumin e tyre për t'i përmirësuar kushtet, për të vazhduar në këtë fushë po i'a potencoj drejtorit të DKRS-së z.Pajtim Balaj, se ka 3 vite që në kuvend është marrë vendim për vendosjen e shtatores së legjendës së futbollit "Fadil Vokrri", dhe nuk e di ku ka mbete puna pse nuk është vendosur shtatorja dhe një gjë të tillë a e kanë paraparë ose jo, këto ishin kërkesat e mia për drejtorin e DKRS-së z.Pajtim Balaj ndoshta e marrë përgjigjen.
**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, po e nisi prej pyetje të fundit që i bërë këshilltari z.Ekrem Rrahmani, para vetës kam kërkesën që e kam bërë dy ditë më parë drejtuar Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, kërkesë të cilës ia kam bashkangjitur edhe vendimin e datë 09.09.2020, kur kuvendi voton për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtatores së "Fadil Vokrri", në kërkesën që ne e kemi dorëzuar ne marrim përsipër mbulimin e bazamentit të shtatores për shkak se shtatorja ka kosto më të lartë dhe Ministria i ka mundësitë më të mëdha buxhetore, unë besoj, shpresoj, që shumë shpejt do ta kryejmë këtë punë dhe parku i qytetit në lokacionin ku është votuar do ta ketë shtatoren e legjendës së futbollit "Fadil Vokrri", për punën e stadiumit po ashtu kam përgatitur një kërkesë drejtuar Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që të financohen mbulojat e stadiumit mirëpo jemi në një fazë ku po diskutojmë me KF Llapi sepse së pari duhet të jetë projekti për mbulojën pastaj së bashku me projektin besoj se do ta dërgojmë edhe kërkesën të gjitha këto janë në proces.
Sa i përket fushave të vogla dhe terreneve të ndryshme sportive këtë vit nuk kemi mundur të bëjmë ndonjë investim për shkak se kemi implikime buxhetore prej projekteve paraprake, kompania që ka qenë e kontraktuar vitet e kaluara për ndërtimin e fushave të vogla sportive një ndër to ka qenë për fshatin Sibofc, besoj se kolegu z.Ekrem Rrahmani ka mundur të shkoj e ta shikoj se në çfarë gjendje kanë mbet punimet aty, është ndërprerë kontrata vitin e kaluar dhe e kemi hapur tenderin sivjet për kryerjen e pjesës së mbetur të punëve mirëpo ka dështuar ritenderimi i parë, zyra e prokurimit është në procedurë të ritenderimit për kryerjen e pjesëve të mbetura të punëve që këto fusha sportive në fshatin Sibofc dhe Gllamnik si dhe në lokalitetet tjera të kryhen sa më shpejt.
Sa i përket qendrës rinore jo qendër rinore por qendër multifunksionale, ditëve në vijim do të nënshkruajmë memorandumin për bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, memorandum i cili përafërsisht ka vlerën e 1,000,000.oo€.
**z.Xhevdet Maloku,** theksoi, i nderuar drejtor po më duket se ke harruar, fjalën e kam për KAB për vitet e ardhshme.
**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i DKRS, theksoi, i nderuar këshilltar z. Xhevdet Maloku pak a shumë e more përgjigjen, nuk kemi mundësi buxhetore për shkak se duhet t'i kryejmë punët që kanë mbetur gjysmë të gjitha ato fusha sportive që kanë mbetur në gjysmë pa u funksionalizuar në fshatra duhet të përfundojnë sivjet, buxheti i vitit të kaluar ka shkuar në suficid, buxhetin që e kemi sivjet nuk mund të iniciojmë

projekte të reja për shkak se është duke u ndërtuar edhe fusha në fshatin Peran mirëpo për vitin tjetër besoj që banorët, komuniteti duhet ta kryejnë pjesën e tyre ta paraqesin kërkesën pastaj besoj se ne kemi buxhet dhe mundësi të zhvillojmë diçka.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kam një plotësim të pyetjes për drejtorin e DBF-së se po kemi problem kur po e lexojmë KAB-in, se nuk ka emërtime të rrugëve p.sh, shkruan se do të asfaltohen disa rrugë në fshatrat Gllamnik dhe Sibofc, të gjitha ato rrugë janë të emërtuara pse nuk i cekni me emra projektet e rrugëve që do të asfaltohen, sa herë të kaloj andej më ndalin qytetarët dhe më pyesin se cilat rrugë do të asfaltohen dhe nuk e di se cilat rrugë janë ato andaj pyetja ime pse nuk e specifikon emrin e rrugëve që do të asfaltohen dhe gjatësinë e tyre në mënyrë që ta dimë se cilat rrugë do të asfaltohen, sepse mund të jenë dy apo dhjetë rrugë që do të asfaltohen e ne nuk e dimë, këto kisha pasë qejf të jenë më të detajuara dhe ta dimë rregullimin e rrugëve sipas emërtimeve të tyre.
**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, kam pas një pyetje për kryetarin por pasi që kryetari nuk është prezent këtu prapë të njëjtën pyetje po e bëj, janë nda mjetet për krerë lopësh dhe këtu e kam pa një gabim apo vërejtje por pikë së pari ju përgëzoj për iniciativën për subvencionimin me krerë lopësh për fermerët Llapjan.
Kam disa pyetje njëkohësisht dhe disa vërejtje konkrete lidhur me subvencionet për krerë lope, fakt është se keni shpërnda 108 lopë dhe dhe çdo fermer është dashur të participoj me 570€ për krerë lope e kjo i bie të jetë një vlerë goxha e madhe, pyetjet e mia janë këto çfarë race janë lopët, çfarë moshe kanë, çfarë destinimi kanë a janë për qumësht apo për mish, cila është mosha më e përshtatshme për fermerin, a janë bartëse, nëse po në cilën fazë të bartësisë janë, a janë lopët e shëndosha, unë besoj se ju nuk mundeni me ju përgjigj këtyre pyetjeve asnjëherë sepse ju as vet nuk jeni profesionistëtë fushës dhe të komisionit vlerësues, sepse edhe në komisionin vlerësues nuk e keni caktuar profesionistin që duhet, kjo i bie që ju keni blerë lopë pa e njohtë racën, moshën, destinacionin dhe pa e ditur gjendjen e tyre shëndetësore dhe fazën e bartësisë së tyre.
Fermeri Llapjan ka participuar në vlerë prej 570€, pa pedigere ju mund të thoni që lopët janë me dokumentacion përcjellës por kush është ai që mund të përcakton se a mund të përputhen të dhënat me kafshën, kjo përcaktohet vetëm nga ekspertët e fushës përkatëse veterinare në këtë rast nga mjeku veterinar, ndërsa ju në komisionin për blerje dhe vlerësim keni caktuar personat që janë jo kompetent për këtë domen, kjo besoj se është shkelje dhe totalisht e pa pranueshme, pyetja ime kryesore është pse në komisionin vlerësues nuk ka pasur veterinar apo ndoshta nuk keni menduar të bëni pazare siç keni dashur, shpresoj që mos të përsëriten më këto veprime.
**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, nëse dikush nga ju ka diçka për të diskutuar rreth rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë mos të dalim jashtë pikave të rendit të ditës.
**z.Fatmir Rudari**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, unë do t'i përgjigjem këshilltarit z.Demokrat Hodolli, nuk mundesh me ble diçka apo të kontraktosh diçka nëse nuk i ke specifikat, të gjitha ato që i ceke janë specifika, po më duket pak e pa arsyeshme me i cekë të gjitha këto me moshë e të gjitha po të gjitha ato mëshqerra janë me dokumentacion me pedigre, raca është simental, është e përzier e dedikuar për qumësht dhe për rritjen e viçave.
Specifikat tjera të gjitha mund të vish e ti shikosh në dokumentacion sepse secilit fermer i jepet një kontratë i jepet dokumentacioni i mëshqerrës dhe të gjitha ato janë cek në specifika kur janë kërkuar sa për çmim është e vërtetë se ndoshta çmimi është pak i lartë, ka qenë vetëm një ofertues dhe ai ka qenë përfitues i atyre mëshqerrave por duke u bazuar edhe në çmimin aktual që është në treg do të thotë se është në përputhje me çmimin aktual që është në treg.
**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, a ka mundësi të na tregoni emrat se cilët kanë qenë ata ekspert që i kanë jap këto të dhëna, kush ka qenë ekspert se ju mund të thoni se ka dokumentacion por ekspert nuk ke.

**z.Fatmir Rudari**, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, i nderuar z.Demokrat Hodolli ata që ta kanë shkruar fjalimin duhet t'i pyesësh më mirë ti, ekspert i ka drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjithë zyrtarët sepse të gjithë e kanë të përfunduar fakultetin e bujqësisë, çka duhet me pas më shumë për ekspert adekuatë kur i gjithë stafi i drejtorisë është me fakultet përkatës e këtë staf unë e kam gjet aty dhe është staf i rekrutuar, ata kanë qenë në komision dhe vetëm i përputhim specifikat të cilat i kanë kërkuar dhe specifikat të cilat kanë ardhë dhe s'ke çka të diskutosh më tepër, këtë punë mund ta bëj secili por edhe ti mund ta bësh.
**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, vitin e kaluar kur janë ndarë mështqerrat prej tyre kanë qëlluar dy lopë të sëmura.
**Kryesuesi i Kuvendit,** theksoi, kërkoj nga parafolësi të mos zgjatet më shum ky debat.
**z.Haki Rudari**, theksoi, korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Podujevës është një dokument i nivelit të lartë strategjik në bazë të cilit janë synimet apo caqet e zhvillimit të përgjithshëm si dhe shpenzimeve qoftë nga të hyrat vetanake ose nëse e marrim në përgjithësi paraqet një dokument përmes të cilit komuna e ka afatin apo kohën e zhvillimit brenda tri viteve, në kuadër të kësaj kornize kemi edhe objektivat të cilat po i lexoj si në vijim; përmirësimi i infrastrukturës së qytetit, përmirësimi i infrastrukturës në fshatra, krijimin e një qyteti të zhvilluar me planin urbanistik, ngritje të nivelit të arsimit duke krijuar kushte të mira për zhvillimin e arsimit dhe duke e lidhur me ekonominë, zhvillim i shëndetësisë duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët, rritja e mirëqenies sociale, zhvillimi i kulturës rinisë dhe sportit, përkrahja e bizneseve në mënyrë që të ulet papunësia, zhvillimi i turizmit, zhvillimi i bujqësisë etj.
Të gjitha këto që unë i citova janë në KAB dhe mbi të gjitha në bazë të KAB-it, kemi edhe këto; shtim i efikasitetit, rritje e të hyrave vetanake, kontroll reduktim i shpenzimeve, ngritje të kapaciteteve njerëzore dhe sigurim i disiplinës financiare që është një element shumë i rëndësishëm për ata të cilët e kanë lexuar materialin e që shpresoj të jenë shumë e nuk e di sa janë, e kemi një rritje të grandit të përgjithshme nga vitin 2022 prej 9,160,666.oo€, për vitin 2023, kemi rritje prej 12,119,450.oo€, për të kaluar në vitin 2024 që kemi rritje 13,000,657.oo€, dhe për të arritur në vitin 2025 që kemi rritje 13,000,862.67€, marrë pra në përgjithësi kemi më shumë se 4,000,000.oo€ investime e mendoj se nuk është mirë të anashkalohen.
Sa i përket të hyrave nëpër dikasteret dhe kodet tjera unë kam një propozim për buxhet të zyrës së kuvendit komunal se është e vërtetë që për kategorinë mallra dhe shërbime nuk ka mjete të ndara, jemi 35 anërtar/e të kuvendit dhe duhet ta kemi një buxhet andaj unë propozoj një shumë së paku prej 5,000.oo€, sepse mund të ketë vizita të delegacioneve nëpër komuna apo shtete tjera të ndryshme dhe është mirë që këtu të fokusohet kjo çështje dhe ta kemi një kod buxhetor në shumë prej 5,000.oo€.
Një çështje nëse e analizojmë më tutje kemi disa kode të specifikuara kisha dashur të them vetëm një gjë sa i përket investimeve në terren këtë e kam thënë edhe kur ka qenë në pushtet LDK-ja, po e them edhe tash që të bëhet shpërndarje e investimeve pra mos të bëhet koncentrim të investimeve apo grumbullim të investimeve por të kemi shtrirje dhe investime nëpër lokalitete të ndryshme për arsye sepse këtë buxhet nuk e mirëmbajnë vetëm ato komuna apo ato fshatra që ka investime por për këtë buxhet kontribuojnë edhe banorët e lagjeve dhe fshatrave të tjerë prandaj është mirë që këtë ta ketë para sysh edhe ekzekutivi, marrë në përgjithësi kemi një KAB që në fund është në interes të qytetarëve.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, para se të shkojmë në pauzë desha t'i marr dy përgjigjet e pyetje të mia nga drejtori i DPUMMS-së dhe nga ai i DKA-së, nëse ka mundësi para pauzës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, do ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës pastaj do të vazhdojmë me pauzë dhe do të rikthehemi pas pauzës me vazhdimin e pikave të rendit të ditës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, pa dashur t'i përsërisë të gjitha ato që u folën për KAB-in dhe rëndësinë e këtij dokumenti strategjik që përcakton vijat e zhvillimit të komunës për tri vitet e ardhshme, unë do t'i qasem këtij dokumenti nga një anë tjetër dhe do t'i flas disa fjalë rreth përgatitjes së këtij KAB-i, kornizë kjo

cilat faza do të duhej t'i kalonte deri në momentin kur do të vinte në kuvend për aprovim dhe të finalizohej si një dokument zhvillimor siç e përcaktojnë demokracitë në nivel të lartë zhvillimor e në vendin tonë e kemi një udhëzim administrativ nr.02/2018 të MAPL-së që përcakton standardet minimale të një konsultimi publik siç e kemi kornizën afatmesme buxhetore.
Ky udhëzim administrativ ka për qëllim nxitjen dhe sigurinë nga ana e autoriteteve lokale, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve tjera të interesuara gjatë procesit të politikë bërjes dhe vendim marrjes në nivel lokal të promovoj transparencë komunale si dhe të ndikoj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme në interes të përgjithshëm, pse e thash këtë se e dimë fazën nëpër të cilën kemi kaluar ne por sa jemi të kënaqur me diskutimet publike që i kemi bërë kolegu nga rajoni ku vijë unë z. Xhevdet Maloku e që të dytë ishim prezent në takimin me qytetarë që u organizua në fshatin Lluzhan dhe në një komunë me territorin më të madh në nivel vendi të paraqiten vetëm 4 diskutime publike për KAB-in, është nën nivelin e përcaktimit të minimumit që e përcakton udhëzimi administrativ ose interesin për ta sjellë qytetarin në vendimmarrje gjegjësisht ta dëgjojmë atë nga taksat e të cilit ne funksionojmë.
Diçka tjetër që më bëri përshtypje e që e kam dëgjuar vazhdimisht si refren, se di a është prezent drejtori i DBF-së këtu ndoshta është mirë me pritë deri sa ai të vijë këtu se për atë po flasë se ai është zyrtari kryesor, komuna është e obliguar të shpallë rezultatet e procesit të konsultimit publik raportin si dhe sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave që janë bërë në dëgjimet publike, refrenin për të cilin s'desha të flasë para se të vijë drejtori i DBF-së e që e dëgjova edhe prej një kolegu këtu, ky propozim buxhet është më i madh në vlerë nominale 4,000,000.oo€ dhe e dëgjova me vëmendje kolegun kur i paraqiti ato objektiva që i parasheh korniza afatmesme buxhetore që të gjithë i kemi pa se janë menjëherë pas preambulës dhe s'ka si mos ta tërheq vëmendjen ngritja e mirëqenies qytetare.
Është e vërtetë e madhe se pa fajin e askujt se s'dua ta adresoj fajin askund por gjendja e krijuar pandemike në Kosovë pastaj gjendja e konflikteve në arenën ndërkombëtare ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen rapide të çmimeve në shportën minimale ka bërë që është për të dëshiruar për të folur për mirëqenie mos të them që kemi ardhë në një situatë që të luftojmë për një status kohë për uljen e mirëqenies sociale se për ngritje të saj nuk janë kushtet njëherë, u përmend nga disa koleg këtu çështja e rinisë se më ka rastisë të dëgjoj dhe më ka dhimbtë që sukses i të rinjve tanë sot është se kush po përgatit dokumente gjegjësisht po përgatit një vizë për të migruar jashtë po të ishte kjo gjendje vetëm në komunën tonë do të ishte situatë e lehtë por kjo është gjendje e rënduar në nivel vendi, për mos me zgjatë më tepër po i citoj vetëm dy nene të udhëzimit administrativ që vlejnë për kryesuesin, neni 20 i këtij udhëzimi administrativ thotë kështu; mbikëqyrjen e procesit të konsultimit publik pika 1 kryetari i komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara në kuvend kanë përmbushur standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
Kuvendi që u dëgjua në fillim të seancës nga kolegu im z.Qendrim Softolli, e që paraqiti qëndrimin e grupit të këshilltarëve të LDK-së se nuk mund ta votoj këtë dokument me arsyetimin se kuvendi duhet të refuzojë projekt propozimin në rast kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik të përcaktuara me udhëzim administrativ dhe kjo na bënë që mos e përkrahim këtë kornizë afatmesme buxhetore, krejt në fund i nderuari kryesues nga ato që i kam dëgjuar bashkë me kolegun z.Xhevdet Maloku në takimin e KAB-t, në fshatin Lluzhan, më ka bërë përshtypje diskutimi i një qytetari që është interesuar për një projekt të tij dhe ndihem moralisht i obliguar që atë kërkesë të tij ta potencoj edhe këtu e këtë propozim u mundova ta gjejë në KAB por atë nuk e pashë as në vitin 2022- 2023 dhe as për vitin 2025, prezent kanë qenë drejtori i DPUMM-së dhe ai DBF-së dhe sigurisht këtyre ju kujtohet kur qytetari Zeçir Retkoceri e përmendi rrugën "Baza e Kështjellës", në gjatësi 2.2km dhe unë nuk mund të flas me përgjegjësi se atë rrugë nuk e kam frekuentuar andaj po i përsërisë fjalët e tij se nuk e di gjendjen faktike. Ai thotë se 17 shtëpi nuk kemi mundësi me lëvizë madje shkon aq larg e thotë se kur të dal deri te

autobusi më duhet t'i fus këpucët në qese ose t'i pastroj, kjo rrugë ishte me gjatësi 2.2km dhe të paktën kërkesë e tij ishte që kjo rrugë të shtrohej qoftë me zhavorr por këtë kërkesë nuk e pashë askund.
Mendoj se për këtë rast kisha dashur një shpjegim prej dy drejtorëve që e kanë dëgjuar këtë kërkesë dhe ai arsyetimi që e keni dhënë në diskutim publik se ne kemi të parapara mjete buxhetore për asfaltimin e rrugëve në gjatësi prej 50-200 e jo në gjatësi prej 2 km është arsyetim shqetësues për mua dhe atë shqetësim të tij po e ngrisë këtu, andaj dua një përgjigje se çka do të veprohet për atë rrugë, cila është gjendja e asaj rruge dhe kur parashihet rregullimi i sajë dhe pse nuk është paraparë rregullimi i sajë për tri vitet e ardhshme.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, theksoi, duke ju falënderuar për diskutimet për vërejtjet për sugjerimet më lejoni që të paraqes një rezyme të shkurtër të këtyre diskutimeve të cilat u bënë, korniza afatmeme buxhetore u cek nga të gjithë dhe nga unë që është një dokument strategjik ku përshkruhen objektivat dhe synimet të cilat i ka komuna e Podujevës përgjatë këtyre tri viteve, normalisht se këto synime dhe këto objektiva janë për brenda disa limiteve buxhetore të cilat i përcakton Ministria e Financave përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ka një rritje të dukshme të buxhetit prej afër 4,000,000.oo€, për vitin 2023, dhe vazhdon një rritje progresive dhe në qoftë se pastaj e krahasojmë vitin 2022 me vitin 2025, shkojmë te një rritje afër 7,000,000.oo€.
Në këtë qarkoren e parë buxhetore nuk përcaktohen limitet e kategorive mirëpo komuna kur e ndërton kornizën afatmesme buxhetore limitet të cilat i përcakton janë edhe kërkesë për Ministrinë e Financave që të aprovohen ato limite të kategorive ekonomike për këtë kornizë buxhetore, normalisht kategoria e pagave është e kalkuluar më saktë, dihet se si kalkulohet pastaj edhe kategoria e mallrave, subvencioneve, komunalive dhe investimeve kapitale dhe e mira është se për secilën kategori ka rritje të buxhetit, për investime kapitale kemi rritje afërsisht prej 2,000,000.oo€, krahasuar me vitin 2022, për subvencione prej 900,600.oo€, kemi rritje në 1,650,000.oo€ gjithashtu kemi edhe një rritje në kategorinë e mallrave për arsye se shumë sektor kanë nevoja më të shtuara në kategorinë e mallrave siç është arsimi sepse ka një numër të madh të nxënësve në institucionet arsimore dhe për të gjitha këto problematika normalisht që nevojitet buxhet, gjithashtu edhe në DSHPMSH dhe në DSHMS, mirëpo në mënyrën më të theksuar buxheti është rritur te investimet kapitale dhe te subvencionet.
Është në përgjegjësinë e qeverisjes që t'i përcaktoj prioritetet andaj arsyeja pse jemi këtu është që t'i përcaktojmë prioritetet se gjithmonë mundësitë janë shumë më të vogla se sa nevojat dhe kjo qeverisje në këtë KAB i ka përcaktuar disa prioritete që prioritet është arsimi, ekonomia, kultura, bujqësia, dhe përparësi kanë disa projekte infrastrukturore që janë projekte të mëdha dhe që janë projekte zhvillimore dhe ka një përqendrim më të vogël për projektet që janë më të vogla por normalisht pa i lënë anash as ato se kjo kornizë ka një gjithë përfshirje ashtu siç e cekëm më lartë ku në çdo fshat parashihen investime minimalisht në dy vite në qoftë se ndonjë fshat ka investime në vitin 2023 patjetër do të ketë investime edhe në vitin 2025, të pakta janë ato lokalitete që kanë investime në tri vite për arsye të kufizimeve buxhetore e jo për shkak të vullnetit tonë, ne e kemi për nder me pas prioritet dhe kemi synim se e kemi thënë edhe në premtimet tona edhe në këtë kornizë buxhetore arsimin dhe është shumë e thjeshtë me ditë se sa e kemi prioritet çështjen e arsimit.
Buxheti i Komunës së Podujevës ka një rritje prej 17%, por investimet kapitale në fushën e arsimit janë rritur 17 herë më shumë në rast se i krahasojmë me vitin 2021, kanë qenë 97,582.oo€, janë të planifikuar për vitin 2023, 1,660,000.oo€, pra kemi rritje të buxhetit prej 17%, kjo rritje e buxhetit është për ndërtim dhe renovim të objekteve të institucioneve arsimore dhe një projekt që e kemi synim dhe e kemi të buxhetuar që është digjitalizimi i institucioneve arsimore do të thotë me këtë buxhet që ka qenë në shumë 97,582.oo€, kanë kundërmuar shkollat kurse me këtë buxhet që është do të shkojmë te shkollat e digjitalizuara, bëhet fjalë për një ndryshim radikal për një synim që besoj se çka të flitet rreth çështjes së arsimit pa fol për çështjen e arsimit minimumi mund të them është injorancë.

Te shëndetësia nuk po i ceki të gjitha projektet me emra por me mjetet buxhetore kemi një buxhet gjithëpërfshirës ku sigurohen mjete të mjaftueshme për barëra dhe reagime dhe me kategori tjera të mallrave dhe me shërbime kontraktuese dhe me projekte kapitale siç është bashkëfinancimi me organizatën Chatar Charity, që është një projekt në shumë afër 1,600,000.oo€, që vazhdon deri në vitin 2023, në fushën e ekonomisë u cek që kemi pas premtim dhe nuk po e shohim në KAB që ne i kemi jep prioritet, në DPZHE edhe ky sektor për herë të parë hartohet në buxhetin e vitit 2022 dhe në këtë KAB të cilët e kem para vetës ku janë 450,000.oo€, investime kapitale, pjesë e saj është projekti më madhor ku jemi në procedura të shpronësimit siç është zona industriale me një hapësirë 37.2 ha, ku janë procedurat e shpronësimit në bashkëpunim me AKP-në dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për herë të parë ka mjete në kategorinë e subvencioneve që janë 300,000.ooo€, ku 200,000.oo€ shkojnë për mbështetje të kredive prodhuese, subvencionimin e normave të interesit ku ka një sinkronizim edhe me politikat e qeverisë ku mbështeten me 20%, investimi si kryegjë edhe ne i mbështesim interesat dhe besoj se do të japim një impuls zhvillimit të prodhimit.
Në fushën e kulturës ka 5 fishim të buxhetit për subvencione nga 40,000.oo€ në 200,000.oo€, me të drejtë dikush mund të thotë pse nuk janë 2,000,000.oo€ por tash 200,000.oo€, nuk janë por ka 5 fishim të vlerës buxhetore nëse e marrim si prioritet se për të përcaktuar prioritete jemi këtu, andaj si prioritet këto janë të përcaktuara shumë saktë dhe drejtë edhe në opozitë kur kemi qenë këto prioritete i kemi paraqit në asamble komunale, tani jemi në qeverisje dhe këto prioritete i kemi në kornizë, nuk i kemi rrugicat por e kemi arsimin, kemi projekte jashtëzakonisht të mëdha infrastrukturore siç është përfundimi i rr.”Skenderbeu”, rr.”Xhemajl Mustafa”, ku ka edhe bashkëfinancim me qeverinë rruga përgjatë lumit Llap, vlen të ceket edhe shuma prej 2,150,000.oo€ që është shumë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe kolektorit të ujërave të zeza, vazhdimi i kolektorit të ujërave të zeza ka një kosto prej 1,500,000.oo€, por më parë ky ka kushtuar 5,000,000.oo€, tash këtu kemi një përllogaritje të thjeshtë për diferencën. Pjesa tjetër e mjeteve do të shpërndahet dhe shpresojmë se me këto mjete do të trajtohet e gjithë problematika e trajtimit të ujërave të zeza dhe për rregullimin e hapësirave publike janë 2.6 milion euro dhe për ndërtimin e trotuareve 1.6 milion euro, andaj besojmë se me këtë KAB do ti japim një drejtim të duhur zhvillimit të komunës së Podujevës, për prioritetet nuk ka asnjë dyshim dhe nuk mundesh ta kontestosh asnjërin prej tyre se këto prioritete janë prioritete të cilat i nevojiten Komunës së Podujevës, këtu me të drejtë pat kërkesa që të ketë më shumë buxhet mirëpo këto janë limitet buxhetore por krahasimet tregojnë dhe flasin shumë, kur flet numri duhet të heshtim të gjithë, kështu që unë ju ftoj ta votoni këtë KAB, për vërejtje, sugjerime dhe diskutime jam i hapur për të gjithë kur vjen çështja e buxhetit se normalisht ky është një dokument strategjik dhe nuk e merr formën ligjore për buxhet në muajin shtator dhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen dhe konsiderojmë se janë të nevojshme për tu bërë do të inkuadrohen në buxhet në muajin shtator.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuari drejtor i DBF-së unë mendova që këtë pjesën ekspozenë për arsyetimin e kornizës e jepe që në fillim dhe të njëjtën e dëgjova edhe në fund dhe po ngjason si refren i njëjtë sigurisht se është ngulitë si në ato debatet që të gjitha i kam përcjellë dhe në të gjitha ka qenë i njëjti refren se ne e kemi ngritë buxhetin për 4,000,000.oo€, është e vërtetë se është ngritë buxheti për 4,000,000.oo€, por nuk mund t'i shitet kjo qytetarit apo dikujt tjetër që me këtë ngritje buxhetore kemi arrit të parashohim më shumë projekte, arsyeja pse gjithçka ka ndryshuar dhe ne këtu po jetojmë dhe e dimë se ka ndryshuar kostoja e çdo projekti, ka ndryshuar edhe inkasomi i të hyrave dhe rritja e buxhetit në nivel qendror, më trego drejtor a e keni ngritë përqindjen e ndarjes buxhetore për komunën e Podujevës se normalisht kur të rritet buxheti në nivel qendror rritet nominalisht edhe buxheti për komunat mirëpo edhe atëherë dhe tani e ke të njëjtën përqindje.
Të thuhet sot se kemi arrite me ngritë buxhetin e këtu jetojmë dhe e dimë se deri dje sa është një akcizë dhe një TVSH për një produkt elementar të nisemi nga nafta ose vaji atëherë është inkasuar një tvsh 17% e

tani fitohen 51cent prej saj ose një akcizë që fitohet më shumë se 80 cent, nuk më duket diçka që mund të numërohet si sukses përkundrazi këtë e thash edhe më parë se këtë gjendje nuk e ka krijuar një subjekt politik por është e krijuar në nivel global por mos të tentojmë ato që kanë ndodh si ndikim i ndryshimeve globale t'i adresojmë dhe t'ia faturojmë veti si sukses dhe kjo më bëri përshtypje i nderuar drejtor se kjo nuk mund të kaloj si qeverisjet e kaluara që kanë parapa rrugë e rrugica mos more drejtor se asgjë mangu se ke lënë as ti, këqyr sa ke nda mjete për zhavorr dhe në të njëjtën kohë lëvdohesh se kaq rrugë i kam shtruar në asfalt dhe në të njëjtën kohë i shtron rrugët në zhavorr, cila është logjika këtu nëse një rrugë është shtruar në asfalt, cila është logjika që të shtrohen rrugët në zhavorr, pyetja tjetër është se a ke pa dikund mjete për finalizimin e shtresës së dytë të asfaltit për rrugët e asfaltuara, e dini që s'jam ekspert i fushës por kam dëgjuar që çdo rrugë që është e shtruar me pjesën e parë për një afat shumë të shkurtër kohor duhet të shtrohet shtresa e dytë e asfaltit për finalizim të asaj rruge në mënyrë që mos të dëmtohet cila do rrugë qoftë ajo andaj sa mjete janë parapa për ato rrugë.
Sa mjete janë parapa për kulturë ku e kam përcjellë kulturën ndarjen e trashëgimisë dhe ndërtimin e fushave sportive sepse kolegu z.Haki Rudari e bëri një digresion por Hakiun e kuptoj se e kam koleg moti dhe e kuptoj se vjen nga sfera e arsimit dhe nuk na erdh aq mirë kur tha nuk e di se a keni lexuar se nuk jemi nxënës të shkollës dhe të na pyet se a kem lexuar ose jo se së fundi është e drejtë e imja edhe me lexuar edhe mos me lexuar dhe nuk japë llogari, ti vendosma notën 1 pasi që je mësuar të notosh por këtu nuk i kemi ato dhe varësisht sa dikush dëshiron të jetë në nivel të detyrës e lexon apo lexon.
Drejtor kishim dashur të kuptojmë se këtu të paktën ekzekutivi nuk duhet të dal në rolin e komisarëve por është në rolin e menaxhimit të një takse të qytetarëve pa ngjyrime partiake, unë ju pyeta se a kemi qenë së bashku në dëgjimin publik në fshatin Lluzhan ku aty në atë takim ka qenë edhe drejtori i DPUMM-së dhe më ka shqetësuar përgjigja juaj që keni thënë se kemi mjete financiare ta shtrojmë rrugë në gjatësi 1 km por rrugën e juaj në gjatësi 2 km jo, po cili është prioriteti rruga e atij që është në gjatësi 2 km apo e atij që është 50 metra, nuk mora përgjigje drejtor, të njëjtën ekspoze si të fillimit si të fundit e dëgjova.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në qoftë se nuk ka tjerë të interesuar për të marrë fjalën atëherë shkojmë në votim të KAB-it për vitet, 2023/2025, të Komunës së Podujevës, atëherë e kemi edhe një diskutues urdhëro merreni fjalën.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, para se të kalojmë në votim ju rikujtoj se i kam parashtruar dy pyetje dhe ende s'kam marrë përgjigje.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, sa i përket përgjigjes së Këshilltarit z. Xhevdet Maloku, përgjigjen e ka marrë në kornizën afatmesme buxhetore në debatin publik të mbajtur në fshatin Lluzhan, e përmendi edhe drejtori por për hir të transparencës edhe të qytetarëve po e përmendi edhe njëherë për ta sqaruar më konkretisht se cila është ndoshta arsyeja pse në këtë rast në fshatin Sallabajë nuk janë parapa investime për vitin 2023, duke marrë parasysh që buxheti është i limituar dhe i kufizuar dhe synimet, caqet për këtë buxhet janë të ndryshme në kuadër të DPUMM-së, atëherë kemi bërë një ndarje racionale në bazë të kërkesave të fshatrave të caktuara për këtë arsye jo vetëm fshati Sallabajë por edhe fshatrat e tjerë siç e përmendi drejtori janë të ndara në kuadër të dy viteve për të pas një ndarje racionale për gjithë territorin e Komunës së Podujevës kur e dimë se ka një sipërfaqe relativisht të madhe dhe mundësitë janë pak më të vogla që secilën kërkesë ndoshta të kem mundësi ta realizojmë për një afat të shkurtër kohor, mirëpo këto do të realizohen për një afat më të gjatë kohor dhe besoj se eventualisht brenda dy ose tri viteve do të përfundojnë të gjitha kërkesat për asfaltim.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, lidhur me pyetjen e juaj për shkollën e fshatit Lluzhan sa i përket investimeve në përmirësim të infrastrukturës do të ketë, jemi në prag të lidhjes së kontratës edhe për hapësirën e sallës së sportit por edhe për hapësirën e gjithmbarshme të shkollës, ndërsa për ndërtimin e shkollës së re pa marrë parasysh se rruga kah do të lëvizë nuk kemi mundur të planifikojmë buxhet duke e

ditur gjendjes se disa shkolla në disa fshatra i kemi pas më me prioritet për shkak gjendjes së rëndë të tyre që kanë qenë.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, faleminderit i nderuari kryesues, faleminderit për përgjigjen i nderuari drejtor i DKA-së, për keqardhje ju drejtor i DPUMM-së nuk më keni dhënë kurrfarë përgjigje në debat publik dhe mos kërko me i ikë përgjegjësisë.
Në debat publik nuk kam marrë kurrfarë përgjigje nga ana e juaj kur keni thënë se do të dal në diskutim publik në kuvend, sot të kam bërë pyetjen dhe po bie në kundërshtim me drejtorin e DBF-së i cili tha se çdo dy vite çdo lokalitet do të përfshihet, nëse jo në vitin 2022, në vitin 2024, fshati Sallabajë nuk është i përfshirë as në vitin 2022, e as në vitin 2023, që do të thotë se kemi më shumë se dy vite që nuk parashihen investime në këtë fshat.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse nuk ka tjerë të interesuar për të marrë fjalën atëherë e vë në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023/2025 të Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 17 vota PËR, 12 vota KUNDËR dhe 1 votë të PËRMBAJTUR, miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2023/2025 e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*Pas kërkesave të një numri të anëtarëve të Kuvendit dhe përkrahjes nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë për 1 orë dhe atë nga ora 12:30.*

*Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 14:00, dhe konstatohet se për momentin të pranishëm në sallë janë 29 anëtar/e të Kuvendit, kështu që kuorum ka dhe mund të vazhdohet me punë.*

2. **Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekaliu" në Podujevë**

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, para jush keni një propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - çerdhe publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekaliu" në Podujevë, ky propozim vendim vjen si rezultat i kërkesës që kemi pas nga Ministria e Arsimit për të shfrytëzuar fondet e IPA-3 për të ndërtuar një çerdhe në atë lokalitet ku është më se e rëndësishme andaj kërkoj nga ju përkrahje për të vazhduar me procedurat tjera.
**z.Qëndrim Softolli**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, ne përkrahim këtë propozim.
**z.Artrit Mulliqi**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, e përkrahim propozim vendimin për ndërtimin e çerdhes së re publike në lokacionin e caktuar duke i parë nevojat e atij lokaliteti për një çerdhe publike që janë shumë të mëdha, një numër i madh i hulumtimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e hershëm të fëmijëve konfirmojnë se përvoja me të cilën ballafaqohet fëmija në fëmijërinë e hershme paraqet mendim kritik për suksesin afatgjatë në përgjithësi në jetë e një ndër përvojat e para të fëmijës është ambienti në të cilin fëmija zhvillohet.
Ambienti stimulues për mësim të hershëm ua avancon zhvillimin e hershëm fëmijëve, nxitë shkathtësitë për mendim kritik dhe kreativ të fëmijëve, ashtu fëmijët bëhen të vetëdijshëm për multikulturalizmin dhe ekzistimin e dallimeve ndërsa e fuqizon edhe procesin e gjithmbarshëm të mësimit dhe të zhvillimit fizik,

emocional, social në kognitivt ose të gjethësuar kështu që ne urojmë që ky objekt të shkojë mbarë e mirë dhe në shërbim të komunitetit dhe në shërbim të fëmijëve që do të hyjnë në të.
**z.Gazmend Islami**, në emër të subjektit OBKD, theksoi, si përfaqësues i OBDK, e përkrahi këtë propozim natyrisht që e inkurajoj drejtorin që mos të jetë vetëm kjo çerdhe por të vazhdojmë edhe me çerdhe tjera në fshatra në mënyrë që të kemi një jetë sa më të mirë për të rinjtë tanë.
**znj.Mimoza Abdullahu**, në emër të Grupit të PDK-së, e përkrahi këtë iniciativë për ndërtimin e çerdheve të reja.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, siç po shihet nga diskutimet të gjitha grupet e këshilltarëve të subjekteve politike e përkrahin këtë propozim vendim edhe unë mendoj se kjo është në të mirë të qytetarëve andaj e vë në votim propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - çerdhe publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekaliu" në Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 29 vota PËR, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe Publike në hapësirën e SHFMU "Xheladin Rekaliu" në Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

3. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik:**
   - ***Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës***
   - ***Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm***

**z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi dhe arsyeshmërisë së tij fjalën ia kalojmë drejtorit të DPUMM-së.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, duke paraqitur propozimin në fjalë, theksoi, për këtë mbledhje kuvendit i propozoj dy pika për vënie në diskutim publik e para është Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës dhe e dyta është - Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm, që të hyjnë në kuadër të mbrojtjes së monumenteve të natyrës.
Për pikën e parë "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës që është e pasur me vlera të larta të natyrës të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik, peizashor, edukativo arsimor, kulturor turistik, gjithashtu pjesa përreth lumit është e pasur me biodiversitet me lloje të ndryshme të florës dhe faunës dhe të ujërave të ëmbla, kjo zonë po ashtu paraqet vlera të larta të natyrës estetike të veçanta me rëndësi shumë dimensionale prandaj është një zonë shumë e rëndësishme për mbrojtje për shkak të vlerave natyrore, formës, pamjes së bukur që ka propozohet që të shpallet si zonë e mbrojtur në kuadër të kritereve të IUCN-së, që hyn në kategorinë e 5 si peizazh i mbrojtur.
Sa i përket propozimit të dytë që është - Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm, ky është një monument që është propozuar të hyj në kuadër të mbrojtjes së monumenteve të natyrës që sipas kornizës së klasifikimit të zonave të mbrojtura tokësore dhe detare që është në kuadër të IUCN-së, "Trungu i

Qarrit" (quercus cerris),përndryshe sipas vlerësimeve të bëra ka një moshë afërsisht 400-450 vite i vjetër andaj ftoj që të votohet në kuadër të hapjes së diskutimeve publike këto dy propozime.
**z.Ekrem Rrahmani**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, e përkrahim propozim vendimin e drejtorit të DPUMM-së për shpalljen e zonave të mbrojtura për Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës dhe Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm të Komunës së Podujevës.
**znj.Drita Pajaziti**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, edhe ne si grup i LVV-së i përkrahim propozimet në fjalë dhe mendoj se në Komunën e Podujevës ka edhe shumë hapësira që duhet të jenë në mbrojtje ligjore.
**z.Bahskim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim.
**z.Florent Hasani**, theksoi, meqenëse jemi te kjo pikë kam një pyetje për drejtorin e DPUMM_së, objektet që po ndërtohen në malet rreth liqenit të Batllavës ku nga to duken se janë 5-6 katëshe a janë të pajisura me leje.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, duke pasur parasysh se zonat përreth liqenit të Batllavës janë të shpallura si zona të mbrojtura prej vitit 2013, pastaj edhe në kuadër të udhëzimit administrativ për mirëmbajtjen e pellgjeve lumore të liqeneve ndryshme në zonën e liqenit të Batllavës ka pasë kërkesa mjaftë të mëdha duke filluar prej kohës që kam ardhur deri më sot mirëpo jo të gjithë i fitojnë kushtet, kjo për shkak të përcaktimeve dhe arsyeve që është shpallur si zonë e mbrojtur, kështu që në gjithë zonën përreth liqenit të Batllavës eventualisht mund të them se janë 2 ose 3 leje që janë lëshuar kurse pjesa tjetër mund të them se janë bërë me procedura të shpejta.
**z.Florent Hasani**, theksoi, në bazë të hartës zonale që e kemi votuar në këtë kuvend ndërtimi i objektve 5-6 kat në ato male rreth liqenit dihet se është e ndaluar dhe një i tillë duke në pjesën mes liqenit dhe cilët janë hapat që ndërmerren më tutje për ta ndaluar ndërtimin, çfarë hapash keni menduar që duhet ndërmarr.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, tash për hapat e mëtutjeshëm saktësisht ndoshta do të fliste drejtori i drejtorisë së inspeksionit por meqenëse drejtori nuk është prezent këtu nuk kam kompetencë që të përgjigjem, e kuptueshme është po kjo është situata.
Sa i përket të gjitha ndërtimeve të bëra i nderuari këshilltar z.Florent Hasani po thuajse së bashku me drejtorin e DI-së, kemi pasur takime të shumta me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me Agjencionin Pyjor të Kosovës me të vetmen arsye me ndal këtë progres me ndërtime të shumta të cilat edhe ju i keni pa që e kanë degraduar mjaft shumë edhe mjedisin në hapësirën e Batllavës, sigurisht që ndërtimet në një aspekt duhet lejuar mirëpo në kuadër të kushteve të cilat i cakton DPUMM dhe jo ndërtime të cilat bëhen në formë vetanake dhe pa leje.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vetëm ju lus që mos të kalojmë në një pikë tjetër të rendit të ditës.
**z.Florent Hasani**, theksoi, pika e rendit të ditës ishte në kuadër të zonave të mbrojtura dhe dihet se zona e liqenit të Batllavës është zonë e mbrojtur.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, unë jam pro që secila pasuri natyrore e komunës tonë të jetë në mbrojtje mirëpo jam kundër lokalizmave, në këtë rast kemi dy monumente të mbrojtjes së natyrës që u propozuan nga drejtori i drejtorisë përkatëse mirëpo që të dyja janë në një lokacion shumë të afërt mes veti do të ishte mirë që në të njëjtën kohë të vihej në mbrojtje lumi i fshatit Kaçandoll, Shala e Bajgores, burimi i rrjedhës së lumit Llap në fshatin Murgull dhe të sillen si pako këtu dhe si të tilla do ti sjellin perspektivë turizmit në komunën ton e jo të ndalemi në çështje të tilla lokale, unë mendoj se kjo është e natyrës lokale edhe pse unë e respektoj si vendim, nuk është se sjellë ndonjë dobi shumë të madhe për komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuar këshilltar z. Ragip Fetahu, kjo është vetëm një nismë dhe nuk do të thotë se ka përfunduar dhe është për dy monumente të caktuara, në një legjislaturë tjetër ku kam qenë unë këshilltar i kuvendit janë fut nën mbrojtje ligjore edhe shumë monumente tjera por është mirë që edhe monumentet tjera të futen nën mbrojtjen ligjore.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sigurisht që këto dy pika nuk do të jenë të parat dhe të fundit por se do të jenë veç se të parat, kështu që ne do të vazhdojmë me procedurat tjera për mbrojtjen e zonave të cilat me të vërtetë e meritojnë për zonat të cilat kanë vlera të larta të natyrës të biodiversitetit por edhe vlera që me të vërtetë janë të nevojshme që të ruhen për të ardhmen.
**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i DKRS-së, theksoi, lidhur me njërin prej burimeve të lumit Llap që është kroi i konakut për këtë sa isha drejtor i DPZHE së bashku me shoqatën e bjeshkatarëve Llapi dhe me klubin alpinistëve Prishtina dhe Agjencionin për Mbrojtjen e Natyrës e kemi vizituar atë vend dhe janë bërë matjet dhe sa mbaj në mend ka qenë në proces përgatitja e dokumentacionit për futjen në mbrojtje ligjore mirëpo kemi mbet në pritje për me i sjellë dokumentacionet agjencioini.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në qoftë se s'ka tjerë të interesuar për ta marrë fjalën atëherë e vë në votim Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik: - Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës, si dhe - Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 29 vota PËR, nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik: - Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës "Ushton Lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës, si dhe - Elaborati: Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës "Trungu i Qarrit" (quercus cerris), në fshatin Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

4. **Formimi i Komisionit për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne në një mbledhje kemi ndërhy në këtë rregullore i kemi bërë disa ndryshime tani ka ardhë propozimi nga DPZHE për formimin e një komisioni prej 9 anëtarësh prej tyre 5 anëtarë të jenë nga kuvendi dhe 4 anëtarë nga ekzekutivi.
**z.Vigan Salihu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE,theksoi, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth këtij propozimi, theksoi, ashtu siç jemi dakorduar në mbledhjen e fundit tani është propozim vendimi për formimin e komisionit lidhur me hartimin e draft rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, Nga ekzekutivi i propozoj këta emraz z.Bahri Selim, znj.Antoneta Ejupi, z.Besnik Mulliqi, dhe unë Vigan Salihu nga DDPZHE, ndërsa nga subjektet politike mbetet t'i propozojnë anëtarët e tyre nga shefat e grupeve të tyre.
**z.Valon Demolli**, në emër të Grupit të LDK-së e propozoi z.Ekrem Rrahmanin.
**znj.Adelinë Stublla**, në emër të Grupit të LVV-së e propozoi z.Ardi Hasanin.
**znj.Mimoza Abdullahu**, në emër të Grupit të PDK-së e propozoi z.Bashkim Sylën.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, propozoj që për anëtar në këtë komision të jetë z.Arbnor Fazliu nga radhët e AAK-së.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nga OBKD unë e propozoj z.Gazmend Islami, vetëm pak mos të ngutemi sepse në të gjitha komisionet duhet ta kemi të përfshirë edhe strukturën gjinore e në këtë rast po na del një komision me strukturë gjinore 100% të përfaqësuar nga gjinia mashkullore, andaj mos të ngutemi për votim.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, në njërën nga seancat e kaluara ka qenë propozim i këtij kuvendi për pezullim të dispozitave të caktuara të rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës dhe nga kuvendi ka dalë një propozim për formimin e një komisioni të cilin sot po e bëjmë, krejt çka kisha apeluar te ekzekutivi në këtë rast te drejtori i DPZHE, nuk e di se sa jemi në përputhje me një rregullore të MAPL-së, nr.02/2021, që parasheh procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve normative të komunës, që në një formë me këtë komision miks s'di si ka menduar të funksionoj në çfarë forme se një zyrtar i ekzekutivit e bënë këtë draftin fillestar pastaj ai draft del në diskutim publik. Ndërsa në këtë formën qysh ka ardhë ky draft nuk po e vë në faj drejtorin se ka ardhë një propozim këso fare nga kuvendi dhe ky është gjendur mes dy zgjidhjeve, të shkoj sipas procedurës që e ka miratuar ky kuvend dhe formës që është e përcaktuar ndryshe, ndërsa ai shqetësimi i juaj gjinor edhe ai e ka vendin e vet dhe nuk di dhe nuk dua t'i japë më shumë veti të drejtë të flasë më shumë për këtë mirëpo drejtori duhet ta ketë parasysh rregulloren për hartimin e akteve.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, meqenëse kjo është një çështje shumë e ndjeshme për të cilën edhe z.Naim Çunaku diskutoj por kërkesa jonë atëherë ka qenë që të bëhet një komision ashtu siç u propozua tani, unë mendoj që nuk është ndesh me ligjin, është mirë që bashkarisht ta gjejmë gjuhën e përbashkët duke i mbrojtur interesat e qytetarëve tanë por edhe të bizneseve që ky komision të funksionoj dhe ta sjellë para kuvendit dhe të përkrahet nga të gjithë sepse është një temë e ndjeshme dhe besoj se don një diskutim të thellë për shkak se ne e dimë që dita e diele është ditë pushimi tash ditën e diele janë duke punuar bizneset dhe e dimë se me çfarë pagash janë duke punuar, në qoftë se nuk është e kundërligjshme unë jam për që të funksionoj kjo formë qysh është propozuar prej drejtorit.
**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, i nderuari Kryesues ne e zëvendësojmë propozimin tonë z.Ardi Hasani me znj.Drita Pajaziti, për shkak të strukturës gjinore.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse s'ka pyetje dhe diskutime tjera atëherë e hedh në propozimi për formimin e Komisionit ad-hoc për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1. Bahri Selimi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
2. Antoneta Ejupi, anëtare nga radhët e Ekzekutivit
3. Besnik Mulliqi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
4. Vigan Salihu, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
5. Ekrem Rrahmani, anëtar nga radhët e Kuvendit
6. Drita Pajaziti, anëtare nga radhët e Kuvendit
7. Bashkim Syla, anëtar nga radhët e Kuvendit
8. Arbnor Fazliu, anëtar nga radhët e Kuvendit
9. Gazmend Islami, anëtar nga radhët e Kuvendit

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 29 anëtar/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, me 27 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 1 votë të PËRMBAJTUR, me vendim miratohet propozimi për formimin e Komisionit ad-hoc për hartimin e draft Rregullores për Orarin e Punës së Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:*
*1. Bahri Selimi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
*2. Antoneta Ejupi, anëtare nga radhët e Ekzekutivit*
*3. Besnik Mulliqi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
*4. Vigan Salihu, anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
*5. Ekrem Rrahmani, anëtar nga radhët e Kuvendit*
*6. Drita Pajaziti, anëtare nga radhët e Kuvendit*
*7. Bashkim Syla, anëtar nga radhët e Kuvendit*
*8. Arbnor Fazliu, anëtar nga radhët e Kuvendit*
*9. Gazmend Islami, anëtar nga radhët e Kuvendit*

**5. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë**

**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS-së, duke e paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, siç e dini Komuna e Podujevës qëndron më mirë në aspektin infrastrukturor se sa shumë komuna tjera, megjithatë nevojat e sportistëve tanë janë të mëdha e ndër nevojat më të mëdha është edhe krijimi i infrastrukturës për sportet e ujit për notuesit tanë, klubet e zhytësve po erdhe për shkollat, andaj bazuar në këtë dhe në planifikimin e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për ndërtimin e 7 pishinave gjysmë olimpike, unë besoj se Komuna e Podujevës si Komuna me territorin më të madh në nivel të Republikës së Kosovës dhe që renditet komuna e 7 të sa i përket numrit të banorëve e meriton ta ketë njërën pishinë prej tyre.
Në emër të Kryetarit të Komunës propozoj propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë, me këtë vendim caktohet lokacioni me destinim për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë si në vijim; paluajtshëritë e evidentuara, certifikata pronësore me nr.08-942-06-0039319/22, në njësinë kadastrale parcelë P-71712062-02153-2, pronë komunale me sipërfaqe 30 ari, lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore arë e klasës së parë, shfrytëzimi aktual i parcelës arë, zona kadastrale Podujevë sipas certifikatës pronësore, kopjes së planit dhe skicës ortofoto si dhe parcela afër saj me sipërfaqe prej 22 ari lloji i shfrytëzimit i njëjtë për të cilën paraprakisht jemi konsultuar edhe me DPUMM-në, nëse mund të ndërtohet në këtë pjesë dhe kemi marrë një konfirmim që mund të vazhdojmë tutje. Bazuar në këto propozoj që ky kuvend ta aprovojë propozimin e DKRS-së, për caktimin e lokacionit, pas kësaj vjen faza projektimit dhe kërkesa jonë në ministri për ndërtimin e sajë e që jam optimist se ne mund të jemi një nga përfituesit.
**z.Valon Demolli**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, në lidhje me piken e rendit të ditës për propozim vendimin e DKRS-së, për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë, si grup i asamblistëve të LDK-së, japim mbështetje për realizimin e këtij projekti sepse është nevojë e sidomos për gjeneratat e reja të komunës sonë, ajo që jemi kundër është lokacioni i saj që për mendimin tonë nuk është i planifikuar mirë, sepse mendojmë se lokacioni te rrethi i shqiponjës nuk i plotëson kushtet elementare për realizimin e një projekti të tillë për shkak të hapësirës së pa mjaftueshme, pastaj në këtë pjesë është rruga magjistrale që e lidhë Kosovën me Evropë dhe paraqet rrezik sidomos për gjeneratat më të reja që mund të frekuentojnë, një tjetër problem është edhe mundësia sepse atje veprojnë biznese që shërbimet e tyre mund të ndërlidhen me punën e kësaj pishine.

Një aspekt i veçantë e sidomos për vendin tonë që do ta bëjë këtë pishinë të çuditshme është fakti se shtrihet në mes të varrezave xhamisë dhe qendrës emergjente përveç që shtrihet në një lokacion të pa favorshëm në komunikacion zhurma e saj do të sillet me reagim të qytetarëve në këtë komunitet dhe të objekteve publike që i përmenda më lartë andaj duke i marrë parasysh të gjitha këto kërkoj nga DKRS-ja, që të rishikohet edhe njëherë lokacioni sepse ky lokacion nuk i plotëson kushtet për funksionimin dhe realizimin e saj, ndërsa nëse mendohet se kemi vetëm një godinë atëherë ju i keni numrat ju vazhdojeni dhe miratojeni.
**z.Bahri Blakçori**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, e përkrahim këtë propozim vendim të DKRS-së, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë, shpresoj dhe besoj shumë që kjo do të realizohet sa më shpejt që është e mundur, vërtetë rajonit të Llapit i ka munguar një pishinë e tillë.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, e përkrahim këtë propozim vendim të DKRS-së, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë.
**z.Gazmend Islami**, në emër të subjektit OBKD, theksoi, e përkrahim këtë propozim vendim të DKRS-së, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pishinës gjysmë olimpike në Podujevë, natyrisht e inkurajojmë që të punojë më shumë se e ka mbështetjen tonë, gjithçka që është në të mirë të qytetarëve është edhe në të mirën tonë prandaj vetëm mundem ta përgëzoj e t'i them vazhdo.
**z.Pajtim Balaj**, U.D. drejtor i DKRS-së, theksoi, lidhur me diskutimin e këshilltarit nga grupi i LDK-së, pajtohem se nuk është hapësira ideale për ndërtimin e saj mirëpo e dini se Komuna e Podujevës ka problem me tokat, ka mungesë të madhe të hapësirave që janë pronë e Komunës së Podujevës, në lidhje me hapësirën se sa ka hapësirë dhe a është e mjaftueshme ajo për ndërtimin e objektit dhe parkingut është e mjaftueshme.
Unë nuk kam bë asgjë pa i konsultuar profesionistët, ideja fillestare për hir të korrektësisë është e notuesve të Llapit dhe trajnerëve të këtij sporti të cilët kanë kërkuar 50 ari prej kmomunës së Podujevës as më shumë e as më pak kurse në këtë hapësirë janë 52 ari, ata kanë kërkuar 50 ari për ndërtimin e pishinës së bashku me parkingjet, nuk është lokacioni ideal po të kisha mundësi e kisha bë dikund tjetër por nuk kam mundësi, kam hulumtuar me DPKGJ-në, por nuk kemi gjetur lokacion tjetër të përshtatshëm.
Është fakt se lokacioni është afër rrugës dhe mund të jetë rrezik, mirëpo ne duhet ta projektojmë në atë mënyrë që me pas hyrjen nga rruga mbrapa që mos të ketë rrezik për fëmijët, notuesit dhe këdo tjetër, s'është lokacioni ideal por Komuna e Podujevës nuk ka prona, në të ardhmen ndoshta do të na duhet të shpronësojmë prona private në mënyrë që të realizojmë projekte tjera si për rrugë dhe infrastrukturë sportive apo diçka tjetër.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, ne si grup i këshilltarëve të LDK-së e kontestuam vetëm lokacionin jo projektin prandaj ju përgëzoj për donacionin, kundërthëniet i patëm se mendojmë se lokacioni nuk është i qëlluar.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë nëse s'ka tjerë të interesuar për të marrë fjalën e hedhim në votim Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë, sipas materialit përkatës të paraqitur në mbledhjen e KPF-së dhe shpërndarë me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 24 vota PËR, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pishinës gjysmë Olimpike në Podujevë, sipas materialit përkatës të paraqitur në mbledhjen e KPF-së dhe shpërndarë me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.*

6. **Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për ndryshimin e Statusit të SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP**

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, një korrigjim të vogël se bëhet fjalë për një propozim vendim për ndryshim vetëm të emërtimit andaj kërkoj edhe mirëkuptimin e juaj edhe për dje në mbledhjen e KPF-së se nuk bëhet fjalë për ndryshim të statusit por vetëm për ndryshim të emërtimit.
Ky propozim vendim bazohet në ligjin për vetëqeverisje lokale n. 03/L-040, në vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe në një varg ligjesh të ndërlidhura me të pra me këtë vendim SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP emërohen në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP.
Ndryshimi i emërtimeve të dy institucioneve arsimore sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të rregullimit, strukturimit, organizimit dhe menaxhimit të institucioneve përkatëse të cilat ofrojnë arsim dhe aftësim profesional duke marrë për bazë ligjin nr.04L-138, për arsimin dhe aftësimin profesional. Gjithashtu duke u bazuar edhe në vendimin nr.2-3726, të datës 28.08.2019, për institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional nga MASHT, si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi, pra është vetëm një kërkesë për ta bërë ndryshimin e emërtimit të këtyre dy shkollave që në vitin e ardhshëm të krijojnë hapësirë që kërkon tregu i punës.
**znj.Qëndresë Hajrizi**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, e përkrahim këtë iniciativë e cila buron nga këshilli i shkollave dhe nevojave të reja të tregut për ndryshimin e emërtimit të shkollave në fjalë, kërkesa është e bazuar në nevojat dhe në kërkesat e tregut të punës, me ndryshimin e emërtimit të shkollës nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP emërohen në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP na u mundësohet edhe hapja e fushave dhe profileve tjera duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës.
**z.Arjant Topanica**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, edhe ne e përkrahim këtë nismë për të ndryshuar emërtimin e SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale-SHMLP në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, desha ta marrë fjalën që ta shpreh përkrahjen e grupit të këshilltarëve të LDK-së, mirëpo përkrahjen tonë e theksoi parafolësi im.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, e përshëndes këtë iniciativë të drejtorit dhe e përgëzoj sepse gradualisht është duke e parë që tregu i punës dhe aftësimi profesional ndryshojnë me shkollat e mesme profesionale por kisha kërkuar nga drejtori që për çdo gjë që ka mundësi ne si opozitë ta japim kontributin tonë sa herë ai ka nevojë meqenëse shkollat e mesme profesionale unë i njohë bukur mirë por ka edhe të tjerë që i njohin. Andaj për gjithçka ne jemi të hapur për bashkëpunim kështu vetëm ju uroj suksese dhe punë të mbarë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, i dëgjova edhe kolegët paraprakisht në parim e përkrahi këtë kërkesë por me gjithat kam një shqetësim ose rezervë për arsye se ndoshta mund të ketë probleme për drejtimet që janë aktualisht prandaj propozoj që DKA-ja dhe drejtori të ketë për bazë dhe parasysh shumë bazën ekzistuese të profileve aktuale.
Në të dy shkollat kemi bazat e profileve dhe është mirë që të ruhen këto por njëkohësisht të hapen edhe drejtime të reja, këtë shqetësim ma kanë thënë edhe kolegët që vijnë nga fusha e arsimit dhe është mirë që ta kemi parasysh për arsye se nuk është mirë të krijojmë paralele të reja e t'i mbyllim ato që janë, kështu që është mirë që të jemi më serioz në këtë çështje.

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA-së, theksoi, pajtohem plotësisht i nderuari asamblist qëllimi i këtij emërtimi nuk është për t'i shuar ato drejtime por nganjëherë krijohet nevoja dhe në rastin konkret ka një kohë të gjatë që është drejtimi shpedicion dhe logjistikë, mund të bëhet një drejtim që e kërkon tregu i punës tani dhe ajo nuk ndikon në rënien e numrit të normave të mësimdhënësve, mirëpo vetëm krijon mundësi me u lidhë me tregun e punës siç e potencoi me të drejtë asamblisti z.Gazmend Islami.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqenëse s'ka tjerë të interesuar për të marrë fjalën e vë në votim Propozim Vendimi për ndryshimin e emërtimit të dy shkollave të mesme profesionale SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale, në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP, sipas materialit përkatës të paraqitur nga drejtori i DKA-së me ndryshimin e vetëm që shprehja në propozimin përkatës ".........Ndryshimin e statusit të..........", fshihet dhe zëvendësohet me shprehjen ".......Ndryshimin e emërtimit të dy shkollave.........."

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 29 vota PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim Vendimi për ndryshimin e emërtimit të dy shkollave të mesme profesionale SHMLT "Fan S. Noli" dhe SHMLE "Isa Boletini" nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale, në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP, sipas materialit përkatës të paraqitur nga drejtori i DKA-së me ndryshimin e vetëm që shprehja në propozimin përkatës ".........Ndryshimin e statusit të..........", fshihet dhe zëvendësohet me shprehjen ".......Ndryshimin e emërtimit të dy shkollave.........."*

### 7. Propozim Vendim për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës

**znj.Marigona Lahu**, **Nënkryetare e Komunës**, e paraqiti propozim vendimin në fjalë, ndër të tjera theksoi, para jush po e lexoj propozimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës.
Titulli qytetar nderi i Komunës së Podujevës për z.Halil Kastrati themelues dhe përfaqësues i shoqatës bamirëse "Jetimat e Ballkanit" jepet në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës, titulli qytetar nderi i Komunës së Podujevës sipas këtij vendimi do të ndahet nga Kryetari i Komunës i cili autorizohet që të përcaktojë formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera që i përkasin organizimit dhe solemnitetit të titullit në fjalë për z.Halil Kastrati.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e hedh në votim këtë Propozim Vendimi për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 28 vota PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim Vendimi për shpalljen e z.Halil Kastrati "Qytetar Nderi" i Komunës së Podujevës, sipas prezantimit të paraqitur nga Kryetari i Komunës fillimisht dhe Nënkryetarja e Komunës në fjalën hyrëse.*

## 8. Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, dihet se ne i kemi formuar dy komitete, komitetin për politikë dhe financa dhe komitetin për komunitete mirëpo për të funksionuar kuvendi duhet të formohen edhe disa komitete tjera mirëpo këto komitete nuk janë formuar në mbledhjet e kaluara të kuvendit për shkak se rendi i ditës ka qenë i stërngarkuar me pika të rendit të ditës, kurse sot me propozimin e këshilltarit z. Ragip Fetahu do ta diskutojmë këtë temë.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, themelimi i komiteteve tjera në kuvendin e komunal të komunës tonë përveç se është obligim ligjor është edhe për shkak të efikasitetit dhe të angazhimeve të të gjithë kolegëve tanë asamblistë në punën që ata e bëjnë.
Qëllimi im me këtë propozim është që të angazhohen të gjithë kolegët tanë asamblistë e që fatkeqësisht ka kolegë që 4 vite në kuvend ju përfundon mandati dhe nuk flasin asnjëherë dhe nuk e bëjnë asnjë angazhim të vetëm për qytetarët, mos të themi se "vjen këtu flen dhe e merr atë pagë prej 208€, e që ajo pagë është haram nëse e quajmë me gjuhën fetare".
Komitetet duhet të themelohen bazuar në rregulloren e MAPL-së, nr.05/2020, në të cilin ceken shumë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve tjera si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e asamblistëve në këto komitete dhe obligimet e këtyre komiteteve po ashtu edhe shpërblimi për punën e tyre, mendoj se kjo është domosdoshmëri duke e pasur parasysh që komuna jonë ka shumë probleme, ka shumë sfida, ka shumë telashe të cilat mund të trajtohen nga kolegët dhe mund të analizohen dhe të dërgohen me rekomandim te ekzekutivi për zgjidhjen e mëtejshme të problemeve.
Unë për fillim kam propozuar që në kuadër të këtyre propozimeve të kemi themelimin e tri komiteteve, komitete për të cilat kemi telashet më të mëdha për momentin, është komiteti për zhvillim ekonomik, komiteti për barazi gjinore dhe komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, në këto komitete duhet të ketë gjithë përfshirje nga të gjitha subjektet politike duke u bazuar në numrin e anëtarëve të tyre në kuvend.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, komiteti për komunitete është i themeluar dhe meqenëse i kam vizituar komunitetet këto ditë dhe kam lëvizur kah shtëpitë e tyre dhe e kam parë gjendjen e tyre të rëndë më mirë mund të themi se është një komitet për komunitete vetëm sa për sy e faqe, mendoj se është nën ndershmërinë e shqiptarëve që për komunitetet të cilat jetojnë këtu të punohet shumë më shumë, ne vetë kemi qenë të përndjekur, vetë kemi punuar nëpër botë punë të ndryshme dhe kemi pasur të drejtat e barabarta si në shkollim si në punësim prandaj mendoj se është shumë e ndershme që të mendojmë për atë komunitet ata fëmijë që ishin mbete rrugëve pa shkollë p.sh, kish 10 vite dhe se kish përfunduar klasën e parë.
Mund të punohet shumë më shumë për krijimin e një komisioni ad-hoc, për shkollim për fëmijët të cilët nuk din shkrim lexim, t'ju ofrojmë mundësinë edhe të punësimit, t'ia ofrojmë gjitha mundësitë komunitetit që të jetë i barabartë me shqiptarët, ta marrim si shembull botën e qytetëruar se si i trajtojnë të gjitha komunitetet tjera, kisha kërkuar që këtë punë ta merrni seriozisht se ne vetë kemi qenë të shtypur dhe e dimë çka do të thotë të jesh i shtypur dhe mos ta ndiesh vetën mirë në një shoqëri kur të tjerët të përbuzin andaj është mirë që ne të mendojmë seriozisht për këtë sepse e krijojmë një shembull të mirë si shqiptar me gjithë ato komunitete që jetojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, unë e përshëndes iniciativën e kolegut z.Ragip fetahu për themelimin e komiteteve tjera të kuvendit, e përmendi më herët që është urgjencë themelimi i atyre 3 komiteteve po përveç tyre po ashtu është e rëndësishme që të themelohen edhe komitetet tjera të secilit dikaster udhëheqës qeverisës për shkak se sa është i rëndësishëm arsimi dhe shëndetësia duhet të jenë të rëndësishme edhe sporti dhe fushat tjera të jetës me të cilat merret ekzekutivi dhe kuvendi në të njëjtën kohë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne i kemi 3 propozime nga këshilltari z.Ragip Fetahu, mirëpo sipas statutit të komunës ne mund t'i themelojmë 7 komitete tjera tani ne nuk e dimë se cilën zgjedhje duhet ta bëjmë, komiteti për politikë dhe financa është i formuar dhe komiteti për komunitete ashtu siç e ceku kolegu z.Gazmend Islami se ai komitet ekziston dhe funksionon në të mirë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, mirëpo komitetet tjera që duhet t'i themeloj kuvendi komunal i Podujevës janë komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komiteti për arsim, komiteti për zhvillim ekonomik, komiteti për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit, komiteti për kulturë rini dhe sport, komiteti për pronë, komiteti për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural.
Këto janë 7 komitetet tjera, asamblisti z.Ragip Fetahu propozoj komitetit për barazi gjinore që nuk bënë pjesë në këto komitete, mirëpo unë mendoj se ne këtu nuk kemi çka të diskutojmë për barazinë gjinore se ne nuk e kemi atë problem sa i përket barazisë gjinore.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, një komitet i tillë sugjerohet të formohet në propozim rregulloren të MAPL-sënr.05/2020, e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në fund të vitit 2020, pra ndër të tjera propozohet që të formohen edhe komitete tjera për barazi gjinore.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, faleminderit i nderuari këshilltar z.Ragip Fetahu mirëpo ky Kuvend në përbërje prej 35 anëtarëve nuk ka kapacitet për t'i formuar 10 komitete tjera ashtu siç po dalin sepse secili komitet duhet t'i ketë 5 anëtar dhe kur i llogarisim 7 komitete nga 5 anëtarë atëherë kemi 35 anëtar që do të thotë se një anëtar/e e një komiteti s'ka të drejtë të jetë anëtar/e e dy komiteteve.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, statuti i komunës tonë si akti më i lartë që duhet t'i përmbahemi në nenin 50 është përcaktuar që komitete tjera të përhershme të formohen të cilat i numërove taksativisht i nderuari z.Kryesues, shto kësaj 2 komitete tjera që po bëhen 9 komitete tjera dhe në bazë të statutit ne e kemi këtë mundësi formimin e 7 komiteteve tjera të përhershme.
Tani sa i përket komiteteve konsultative është krejt diçka tjetër sepse ato formohen në bazë të konkursit, mirëpo nuk mund të pajtohem me ty i nderuari z.Kryesues e të themi se nuk kemi kapacitete për formimin e këtyre komiteteve, kapacitete kemi, kuvendi ynë është ky që është në përbërje prej 35 anëtarëve në bazë të numrit të banorëve të Komunës tonë dhe sigurisht ligjvënësi i ka pas parasysh edhe këto, atë që e dëgjova se një anëtarë nuk ka të drejtë të jetë pjesë më shumë se e një komiteti nuk është ashtu sepse sipas rregullores një anëtarë mund të jetë pjesë më së shumti në dy komitete përjashto këtu anëtarët që janë pjesë e komitetit për politikë dhe financa dhe komitetit për komunitete sepse këta anëtar nuk e kanë të drejtën të jenë anëtar të komiteteve tjera kurse anëtarët tjerë të kuvendit e kanë të drejtën të marrin pjesë në dy komitete.
**z.Haki Rudari**, theksoi, këtu para veti kam rregulloren e MAPL-së nr.05.2020, për procedurat dhe themelimin përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, për këtë arsye unë paraprakisht thash se nuk është punë e lehtë themelimi i këtyre komiteteve dhe për atë arsye unë desha që të kemi një konsensus mes përfaqësuesve të subjekteve politike në këtë kuvend megjithatë kemi ardhë deri në këtë pikë.
Në bazë të nenit 14 parashihet përbërja dhe organizimi i komiteteve tjera ku nuk guxojmë të shkojmë në pako për themelimin e komiteteve tjera, këtu është zyra ligjore dhe kam përcjellë praktikat e themelimit të komiteteve tjera në komunat tjera që mund t'i ceku, secili komitet duhet të jetë pikë e veçantë e rendi të ditës prandaj në këtë drejtim unë e pash se sot nuk jemi shumë të përgatitur për themelimin e këtyre komiteteve për kundër dëshirës këtë e thash edhe në foltore se jemi vonuar në themelimin e këtyre komiteteve.
Në këtë rregullore neni 14 paragrafi 1 thotë, komitetet tjera të cilat themelohen nga kuvendi i komunës në fusha të caktuara përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësues jashtë kuvendit që janë ekspertë, shumica e anëtarëve të komiteteve tjera përbëhen nga anëtarët e kuvendit si dhe duhet të reflektojnë përbërjen e kuvendit të komunës, thjeshtë çdo komitet që formohet duhet të ketë për bazë edhe fuqinë

politike të subjekteve për arsye se nuk mund të barazohen subjektet politike sepse aty janë të përfaqësuara në bazë të vullnetit të qytetarëve. Anëtarët e komiteteve tjera nuk kanë të drejtë të jenë pjesë më shumë se e një komiteti do të thotë këtu kemi të bëjmë me këto komitete që veç nëse mund t'i themelojmë sot dhe nuk kemi të bëjmë me dy komitetet tjera të cilat janë të themeluara për ta qartësuar më shumë nuk ka të drejtë me qenë një anëtar i kuvendit anëtar i komitetit të arsimit dhe anëtar i komitetit të shëndetësisë kjo është sipas rregullores që unë e kam para veti, në fund numri i anëtarëve në një komitet duhet të jetë më së paku 5 e këtu duhet të kemi parasysh edhe aspektin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e shoqërisë civile apo ekspertë nga jashtë.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, propozoi një pauzë të shkurtër me qëllim që grupet e këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë kuvend të konsultohen dhe të nxjerrim një përfundim për këtë çështje.

*Nga shumica e anëtarëve të Kuvendit mbështetet propozimi për një pauzë të shkurtër brenda hapësirës së objektit të Komunës, dhe atë duke filluar në ora 14:55.*

*Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:15.*

**Kryesuesi i Kuvendit,** fillimisht konstaton kuorumin ku prezent në sallë për momentin ishin 23 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, në vazhdim theksoi, kemi mbetur te pika e rendit të ditës të cilën e propozoi këshilltari z.Ragip Fetahu për formimin e tri komiteteve tjera, komitetitn për zhvillim ekonomi, komitetin për barazi gjinore dhe komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
Tani vazhdojmë me themelimin e komiteteve konkretisht me propozimet për themelimin e komitetit për zhvillim ekonomik, kërkojmë nga LDK-ja që të jap propozimin për anëtarët e këtij komiteti sepse sipas marrëveshjes LDK-ja e udhëheq këtë komitet.
**z.Ekrem Rrahmani,** në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, propozojmë që kryesues i komitetit për zhvillim ekonomik të jetë z.Arjant Topanica.
**znj.Adelina Stublla,** në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, propozojmë që anëtar i komitetit për zhvillim ekonomik të jetë z.Xhevdet Maloku.
**znj.Mimoza Abdullahu,** në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, propozojmë që anëtar i komitetit për zhvillim ekonomik të jetë znj Endritë Murati.
**z.Arbnor Fazliu,** në emër të grupit të këshilltarëve të AAK-së, theksoi, propozojmë që anëtar i komitetit për zhvillim ekonomik të jetë z.Burim Hasani.
**z.Gazmend Islami,** nga radhët e subjektit politik OBDK, theksoi, propozoj që anëtar i komitetit për zhvillim ekonomit të jetë miku im z.Haki Rudari nga subjekti politik i LVV-së.
**z.Haki Rudari,** theksoi, faleminderit për propozimin z.Gazmend Islami, me thënë të drejtën kjo bindje që është krijuar nuk qëndron se kjo që thuhet se s'ka të drejtë ndonjëri prej anëtarëve të jetë pjesë e dy komiteteve nuk qëndron sepse kjo ka të bëjë me këto komitetet që po themelohen e jo me ato komitete të cilat janë themeluar megjithatë faleminderit për propozim por nuk jam i gatshëm.
**z.Gazmend Islami,** nga radhët e subjektit politik OBDK, theksoi, propozoj që anëtar i komitetit për zhvillim ekonomit të jetë znj.Arjeta Fetahu jashtë kuvendit.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 23 vota PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me vendim themelohet Komiteti për Zhvillim Ekonomik, me këtë përbërje:*
*1. Arjant Topanica, anëtar, nga radhët Kuvendit të Komunës-LDK,*
*2. Xhevdet Maloku, anëtar, nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV,*
*3. Endritë Murati, anëtare, nga radhët e Kuvendit të Komunës-PDK,*
*4. Burim Hasani, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK,*
*5. Arjeta Fetahu, anëtare, përfaqësuese nga jashtë Kuvendit, propozuar nga OBKD*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani vazhdojmë me propozimet tjera për themelimin e komitetit për barazi gjinore që këtë komitet e udhëheq PDK-ja.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, i nderuari Kryesues në fillim ne u dakorduam se nuk kemi propozim për këtë komitet për arsye se ne nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në dy komitete, kështu që kryesuesi i këtij komiteti të jetë nga LVV-ja.
**znj.Adelina Stublla,** në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, propozojmë që anëtar i komitetit për barazi gjinore të jetë z.Ragip Fetahu.
**z.Ekrem Rrahmani,** në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, propozojmë që anëtare e komitetit për barazi gjinore të jetë znj.Edona Shabani.
**z.Arbnor Fazliu,** në emër të grupit të këshilltarëve të AAK-së, theksoi, propozojmë që anëtar i komitetit për barazi gjinore të jetë znj.Gentiana Gashi jashtë kuvendit.
**z.Gazmend Islami,** nga radhët e subjektit politik OBDK, theksoi, propozoj që anëtare i komitetit për barazi gjinore të jetë znj.Fikrie Miftari jashtë kuvendit.
**z.Bashkim Syla,** në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, propozojmë që anëtare ekomitetit për barazi gjinore të jetë znj.Dalina Gashi jashtë kuvendit.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, këtu kemi tre anëtar të propozuar jashtë kuvendit komunal e në rastin konkret duhet të jenë 3 anëtar nga radhët e kuvendit e dy anëtar jashtë kuvendit.
**z.Haki Rudari,** theksoi, nuk barazohen subjektet që janë të përfaqësuara në kuvend me 2 ose 3 këshilltar me subjektet tjera që kanë të përfaqësuara në kuvend 12 ose 13 këshilltar, jo pse unë e them këtë por këtë e thotë rregullorja andaj është mirë që komitetet të themelohen nga subjektet që kanë numër më të madh të këshilltarëve në kuvend mirëpo këto komitete duhet të jenë të përfaqësuara edhe nga anëtarët e subjekteve tjerë e jo të shkojmë në këtë formë një nga një sepse rregullorja na e ndalon këtë.
Me gjithë respektin për të gjitha subjektet politike por subjektet që kanë numër më të madh të këshilltarëve në kuvend kanë të drejtë më shumë të jenë të përfaqësuara në komitete dhe gjithherë shumica duhet të jetë nga kuvendi komunal.
**z.Gazmend Islami,** nga radhët e subjektit politik OBDK, theksoi, më së miri është që LVV-ja t'i themelon vetë të gjitha komitetet e ne nuk po përfaqësohemi por lëni këto gjëra se këtu jemi për të bërë diçka mirë për qytetarët dhe nuk ka rëndësi ajo punë se ne nuk përfitojmë por thjeshtë po mundohemi me dhënë kontributin tonë çdo subjekt politik me njerëzit më të mirë që i kemi për të mirën e qytetarëve.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, kam një lutje për kolegun z.Gazmend Islami që ta tërheq propozimin e tij pasi që është e paraparë edhe me rregullore që shumica e anëtarëve të komiteteve të jenë nga radhët e kuvendit dhe t'i ofrohet mundësia ndonjë kolegu prej asamblesë komunale nga subjektet e mëdha politike.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, ne e tërheqim propozimin tonë dhe në vend të PDK-së të japë propozim LVV.
**znj.Adelina Stublla,** theksoi, edhe pse nuk është znj.Mrika Thaçi prezent besoj se ajo pranon të jetë anëtare e komitetit për barazi gjinore kështu që është mirë që ta propozojmë atë anëtare të këtij komiteti.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, i nderuari kryesues pasi që kolegu Ragip Fetahu është kryesues i Komitetit për barazi gjinore unë e propozoj znj.Donjetë Sheqiri që të jetë anëtare e komitetit për barazi gjinore.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket propozimit të znj.Adelina Stublla po e sqaroi se znj.Mrika Thaçi është anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ne nuk jemi konsultuar me të.
**znj.Adelina Stublla,** theksoi, atëherë propozoj që anëtare e këtij komiteti të jetë znj.Drita Pajaziti dhe të përmbyllet kjo temë.
**z.Valon Demolli,** theksoi, ne grupi i këshilltarëve të LDK-së, në vend të znj.Donjeta Sheqiri propozojmë që anëtar i komitetit për barazi gjinore të jetë z.Fahri Hasani.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë nëse nuk ka propozime tjera shkojmë në votim që anëtarët/et e propozuara të jenë pjesë e komitetit për barazi gjinore.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 24 vota PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me vendim themelohet Komiteti për Barazi Gjinore, me këtë përbërje:*
*1. Ragip Fetahu, anëtar, nga radhët Kuvendit të Komunës-LVV,*
*2. Drita Pajaziti, anëtare, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV,*
*3. Edona Shabani, anëtare, nga radhët Kuvendit të Komunës-LDK,*
*4. Fahri Hasani, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK,*
*5. Gentiana Gashi, anëtare, përfaqësuese nga jashtë Kuvendit, propozuar nga AAK*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani vazhdojmë me propozimet tjera për themelimin e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
**z.Bashkim Syla,** theksoi në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, propozojmë që anëtare e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të jetë znj.Mimoza Stublla.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, propozojmë që anëtare e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të jetë znj.Tringa Sfishta.
**znj.Adelina Stublla,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, propozojmë që anëtare e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të jetë z. Kasib Bashota.
**z.Arbnor Fazliu,** në emër të grupit të këshilltarëve të AAK-së propozojmë që anëtare e komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale jashtë Kuvendi të jetë z.Kron Saliu.
**z.Haki Rudari,** theksoi, kam një propozim i nderuari Kryesues sepse në këtë komitet përbërja duhet të jetë 3 anëtar nga radhët e kuvendit dhe 2 anëtarë jashtë kuvendit andaj propozoj që anëtar i këtij komiteti jashtë kuvendi të jetë Dr.Arben Beçiri.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë sipas propozimeve kemi këta anëtar/e të propozuar znj.Mimoza Abdullahu, Znj.Tringa Sfishta, z.Kasib bashota, z.Kron Salihu, z.Arben Beçiri, këta janë anëtarët/et e propozuara për këtë komision, nëse s'ka propozime tjera atëherë shkojmë në votim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 23 vota PËR, asnjë votë kundër dhe 1 votë të PËRMBAJTUR, me vendim themelohet Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me këtë përbërje:*
*1. Mimoza Abdullahu, anëtare, nga radhët Kuvendit të Komunës-PDK,*
*2. Tringa Sfishta, anëtare, nga radhët Kuvendit të Komunës-LDK,*
*3. Kasib Bashota, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV,*
*4. Arben Beçiri, anëtar, përfaqësues nga jashtë Kuvendit, propozuar nga LVV,*
*5. Kron Salihu, anëtar, përfaqësues nga jashtë Kuvendit, propozuar nga AAK*

9. **Draft Rregullorja për organizmin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës.**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, lidhur me propozim rregulloren në fjalë, fjalën ia kalojmë propozuesit të saj z.Ragip Fetahu.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, së pari më lejoni që t'i falënderoj gjithë kolegët e mi asamblist nga të gjitha subjektet politike të cilët i përkrahen këto pika të rendit të ditës të propozuara nga unë, pika të cilat nuk kanë të bëjnë me çështje politike apo i përkasin këtij apo atij subjekti politik, apo përkrahim këtë apo atë subjekt politik, qëllimi është interesi i përgjithshëm qytetar që t'i zgjedhim problemet me të cilat ballafaqohet qyteti ynë.
Unë nuk jam këtu për të ngritur polemika politike se jo ky me këtë ose ai me atë, unë jam përfaqësues i qytetarëve e kam dhënë një betim, betimi ndër të tjera është se do t'i kryej me nder dhe përgjegjësi detyrat të cilat më caktohen dhe kjo është një detyrë e cila më është dhënë nga qytetarët dhe asgjë më shumë, unë jam asamblist nga LVV-ja, mu desh ta bëjë këtë sqarim pa tjetër, çështja të cilën unë e kam ngritë si pikë të rendit të ditës ka të bëjë me Propozim Rregulloren për organizmin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës.
Kjo propozim rregullore nëse nuk gaboj na ka ardhë në kuvend në muajin mars të vitit 2021 dhe kjo rregullore është stërzgjatur duke u bazuar në atë se komunat tjera e kanë tejkaluar këtë fazë dhe kanë një rregullim institucional të hapësirave të saj pra sa i përket këshillit të fshatrave dhe lagjeve urbane, për komunën tonë kjo rregullore është e domosdoshme e kuptojmë që kornizat ligjore dhe rregullativa e përgjithshme ligjore e nivelit nacional na e kufizon numrin e caktuar të këshillave të fshatrave, është shumë e qartë që nuk mund të ketë në secilin fshat këshill për shkak se kornizat buxhetore nuk e lejojnë këtë çështje dhe kjo rregullore shumë qartë e sqaron se secili këshill i fshatrave duhet të përbëhet prej 5-6 anëtar e që kanë mundësi të gjitha fshatrat të përfaqësohen denjësisht dhe përveç kësaj procesverbalet i lexova me kujdes përveç fshatit Doberdol që kishte një pakënaqësi të qytetarëve gjatë dëgjimit publik nuk pash askund pakënaqësi të theksuar të qytetarëve me këtë rregullore.
Çështja tjetër të cilën dua ta theksoi të cilën e ka sjellë drejtoresha e DA-së para nesh një email përmes të cilës ka kërkuar sqarime nga ministria përkatëse për rregulloren se a është në përputhje me rregullativën e përgjithshme ligjore të nivelit nacional unë mund t'ju them se ky email është dërguar më datë 17qershor mirëpo nuk ka marrë përgjigje drejtoria dhe si e tillë kjo çështje duhet të mbyllet për shkak se brenda kornizave të afatit ligjor drejtoria nuk është përgjigjur drejtorisë përkatëse atëherë ne duhet të shkojmë me hapat e më tejshëm, po ashtu procesverbalet edhe pse na erdhën shumë vonë unë i lexova me shumë kujdes përndryshe nuk pash ndonjë propozim i cili do mundej të inkorporohet në rregullore, propozim i cili do të jetë efektiv në menaxhimin e ardhshëm të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.
Pasi që janë shter gjitha diskutimet kjo rregullore duhet të hidhet në votim për shkak se kjo rregullore po prolongon punën e këshillave të fshatrave, po prolongon bashkëpunimin institucione qytetar për ndërtimin dhe zgjedhjen e problemeve të thjeshta të qytetarëve me të cilat po ballafaqohen, kjo rregullore nuk ka të bëjë me çështje personale, kjo rregullore kërkohet në vazhdimësi me ngulm nga shoqëria civile në komunën tonë, si mendim shoqëria civile duhet të respektohet dhe për këtë kam marrë iniciativën që kjo rregullore të kaloj në fazat e mëtejshme, në qoftë se kjo rregullore nuk është në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi MAPL-ja e jep mendimin e saj pasi t'i kalon procedurat dhe ne si argument për këtë çështje e kemi edhe emalin e dërguar nga drejtoresha e Drejtorisë së Administratës të cilës drejtoria e linjës nuk i është përgjigjur.

**z.Haki Rudari**, theksoi, unë e dëgjova kolegun parafolës por megjithatë disa çështje janë krejt ndryshe në procesverbal ngase në procesverbal ka pas vërejtje nga qytetarët lidhur me bashkimin e shumë fshatrave në një këshill disa nga këta i pash edhe unë se pat vërejtje nga përfaqësuesit e fshatrave Herticë, Shajkofc, Siboc, Gllamnik, dhe kjo nuk qëndron sepse ka pas vërejtje nga qytetarët.
Në bazë të rregullores në nenin 4 paragrafi 1 thuhet në territorin e Komunës së Podujevës themelohen këshillat lokale përkatësisht 6 këshilla lokale urbane në qytet dhe 24 këshilla lokale nëpër fshatra që nënkupton se në të gjitha fshatrat e Komunës së Podujevës janë vetën 24 këshilla lokale, në bazë të kësaj rregulloreje duhet të bashkohen shumë fshatra në një këshill kështu që vërejtjet e qytetarëve janë prandaj unë mendoj se ende duhet të përgatitet kjo rregullore, unë e respektoj shumë shoqërinë civile megjithatë votën time shoqëria civile nuk mund të ma imponoj, sistemin nervor e tha kryetari askush nuk mund ta imponon dhe koordinon, atë e bëj vet.
Duke u nisur nga kjo mendoj se interesi i të gjithëve është që të përgatitet sa më mirë kjo rregullore në të ardhmen në mënyrë që kur të dalim në terren të zbatohet sepse këtu parashihet formimin i një komisioni prej 5-9 anëtar andaj po e citoj nenin 5 paragrafi 1 ku thuhet se këshilli lokal mund të ketë 5- 9 anëtar, nëse ka diçka le të më përmirëson edhe drejtori mirëpo kështu thuhet në rregullore prandaj asgjë nuk është nëse këtë rregullore e lëmë për seancën e ardhshme në mënyrë që të jemi më të përgatitur edhe si subjekte politike por pse jo edhe shoqëria civile.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, themelimi i këshillat të fshatrave është një problematik që ka kohë që mungon dhe është duke u shty kjo procedurë andaj është mirë që bashkarisht të koordinohemi dhe të dalim sa më mirë të gjithë por është koha që në fund të kryhet ky proces për shkak se dikush duhet me i përcjellë problemet e qytetarëve nëpër fshatra andaj ndryshe është kur nuk kemi përfaqësues të tyre për t’i adresuar problemet e tyre  sepse mbushet drejtoria me 100 kërkesa të tyre por kur është përfaqësuesi i tyre lehtësohet puna nëm zyre të drejtorisë dhe duhet t’i japim prioritet kësaj pune.
Unë i përkrahi dy propozimet por duhet ta gjejmë mënyrën më të mirë të mundshme që të bëhet një zgjidhje dhe ta thërrasim një mbledhje sa më shpejt që të jetë e mundur që ta tejkalojmë këtë dhe të zgjidhet ky problem se ka kohë që na mundon të gjithëve.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, sa i përket themelimit të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane është e vërtetë se është e nevojshme që të formohen sa më parë sepse këtë më parë e dëgjova nga kryetari se këto këshilla nuk janë të themeluara dhe nuk funksionojnë sepse ju ka kaluar mandati, këshillat e fshatrave në Komunën e Podujevës janë të konstituara nëse nuk gaboj në bazë të një vendimi të Kuvendit të Komunës së Podujevës të vitit 2001 dhe atë si rezultat në bazë të rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve lokale janë përcaktuar atëherë dhe tani quhen komitete të fshatrave dhe këshilla të fshatrave, që nga ajo kohë e deri pas shpalljes së pavarësisë kemi pasur udhëzimin e parë pastaj udhëzimin e dytë dhe sa kam njohuri ky është udhëzimi i tretë nga niveli qendror për organizimin e nen nivelit komunal. Në bazë të ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale është kompetencë e komunës dhe duke parë se kemi pasë një laramani të organizimit të niveleve nën komunale duke filluar nga komuna fqinjë e Prishtinës që ka funksionuar në sistemin e ish bashkësive lokale pastaj komuna të ndryshme kanë pasë shpërblimet për bartësit gjegjësisht për kryetarët e komiteteve dhe ne kemi mbete në atë fazë ku kemi mbete dhe e pranojmë ose jo jemi në një fazë ku  komitetet e fshatrave dhe lagjeve urbane nuk mund t’i konsiderojmë se i kemi të organizuara aq mirë dhe që janë si adresë e parë e qytetarëve për shqetësimet dhe kompetencat e tyre, kompetencat e tyre varen nga ne se a dojmë të delegojmë kompetenca te ta dhe nuk them se kjo është forma më e mirë që vendosim por në një formë prapë i kthehem planit të punës që e kemi pasë në muajin prill ose muajin maj dhe jemi duke u vonuar kur më parë biseduam për kornizën afatmesme buxhetore që na ka shkaktuar telashe shkaku i organizimit të debateve publike, shkaku se nuk i kemi pasur funksionale këto komitete.

Unë mendoj se sa më shpejtë duhet të punojmë në ndërtimin e këshillave të fshatrave, sa i përket asaj se do të kemi probleme në riorganizimin e fshatrave se më parë kanë qenë bashkësi lokale pastaj çdo fshat e ka pas komitetin e tij e tani me këtë udhëzimin administrativ na bie t'i reduktojmë këshillat e fshatrave gjegjësisht bashkimin e dy apo më shumë fshatrave në një këshill por fundja ne duhet të veprojmë dhe veprimi është ky që po ndodh sot, ne duhet të marrim një vendim dhe të provojmë t'i funksionalizojmë ato këshilla të fshatrave dhe sigurisht që do të ketë shtyrje sa i përket zgjedhjes së kryetarit të këshillit të fshatrave se nga cili fshat do të jetë se ky është mentaliteti ynë, mirëpo nëse rrimë dhe s'na pëlqen ky udhëzim administrativ derisa të krijohet hapësirë për një udhëzim tjetër dhe për komunën tonë nuk bëhet një udhëzim tjetër sepse ky udhëzim vlen për tërë territorin e Republikës së Kosovës andaj ne deshëm apo jo duhet t'i përmbahemi këtij udhëzimi administrativ në përpjekjet tona për të pasur këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane sa më funksionale.
Në rend të parë kishin me qenë ndihmëse edhe për vetë funksionimin e pushtetit lokal do të caktoheshin adresa që edhe qytetari dhe ekzekutivi të këmbejnë informacione të ndërsjella dhe për atë ne na bëri që ta votojmë dhe trajtojmë si pikë të rendit të ditës, sigurisht se do të ketë probleme por nuk besoj se do të ketë probleme të natyrës që nuk mund të zgjedhën edhe pse është përcaktuar numri maksimal ne në një punëtori që e kemi pasë sa di unë prezent ka qenë edhe tashmë drejtori i DSHPMSHP që në atë kohë ishte drejtor i DA-së, aty kemi biseduar që ndoshta kishte qenë më mirë që të reduktohen numrat e këshillave të fshatrave, neve nuk na përkufizon askush që të zbresim më pak dhe si alternativë kemi organizimin e 19 këshillave të fshatrave dhe këshillat tjerë të lagjeve urbane, si do qoftë sot ne kemi një propozim të kolegut z.Ragip Fetahu që të merret vendim për funksionalizimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe të shohim se si do të dalin në terren deh çfarë mund të bëjmë.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, ne të gjithë e dimë këtu se asnjëri nuk jemi kundër formimit të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane por problemi kryesor është se nga ana e ministrisë na është thënë se kjo nuk është në përputhje me hartën zonale dhe i gjithë problemi është këtu që mos të nxjerrim një vendim që është jo ligjor, kështu që unë propozoj që në mbledhjen e ardhshme Drejtoria e Administratës të na sjellë informacione plotësuese për këtë pikë të rendit të ditës dhe të vazhdojmë tutje se është bërë mund i madh këtu, ka 2 ose 3 vite që kjo draft rregullore është proceduar në kuvend kështu që mos ta çojmë huq gjithë atë mund por të marrim një vendim që është në zbatueshmëri të ligjit.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, është e vërtetë se në materialin që kemi marrë nga drejtoria përmendet harta zonale por hartat zonale nuk përcaktojnë ndarjen apo administrimin e një nën niveli komunal, nuk do të thotë që hartat zonale e përcaktojnë atë, s'kanë të bëjnë asgjë me organizimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, hartat zonale nuk na e pakësojnë apo rrisin numrin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, ndoshta po e teprojmë pak mirëpo kjo rregullore i ka kaluar të gjitha fazat edhe fazën e diskutimit publik dhe atë të fazë ku secili nga ne asamblistët ka pasë mundësi që t'i paraqes idetë e tij për ndryshime, rritje apo zvogëlim të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, pra ka pasë mundësi që ta heq apo shtoj një këshill, megjithatë këtë e potencoj edhe kryetari që ka një problematikë te fshati Gllamnik që është i përfshirë në një këshill me fshatrat Llapashticë e Epërme dhe Llapashticë e Poshtme unë propozoj që fshati Gllamnik të jetë në një këshill me fshatrat Siboc i Epërm dhe Siboc i Poshtëm dhe me këtë propozim ndryshim rregullorja të hidhet në votim.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës-DA, theksoi, i nderuar këshilltar z.Ragip Fetahu, çuditërisht materialin e kemi përgatitur brenda ditës sot, sa për dijeninë e juaj përgatitja e materialit bëhet nga ana e zyrtarëve përkatës e jo nga ana jonë si ekzekutiv gjithsesi shpresoj se e keni pasë kohën e mjaftueshme për ta analizuar materialin dhe për të marrë vendimin më të mirë të mundshëm në interes të qytetarëve, sa i përket kësaj draft rregulloreje ne si ekzekutiv e kemi përgatitur

një grup punues i cili është munduar të bëjë më të mirën e mundshme lidhur me organizimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.
Komuna e Podujevës është njëra Komuna që ka numrin më të madh të fshatrave në territorin e Republikës së Kosovës dhe numri i këshillave të fshatrave përkufizohet me udhëzim administrativ që është maksimumi 30 këshilla të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane, ky numër është i pa mjaftueshëm për të organizuar fshatrat ashtu siç i kemi pranuar propozimet nga ana e qytetarëve në dëgjimet publike, propozimi juaj që fshati Gllamnik të përfshihet në një këshill lokal me fshatrat Siboc i Epërm dhe Siboc i Poshtëm, nuk mund të jetë si propozim sepse nuk është në përputhje me udhëzimin administrativ dhe propozimet e qytetarëve nuk mund të merren parasysh sepse udhëzimi administrativ në mënyrë imperativë thekson që Komuna e Podujevës mund të organizoj vetëm 30 këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane.
Për këtë arsye unë propozoj që kjo draft rregullore të mos miratohet tani por të pritet derisa të marrim një mendim apo vendim nga ana e MAPL-së, për të na treguar në qoftë se ne duhet t'i fillojmë edhe njëherë procedurat nga fillimi, të mbahen dëgjimet publike, të bëhet një organizim më i mirë i këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane në mënyrë që të kemi implementimin e tyre në praktikë dhe të rregullohet ky organizim në mënyrën më të mirë të mundshme, gjithsesi vendimi është i juaji dhe presim vendimin nga ana e juaj.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, këtu kemi dy propozime atë të z.Ragip Fetahu që të miratohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës dhe kemi propozimin e drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës znj.Antoneta Ejupi që sipas saj kjo rregullore nuk i ka kaluar ende gjitha procedurat dhe si e tillë nuk mund të vihet në votim kështu që kjo mbetet në dorën e juaj, mirëpo unë nuk e shohë këtë procedurë si të ngutshme sepse nuk është diçka urgjente prandaj besoj që në një periudhe kohore prej një ose dy muajsh e kemi mundësinë që ta miratojmë këtë rregullore.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, para jush e keni draft rregulloren dhe nga ajo që shihet ka lëshime por nëse ju si asamblistë mendoni se është në rregull gjithçka ne vazhdojmë tutje nuk kemi kurrfarë problemi, t'ju them të drejtën për ne nuk është punë e lehtë që të rikthehemi edhe një herë dhe të merremi me gjithë procesin e kësaj rregulloreje, unë nuk i di arsyet pse kanë ndodh këto por nëse e bëni vetëm një analizë të thjeshtë të nenit 4 paragrafit 1.8 të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës kemi këshillin lokal të fshatrave Kërpimeh, Metehi, Repë, Sylevicë, nëse fshatrat Repë dhe Sylevicë i bëjmë në një këshill e kemi shumë problem por është problem të jenë në një këshill edhe fshatrat Repë dhe Metehi ose fshatrat Pakashticë e Epërme dhe Pakashticë e Poshtme të jenë në një këshill me fshatin Revuç, gjeografikisht lidhen këto fshatra mirëpo nga praktika ne e dimë se fshati Pakashticë gjithmonë ka pasur lidhje me fshatrat Kërpimeh dhe Metehi si bashkësi lokale këtë mund të na tregoj edhe asamblisti i nderuar që është më i moshuari këtu z.Fahri Hasani sepse e dinë këtë më së miri si ka funksionuar.
Mendoj se ndoshta më së miri është dashur të funksionoj ajo formë që ka qenë ose kemi shembuj tjerë që janë në një këshill fshatrat LLapashticë e Epërme dhe Llapashticë e Poshtme, mirëpo unë e kam pas një draft rregullore tjetër ku në këtë këshill ka qenë pjesë edhe fshati Gllamnik, mirëpo në një këshill lokal mendoj se mund të jenë fshatrat Gllamnik dhe Sibofc ashtu siç kanë funksionalizuar gjithmonë, fakti që më brengos këtu është përbërja e këshillit të fshatrave Brainë, Kalaticë, Bërvenik, Metergofc, Bllatë, Muhazob si dhe këshilli i fshatrave Orllan,Turuçicë, Rakinicë, Kushevicë, nëse e marrim në tërësi numrin e banorëve mendoj se fshati Orllan tërësisht do ta mbulonte atë zonë sepse nuk ka banorë dhe do të kishim mundësi ta bënim një këshill të një fshati tjetër që ka numër më të madh të banorëve dhe të krijonim një komoditet që me pasë zgjidhje brenda për brenda.

Sa i përket këshillit të fshatrave Barainë, Batllavë, Radujevë, faktikisht fshati Radujevë s'ka banorë mirëpo fshati Barainë me fshatin Batllavë nuk kanë korresponduar asnjëherë sepse gjithherë fshati Barainë ka korresponduar kah fshati Orllan, pastaj kemi këshillin e fshatrave Ballofc, Lladofc, Herticë, Surdull, në këtë rast fshatrat Ballofc dhe Lladofc t'i lëm në një këshill me fshatrat Herticë dhe Surdull nuk më duket se korrespondojnë shumë mes veti ose këshillin e fshatrave Godishnjak, Kunushefc, Buricë, Penuhë kur dihet se fshati Godishnjak asnjëherë nuk ka korresponduar kah fshati Penuhë përkundrazi fshati Penuhë ka korresponduar kah fshati Lluzhan si qendër lokale po nuk ka ndodhur e kundërta, si do që të jetë nëse ju si kuvend sot e votoni këtë draft rregullore besoni se neve na e lehtësoni shumë punën dhe do ta bënim një veprim të mirë por praktikisht sa do të jetë e mundshme zbatimi i saj ajo është një pikëpyetje dhe për këtë duhet të na ndihmojnë këta propozuesit e kësaj pike të rendit të ditës për ta zgjedhur problemin e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane praktikisht.
Unë e di se një gjë e tillë praktikisht paraqet problem për tu zbatuar por si do qoftë po them për neve si ekzekutiv pavarësisht asaj që ne kemi diskutuar edhe me drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës dhe në një farë forme edhe unë nuk pajtohem që të kaloj kjo draft rregullore por parimisht nëse sot ju e votoni këtë neve na e lehtësoni shumë punën dhe pastaj na mbetet të fillojmë me proceset tjera për formimin e këtyre këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
Se a është e nevojshme të ecim tutje me këtë proces, është shumë e nevojshme sepse shumë lokalitete i kemi pa përfaqësues tani për tani, ndoshta në mesin e dy propozimeve jo të mira mendoj se më mirë të kemi një propozim jo të mirë se sa mos të kemi kurrfarë propozimesh, kështu që për këtë rregullore mbetet që ju të vendosni, të merrni ose jo vendim si kuvend, nëse e shtyni përpara këtë si proces ne ecim tutje por tani unë mund t'i jap disa propozime të vogla të cilat mund t'i inkorporonim brenda seancës edhe pse jemi para publikut por nuk e di se sa do të jenë këto propozime të qëndrueshme për të përmirësuar diçka që nuk është në rregull.
Si do qoftë janë dy alternativa përpara nëse e votoni këtë draft rregullore neve na ndihmoni shumë nëse votoni kundër ne na shtoni punë shtesë por besoj se nxjerrim version më të mirë, tani mund të themi se kemi një situatë të ngjashme me atë të miratimit të hartës zonale të Komunës së Podujevës sepse kemi këtu dy mundësi të shkojmë me mundësinë e parë për ta votuar këtë draft rregullore dhe mundësia e dytë për t'iu kthyer procesit dhe për të punuar dy ose tre muaj deri në finalizimin e kësaj draft rregulloreje, të gjithë fshatrat kanë nevojë që të kenë një përfaqësues të mirëfilltë sepse edhe koordinatori i fshatrave në Komunën e Podujevës me një organizim do të mund të fillonte punën me përfaqësuesit e fshatrave.
**z.Kasib Bashota**, theksoi, për këtë çështje nëse drejtoresha e DA-së na e jep një afat kohor deri në seancën e radhës ndoshta do të kishim mundësi t'i harmonizonim qëndrimet dhe t'i eliminonim ato defekte për të cilat thuhet se janë dhe t'i ndërlidhim fshatrat që kanë lidhje gjeografike sa i përket shtrirjes territoriale në mënyrë që të kemi sa më pak probleme.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, nga drejtoresha e DA-së, kërkoj një sqarim nëse shtyhet procesi i votimit të kësaj rregulloreje kush do t'i bëjë përmirësimet dhe në çfarë afati kohor sepse edhe unë kam vërejtur se këshilli lokal i fshatrave Obrançë, Peran, Bradash, Dobratin nuk është në rregull sepse janë fshatra të mëdha dhe nuk mund ta kenë vetëm një këshill, (pse po qesh i nderuar Kryetar kur po e përmendi fshatin Bradash, ti e kapërceve por në rend të parë paska qenë nuk e përmende, ti dhe ai keni dalë në Prishtinë tani s'keni punë me këto fshatra), sa i përket këshilli lokal i fshatrave Obrançë, Peran,Bradash, Dobratin dua ta di se a ka mundësi që të ndahen nga përbërja e këtij këshilli këto fshatra dhe në cilin afat kohor kur dihet se numri i këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane nuk mund të jetë më i madh se 30 prandaj pyes se a mund të bëhet ndonjë riorganizim ndryshe.
**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, përderisa shohim se ka paqartësi rreth kësaj rregulloreje dhe shihet mos zoonimi i fshatrave unë mendoj se duhet të përmirësohet përbërja e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe të shtyhet kjo rregullore për një seancë tjetër dhe të na sjellët pak më e përgatitur.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, po mundohem t'i jap disa sqarime, neve po na pengon organizimi që e kemi në këtë draft rregullore, ky nuk është një dokument i miratuar ky kuvend ka kompetencë dhe ne jemi ata që vendosim për këtë rregullore e jo drejtoresha e DA-së, nëse dikush mendon se duhet të bëhet një organizim tjetër më i përafërt dhe më i qëlluar i këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane le të bëjë propozimin në foltore, propozimi le të dal në votim dhe bëhet ndryshim plotësimi i kësaj draft rregulloreje dhe ky dokumet del si dokument final.
Nuk e di pse kemi shumë kundërthënie këtu se qenka shkruar në dokument kështu por ne mendojmë se duhet të jetë kështu sepse ne mund t'i bëjmë ndryshimet se ne në kuvend jemi vendimmarrësit që mund të bëjmë ndryshime kaq kisha për të thënë.
**z.Kasib Bashota**, theksoi, a është e mundur të bëhet një komision brenda kuvendit dhe t'i përafroj këto qëndrime dhe kundërthënie sa i përket rregullores në fjalë.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, a kemi vullnet nëse mundemi këtu drejtpërdrejtë me i bë disa ndryshime të vogla dhe të vazhdojmë tutje por së pari duhet të shikojmë se a kemi vullnet për këtë çështje si grupe të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë kuvend.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, ne tani jemi në këtë fazë ku kemi dy rrugë ose ta refuzojmë si dokument ose ta përpunojmë këtë dokument ashtu siç mendojmë ne që të bëjmë një draft rregullore më të favorshme ose ta shtyjmë për një seancë të radhës.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, këtu në foltore po i jap disa propozime si sugjerime por nuk është e thënë se ju duhet t'i pranoni por edhe ju i jepni mendimet e juaja dhe t'i bëjmë korrigjimet shpejtë e shpejtë dhe të vazhdojmë tutje, nëse pajtohemi, ta marrim shembull këshillin lokal të fshatrave Obrançë, Peran, Bradash, Dobratin, kemi numër të madh të banorëve, ne mund ta votojmë këtë draft rregullore si është tani dhe të shohim se a mund të realizohet një gjë e tillë praktikisht nëse jo atëherë pastaj e bëjmë plotësim ndryshimin e saj.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, është mirë që të marrim pauzë 15 minuta, pastaj të diskutohet për këtë çështje.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë kërkesën e propozuesit e vë në votim.

*Mbështetet kërkesa për një pauzë të shkurtër, dhe atë duke filluar nga ora 16:15, me qëllim të konsultimeve mes përfaqësuesve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend dhe Ekzekutivit të Komunës, lidhur me gjetjen e mundësive për rishqyrtimin e draftit aktual të Rregullores në fjalë, me qëllim të dhënies së një zgjidhje sa më të mirë të mundshme sa i përket organizmit të këshillave lokale.*

*Pas pauzës, mbledhja nis të vazhdoi në në ora 16;35.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke konstatuar kuorumin, theksoi, në pamundësi për të vazhduar për shkak të mungesës së kuorumit ju njoftojmë për vazhdimin e kësaj seance, mirëpo e vlerësoj të arsyeshme t'ju njoftoj se në takimin që kishim mes shefave të Grupeve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend, Kryetarin e Komunës dhe drejtorëve të Drejtorive përkatëse, formuam një ekip që do ta shqyrtojë edhe njëherë këtë draft Rregullore para se e njëjta të sjellët sërish në Kuvend për miratim final. Ekipa në fjalë përbëhet nga; z.Kasib Bashota, z.Ragip Fetahu, z.Naim Çunaku, z.Valon Demolli, znj.Mimoza Abdullahu, z.Arbnor Fazliu, znj.Mrika Thaçi, z.Gazmend Islami, z.Bahri Selimi, z.Leutrim Krasniqi, znj.Antoneta Ejupi, z.Latif Mehmeti, z.Sabedin Namani dhe z.Enis Sheholli.

*Meqë në sallë janë vetëm 15 anëtar/e të Kuvendit dhe nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen e filluar sot, Kryesuesi i Kuvendit ndërprenë mbledhjen dhe në dakordim me anëtarët e Kuvendit që janë të pranishëm konstatohet se për vazhdimin e kësaj mbledhje, datën, kohën, vendin dhe çështje tjera të nevojshme, do të njoftohen me shkrim gjithë anëtarët e Kuvendit, institucionet përkatëse dhe publiku i gjerë.* Mbledhja ndërpritet në ora 17:45

**<u>Vazhdimi i mbledhjes, më 15 korrik 2022</u>**

Vazhdimi i mbledhjes filloi në orën 10:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, në ndërtesën e re të Komunës së Podujevës.
Mbledhjen e vazhdoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës.
Në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm ishin 26 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, kurse 9 anëtar/e (z.Demokrat Hodolli, znj.Arnisa Sylejmani, znj.Donjetë Sheqiri, z.Ilir Koprani, znj.Tringa Sfishta, znj.Endritë Murati, znj.Mimoza Abdullahu, z.Arbnor Fazliu, dhe z.Gazmend Islami), nuk ishin prezent.
Gjithashtu në mbledhje e pranishme ishte Nënkryetarja e Komunës znj.Marigona Lahu, U.D. drejtoresha e Drejtorisë së Administratës znj.Antoneta Ejupi, U.D. drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM z.Leutrim Krasniqi, U.D. drejtori i Drejtorisë së Arsimit-DKA z.Avni Fetahu, përfaqësues të OJQ-së SDK, media lokale dhe një numër i zyrtarëve komunal.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi vazhdimin e mbledhjes së datës 30 qershor 2022 të ndërprerë në mungesë të kuorumit, për të vazhduar aty ku ka mbet, sot më 15 korrik 2022.
Para se të fillojmë konstatohet se në bazë të nënshkrimeve në listën e pjesëmarrjes dhe verifikimit nga ana e zyrës për punë të Kuvendit, prezent në sallë momentalisht janë 26 anëtar/e të Kuvendit, kurse për momentin mungojnë 9 anëtar/e.
Si proces kemi mbet në shqyrtimin e pikës së 9-të të rendit të ditës që është draft Rregullorja për organizmin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, siç dihet në këtë pikë ne gjatë diskutimeve kemi kërkuar një pauzë 30 minuta për t'i harmonizuar qëndrimet e partive politike në lidhje me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane, kështu që ka qenë një problem goxha i madh deri te realizimi i tyre për shkak se kemi 78 vendbanime në Komunën e Podujevës dhe ndarja e tyre në 30 këshilla nuk ka qenë e lehtë.
Gjatë diskutimeve jemi munduar që të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë mirëpo kur jemi kthyer në sallë ka munguar kuorumi dhe mbledhja është shtyrë për një datë tjetër, kjo datë është caktuar për sot më 15.07.2022, prandaj sot prapë do të diskutohet për draft rregulloren që për të cilën është diskutuar edhe në seancën e kaluar mirëpo ndryshimet janë bërë kryesisht vetëm në nenin 4 të rregullores, prezent i kemi edhe drejtoreshën e DA-së dhe drejtorin e DPUMM-së, për sqarime tjera fjalën ia kaloj drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës znj.Antoneta Ejupi.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, ashtu siç e theksoi edhe kryesuesi jemi në vazhdimin e mbledhjes së datës 30.06.2022, në të cilën ka mbetur pa u shqyrtuar pika e cila ka qenë si pikë shtesë e rendit të ditës që është draft rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, kjo draft rregullore i ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme për hartimin e një akti siç është shqyrtimi fillestar pastaj miratimi për konsultim publik dhe çështjet e tjera procedurale.
Lidhur me këtë draft rregullore janë mbajtur dhe kanë përfunduar diskutimet publike me ç'rast janë përpiluar edhe raportet përkatëse të cilat në mbledhjen e fundit ju keni pasur mundësi që t'i shqyrtoni dhe t'i analizoni do të thotë ky dokument ka qenë si pikë shtesë e rendit të ditës dhe deri në një masë është shqyrtuar mirëpo me pajtimin e të gjitha grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës si dhe në pajtim me ekzekutivin e komunës jemi dakorduar që të mbahet një pauzë me qëllim të organizimit më të mirë të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane, në këtë draft rregullore kanë qenë disa pjesë të tjera të cilat nuk kanë qenë të pa plotësuara, kan qenë përshkrimi i këshillave urbane dhe hartat e këshillave të fshatrave.

Gjithsesi pas pauzës me rastin e kthimit në kuvend nuk ka qenë numri i mjaftueshëm i asamblistëve për të krijuar kuorumin dhe për këtë arsye kryesuesi e ka ndërprerë mbledhjen me qëllim që e njëjta të vazhdohet pas disa ditëve, me përfundimin e punimeve nga ana e ekipit punues ekip ky që ka qenë në përbërje prej anëtarëve nga radhët e ekzekutivit dhe përfaqësues nga të gjitha subjektet politike të Kuvendit të Komunës së Podujevës.
Pas këtij takimi ne si ekip punues kemi bërë ndërhyrje përkatësisht e kemi bërë harmonizimin e kësaj draft rregulloreje përkatësisht në nenin 4 ku kemi bërë një organizim ndryshe të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në mënyrë që të bëhet ndarja më e mirë e këtyre këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane pasi që me udhëzim administrativ përcaktohet se Komuna e Podujevës mund t'i ketë 30 këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe për këtë arsye ne e kemi mbajtur këtë takim punues me që rast kemi bërë ndryshime në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
Unë mund t'i lexoj ndryshimet e bëra sa i përket këshillave të fshatrave kurse për ndryshimet e bëra për këshillat e lagjeve urbane sqarimet para jush do t'i bëjë drejtori i DPUMM-së, gjithsesi nëse ju e shihni të arsyeshme pas këtij leximi propozoj që ta mbajmë një pauzë 15-20 minuta që të keni mundësi që të analizoni draft rregulloren dhe të keni mundësi që t'i paraqisni propozimet dhe sugjerimet e juaja. Atëherë ne kemi bërë ndarjen e fshatrave në 24 këshilla, po filloj me këshillin lokal të fshatrave Murgull, Tërrnavicë, Reçicë, Sllatinë, Brecë, Dvorishtë, Pollatë, Potok, Zhiti, gjithsesi dua të theksoi që në bazë të udhëzimit administrativ një këshill nuk mundet t'i ketë në përbërje më shumë se 9 fshatra dhe për këtë arsye nuk kemi mundur që ta kalojmë këtë përbërje e ti kemi më shumë se 9 fshatra në një këshill dhe kjo ndarje e fshatrave është bërë duke marrë parasysh afërsinë dhe lidhjen e fshatrave mes tyre si dhe numrin e banorëve.
Në këshillin tjetër lokal bëjnë pjesë fshatrat Kërpimeh, Metehi, Repë, pastaj kemi këshillin lokal të fshatrave Sylevicë, Revuç, Pakashticë e Epërme dhe Pakashticë e Poshtme, këshilli lokal i fshatrave Dobërdol, Zakut, këshilli lokal i fshatrave Dobratin, Bajçinë, këshilli lokal i fshatrave Bradash, Peran, këshilli lokal i fshatrave Velikarekë, Obrançë, këshilli lokal i fshatrave Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, këshilli lokal i fshatrave Sallabajë, Shakovicë, Godishnjak, këshilli lokal i fshatrave Lluzhan, Llugë, këshilli lokal i fshatrave Buricë, Kunushefc, Penuhë, këshilli lokal i fshatrave Sibofc i Poshtëpm, Sibofc i Epërm, këshilli lokal i fshatrave Kaçybeg, Gërdofc, këshilli lokal i fshatrave Bellopojë, Tërrnavë, Halabak, këshilli lokal i fshatrave Batllavë, Dyz, Barainë, Radujevë, këshilli lokal i fshatrave Orllan, Muhazob, Metërgofc, Bllatë, Bërvenik, Kalaticë, Brainë, Kushevicë, këshilli lokal i fshatrave Herticë, Turuçicë, Rakinicë, Surdull, këshilli lokal i fshatrave Ballofc, Lladofc, Shajkofc, këshilli lokal i fshatrave Shtedim, Mirofc, Livadicë, Merdar, këshilli lokal i fshatrave Surkish, Sfeçël, Dumosh, këshilli lokal i fshatrave Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Epërme, Llaushë, Përpellac, këshilli lokal i fshatit Letanc.
Para se të filloj drejtori i DPUMM-së të prezantoj ndarjen e lagjeve urbane dua të theksoi që ne si ekip jemi munduar që ta bëjmë më të mirën e mundshme për organizimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane brenda mundësive dhe kornizave të lejuara ligjore. Gjithsesi miratimi i kësaj draft rregulloreje mbetet në dorën e juaj, të gjithë jemi në dijeni që kjo rregullore është stërzgjatur shumë andaj mendoj se duhet t'i jepet një përfundim, konkretisht një epilog këtij dokumenti.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, siç e ceku edhe drejtoresha e DA-së për ndarjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane që janë gjithsej 30 sosh, unë nuk do të ndalem në pjesën e këshillave të fshatrave por do të mundohem që të elaboroj pjesën e shtrirjes dhe formimit të këshillave të lagjeve urbane. Ne kemi 24 këshillat të fshatrave dhe 6 këshilla të lagjeve urbane në ndarjen e këshillave të lagjeve urbane janë marrë për bazë elementet më të rëndësishme duke filuar prej rrugës magjistrale Podujevë – Prishtinë, konkretisht prej rrugës "Gryka e Llapi", lumit Llap, hekurudhës si dhe të rrugëve regjionale.

Këshilli lokal urban qendra 1 është në pjesën perëndimore përgjatë lumit Llap ku gjendet rr.“Met Podujeva”, duke vazhduar te pjesa e urës që është rr. ”Vëllezrit Frashëri”, rr.”Besnik Restelica”, duke vazhduar pastaj në rr. “Ali Ajeti”, dhe në pjesën lindore kufizohet me hekurudhën, pastaj vazhdon në pjesën veriore në rr.“Ilir Kunushefci”, deri te rrethrrotullimi i rr.”Afrim Zhitia”, dhe përfundon në rr.”Xhemajl Mustafa”ku është ura nën të cilën kalon lumi Llap, këshilli lokal urban qendra 2 kufirin perëndimor e ka lumin Llap, kufi jugor rrugën magjistrale Podujevë – Prishtinë, kurse në pjesën lindore kufij është rruga regjionale që kalon nëpër qytet rr.”Ali Ajeti”, duke vazhduar në pjesën veriore që kufizohet me rr.”Besnik Restelica”, dhe rr.”vëllezërit Frashëri.

Këshilli lokal urban qendra 3 perëndim kufij lindor e ka lumin Llap pastaj në pjesën jugore kufij është rruga magjistrale Podujevë – Prishtinë, dhe përfundon në zonën kadastrale të fshatrave Llapashticë e Poshtme, Llapashticë e Epërme, Obrançë deri te rruga “Ismet Dërguti”, që i ndan rr.“Skenderbeu”, rr.”Xhemajl Mustafa”, rr. “28 Nëntori” që ndryshe njihet si pjesa e rrugëve te rreth rrotullimi për fshatin Kërpimeh, këshilli lokal urban qendra 4 veri, kufirin verior e përbëjnë zonat kadastrale të fshatrave Obrançë, Letanc, Dumnicë e Poshtme, Livadicë, kurse kufirin jugor e përbën rr.”Ilir Kunushefci”, duke vazhduar deri te rreth rrotullimi i rr.”Afrim Zhitia”, dhe rr.”Xhemajl Mustafa”, që përfundon përsëri te rreth rrotullimi i rrugëve “Skenderbeu”, rr.”Xhemajl Mustafa”, rr.“28 Nëntori”.

Këshilli lokal urban qendra 5 jug kufirin verior e ka rr.”Gryka e Llapit”, kufi jugor e ka zonat kadastrale të fshatrave Llapashticë e Poshtme, Gllamnik, Surkish, Ballofc, Shtedim, Këshilli lokal urban qendra 6 lindje në pjesën më perendimore ka kufij hekurudhën pastaj vazhdon në rr.”Ali Ajeti”, në rrugën magjistrale Podujevë Prishtinë, zonat kadastrale të fshatrave Shtedim, Livadicë dhe në pjesën veriore është i kufizuar me rr.”Ilir Kunushefci”, Kjo pak a shumë ishte elaborimi i ndarjes së këshillave urban që është bërë në bashkëpunim me komisionin.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, së pari është e pa pranueshme dhe jo serioze nëse na e sillni materialin në seancë, së paku materialin është dashur ta pranojmë në momentin kur është thirrur seanca, nuk është material që përpunohet ose shtjellohet për çështje të minutave prandaj ne grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk e përkrahim këtë, as anëtarëve që kanë marrë pjesë në komision nuk ua keni dërguar materialin. Qasje jo serioze nëse mund të themi për një pikë shumë të rëndësishme që ka marrë kohë 6-7 muaj derisa është sjellë kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në vazhdimësi të mbledhjeve në mënyrë ligjore nuk lejohet dërgimi i materialit një ditë më herët, kështu që besoj se asnjë ndryshim nuk është bë nga ai takim që kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e LDK-së, nuk kemi bërë ndryshime sepse ne ashtu jemi dakorduar me të gjithë përfaqësuesit e grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend dhe bashkërisht kemi ardhë në përfundim që materialin ta sjellim në mbledhje dhe këtu ta diskutojmë, kjo ishte marrëveshja jonë prandaj nuk kisha dashur të hap debat para se ta shqyrtoni materialin nëse keni vërejtje unë pajtohem me ju dhe nuk kam asgjë kundër.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, i nderuar kryesues ju e potencuat se nuk ka ndryshime mirëpo unë këtu po shohë shumë ndryshime, unë nuk e di se çka është diskutuar në takim se s’kam qenë prezent për këtë arsye më parë thash se është dashur të na sillet materiali më herët.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në atë takim që kemi pasë kanë qenë të dy përfaqësues nga grupi i këshilltareve të LDK-së.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, ne këtu jemi duke diskutuar për emra të përveçëm nëse nuk gaboj.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kësaj teme ju keni mundur ta formoni një grup dhe të konsultoheni mes veti andaj për mos ta zgjatur më shumë këtë diskutim fjalën ia kaloj z.Naim Çunaku.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kisha dashur që vazhdimi i kësaj seance të ishte në një formë tjetër sepse që në fillim kjo seancë mori rrugë që nuk është e dëshiruar drejt asaj që e kemi synimin.

Për rolin rëndësinë, vonesën e ndërtimit dhe funksionalizimit të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane nuk do të marrë kohë sepse rëndësinë e tyre e ceku edhe drejtoresha e DA-së dhe s'do koment këtu sepse këtë e ka përcaktuar edhe ligji për vetëqeverisje lokale dhe e ka autorizuar Kuvendin e Komunës si organ i cili e ka të drejtën të bëjë organizimin e nivelit nën komunal, e vërtetë e madhe është se prej vitit 2007 e kemi udhëzimin e parë dhe deri sot komuna jonë nuk ka arrit në masën e dëshiruar t'i realizoj këshillat lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane.
Këshillat lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane në një demokraci do të ndikonin drejtpërdrejtë për një qeverisje më të mirë, për një investim më të qëndrueshëm dhe në një formë kur bisedohet për qytetarin ta ofrojmë sa më shumë qytetarin në vendimmarrje aty ku e sheh demokracia, arsyeja që më bëri të dal në foltore të flasë është se në mënyrë kronologjike e shpjegoi drejtoresha e DA-së rrjedhjen e seancës së datës 30.07.2022, pse jemi këtu, këtu jemi që të bëjmë zgjidhje dhe pajtohem me atë që e tha drejtoresha e DA-së në fund të diskutimit se jemi këtu për t'i dhënë një epilog kësaj rregulloreje dhe duhet të dalim nga kjo situatë.
Si do të dalim nga kjo situatë, për të dalur nga kjo situatë në rend të parë na duhet një vullnet i të gjithëve që po bëjmë diçka të mirë për komunën tonë, për këshillat lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane, këtu u potencua disa herë për një punëtori që ishte e organizuar dhe e dakorduar nga të gjitha grupet e këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë kuvend, sepse këshillat lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane në atë moment që të marrin ngjyrime politike nuk do të kemi mundësi t'i themelojmë.
Këshillat lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane nuk janë organe politike por janë jo politike në një masë sa mund të bëhet dhe këtu që në fillim filluam debatin rreth asaj punëtorie dhe është e vërtetë se ai grup punues ishte i përbërë prej anëtarëve të ekzekutivit dhe nga të gjitha grupet e këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë kuvend, në një formë u munduam që të arrijmë më të mirën e mundshme dhe se a e kemi arritur këtë po ose jo jeni ju ata që vendosni, më bëri përshtypje deklarimi i kolegut tim z.Qendrim Softolli i cili me të drejtë tha se nuk na është dërguar materiali sepse i nderuari kryesues ne kemi pas një dakordim që s'ka qenë në formë të shkruar, nuk e kemi pasur as ne materialin deri tani, kjo ka ndodh dhe arsyeja që më bëri të flas është se dakordimi që kemi pasur, disa prej tyre janë avulluar rrugës e njëra ndër to është kjo z.Kryesues.
Në procesin e hartimit dhe organizimit të draft rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, nga punëtoria e organizuar të cilën e ceka më lartë jemi dakorduar që këshillat lokale të jenë më të avancuara dhe më përgjegjëse ndaj nevojave të qytetarëve dhe të jenë sa më funksionale dhe kemi shtuar te neni 8 pikën 4 në draft rregulloren për konsultime në mes të komunës dhe këshillave lokale, në këtë përshkrim pika 4, ka qenë ky propozim nëse unë nuk gaboj dhe ky propozim tani po heshtet pse Komuna përdor platformën elektronike për informimin dhe komunikimin, konsultimin, bashkëveprimin, në këshillat lokale.
Arsyetimi i nenit 8 do të thotë i shtohet pika 4 që ka qenë propozim e që është në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, në harmoni me politikat dhe rregullativën e fushës, transparencës dhe konsultimit publik si dhe në trend me praktikat dhe modelet më të avancuara në këtë fushë përkatësisht me udhëzimin administrativ të MAPL-së nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimeve publike në komuna gjegjësisht neni 10 format dhe teknikat.
Siç e parasheh ai udhëzim administrativ taksativisht në nenin 10 format dhe teknikat e konsultimit publik pika 1.5 janë të obliguar të publikohen në platformën elektronike në ato komuna ku janë aktive dhe ky nuk e di a ishte një lëshim e nderuara znj. drejtoreshë e DA-së, apo mos gatishmëri për përfshirje nuk e di, unë propozoj që kjo të jetë ashtu siç jemi dakorduar që pika 4 t'i shtohet nenit 8.

**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, faleminderit për pyetjen i nderuari z.Naim Çunaku, sa i përket pikës të cilës ju dëshironi që të jetë si klauzolë e veçantë në këtë draft rregullore dua të theksoi faktin që në mbledhjen e fundit ne të gjithë jemi dakorduar vetëm për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje do të thotë ne në seancë këtu kemi thënë që kemi me mbajte një takim punues vetëm me qëllim të organizimit ndryshe të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përkatësisht plotësimit të rregullores që ka qenë për përshkrimin e pjesës urbane dhe krijimit të hartave nga ana e DPUMM-së, do të thotë ne nuk e kemi pasë një pajtim nga ana e juaj si asamblist që të ndryshohet edhe diçka tjetër në këtë draft rregullore. Gjithsesi është shumë e pranueshme kjo pjesa që ju e theksuat konkretisht një platformë e cila duhet të jetë me qëllim të komuinikimit të komunës me këshillat lokale, gjithsesi kjo mund të paraqitet si klauzolë e veçantë pas miratimit të kësaj rregulloreje, me rasin e krijimit të kësaj platforme në mbledhjet e ardhshme ne mund ta vendosim si pikë të rendit të ditës që kjo rregullore të plotësohet edhe me këtë klauzolë.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, drejtoreshë se jemi dakorduar s'ka diskutim, se sot e kemi pikë të rendit të ditës miratimin e draft rregullores dhe po më duket jo e logjikshme që sot kur mundemi me bë pjesë integrale të rregullores, tani një dakordim tonin ta shtyjmë për një seancë tjetër për platformë elektronike po më duket e pa arsyeshme dhe propozimi im ishte decidiv që t'i shtohet kësaj rregulloreje nenit 8 pika 4 dhe kërkoj prej kuvendit të votohet ky propozim për ose kundër nuk ka asnjë arsyetim këtu që në një të ardhme të afërm ose të largët ta fusim këtë klauzolë si pjesë të kësaj rregulloreje kur kemi mundësi që këtë ta bëjmë sot.
**znj.Adelinë Stublla**, theksoi, meqenëse po dihen këto paqartësi në lidhje me këtë draft rregullore ne kërkojmë një pauzë prej 30 minuta pastaj do të diskutojmë për këtë çështje.
**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, propozimin e znj.Adelina Stubulla që të shkojmë në një pauzë për 30 minuata e vë në votim.

*Nga shumica e anëtarëve, mbështet kërkesa për 30 minuta pauzë, dhe atë duke filluar nga ora 10:45.*

*Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 11:20, duke u konstatuar kuorumi ku prezent për momentin janë 26 anëtar/e të Kuvendit të Komunës.*

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani mund të vazhdojmë me punë aty ku kemi mbet.
**z.Haki Rudari**, theksoi, nxjerrja e një rregulloreje për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës është e një rëndësie të madhe dhe të jashtëzakonshme dhe në këtë drejtim mendoj se duhet të jemi shumë unik prandaj dua ta nxjerrim një konsensus për këtë çështje.
Unë edhe në seancën e rregullt pata propozuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës dhe tani po vërtetohet se kam pasur të drejtë për arsye se sot jemi më datë 15.07.2022, dhe ende kemi divergjenca lidhur me këtë, kam dy çështje për këtë rregullore paraprakisht te aspekti i përkufizimit juridik ku neni 2 te përkufizimet shkruhet kryetari i këshillit nënkupton personin më të votuar në tubimin zgjedhor në fshatra po e përsëris kryetari i këshillit nënkupton personin më të votuar në tubim zgjedhor në fshatra. Në nenin 5 paragrafi 11 thuhet kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga anëtarët e këshillit lokal të një fshati vendbanimi apo lagjeje, në nenin 13 thuhet tubimet kanë legjitimitet nëse në një tubim marrin pjesë më shumë se 31 anëtar, neni 5 paragrafi 1 thotë se këshilli lokal duhet të ketë përbërjen prej 5-9 anëtar.

Tani cilës t'i referohemi pra kryetari i këshillit nga këshilli prej 5-9 anëtar që është neni 5 paragrafi 1 apo duhet të zgjidhet sipas përkufizimeve që për hir të transparencës po e citoj se thuhet Kryetari i këshillit nënkupton personin më të votuar në një tubim zgjedhor dhe këto të dyja nuk shkojnë së bashku sepse nuk janë të njëjta, nuk janë të njëjta një tubim zgjedhor dhe një këshill lokal i fshatit prandaj në këtë drejtim duhet të bëhen sqarime dhe ndryshime se një tubim zgjedhor quhet një tubim ku marrin pjesë 31 anëtar por këshilli lokal i fshatit nuk quhet tubim zgjedhor, ai është një këshill lokal që mund të përbëhet 5-9 anëtar që varet nga propozimet e qytetarëve nëpër fshatra.
Sa i përket renditjes kam vërejtje dhe të njëjtën kohë propozim te renditja sepse kam hartën e këshillave lokal të fshatrave andaj kam vërejtje te renditja e këshillit të fshatrave Ballofc, Lladofc, Shajkofc, që është një territor shumë i gjerë dhe mendoj se shumë më mirë do të ishte që Ballofci t'i takoj këshillit lokal të fshatit Herticë sepse lidhen gjeografikisht dhe të jetë një këshill lokal prej dy fshatrave Lladofc, Shajkofc sepse këto dy fshatra kanë një afërsi mes veti.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, kam një propozim sa i përket ndarjes së këshillave lokale të fshatrave realisht shohë ndarjen e këshillit lokal të fshatrave Turuçicë, Rakinicë, Barainë, nga këshilli lokal i fshatit Orllan dhe të gjithë e dimë se këto fshatra kanë qenë pjesë e bashkësisë lokale të fshatit Orllan dhe kjo ndarje është kundërshtuar në diskutime publike gjë që u kundërshtua edhe tani pasi që u prononcua, jam e vetëdijshme që sipas ligjit nuk lejohen më shumë se 9 fshatra në një këshill lokal por të paktën fshati Turuçicë të jetë pjesë e këshillit lokal të fshatit Orllan, ose fshatrat Muhazob dhe Bllatë që s'kanë banor të zëvendësohen me këshillin lokal të fshatit Rakinicë, Barainë.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, kam një propozim sa i përket nenit 5 të rregullores ku bëhet zgjedhja e kryetarit të këshillit lokal të fshatrave, kisha propozuar që kryetari i këshillit lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane të bëhet me rotacion.
**z.Florent Hasani**, theksoi, propozoj që të bëhet një ndarje më ndryshe te këshilli lokal i lagjes urbane qendra 6 në qytet në veri të shtrihet ky këshill deri te hekurudha ku bëhet ndarja e këshillit lokal urban qendra 4 me këshillin lokal të lagjes urbane qendra 6, ndarja të jetë hekurudha dhe në jugperëndim kufizimi me këshillin lokal të lagjes urbane qendra 2 hekurudhën ta keni si vijë kufiri e jo të ndahen lagjet në mes.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, sa i përket pyetjes së këshilltarit z.Haki Rudari te neni 2 i udhëzimit administrativ theksohet se kryetar i këshillit nënkupton personin më të votuar në tubim zgjedhor në fshatra vendbanime dhe lagje urbane, nuk e di se sa e kam të qartë pyetjen po gjithsesi po mundohem të japë një përgjigje në bazë të asaj që po e lexoj në këtë draft rregullore.
Te neni 5 paragrafi 1 theksohet se këshilli lokal mund të ketë 5-9 anëtar, numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në tubim zgjedhor.
Në nenin 5 paragrafi 13 thuhet tubimet kanë legjitimitet nëse në tubim janë të pranishëm së paku 31 pjesëmarrës ndërsa paragrafi 11 përcakton që kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të pjesëmarrësve në tubim që nënkupton se kryetar i këshillit sipas nenit 2 është në përputhje me këtë përkufizim që bëhet në nenin 5 paragrafi 11, ndërsa paragrafi 1 i nenit 5 vetëm thekson që në një këshill lokal mund të jenë 5-9 anëtar ndërsa kryetari do të zgjidhet nga radhët e këtyre anëtarëve i cili ka shumicën e votave, këto këshilla do të zgjidhen në tubime që duhet të jenë së paku 31 pjesëmarrës.
Këtu nuk po shohë diçka që nuk është në përputhje neni 2 me nenin 5 të rregullores së lartcekur.
**z.Haki Rudari**, theksoi, e nderuara drejtoreshë e DA-së unë po e lexojë rregulloren që kam para vetës ku thuhet kryetari i këshillit nënkupton personin më të votuar në tubim zgjedhor në fshatra dhe tubimi zgjedhor në fshatra nënkupton një pjesëmarrje prej 31 e më shumë anëtarëve, sa i përket nenit 5 është krejt kontradiktore tani në paragrafin 11 të nenit 5 thuhet kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e

anëtarëve të këshillit lokal, po kush është këshilli lokal, është përbërja prej 5-9 anëtar pra kryetarin e këshillit nuk e zgjedh një tubim i përbërë prej 31 anëtarëve por i zgjedh këshilli lokal prej 5-9 anëtar e përbërja e këshillit lokal prej 5-9 anëtar natyrisht vjen nga banorët sipas dëshirës së banorëve por megjithatë kjo është kontradiktore sepse në fillim të udhëzimit administrativ thuhet se kryetari i këshillit të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane zgjidhet në një tubim kurse këtu thuhet se zgjidhet nga këshilli i fshatrave kjo ishte vërejtja ime.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, në rend të parë desha të konkretizoj propozimin tim ku nenit 8 të kësaj rregulloreje i shtohet paragrafi 4 me këtë tekst, komuna përdor platforma elektronike për informim, komunikim, konsultim dhe bashkëpunim me këshillat lokale ky ishte propozimi im.
Sa i përket dilemave rreth zgjedhjes së kryetarit të këshillit të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane nga ajo që u potencua nga kolegu z.Haki Rudari dhe nga ajo që kuptohet nga propozuesit e rregullores, kuptohet kështu tubimi në rend të parë e zgjedh këshillin pastaj kush mund të jetë kryetar i këshillit njëri prej atyre anëtarëve që është në këshill dhe këtë e shpjegon udhëzimi do të thotë cili do prej atyre anëtarëve të këshillit është anëtar i barabartë i këshillit, tubimi zgjedhor e zgjedh këshillin pasi që të zgjidhet këshilli hyjnë në votim anëtarët e këshillit që pretendojnë të jenë kandidat për kryetar dhe cili merr shumicën e të pranishmëve zgjidhet kryetar, unë kështu e kuptoj domethënien e kësaj rregulloreje znj.drejtorershë DA-së.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket ndarjeve të cilat u propozuan përsëri në këtë aspekt nuk është që ka ndonjë problem mirëpo të jeni në koordinim me të gjithë për këto ndarje të reja që tashmë po propozohen, po filloj prej propozimit të këshilltarit z.Florent Hasani për pjesën e qytetit e që besoj se është më lehtë e realizueshme që hekurudha të merret si kufi ndarës mes qendrës 4, qendrës 6 dhe qendrës 2, kurse te pjesa rurale te pjesa e fshatit Orllan më konkretisht sipas rregullores çdo herë po flas sipas udhëzimit administrativ në një këshill mund të jenë maksimumi 9 fshatra.
Tani edhe pse disa fshatra nuk kanë banor dhe nëse ju e shihni si të arsyeshme mundemi fshatrat Turuçicë dhe Rakinicë t'i bashkojmë me këshillin e fshatit Orllan mirëpo tani po bëhen 10 fshatra në një këshill dhe në këtë rast e kemi kaluar numrin e fshatrave që mund të jenë në një këshill, sa i përket fshatit Ballofc që të jetë në një këshill me fshatin Herticë edhe kjo mund të bëhet mirëpo ne kemi bërë një ndarje racionale duke marrë për bazë territorin, numrin e popullsisë dhe lidhjet që kanë mes veti fshatrat mirëpo disa propozime që i jepni ju për mua është lehtë të realizohen dhe produkti vjen shumë shpejt.
**z.Florent Hasani**, theksoi, po e shohë një ndarje në mes fshatrave Revuç dhe Kërpimeh kur dihet se këto fshatra gjithherë tradicionalisht kanë qenë në një qendër, propozimi im është që fshatrat Kërpimeh, Pakashticë e Poshtme, Pakashticë e Epërme, Revuç të jenë në një këshill lokal kurse fshatrat Metehi, Repë, Sylevicë të jenë në një këshill lokal mendoj se kjo ndarje do të jetë më funksionale edhe për banorët atje sepse mes këtyre fshatrave bëhet edhe lidhja rrugore.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse nuk ka propozime tjera e vë në votim propozimi që në nenin 8 të draft Rregullores në fjalë të shtohet edhe një paragraf i ri (paragrafi 4) me tekstin si në vijim: Komuna përdorë platforma elektronike për informim, komunikim, konsultim dhe bashkëpunim me këshillat lokal.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 26 vota PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështet propozimi që në nenin 8 të draft Rregullores në fjalë të shtohet edhe një paragraf i ri (paragrafi 4) me tekstin si në vijim:* ***Komuna përdorë platforma elektronike për informim, komunikim, konsultim dhe bashkëpunim me këshillat lokal.***

**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket propozimeve mundësisht të jenë më të qarta dhe para se të bëni propozimet llogaritni se mund të bëhen ndryshime në numrin e këshillave andaj llogaritni se në ato propozimet e juaja mos të kalojnë numrin prej 24 këshillave të fshatrave sepse ju po kërkoni një ndarje të re mirëpo kjo ndarje mund të na i rris numrat e këshillave të fshatrave, mundësisht mos e kaloni numrin prej 24 këshillave të fshatrave.
**z.Haki Rudari**, theksoi, numri i këshillave nuk ndryshon i nderuari drejtor i DPUMM-së, ai numër mbetet i njëjtë vetëm ndryshon renditja në aspektin gjeografik prandaj unë propozova që fshati Ballofc të kaloj në këshillin lokal të fshatrave; Herticë-Turuqicë-Rakinicë-Surdull, kurse fshatrat Lladofc, Shajkofc të mbesin në një këshill sepse e gjithë kjo po bëhet në të mirë të qytetarëve.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse nuk ka propozime tjera atëherë propozimin e këshilltarit z. Haki Rudari e vë në votim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, mbështet propozimi **që fshati Ballofc të kaloj në këshillin lokal të fshatrave; Herticë-Turuqicë-Rakinicë-Surdull.***

**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket këtyre dy propozimeve këto po bien ndesh mes veti sepse ju e votuat një propozim që fshatrat Ballofc, Herticë, Turuçicë,Rakinicë, Surdull, të jenë në një këshill lokal, tash propozimi tjetër është që fshati Turuçicë të kaloj në këshillin lokal të fshatit Orllan.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, unë bëra propozimin që fshati Orllan të mbetet ashtu siç ka qenë në bashkësi lokale më herët, që do të thotë se fshatrat Rakinicë, Turuçicë, Barainë kanë qenë gjithmonë pjesë përbërëse e bashkësisë lokale të fshatit Orllan, jam e vetëdijshme se në një këshill lokal mund të jenë deri në 9 fshatra por të paktën meqenëse fshati Bllatë nuk ka banorë por nuk mund ta largojmë prandaj propozoj që fshati Rakinicë të kaloj në këshillin e fshatrave Ballofc, Herticë, Surdull, kurse fshati Turuçicë të kaloj në këshillin e fshatit Orllan.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, ne të gjitha subjektet politike i kemi propozuar anëtarët për grupin punues për finalizimin e kësaj draft rregulloreje mirëpo këto ndryshime së paku të bëhen sipas renditjes e mos të bien ndesh njëra me tjetrën në mënyrë që mos të bëhet ndryshimi i propozimeve të miratuara.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, veç se u miratua përbërja e këshillit të fshatrave Ballofc, Herticë, Surdull, Rakinicë, Turuçicë, tash nëse doni edhe njëherë miratojeni këtë për mos me qenë një këshill, nuk i di procedurat tjera saktësisht por ky këshill u miratua më parë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, mirëpo tani kemi një propozim nga këshilltarja znj.Drita Pajaziti që fshati Turuqicë të kaloj në këshillin lokal të fshatrave; Orllan-Muhazob-Metergoc-Bllatë-Bërvenik-Kalaticë-Brainë-Kushevicë.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuari Kryesues a po bindeni tani se keni gabuar që se keni dërguar materialin, nga grupi i këshilltarëve të LVV-së kanë qenë dy anëtar në komision ndërsa kanë qenë të ftuar 3 drejtor prej tyre njëri nuk ka marrë pjesë në grupin punues, këta është dashur të dakordohen dhe t'ia dërgojnë materialin anëtarëve të grupit punues asamblesë dhe grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend.
Ne mbajmë takime para fillimit të mbledhjes së Kuvendit dhe është dashur t'ju shpjegojmë kolegëve se si është bërë ndarja e këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane sepse tani kemi dy propozime për përfshirjen e fshatit Turuçicë në dy këshilla të fshatrave.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, materiali ka ardhë si propozim këtu për këtë arsye ai mund të ndryshoj sepse këtu në kuvend vendoset për këtë çështje.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, që në fillim thash se jemi duke i shkaktuar veti telash se ju i nderuari kryesues keni qenë ai që e keni potencuar disa herë që ta ndërtojmë një unitet mes grupeve të këshilltarëve subjekteve politike të përfaqësuara në këtë kuvend dhe mos të hapim debate rresht rreth këshillave të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane se po humbim kohë me propozime të ndryshme pa dashur t'ia cungoj dikujt ndonjë të drejtë se të gjithë e kanë atë të drejtë por kur të bëhet një dakordim ai duhet të vlejë dhe ju i nderuari kryesues keni qenë zëri kryesor që ta kemi atë dakordim kurse tani ju po e hapni mundësinë për atë që e ceku parafolësi im z.Ekrem Rrahmani dhe parafolësi i tij z.Qendrim Softolli se kemi hy në një mbledhje të pa përgatitur prandaj mos të hapim debat më tutje por të vazhdojmë dhe ta arrijmë unitetin, ka ndodhur çfarë ka ndodhur për këtë seancë të pa përgatitur por ta kalojmë edhe këtë.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, sa i përket materialit edhe njëherë po e theksoi që është vetëm vazhdimi i seancës të datës 30.06.2022, nuk kemi bazë ligjore për ta përcjellë materialin paraprakisht sepse është vetëm vazhdim i seancës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, me gjithë respektin znj.drejtoreshë e DA-së, të gjithë ata që kanë marrë pjesë në atë punëtori, në fund të gjithë kemi dalë kemi vazhduar rrugën për në shtëpi dhe asnjëri nga ne nuk ka pasë dokumentacion të shkruar, keni mundur materialin mos me ia dërgua kuvendarëve nëse ju ashtu keni menduar por të paktën ne anëtarët e grupit punues është dashur të pajisemi me material për atë që jemi dakorduar. Për materialin shtesë po e marrë një shembull se si të gjithë ne e marrim materialin për seancë shkojmë në mbledhjen e KPF-së, dhe qëndrimet e mbledhjes së KPF-së prapë iu dërgohen anëtarëve të kuvendit kështu që e njëjta formë është dashur të përdoret edhe këtu, si do që të jetë kjo ka ndodhur dhe nuk dua të kthehem prapa dhe kjo formë të vazhdoj kështu.
**z.Kasib Bashota**, theksoi, ne ishim në atë takim dhe u dakorduam që këto propozime t'i harmonizojmë dhe t'i sjellim në kuvend për miratim tash dikush mund të mendoj për një çështje ndryshe mirëpo ne aty jemi munduar që ta bëjmë zgjidhjen më të mirë dhe është mirë që të votohet kjo si pako ashtu siç jemi dakorduar i nderuari kryeses dhe ju anëtar tjerë të kuvendit se kemi bërë zgjidhjen më të mirë dhe kemi diskutuar 4 ose 5 orë, secila çështje mund të ketë ndonjë paqartësi dhe të gjitha këto mund të nxjerrin telashe për ndonjë këshill të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane mirëpo ne këto i harmonizuam dhe të gjitha propozimet prej të gjitha lokaliteteve i përafruam si gjeografikisht ashtu edhe sipas numrit të banorëve dhe për këtë ne jemi dakorduar njëherë andaj besoj se për këtë çështje duhet të shkojmë në votim.
**z.Haki Rudari**, theksoi, i nderuari z.kryesues dua të sqaroj diçka komisionet, grupet punëtorit nuk e kanë të drejtën për të marrë vendime, vendim ka të drejtë të marrë vetëm kuvendi komunal dhe këshilltarët këtu, atje mund të ketë propozime por çfarë propozimesh janë bërë ne se dimë se s'kemi qenë pjesë e atij grupi punues por mendoj se është plotësisht e drejtë legjitime që këshilltarët sipas ligjit dhe rregullores të bëjnë propozimet e tyre prandaj edhe këtu nuk pat shumë propozime.
Numrin e këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane askush nuk e kërkon që të rritet por kemi 3- 4 propozime që disa fshatra të kalojnë nga një këshill loakl i një fshate në një këshill lokal të një fshati tjetër krejt në rregull është kjo, ishte propozimi i koleges që një fshat të kaloj në këshillin e fshatrave të Orllanit, ishte propozimi që fshati Ballofc të kalojë në këshillin e fshatrave të Herticës kurse fshati Lladof dhe Shajkofc të jenë në një këshill lokal.
Këshilltarët kanë të drejtën e tyre të propozojnë dhe të marrin vendime, komisionet, grupet dhe punëtoritë ato bëjnë vetëm rekomandime, ata mund të rekomandojnë por kuvendi merr vendim.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk po flasë me qëllim të replikës por mos ta deformojmë debatin sepse nga asnjë folës në këtë kuvend nuk dëgjova që të ketë thënë se ne kemi marrë vendim në punëtori, asnjëri nga ne nuk tha që kemi marrë vendim por kemi arritur dakordancë, dakordimi dhe vendimi nuk janë të njëjta sepse të gjithë ne këtu e dimë se kush merr vendim.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne nuk ia kemi muhar askujt të drejtën këtu që mos të bëjë propozime, ne jemi munduar që t'i përafrojmë qëndrimet dhe këto qëndrime i kemi ofruar mes veti siç po shihet këtu rreth 90%, edhe pse ka propozime të reja unë nuk po shohë asgjë të keqe sepse nuk është njësoj kur bisedojnë 10 persona dhe 35 persona, andaj unë po shohë që këto propozime kanë qëllimin më të mirë që mos të kemi telashe në zbatimin e kësaj rregulloreje në terren, njëri ndër propozuesit e parë në këtë mbledhje ishte këshilltari i nderuar z.Naim Çunaku andaj mos të humbim kohë më shumë por të vazhdojmë tutje.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuari kryesues është e vërtetë se unë i pari bëra propozim dhe hapa debatin rreth kësaj çështje sepse ju së bashku me ne në atë punëtori dhe i gjithë grupi u dakordua për atë propozimin që e bëra unë dhe këtë propozim nuk e ke marrë parasysh edhe pse jemi dakorduar në punëtori dhe një dakordim të asaj punëtorie e propozova këtu.
I nderuari Kryesues propozimin e bërë nga unë e keni pranuar në formë të shkruar dhe keni heshtur sepse ky propozim i është adresuar këshilltarëve të kuvendit komunal, kryesuesit të kuvendit, kryetarit të komunës, dhe të gjithë ju e keni pranuar këtë propozim në formë të shkruar elektronike.
**z.Florent Hasani**, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DPUMM-së dhe drejtoreshën e DA-së, nëse një fshat është i pa banuar a duhet të jetë i përfaqësuar në këshill lokal.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, sipas udhëzimit administrativ përcaktohet se çdo fshat duhet të jetë i përfaqësuar në këshill lokal të fshatrave ose lagjeve urbane pavarësisht se a ka banorë ose jo sepse ne nuk mund t'ia mohojmë një të drejtë ndonjë qytetari që të kthehet të jetojë në fshatin e tij prej ndonjë fshati tjetër apo prej qyteti për këtë arsye secili fshat duhet të jetë i përfshirë në këshill lokal.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi mbetur te propozimi i këshilltares znj.Drita Pajaziti.
**znj.Drita Pajaziti,** theksoi, unë qëndroj prapa asaj që fshati Turuçicë gjithherë ka qenë pjesë e bashkësisë së fshatit Orllan dhe mendoj se edhe tani duhet të jetë pjesë përbërëse e këshillit lokal të fshatit Orllan dhe tani mora kritika nga banorët e fshatit Turuçicë që janë kundër të jenë pjesë përbërëse e ndonjë këshilli lokal të ndonjë fshati tjetër përpos këshillit të fshatit Orllan, kështu që propozoj që fshati Turu]icë të jetë pjesë përbërëse e këshillit të fshatit Orllan.
**z.Florent Hasani**, theksoi, për mos me tejkaluar normën apo numrin e këshillave të fshatrave që është përcaktuar në bazë të udhëzimit administrativ kisha propozuar që fashatrat Lluzhan, Llugë, Sallabajë, Godishnjak, Sallabajë, të jenë në një këshill ose fshatrat e pjesës së sipërme të Komunës së Podujevës si Revuç, Pakashticë e Poshtme, Pakashticë e Epërme, Repë, të jenë një këshill kurse në gollak të kemi ndarje të dy këshillave psh të kemi një këshill të veçantë të fshatrave Turuçicë, Rakinicë, Muhazob, Metergofc, dhe fshati Orllan të jetë një këshill me fshatrat tjerë.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket propozimit që fshati Turuçicë t'i bashkohet këshillit lokal të fshatit Orllan në bazë të numrit të këshillave ka të drejtë mirëpo në anën tjetër atëherë fshatin Rakinicë po e lëmë pa kontakt gjeografik me fshatrat Herticë dhe Ballofc, kurse sa i përket propozimit të këshilltarit z.Florent Hasani për të krijuar numër më të madh të këshillave të fshatrave në pjesën e Orllanit ne e kemi analizuar këtë dhe në atë pjesë kemi një numër të vogël të banorëve dhe vetëm një këshill mjafton për këtë hapësirë mirëpo nëse ne tani krijojmë këshillin e fshatrave Lluzhan, Llugë, Sallabajë, Godishjnak, është numër mjaftë i madh dhe me numër të banorëve dhe në fund unë kam një sugjerim për të gjithë ju para se të votoni mendoni se a është e drejtë kjo ndarje apo s'është e drejtë sepse nuk është e thëne se funksionon ajo që propozohet.

**z.Ardi Hasani**, theksoi, dua t'i bashkëngjitëm propozimit të z.Florent Hasani, që fshati Llugë të jetë pjesë e këshillit të fshatrave Bellopojë, Halabk, Tërrnavë, në mënyrë që ta krijojmë edhe një këshill në zonën e gollakut.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, kjo është e tepërt i nderuari kryesues kur diskutohet për një lokalitet që s'kanë të bëjnë asgjë me të e që unë vij nga ai lokalitet.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne dëgjuam disa propozime që të ketë lëvizje të një fshati nga një këshill në një këshill tjetër, vetëm te propozimi i këshilltares znj.Drita Pajaziti do ta bëjmë një ndryshim dhe te propozimi i këshilltarit të z.Florent Hasani që hekurudha të jetë vijë ndarse në mes të këshillave urbane.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, fillimisht po më vjen shumë çudi prej kolegut z.Naim Çunaku që thirret shumë në rregullore por tani e merr fjalën pa iu dhënë të lutem z.Naim isha parafolës para teje respektoje rendin.
Sa i përket propozimit që të jetë një këshill lokal i fshatrave Lluzhan, Llugë, Shakovicë, Godishnjak, po ashtu të ndahet fshati Llugë, Penuhë dhe fshati Lluzhan me fshatin Godishnjak në një këshill prapë këto nuk qëndrojnë kjo dihet se këto fshatra kanë numër të madh të banorëve dhe le të mbeten kështu siç janë, nëse do të ketë propozime tjera unë nuk e di por këshilli lokal i fshatrave Lluzhan, Llugë qëndrojnë shumë mirë si dhe këshilli lokal i fshatrave Sallabajë, Godishnjak, Shakovicë, besoj se në këto këshilla lokale të fshatrave nuk ka nevojë të bëhet ndërhyrje sepse unë dhe kolegu im z.Naim Çunaku jemi banorë të asaj ane dhe jemi dakord për këtë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, propozime tjera ne nuk mund të marrim sa i përket ndryshimeve të këshillave lokale të fshatrave, ne kemi mundur të propozojmë kalimin e një fshati nga një këshill në një këshill tjetër por ne ende nuk e kemi dhënë vendimin përfundimtar, mirëpo kur unë kam kërkuar nga shefat e grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë Kuvend ju nuk u pajtuat që të jepet pëlqimi dhe ky dokument të kaloj në votim, sa i përket propozimeve unë i mbështes propozimet e znj.Drita Pajaziti dhe z.Florent Hasani.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DPUMM-së, se a është e kundërligjshme bashkimi i fshatit Turuçicë në këshillin lokal të fshatrave; Orllan-Muhazob-Metergoc-Bllatë-Bërvenik-Kalaticë-Brainë-Kushevicë,kurse fshati Rakinicë të kaloj në këshillin lokal të fshatrave Ballofc, Herticë, Surdull.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, mënyra se si po vihen në votim këto propozime nuk është në rregull sepse së pari fjalën duhet të ia japësh drejtorit se a janë ato propozime konform atyre pikave të rregullores dhe udhëzimit administrativ dhe a përputhen ato fshatra territorialisht dhe gjeografikisht mes veti para se të dalin ato propozime në votim, ne po votojmë diçka që se dimë çka po votojmë, pastaj ato vendime duhet t'i rikthejmë edhe një herë për shfuqizim dhe kështu po vazhdon 24 h seanca e kuvendit, kam një kërkesë për ju z.kryesues sepse ka 30 minuta deri më tani që kam kërkuar fjalën mirëpo kjo kërkesë e imja deri më tani nuk është marrë parasysh.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket pyetjes rreth propozimit tuaj znj.Drita Pajaziti një gjë e tillë ligjërisht nuk është e ndaluar po është propozim jo i përshtatshëm dhe jo praktik për shkak se po mbetet fshati Rakinicë, së fundi për këtë çështje ju asambleja e kuvendit vendosni jo unë.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, meqenëse kërkesë e banorëve të fshatit Turuçicë është që ky fshat të kaloj në këshillin lokal të fshatrave Orllan-Muhazob-Metergoc-Bllatë-Bërvenik-Kalaticë-Brainë-Kushevicë, unë këtë po e kërkoj që kjo kërkesë e tyre të realizohet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë propozimin e znj.Drita Pajaziti që fshati Turuçicë të kaloj në këshillin lokal të fshatrave; Orllan-Muhazob-Metergoc-Bllatë-Bërvenik-Kalaticë-Brainë-Kushevicë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 21 PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështet propozimi* ***që fshati Turuqicë të kaloj në këshillin lokal të fshatrave; Orllan-Muhazob-Metergofc-Bllatë-Bërvenik-Kalaticë-Brainë-Kushevicë.***

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, kam një propozim sa i përket nenit 19 të kësaj rregulloreje ku thuhet anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve apo lagjeve urbane zgjedhën me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat sipas procedurave të njëjta, unë kisha propozuar që zgjedhja e kryetarëve të jetë me rotacion 6 muaj ose 1 vit pastaj të bëhet rizgjedhja e kryetarit të fshatrave vendbanimeve apo lagjeve urbane.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, sa i përket propozimit të koleges znj.Sebastina Vokrri këtë e kemi diskutuar paraprakisht sa është e mundshme kjo por problemi ka qenë se për tu zgjedhur një kryetar i këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve apo lagjeve urbane duhet të thirret kuvendi andaj me delegacion nuk mund t'ia delegosh kompetencat e kryetarit dikujt tjetër por kryetarin duhet kuvendi me zgjedh dhe po më duket jo e arsyeshme për çdo vit me thirr kuvend zgjedhor për rizgjedhje të kryetarit të këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve apo lagjeve urbane ky ishte problemi i rotacionit që e kemi diskutuar që në fillim, si ide parimisht është e mirë për shkak të lidh mërisë së fshatrave por për shkak të realizueshmërisë është e pa mundur se çdo herë duhet të thirren kuvendet për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, faleminderit për sqarimin i nderuari koleg z.Arjant Topanica, mirëpo unë mendoj se periudha kohore prej 1 viti nuk është periudhe e shkurt sepse ka mundësi që të mblidhen këshillat lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane andaj propozoj që përzgjedhja e tyre të bëhet për periudhën kohore 6 muaj ose 1 vit.
**znj.Antoneta Ejupi**, U.D. drejtoresh e DA-së, theksoi, faleminderit për sugjerimin e nderuara këshilltare znj.Sebastina Vokrri, ne të gjithë po pajtohemi që propozimi juaj është shumë praktik mirëpo kemi një udhëzim administrativ i cili përcakton zgjedhjen dhe mandatin e kryetarit të këshillave lokale të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane, në këtë rast ne nuk mundemi të propozojmë diçka ose të miratojmë diçka që është në kundërshtim me udhëzimin administrativ.
**z.Florent Hasani**, theksoi, propozimi im ishte që këshilli lokal urban qendra 6 shtrirjen në veri ta ketë deri te hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal urban qendra 4 dhe në jug perëndim prapë shtrirja të jetë deri te hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal qendra 2.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë propozimin e z.Florent Hasani që këshilli lokal urban qendra 6 shtrirjen në veri ta ketë deri te hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal urban qendra 4 dhe në jug perëndim prapë të jetë hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal qendra 2.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 23 PËR nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, mbështet propozimi* ***që*** **këshilli lokal urban qendra 6 shtrirjen në veri ta ketë deri te hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal urban qendra 4 dhe në jug perëndim prapë të jetë hekurudha si vijë ndarëse me këshillin lokal qendra 2.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, besoj se debati rreth kësaj pike të rendit të ditës ka përfunduar sepse lidhur me këtë çështje kemi debatuar edhe në seancën e kaluar dhe kemi marrë propozime të cilat janë të mirëseardhura, propozime këto me qëllimin më të mirë që kjo rregullore të jetë e aplikueshme.
Andaj për mos të humbur kohë më shumë e vë në votim Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, sipas draftit përkatës të prezantuar më 30 qershor 2022 dhe plotësim ndryshimeve të prezantuara dhe të shpërndara sot në fillim të vazhdimit të seancës nga Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me theks përshkrimet në paragrafët 1.1 deri në 1.6 të nenit 4 përfshirë edhe shtojcat e Rregullores përkatëse, si dhe propozimeve të paraqitura dhe miratuara nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 23 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, sipas draftit përkatës të prezantuar më 30 qershor 2022 dhe plotësim ndryshimeve të prezantuara dhe të shpërndara sot në fillim të vazhdimit të seancës nga Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, me theks përshkrimet në paragrafët 1.1 deri në 1.6 të nenit 4 përfshirë edhe shtojcat e Rregullores përkatëse, si dhe propozimeve të paraqitura dhe miratuara nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.*

## 10. Të Ndryshme

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, kam një pyetje për ekzekutivin që ka të bëj me varrezat e qytetit sepse ekziston një thënie popullore që para se t'i ndërtojmë shtëpitë tona duhet ta dimë se ku i kemi varret tona, qyteti i Podujevës është në një gjendje kaotike në qoftë se brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore nuk bëhet një zgjidhje për varrezat e qytetit ne shumë shpejt nuk do të kemi vend se ku t'i varrosim të afërmit tanë.
Lidhur me këtë kërkoj një përgjigje nga ekzekutivi nëse është e mundshme, e di se kanë filluar procedurat nga ekzekutivi për caktimin e lokacionit për varrezat e qytetit por dua ta di se deri ku kanë shkuar këto procedura sepse e di që edhe në të kaluarën kjo procedurë ka filluar në kohën kur ekzekutivin e ka udhëhequr LDK-ja, që nga vitii 2008, mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë konkrete në këtë drejtim.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, edhe pse drejtorët e drejtorive përkatëse nuk janë të pranishëm unë desha t'i bëjë disa pyetje ose t'i jap disa sugjerime, desha të lidhem në temën sa i përket realizimi të projekteve të fshatrat nga vij unë si Shtedim, Mirofc, Ballofc, në fshatin Shtedim janë ndërpre projektet sa i përket shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik për shkaqe politike, gjithashtu në fshatin Mirofc është ndërpre ky projekt në gjatësi 1000 m dhe asfaltimi i rrugëve në gjatësi 400m, rruga në fjalë është "Ganimete Miftar Hajdari", ndërsa në fshatin Shtedim është ndërpre asfaltimi i rrugës në gjatësi 700m, rruga quhet "Luigj Gurakuqi".
Sa i përket fshatit Ballofc është devijuar shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik nga rruga kryesore për në rrugë dytësore si dhe mungojnë trotuaret në pjesën e sipërme të fshatit ku rrezikohet siguria e nxënësve të cilët në mungesë të trotuarit detyrohen të ecin rrugës dhe nuk kanë të siguruar transportin publik. Gjithashtu kemi edhe nënshkrime të peticioneve sa i përket ndërtimit të fabrikës në fshatin Mirofc që e kundërshtojnë ndërtimin e saj madje edhe ngritje të kallëzimeve penale, për të gjitha këto a mundet dikush të na japë ndonjë shpjegim edhe pse nuk janë drejtorët prezent për të gjitha këto unë pres shpjegime.

**z.Adnan Zymeri**, theksoi, arsyeja pse sot unë po e marr fjalën është për një komunikim që kam pasë ta bëjë me kryetarin meqenëse kryetari nuk qenka prezent këtu si përfaqësuese e tij nga radhët e ekzekutivit është nënkryetarja e komunës, diskutimi im ka të bëjë me një vendim që e ka nxjerrë kryetari për lejimin e hapësirave të komunës për bashkatdhetarët tanë që në prizmin tim është vendim i mirë në shenjë mirëseardhje për kontributin e tyre që e gëzojmë për ta por përkundër kësaj përveç këtij benifiti sa do simbolik që ua kemi dhënë gjatë diskutimeve dhe takimeve që i kemi me qytetarët rezident të Komunës së Podujevës ata kanë pakënaqësi dhe e konsiderojnë padrejtësi goxha të madhe që atyre nuk iu lejohet shfrytëzimi i të njëjtës hapësirë që iu lejohet mërgimtarëve në këtë periudhë kohore.
Nëse ekziston vullneti e di që mundet me pas modalitete për ta zgjidhur këtë çështje se nëse nuk na pengon oborri i Komunës i mbushur me vetura në këtë periudhë kohore sa janë në pushime mërgimtarët se di pse mund të na pengojë kjo çështje në periudhat tjera kohore kur nuk janë mërgimtarët në pushime, kjo nëse nuk është e lejuar për një periudhë kohore më afatgjatë p.sh mundet oborri i Komunës të shfrytëzohet për 15-20 minuta nga qytetarët të cilët janë me veturë dhe kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve të ndryshme komunale atëherë ata qytetarë duhet të paguajnë për parkim të veturës në vlera të caktuara në treg.
Përveç qytetarëve edhe anëtarët e asamblesë komunale nuk e kanë kurrfarë mundësie që ta shfrytëzojnë parkingun e komunës përderisa e njëjta gjë ndodh për drejtorët e drejtorive të komunës dhe nuk e di pse një drejtor ka të drejtë ta shfrytëzoj parkingun e komunës për veturën e tij kurse një asamblist mos ta ketë këtë të drejtë por para asamblistëve po e them se poenta kryesore e këtij propozimi është që të jepet në shfrytëzim afatgjatë parkingu i komunës për qytetarët rezident në Komunën e Podujevës.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, për arsyen e vendosjes së flamurit të KF.Llapi në foltore kam një sqarim dhe ky sqarim nuk ka të bëjë me ligjërata se sa e duam KF.Llapin se kjo gjë dihet se KF.Llapi duhet nga të gjithë ne dhe për këtë kam një thirrje për DKRS-në që të gjejë alternativa që ta ndihmojë këtë klub i cili na përfaqëson dhe na bënë krenar, kështu që të gjinden forma të ndryshme që ta përkrahim KF.Llapin dhe ta ngrisim në nivelet më të larta.
**z.Ekrem Rrahamni**, theksoi, edhe pse nuk janë prezent drejtorët e drejtorive ne po i parashtrojmë disa pyetje që kanë të bëjnë me disa çështje një ndër to është edhe ajo e mirëmbajtjes së mbeturinave po flas për pjesën e fshatrave Gllamnik, Sibofc, Lluzhan ku kompania e kontraktuar nuk e kryen shërbimin e saj me kohë ashtu siç ka qenë ditën e enjte dhe nuk kemi marrë kurrfarë njoftimi apo arsyetimi lidhur me vonesën e saj dhe mos kryerjen e shërbimi.
Një çështje tjetër është edhe ndërtimi i trotuarit në të cilin janë bërë punime deri në ditën e zgjedhjeve në muajin tetor dhe në ditën e zgjedhjeve janë ndërprerë punimet mirëpo tani ai ka mbete i pa përfunduar dhe për ndërtimin e këtij trotuari ne nuk e dimë se kush ka qenë menaxher i tij dhe në bazë të cilit projekt realizohet ai dhe për këtë ne duam sqarime se a i janë ndarë mjetet kontraktorit dhe se i njëjti a i ka marrë ato mjete dhe pse ka mbetur i pa përfunduar ai projekt apo ky projekt është i paraparë tani në projekt buxhet dhe parashihet vazhdimi i tij.
Sa i përket ndriçimit në fshatin Sibofc njëherë e ka goditur rrufeja atë rrjet dhe më asnjëherë nuk ka funksionuar dhe askush nga komuna nuk ka ardhë e të shikojë se ku është defekti që nuk funksionon ai ndriçim dhe ne nuk e dimë atë defekt se a është si shkak i rrufesë apo djegies së trafos, ai rrjet i ndriçimit publik fizikisht ditën duket shumë bukur po natën nuk funksionon dhe i tërë fshati ka mbete në errësirë.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, shqetësimin e njëjtë e kam edhe unë sa i përket ndriçimit publik për arsye se kam marrë shqetësime të shumta që nuk dihet se a është ndriçimi i cilësisë së dobët sepse pas shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik menjëherë fillon mosfunksionimi i tij si pasoj e defekteve, sa i përket shtrimit të trotuareve meqenëse drejtori i DSHPMSHP nuk qenka këtu po e theksoi se kisha pasur dëshirë që kur ka projekte nga lokalitetet të cilat vijmë ne asamblistët do të ishte e rrugës që të konsultohet dhe dakordohet me ne paraprakisht për pjesën e rrugës apo të trotuarit se kah është me më

prioritet për qytetarët për arsye se jemi përfaqësues të lokaliteteve të caktuara mundemi me i ditë edhe me i njohtë problemet kërkesat dhe prioritetet që i përkasin atyre.

Një shqetësim të shkurt po e ngrisë sa i përket rr."Skenderbeu", meqenëse është projekt në realizim dhe kisha dashur një sqarim prej drejtorit pse kanë filluar punimet në këtë periudhë kur dihet se muajt korrik dhe gusht janë muajt më të ngarkuar të vitit dhe kemi pasur shumë shqetësime se nëse ajo rrugë bllokohet për hyrje në qytet do të stërngarkohet rruga "Zahir Pajaziti" dhe nuk e di se si do të funksionoj duke e ditur se edhe bashkatdhetarët tanë tani janë në pushime në vendlindje.

**z.Valon Demolli**, theksoi, fillimisht dua të ndërlidhem me një shqetësim që po paraqitet në qytetin tonë nga shitësit ambulant që veprimtarinë e tyre po e zhvillojnë në shesh dhe ankesat e tyre nuk po merren parasysh andaj kërkojmë nga drejtoritë përkatëse që të gjejnë forma dhe të mundësojnë operimin e tyre dhe mos të trajtohen me përbuzje, në të gjithë boten ka sheshe ku shitësit ambulant zhvillojnë veprimtarinë e tyre andaj kërkojmë që të merren praktika më të mira dhe tu bëhet një zgjidhje këtyre, mos të mbyllen sytë për ato biznese që uzurpojnë prona publike dhe po tregohet forcë te njerëzit që sigurojnë bukën e gojës me këtë aktivitet.

**znj.Marigona Lahu**, Nënkryetare e Komunës, theksoi, po mundohem të përgjigjem në disa prej pyetjeve të cilat ju i parashtruat mirëpo për informata më të sakta ju kisha lutur që t'i drejtoheni drejtorive përkatëse, po përgjigjem në pyetjen e parë të këshilltarit z.Artrit Mulliqi e cila ka të bëjë me varrezat e qytetit.

Ne si Komunë kemi ndarë një lokacion për varrezat e qytetit mirëpo jemi në fazën përfundimtare të procedurave të shpronësimit për sipërfaqen të cilën e kemi destinuar për varreza të qytetit së bashku me varrezat e qytetit janë edhe disa parcela të cilat i nevojiten Komunës dhe janë në fazën e procesit të shpronësimit.

Sa i përket parkingut të Komunës po ndalem te pjesa e parkingut për asamblistët, që besoj se është shumë e drejtë që asamblistët ta shfrytëzojnë parkingun e komunës dhe për këtë çështje së bashku me drejtoreshën e DA-së do të shohim mundësinë se si ta procedojmë, sa i përket qytetarëve për shfrytëzimin e parkingut në hapësirat e Komunës ne kemi marrë këtë vendim se e dimë që gjatë muajve të verës kemi qarkullim të madh të veturave në qytet dhe rrugët bllokohen, tani jemi në procesin e fundit të hartimit të planit të mobilitetit i cili shumë shpejtë do të dal në kuvend për aprovim plan ky i cili do ta zgjidhë çështjen e parkingut, gjithashtu edhe për parkingun nëntokësor kemi filluar procedurat për realizimn e tij.

Sa i përket pjesës së financimit të KF Llapi, Komuna e Podujevës gjithherë publikon shpalljen për financimin e klubeve sportive mirëpo KF. Llapi është klub më specifik për shkak se është klub i cili garon në garat e super ligës dhe realisht financohet përmes FFK-së, ne e kemi mbështetë KF Llapin me mundësitë tona kur do që kemi pasur hapësirë, vitin e kaluar i kemi nda 10,000.00€ , për KF Llapin mjete për të cilat kemi marrë vërejtje në raportin e auditorit, kështu që kurdo që i kemi mundësitë financiare ne e mbështesim jo vetëm KF Llapin por secilin klub i cili ka sukses dhe e përfaqëson Komunën tonë.

Sa i përket shitësve ambulant është krijuar një vijë e shitjes për ata shitës ambulant të cilët fatkeqësisht atë vijë nuk janë duke e respektuar, unë kam qenë vetë ai person që jam marrë me këtë çështje mirëpo jam takuar me ata shitës dhe të njëjtit nuk e respektojnë vijën të cilën ua ka përcaktuar komuna dhe janë duke i shkaktuar disa probleme, mirëpo ne jemi në kontakt të vazhduar me ta, këto ishin disa përgjigje të pyetjeve tuaja për pjesën e infrastrukturës rrugore iu përgjigjet drejtori i DPUMM-së kurse për pyetjet tjera drejtorët e drejtorive përkatëse.

**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket pjesës që u përmenden tri fshatrat Shtedim, Mirofc, Ballofc, për fshatin Shtedim është një kontratë e vitit 2021 që është kontratë dy vjeçare dhe momentalisht ne po kemi probleme me operatorët e caktuar për shkak të ngritjes së çmimeve për këtë arsye është një rrugë që gjendet në fshatin Shtedim e që besoj që do të kemi komoditetin edhe prej kompanive që të fillojmë asfaltimin e saj e sidomos për të gjitha kontratat që janë lidhur në vitin e kaluar.
Çështja e fabrikës në fshatin Mirofc, sa i përket kësaj fabrike peticioni i cili është ngritur, është ngritur pas lëshimit të kushteve ndërtimore, për të marrë leje ndërtimore fillimisht lëshohen kushtet ndërtimore pastaj vjen leja ndërtimore, kështu që fabrika në momentin që i kompleton kushtet vjen dhe aplikon për leje mirëpo momentalisht ka 3 ose 4 muaj që është në proces të përmbushjes së kushteve dhe në qoftë se i përmbush kushtet normalisht që po, komuna e ka për obligim pjesën, strukturën si objekt për ta lëshuar lejen kurse sa i përket ndotjes që është një shqetësim kryesor për banorët është pëlqimi mjedisor që lëshohet prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
Në rast se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e sheh të arsyeshme se ajo fabrikë nuk e ndotë ajrin ajo atëherë merr një vendim, mirëpo edhe peticionin që e kanë ngritë banorët unë e kam dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që edhe ata ta kenë parasysh peticionin ose më saktë shqetësimin që e kanë banorët për këtë fabrikë.
Çështja tjetër që ka të bëjë me rr.”Skenderbeu”, tashmë edhe pse është koha kur në vendlindje vijnë bashkatdhetarët dhe qarkullimi i qytetarëve është më i madh në të njëjtën vijë është edhe koha kur punohet, ne e dimë këtë aspekt mirëpo duke marrë parasysh këtë gjë dhe procedurat që duhet të ndjekim së bashku me operatorin në fjalë që është përcaktuar si kontraktor punimet do të realizohen në disa faza me të vetmin qëllim mos pengimin e qarkullimit të qytetarëve, mirëpo bëjë thirrje publike që të gjithë qytetarët të shfrytëzojnë rrugë alternative e jo çdo herë ta ndjekin atë rrugë sepse janë duke u zhvilluar punime dhe ka një pengesë në ketë drejtim.
Dua të ndërlidhem edhe me çështjen e shitësve ambulant edhe pse pak a shumë e potencoi edhe Nënkryetarja e Komunës znj.Marigona Lahu, DPUMM me kërkesë të DSHPMSH ka përcaktuar hapësirën ku do të qëndrojnë shitësit ambulant që është një pozitë e favorshme mirëpo në raste të caktuara atyre nuk po iu pëlqen ajo pozitë e shitjes dhe po dalin jashtë kësaj mirëpo nuk qëndron fakti se këta shitës nuk i ka marrë parasysh komuna por ka caktuar një hapësirë për ta që për mendimin tim është një hapësirë mjaftë e favorshme.

*Kryesues i Kuvendit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:35**

**Procesverbalin e mbajti**
**Osmon Bajrami**

**Nr.prot.01-060/04-0058143/22**
**Podujevë,**
**30 qershor 2022**, e ndërprerë
**15 korrik 2022**, e përfunduar

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal i mbajtur më 29 korrik 2022 në mbledhjen e XIII-të (trembëdhjetë), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.**

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç znj.Adelinë Stublla dhe z.Ragip Fetahu të cilët munguan.
Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive (*DBF, DPZHE, DPKGJ, DKA, DPUMM, DSHPMSH, DBPZHR, DA, DSHMS*)
Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale, disa zyrtarë komunal dhe një numër i qytetarëve.

## Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 31 anëtar/e të Kuvendit ndërsa tani për tani mungojnë 4.
Sa i përket kësaj mbledhje konsideroj se të gjithëve ju është dërguar thirrja dhe materiali përkatës brenda afateve përkatëse ligjore, gjithashtu ju janë përcjellë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë ku keni mund të vëreni se janë rekomanduar edhe 4 pika shtesë që të përfshihen në kuadër të rendit të propozuar të ditës së bashku me materialin përkatës, kështu që urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.
**z.Valon Demolli**, theksoi, fillimisht më lejoni të bëjë të qartë se ky deklarim i imi është jashtë rendit të ditës dhe nuk ka të bëjë aspak me politikën partiake, por me integritetin e shërbyesve civil dhe me mendësinë e qeverisjes që është instaluar në Podujevë nga qeverisja e quajtur e ndryshimit.
Që nga fillimi i mandatit ata që erdhën në pushtet me sloganin Bashkë Qeverisim, kanë filluar mbrapsht dhe keç, dhe kur dështon t'i përmbush ato që i ke premtuar fajin gjithmonë e kanë punëtorët, kjo është gabim dhe shumë gabim dhe si rezultat i kësaj është edhe problemi që po shfaqet në administratën e Komunës. Qeverisa e "bishtit të sakicës" në krye me Shpejtimin, nis në seancën e kaluar duke ushtruar presion ndaj asambleistëve për votim apo mos votim, është çudi edhe nga Grupi i asambleistëve të tyre pasi që nuk ka reaguar askush.
Klimën zgjedhore brenda partisë LVV, e ka bartur fatkeqësisht edhe në administratën komunale, për t'iu hyrë n qejf disa aktivistëve, javën e kaluar duke tejkaluar komplet autoritetin e tij zyrtar Kryetari i Komunës ka nxjerrë vendime për transferimin e shërbyesve civil duke keqpërdorur rregulloren përkatëse për transferim të punëtorëve, dhe këtë për hakmarrje e degradim, e kjo në rend të parë vendosë paaftësinë qeverisëse të këtij koalicioni duke mos përfillura asnjë procedurë ligjore ku së pari nxjerrën autorizime për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të Drejtorive, madje kemi raste ku autorizimet bëhen në afat kohorë prej dy orësh, pra ka drejtor që vetëm dy orë ka qenë ushtrues detyre i Inspeksionit. Drejtorët në fjalë posa marrin urdhrat menjëherë fillojnë procedurat e

transferimit ndërsa Kryetari pa humbur kohë fillon ligjin për nxjerrjen e vendimeve dhe transferimeve. Me gjasë në mendje Kryetari i Komunës ka mbetur në vitin 2005 sepse në Komunën e Podujevës rregullativa ligjore nuk ekziston, punëtorët e Komunës për çdo ditë degradohen, poshtërohen, ndëshkohen dhe transferohen pa vullnetin e tyre dhe këtë më së mirë e argumentojnë transferimet e bëra që disa prej tyre po i cekë tani; zyrtari i shëndetësisë transferohet në kryeshef të inspeksionit, inspektori i tregut bëhet zyrtar për kulturë, inspektori i ambientit bëhet zyrtar i arshivës në bibliotekë, po ashtu ofiqari kalon në inspektor të tregut, zyrtari i lartë bëhet asistent administrativ, ndërsa zyrtari i prokurimit dërgohet në gjendjen civile, paramendojeni. Qysh bëhet kjo dhe qysh munden të punojnë këta njerëz mund ta di vetëm Kryetari, nëse jo ndokush nga Ekzekutivi do të doja të dëgjoja edhe nga të tjerët.
Shqetësuese është edhe fakti se është kapur edhe Sindikata e shërbyesve civilë të cilës nuk i është dëgjuar zëri.
Kryetari i Komunës, vendimet e ka nxjerrë duke shkelur Ligjin për zyrtarët publik dhe Rregulloren për transferime sepse transferet pas kërkesës së Drejtorisë mund t'i bëjë vetëm Njësia e burimeve njerëzore, mirëpo Kryetari në këtë rast i ka tejkaluar autorizimet zyrtare dhe këto ne do t'i adresojmë në organet e rendit, dhe njëkohësisht me këtë rast i ftoj organet kompetente që të merren me rastet në fjalë si dhe gjithashtu ftojmë edhe mediat, shoqërinë civile, sindikatën e punëtorëve që të na ndihmojnë në këtë çështje.
Po ashtu, pas gjithë këtij presioni të shërbyesve civilë, kam edhe një kërkesë edhe për mediat, përkatësisht kërkojmë që kamera të qëndrojë në vendin ku ka qenë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju lus që të qëndrojmë në rend të ditës dhe të mos dalim me diskutime jashtë rendit të ditës, e kemi pikën, Të ndryshme ku mund të diskutohen çështje të ndryshme por jo të na përsëriten dy pika Të ndryshme (në fillim dhe në fund). Pra në fillim të mbledhjes mund të diskutojmë vetëm rreth rendit të ditës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, po e bëjë një reagim e që në fakt nuk i përket shumë natyrës time sepse sigurisht se më njihni dhe jeni në dijeni se nuk jam nga ata që promovohem, e sidomos në rrjete sociale, mirëpo reagimi vie për shkak se zyra komunale e informimit në mënyrë tendencioze ka paraqitur mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF. Unë nuk jam kundër promovimit të Ekzekutivit dhe punës së tij në ueb faqen zyrtare, por në mbledhjen e KPF-së dihet roli i anëtarëve të tij. Forma se si është paraqitur ajo mbledhje për publikun në faqen zyrtare të Komunës, publiku nga ajo që është shfaqur ka mundur ta perceptoj se është një mbledhje e bordit të drejtorëve, përjashto këtu Kryesuesin e Kuvendit dhe Komitetit e që ndoshta ndokush ka mundur ta nënkuptoj se është kryetar i bordit të drejtorëve. E them këtë sepse të gjithë jemi dëshmitar të asaj që kemi parë dhe është e vërtetë e madhe se unë zyrtarëve të informimit individualisht ju kam potencuar se jeni duke ngjyrosur politikisht dhe të mos vazhdohet kështu, por përkundrazi vetëm kanë vazhduar më tutje.
Kësaj radhe nuk do ta zgjas më shumë, por meqë kjo zyrë është pjesë e kabinetit të Kryetarit të Komunës do të doja të jetë në përgjegjësi të punës së e kryen, të jetë më profesionale, e pa anshme ashtu siç e kërkon rendi dhe Rregullorja për transparencën dhe informimin e drejtë të publikut.
Nuk dëshiroj të keqkuptohem sepse për qëllim e kisha që këtë çështje ta propozoj si pikë shtesë të rendit të ditës, ngase ja vlen të debatohet sepse zyra e informimit duhet t'i nënshtrohet rregullave të Komunës, ndërsa Komunën e përbëjnë edhe Kuvendi edhe Ekzekutivi, mirëpo meqë Kryetari i Komunës nuk është prezent këtu do ta kem parasysh që në një prej seancave të ardhshme ta paraqes si propozim për rend të ditës.

**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, lus që t'i përmbaheni Rregullores së punës së Kuvendit, përndryshe herëve tjera pikën e rendit të ditës, Të ndryshme po zhvendosim të parën dhe po fillojmë nga ajo.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, meqë u kërkua dhe po kritikohemi që po diskutohet sikurse të jemi në pikën Të ndryshme, atëherë lus edhe drejtorët e Ekzekutivit të qëndrojnë në sallë deri në fund të mbledhjes sepse deri më tani në asnjë seancë nuk kanë qëndruar deri në fund për t'i dëgjuar kërkesat tona.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, si dhe duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, ne kemi pasë një rend të ditës që na është përcjellë dhe kemi sugjerimet e KPF-së, andaj pikat e sugjeruara nga KPF duhet paraqitur si pika të veçanta para Kuvendit sepse të veçanta janë, pra ato pika të numërohen takstativisht dhe për të njëjtat të jepet arsyeshmëri përse ne si Kuvend duhet t'i votojmë apo jo.
Ne kemi rekomanduar si KPF, mirëpo aryeshmërinë e tyre duhet ta bëjnë edhe në Kuvend sepse Kuvendi vendosë për rendin e punës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se drejtorët përkatës i kanë dhënë të gjitha arsyetimet në mbledhjen e KPF-së për ato pika shtesë që janë rekomanduar nga mbledhja e KPF-së dhe besoj se secili drejtor që ka propozuar pikat në fjalë do të jep edhe arsyetimet këtu në Kuvend, kështu që për t'i votuar për përfshirje në rend të ditës nuk kemi nevojë për arsyetim edhe njëherë ndoshta por në qoftë se ka nevojë besoj se drejtorët janë të gatshëm për dhënë, kështu që meqë u hedh në votim dhe u votua konsideroj se nuk kemi nevojë që procesin ta kthejmë mbrapa, pra 18 vota ishin Për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

*Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 18 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje përfshirë edhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28 korrik 2022.*

## 1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit, të mbajtura më; 29 prill 2022; 20 maj 2022 dhe 19 qershor 2022

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kemi tri procesverbale nga mbledhjet e Kuvendit, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë i hedh në votim procesverbalet në fjalë ashtu siç ju janë përcjellë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, nga 33 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, miratohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës sipas materialit përkatës të kësaj pike të rendit të ditës.*

2. **Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2021**
   **- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit**

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Komunën është i një rëndësie të madhe për arsye se paraqet gjendjen reale të respektimit të ligjshmërisë gjatë aktivitetit të saj për vitin 2021, Raport i cili është me një opinion të pa modifikuar, pra është një raport pozitiv dhe sipas këtij raporti pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Baza sipas të cilës është krijuar opinioni pozitiv i Auditorit është konstatimi i tyre se transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Podujevës kanë qenë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.
Raporti i pa modifikuar i Auditorit është i një rëndësi të madhe edhe për shkakun se Komunës së Podujevës i mundëson një qasje në kredi investive nga Institucione ndërkombëtare financiare dhe në grante të tjera qoftë nga Organizata të huaja qoftë nga Ministritë sikurse që është granti i perfomancës.
Raporti në fjalë paraqet edhe të gjeturat që janë konstatuar kryesisht të natyrës teknike apo disa të gjetura të cilat nuk janë shkaktuar nga veprimet e Komunës së Podujevës por që kanë shkaktuar dëme edhe tek ne, pra janë gjithsej 12 të gjetura të Zyrës Kombëtare të Auditimit për të cilat kemi hartuar edhe planin e veprimit në mënyrë që këto të gjetura të mos përsëriten në vitin 2022.
Për fillim nuk dëshiroj të marrë kohë më shumë mirëpo gjatë debatit do t'i shkoqisim të gjitha këto të gjetura si dhe do të diskutojmë për planin e veprimit i cili është hartuar me qëllim të zbatimit e këtyre të gjeturave.
**z.Arjant Topanica**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, sot në këtë mbledhje një ndër pikat e rendit të ditës është edhe pasqyrat e Auditorit dhe ajo se çfarë Auditori ka paraqitur se si shkojnë punët në Komunën e Podujevës. Fillimisht do të ndalesha tek hartimi i këtij Raporti të auditimit i cili duke marrë në përgjithësi ose në rast se e sheh dikush nga jashtë duket mjaft pozitiv, mirëpo në këtë pozitivitetin e tij fshehët diçka prapa tij, pra gjatë hartimit të tij janë bërë disa marrëveshje që kush i din veç e din për çfarë është fjala, me qëllim që ky Raport të del i tillë çfarë edhe është, por megjithatë nuk është i fshehur dhe edhe ky përmban një varg mangësish.
Tek arsimi dhe tek drunjtë dekorativ, si pika që të gjithë i dimë janë dy procese të cilat janë në procese gjyqësore kurse ne nuk i kemi të parapara në auditim, pra kjo është si pikë fillestare përse unë e thash më herët se ky Raport nuk është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nuk është bërë në mënyrën më korrekte nga hartuesit e tij.
Ky Raport rezulton me 12 gjetje apo rekomandime prej të cilave 6 janë rekomandime të cilat janë përsëritur nga vitet e kaluara e që do të thotë se nuk është marrë askush me to, si dhe 6 janë të gjetura të reja. Tek gjetjet e mëhershme që janë përsëritur edhe në këtë Raport të auditimit do të përmend vetëm shkurtë për arsye se ato përsëriten edhe në gjetjet e këtij viti, si gjetje të mëhershme me të cilat nuk është marrë askush dhe që nuk janë përmirësuar janë subvencionimi dhe transferet, janë tek pasuritë e Komunës, tek llogaritë e arkëtueshme apo borxhet që qytetarët i kanë ndaj Komunës, dhe tek obligimet e papaguara për të cilat Komuna vazhdon të marrë gjoba nga proceset gjyqësore dhe ato të përmbaruesit.

Si rekomandime të gjetura të reja tek raporti i fundit i auditimit janë pagesat përmes vendimeve gjyqësore për të cilat vetëm sa isha duke cekur, pra janë mbi 500,000.00€ pagesa që janë bërë si shkak i vendimeve gjyqësore apo si mos përmbushjes së detyrimeve të Komunës dhe për këto Komuna paguan nga taksat tona shumën prej 500,000.00€ për gjobat që ajo merr. Mandej janë mangësitë në menaxhimin e subvencioneve ku disa OJQ kanë përfituar në kundërshtim me ligjin për përfitime të OJQ-ve, ka raste kur ato në dokumentacionin e tyre nuk kanë paraqitur dëshmi se nuk i kanë kryer obligimet në ATK e që për këtë arsye nuk mund të jenë përfituese të subvencioneve por që në rastin tonë kanë përfituar, pastaj kanë paraqitur dëshmi jo relevante për këto pagesa e që më vonë është kuptuar se dokumentacionet e OJQ-ve nuk kanë qenë në rregull dhe korrekt por që edhe ato OJQ kanë përfituar, si dhe rast tjetër konkret është ku OJQ-të nuk kanë paraqitur fare raport financiar në dokumentacionet e tyre por që edhe në këto raste kanë përfituar. Mungesa e planit vjetor për financim të OJQ-ve është edhe kjo nga pikat e paraqitura në raportin e auditorit e që Komuna obligohet ta ketë një plan vjetor për financimin e OJQ-ve por që nuk e ka një plan të tillë.
Mos pagesa e fatura dhe borxheve brenda afateve të caktuara ligjore, këtë çështje veç e ceka më parë se Komuna nuk ka arritur t'i përmbush borxhet dhe obligimet e saj në kohë reale e që për këtë arsye mund të ndëshkohet sepse lënda mund të shkoj tek përmbaruesi dhe kështu mund të ndëshkohet dhe të paguaj edhe kamatën e interesit
Klasifikim jo i duhur i kategorive të shpenzimeve, kjo si gjetje e auditorit që si rezultat i planifikimit jo të mirë ka raste kur për disa shpenzime merren para nga kodet tjera buxhetore dhe paguhen ato shpenzime. Pastaj mungesë e kontrollit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare është një e gjetur që pasqyrat financiare nuk janë të përgatitura në mënyrë të drejtë dhe të sakt. Mandej anashkalim i sistemit informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore, pra për çdo ditë kemi konkurse e më shumë kemi të punësuat pa konkurse kurse kjo Komunë e anashkalon tërësisht sistemin informativ që është bërë me këtë qëllim që të lehtësoj dhe për të qenë më transparent procesi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i tyre. Vonesa në kryerjen e punëve të kontraktuara si e gjetur e auditorit që kjo Komunën dhe operatorët e saj kanë bërë gjatë realizimit të punëve të kontraktuara. Mandej kemi të gjeturën regjistrim jo i plotë dhe mangësi në menaxhimin e pasurisë e që sipas këtij raporti kjo Komunë tregon një kujdes të ulët ndaj pasurive që janë pasuri e taksapaguesve tanë/tonat e që kjo të dërgon tek një mos dijeni se çka ka Komuna në pronësinë e saj dhe ato si rezultat i kësaj mund edhe të tjetërsohen por edhe të manipulohen kur nuk janë të evidentuara si pasuri të Komunës.
Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, pra Komunës së Podujevës në vitin 2021 i kanë borxhe qytetarët 4.3 milion euro prej të cilave 3.3 milion euro apo afër 80% janë borxhe nga tatimi në pronë e që Komuna nuk arrin të gjej mënyra dhe forma efikase si dhe politika të thithjes së këtyre borxheve të qytetarëve ndaj Komunës për realizueshmërinë sa më të madhe të llogarive të arkëtueshme, mirëpo që në këtë vit që jemi 2022 ky borxh veç është duke u rritur përkundër që do të duhej të zvogëlohej.
Si çdo raport edhe ky i auditorit të përgjithshëm i ka pikat pozitive mirëpo e jona është që qytetarëve t'i tregohet realja se çfarë po ndodh në këtë Komunë dhe atë do ta bëjmë gjithherë deri në fund të mandatit, si dhe punëve të mira gjithsesi se do t'iu themi puna e mbarë.
**z.Xhevdet Maloku**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, raporti i fundit i auditimit para së gjithash dallon shumë nga raportet e mëparshme të cilat kanë pasur të gjetura të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare në buxhetin e Komunës së Podujevës. Raporti në fjalë është vlerësuar si raport pozitiv i pa modifikuar dhe i cili përmban të gjetura të cilat janë kryesisht të natyrës teknike.
Vlen të përmendet fakti se nga 13 Komunat e Kosovës të cilat kanë pranuar raport pozitiv, vetëm 2 prej tyre janë Komuna të mëdha dhe njëra prej këtyre Komunave të mëdha është Komuna e Podujevës. Llogaridhënia dhe ndershmëria përkufizojnë transparencën e qeverisë, transparenca më e

madhe është e barabartë me nivelin më të ultë të korrupsionit, andaj sipas opinionit të auditorit pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.
Raporti pozitiv i auditimit i mundëson Komunës së Podujevës përfitimin e donacioneve dhe kredive nga institucione Evropiane, ndër to siç është projekti i kolektorit të ujërave të zeza dhe granti i performancës nga MAPL.
Në emër të Grupit të asambleistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, e vlerësojmë maksimalisht punën e qeverisë në arritjen e një rezultati të tillë nga raporti i auditorit, gjithashtu e vlerësojmë pozitivisht përgatitjen profesionale të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, pasi që ndjekja e rekomandimeve është nga fazat e fundit të procesit dhe kjo fazë në fakt paraqet vlerën e shtuar të organizatës që japin auditorët pasi që ndihmon përmirësimin e procesit, andaj kërkojmë nga Ekzekutivi i Komunës që të gjeturat e këtij raporti të mos përsëritën më por të veprohet menjëherë që të përmirësohen edhe këto pika dhe në raportin e ardhshëm të mos kemi gjetje të përsëritura.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, në raportin e auditimit të vitit 2020 zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 14 rekomandime për vitin 2021, dhe nga ato 14 rekomandime 8 prej tyre janë zbatuar kurse 6 prej tyre jo. Unë dëshiroj të ndalem në 6 rekomandimet të cilat Komuna nuk i ka zbatuar, dhe atë; 1-subvencionet dhe transferet, përzgjedhja e përfituesve nga komisionet përkatëse të bëhen vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në thirrjen për aplikim, 2-përgatitja e planit vjetor për financimin e OJQ-ve dhe i njëjti të dërgohet në Zyrën e Kryeministrit, 3-regjistrimi i pasurive mbi dhe nën 1000€ në sistemet përkatëse, edhe në rekomandimin e 4-të është rekomandim i të njëjtës natyrë mirëpo të bëhet një krahasim i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë, pastaj 5-llogaritë e arkëtueshme dhe efikasiteti i mbledhjes së borxheve si dhe shqyrtimi i masave ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet, ndërsa rekomandimi 6-pagesa e faturave të bëhet në afatet ligjore.
Unë mendoj se disa prej rekomandimeve janë teknike të cilat munden lehtë të përmirësohen kurse për disa prej tyre duhet një plan për t'i përmbushur ato.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, ju falënderoj për diskutimet e bëra deri më tani për raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Komunën e Podujevës për vitin 2021 si dhe për planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna me raportin në fjalë, plan i cili është hartuar nga ana jonë.
Edhe në fjalën hyrëse e potencova që elementi më i mirë dhe më pozitiv është që ky raport është raport i pa modifikuar dhe për faktin që në këtë edhe Zyra Kombëtare e Auditimit ka pasë pulitka shumë më strikte në auditimin e pasqyrave financiare e që si rezultat i kësaj pjesa dërmuese e institucioneve të Kosovës kanë dal me raport negativ financiar. Nga gjitha Komunat e Kosovës vetëm 13 prej tyre janë me raport pozitiv financiar dhe nëse i marrim Komunat e mëdha janë vetëm 2 prej tyre me raport të tillë, Podujeva dhe Gjakova, ndërsa të tjerat kryesisht janë Komuna të vogla të cilat kanë pasë një raport pozitiv financiar, dhe kjo është tepër e rëndësishme për arsye se investimet e mundshme që do t'i kemi nga institucionet financiare ndërkombëtare e që normalisht vijnë përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës, sikurse që është impianti për trajtimin e ujërave të zeza, do të thotë në qoftë se ky raport do të ishte negativ atëherë ne nuk do të mundnim të aplikonim për ato kredi, gjithashtu tek granti i performancës ku pritet të jetë ndoshta mbi gjysmë milion euro, sigurisht që nëse ky raport do të ishte negativ ne nuk do të mundnim të aplikojmë fare për këtë grant, prandaj po e them se këto janë ndikime shumë pozitive të cilat i ka raporti pozitiv i auditorit.

Sigurisht se ky raport i ka edhe të gjeturat për të cilat me të drejtë u diskutua këtu nga parafolësit, dhe shumë nga këto të gjetura janë të natyrës teknike por që të cilat ekziston mundësia të përmirësohen, ta zëmë plani për subvencionimin e OJQ-ve të dërgohet në Zyrën e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, e që pa dyshim se është dashtë të dërgohet por sa unë jam në dijeni ka qenë i përgatitur por që nga Drejtoria përkatëse nuk e di përse nuk është dërguar, mirëpo që këtë vit dërgohet e që është një e gjetur teknike.
Gjithashtu janë edhe disa të gjetura tek regjistrimi i pasurive, por që në këto çështje ka edhe paqartësi ligjore dhe të gjithë jemi në dijeni se me vite të tëra janë disa problematika në regjistrimin e pasurive, bëhet fjalë edhe për disa pasuri të cilat janë të trashëguara dhe të ndërtuara pas luftës e që nuk ka një infrastrukturë ligjore të qartë se si do të regjistrohen ato, por edhe për disa lëshime teknike për regjistrimin e këtyre pasurive.
Ajo që ndoshta është e gjetura më shqetësuese që na shqetëson të gjithëve është tek çështjet e ekzekutimeve të buxhetit përmes vendimeve gjyqësore. Nga kontratat e prokurimit të lidhura në vitin 2021 dhe nga punët që ka kryer Komuna në vitin 2021 nuk është asnjë ekzekutim përmes procesit të vendimit gjyqësor, por të gjitha këto janë nga nënshkrimi i kontratave kolektive që kanë ndodhur nga niveli qendrorë nga Qeveritë e kaluara të cilat kanë nënshkruar kontrata kolektive pa mbulesë financiare dhe rrjedhimisht Komuna e Podujevës nuk ka buxhet as të planifikuara e as mënyrë se si t'i procedoj ato kontrata kolektive për pagesë dhe rrjedhimisht duke u bazuar në Kontratën Kolektive, kryesisht mësimdhënësit dhe mjekët i gjejnë rrugët e tyre përmes Gjykatave që t'i marrin ato mjete financiare e që është shumë shqetësuese mirëpo është diçka që nuk e ka shkaktuar Komuna e Podujevës e që de-facto e vuan edhe Komuna e Podujevës edhe pse ato mjete financiare janë paguar nga mjetet shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që do të thotë se nga ajo shumë nuk është prekur Komuna e Podujevës por si do që të jetë edhe ato mjete të qytetarëve kudo që merren.
Tek llogaritë e arkëtueshme, Komuna e Podujevës i trashëgon mbi 3 milion euro obligime që kanë qytetarët, kryesisht tek qiratë dhe tatimi në pronë, mirëpo edhe në bazë të këtij raporti vërehet se ka një rritje të ndjeshme të të hyrave nga tatimi në pronë, madje vitin e kaluar kemi pasë dyfishim të të hyrave nga tatimi në pronë, por që nuk kemi mundësi që ato mjete që janë grumbulluar për 20 vite të mblidhen për 1 vit, madje nuk ka as rrugë ligjore se si të mblidhen ato borxhe.
Ka pas raste që ka ndodhur Keq klasifikime, por kanë ndodhur kryekëput për të mirën e qytetarëve, dhe këtë e them duke marrë për bazë faktin ku ka raste kur është ofruar një donatorë për realizmin e ndonjë projekti të caktuar dhe ai donator ka kërkuar participim 10% të vlerës së Marrëveshjes, ne nuk e kemi pasë të planifikuar atë dhe nuk ka logjikë, as arsyeshmëri e as asgjë ta zëmë që të lëshohet një investim në shumë 100,000.00€ për një shumë prej 10,000.00€ nga ne si Komunë, dhe në këtë aspekt ne është dashtë të bëjmë ndonjë keq klasifikim në mënyrë që ai investim të shkoj në dobi të qytetarëve.
U përmenden edhe pasqyrat financiare dhe këtu absolutisht ashtu siç edhe e potencon raporti i auditorit janë në përputhje dhe paraqesin gjendjen reale të Komunës së Podujevës dhe janë të ndërtuara në raport me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik.
Përgjatë procesit ka ndodh një lëshim teknik i cili është përmirësuar përmes thesarit me rekomandim të Auditorit Gjeneral dhe në fund kemi pasqyra të drejta financiare.
Përveç anës pozitive, edhe diçka që është pozitive në raport me të gjeturat e vitit të kaluar, e mira është se nuk është asnjë e gjetur që i ka shkaktuar dëm financiar Komunës së Podujevës, përjashtimisht çështja e vendimeve gjyqësore e që nuk është diçka që e ka shkaktuar Komuna e Podujevës, për dallim nga viti i kaluar ku kemi anashkalime të procedurave të prokurimit 69,500.00€ blerje, pastaj tejkalim të kontratës kornizë që është konstatim i auditorit e që Komunës së Podujevës i është shkaktuar dëm financiar afër 40,000.00€, ka pas dobësi në menaxhimin e kontratave ku janë

paguar punë të pakryera, ka pas specifikime teknike jo të qarta dhe janë përmendur edhe emra tregtar që u janë drejtuar specifikimet teknike drejt operatorëve të caktuar, por fatmirësisht këto të gjetura nuk janë në vitin 2021 dhe duke shpresuar që të gjeturat e vitit 2021 të mos jenë në vitin 2022.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, po nisem prej aty ku e la drejtori parafolës duke përmendur të kaluarën e që mendoj se ajo është e shkuar tash më dhe është bërë paksa e tepërt duke u kthyer të kaluarën sepse ne po flasim diçka çka është reale (ne po i themi shiko ku është rruga, drejtori po thotë shiko ku është gropa). Sa i përket asaj që u përmend se raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit është pozitiv dua ta potencoj se posa kanë ardhur në pushtet partia që këta përfaqësojnë e kanë ndërruar kryetarin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, dhe për herë të parë dhe ndoshta prej rasteve më të rralla këtë raport e bënë dikush që është i këtij vendi, apo edhe i vendeve tjera për vendet prej nga vijnë, shembull raportin e Komunës së Podujevës e bënë dikush që është i anës tonë e që kjo nuk ndodh shpesh, madje ka pasë bujë edhe në media që kjo nuk është të lejohet.
Pastaj u përmend Kontrata Kolektive dhe u tha se nuk ka buxhet dhe nuk ka planifikim, atëherë do të doja ta di përse nëse nuk ka qenë e planifikuar dhe nuk ka buxhet përse ka qenë një prej premtimeve kryesore elektorale, këto dyja bashkë nuk shkojnë.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, Komunën e Podujevës e kanë audituar tre auditor dhe kanë qenë të Komunave të ndryshme dhe pastaj Raporti i Auditorit kalon edhe disa filtra nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Nuk dëshirova të lëshohem në detaje për këtë edhe pse më herët pati vërejtje për disa mostra të cilat nuk janë zgjedh, ka një procedurë teknike se si kjo Zyrë i përzgjedh mostrat, dhe ato mostra kanë qellu, ndoshta nëse ne do t'i zgjedhnim mostrat nuk do të ishin as këto 12 të gjetura ngase i kishim anashkaluar edhe këto, do të thotë ata i kanë zgjedh dhe sot kemi 12 të gjetura, po t'i zgjedhnim ne asnjë e gjetur nuk do të ishte.
Sa i përket ndikimit tek Zyra Kombëtare e Auditimit, unë nuk e di si mund të ketë ndikime të tilla kur ata kanë qenë për 1 muaj këtu dhe unë 2 herë i kam takuar, nuk kam shkuar unë me ta në Batllavë sikurse që kanë shkuar në të kaluarën, pra nuk ka kurrfarë mundësie të ndikimit, madje u cek ndikimi politik i LVV-së, mirëpo ka Ministri të ndryshme të cilat kanë dalë me raport jo pozitiv, andaj është absurditet logjik me mëndu kështu, dhe tjetra unë nuk e di çfarë interesi ka Zyra Kombëtare e Auditimit që të hartoj një raport pozitiv të tillë për Komunën e Podujevës.
Prandaj është shumë pozitive që ky raport është pozitiv, janë edhe të gjeturat që ceken në raport por që nga asnjë e gjetur nuk paraqet asnjë cent dëmtim financiar të buxhetit të Komunës së Podujevës, përjashto ato vendime gjyqësore që nënshkruajshi Kontrata Kolektive pak para zgjedhjeve për me marrë ndonjë votë prej mësimdhënësve/arsimtarëve, pra kjo është e gjetura e vetme realisht, por sigurisht se edhe në vitin e ardhshëm do të ketë ndonjë të gjetur ngase asgjë nuk në perfeksion sepse po të mos ketë ndonjë gjë të tillë atëherë do të duhej të mbyllej i gjithë profesioni i auditimit, pra nuk ka mundësi asnjëherë të mos ketë asnjë të gjetur.
Edhe njëherë po e ritheksoi se dy çështje janë me rëndësi, 1-nuk ka asnjë cent dëm financiar të buxhetit të Komunës së Podujevës, dhe që 2-raporti është pozitiv ndër Komunat e pakta.
**z.Xhevdet Maloku**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, fillimisht do të doja nga administrata të shikohen se a punojnë edhe mikrofonat tanë që jemi ulur në anën e majtë apo jo sepse vetëm këta në anën e djathtë po shikohen, si dhe do të doja të ndalej gjuha e përdorur nga vendi prej në drejtim timin sepse nuk është mirë për qytetarët një gjuhë e tillë.
e kaluara nuk do të ishte e lehtë të harrohet ashtu siç po e kërkon opozita, po të mos ishte rëndësishme as tek raporti i auditorit nuk do të kishte të gjeturat të përsëritura apo të gjetura të cilat janë marrë për bazë dhe janë përmirësuar.
Është mirë të njoftohet opinioni dhe qytetarët se Komuna e Podujevës në vitin 2020 kishte lidhë Kontratë për blerjen e një kamioni për departamentin e zjarrfikësve në vlerë 69,500.00€ duke

anashkaluar të gjitha procedurat e prokurimit publik, po ashtu kishte pagesa të avancit në kundërshtim me ligjin e buxhetit ku kishte paradhënie 20,850.00€ për blerjen e po këtij kamioni për zjarrëfikësit duke kaluar kështu 30% të vlerës së Kontratës kurse me ligj është deri në 15% të vlerës së kontratës. Gjithashtu kemi dobësi në procedura të prokurimit ku tek rregullimi i shtratit të lumit Llap-vazhdim është eliminuar oferta e operatorit ekonomik prej 136,666.00€, ndërsa kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik ishte 159,751.00€ apo 23,000.00€ më e madhe.
Po ashtu kemi të gjetura tjera ku është dëmtuar buxheti i Komunë me 31,000.00€ duke paguar kështu kompensimin e pagave të një punëtoreje të arsimit të lartë e larguar nga puna pa bazë ligjore, do të thotë kemi shkelje të ndryshme siç është edhe tek dhënia e subvencioneve te projekti për mullinj për prodhimin e ushqimit ku fermeri ka aplikuar me dokumentacion të një fermeri tjetër dhe përsëri ka përfituar subvencion.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, fillimisht do të doja të ndërlidhem me kolegun parafolës i cili nuk është hera e parë që po e mban rendin në Kuvend e që nuk është i thirrur për këtë gjë, pra në çdo seancë e jep nga një vërejtje por që nuk është detyrë e tij kjo. Sa i përket gjitha ato gjetje që parafolësi i ceku mendoj se vetëm i'a lehtësoj punën paksa drejtorit të DBF-së dhe nëse atij i duket se është dëmtuar buxheti më parë apo që auditori ka pasë gjetje të mëhershme për dëmtimin e buxhetit të Komunës atëherë edhe për Kontratat Kolektive është dëmtim i buxhetit sepse pagesat do të bëhen, madje disa prej tyre edhe përmes përmbaruesit e që ka edhe një lloj interesi ose kamate aty dhe rrjedhimisht është dëmtim. Pastaj është në prokurori edhe lënda tjetër për drunjtë dekorativ dhe nëse kjo i'u duket asgjë atëherë paraqiteni ashtu si të doni.
Drejtori goxha me injorancë i paraqiti të gjitha ato rekomandime dhe u mundua t'i zbus goxha shumë, por nuk janë ashtu asgjë fare siç i potencoj. Ka gjetje dhe pse është e vërtetë dhe nuk mund ta tjetërsoni që është ndikuar në raportin e auditimit, edhe pse drejtori e tha se nuk ka pasë interes për një gjë të tillë, ne e dimë këtë nga e kaluara se si shkojnë këto, e them këtë sepse drejtori e tha që keni qenë në Batllavë, kurse unë ju them se ju e keni pasë njeriun e fshatit Llapashticë të cilit i keni premtuar edhe rrugë edhe ndriçim, madje ai i'u ka premtuar banorëve të ati fshati duke i'u thënë se unë jua kryeva rrugët, e ceka këtë sepse drejtori më detyroi të lëshohem deri në këtë pikë.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, pasi që diskutimet morën kahje tjetër e që edhe dje në mbledhjen e KPF-së apelova që institucioni është institucion kurse partitë politike janë parti politike, por që po tentohet të bëhet politikë gjegjësisht po involvohen edhe programet e partive politike edhe pse jam në dijeni se partitë politike funksionojnë dhe qeverisin në bazë të programeve të tyre politike, mirëpo sot të thirresh në atë që ne e kemi dëmtuar buxhetin e Komunës për 500,000.00€ ngase dy partitë tjera që kanë qenë në pushtet e kanë nënshkruar Kontratën Kolektive, prandaj të mos harrojmë se ato parti që kanë qenë në pushtet nuk ka nënshkruar si parti dhe këtu nuk po mund ta bëjmë një dallim ngase ato kanë nënshkruar dhe kanë lehtësuar jetën duke i rritur pagat dhe mirëqenien e qytetarëve gjegjësisht punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë dhe kjo mua më bënë të ndjehem mirë, dhe çdo kush që arrin t'iu përgjigjet kërkesave të arsyeshme të punëtorëve të vet për rritjen e mirëqenies më bën të ndihem mirë, mirëpo ajo që nuk më bënë të ndihem mirë dhe që nuk po mund ta akceptoj është se pse gjithë ky averzion që të thuhet se një parti politike, në këtë rast duhet kush kanë qenë LDK-PDK që kanë nënshkruar, jo mor, Kontratën e kanë nënshkruar Institucionet e Republikës së Kosovës dhe ato Institucione e kanë shpallë edhe Republikën e Kosovës dhe çka tani të thuhet se ato e kanë shpall dhe nuk është e mirë, jo nuk mendoj kështu dhe konsideroj se duhet të lirohemi nga këto sepse institucioni është institucion.
Meqë e mora fjalën dua të them se shqetësimi më i madh dhe kryesor për mua janë pagesat sipas Kontratës Kolektive që punëtorët i kanë realizuar në mënyrë të dhunshme me vendime gjyqësore në shumë 5000,000.00€ dhe e keçja është se shkaku i mos azhurimit me kohë të atyre mjeteve që janë

paguar përmes vendimeve gjyqësore është dashtë të paguhet edhe interesi në shumë rreth 300,000.00€, dua të them se më e favorshme do të ishte që të parashiheshin me kohë në projeksione buxhetore dhe të paguheshin me kohë në mënyrë që të mos paguanim pastaj edhe kamata.
Për fund dua të them se shqetësuese është edhe një element, këto të gjetura në raport, qofshin të vogla apo të mëdha e që vazhdimisht na referohet se raporti nuk ka të gjetura dhe është në përputhje me këtë / atë, shqetësim për qytetarin e Komunës së Podujevës duhet të jetë që buxheti i Komunës së Podujevës i vitit të kaluar është shpenzuar 83.03%, dhe në vitin paraprak e që po duhet të merret referencë sepse po ndodh vazhdimisht të kritikohet një pushtet që ka qenë dhe të vazhdohet tutje, edhe ai e ka realizuar 83%, pra ndryshimi i vetëm është 0.3%, dhe krejt poenta ku dëshiroj të dal është se nga mos shfrytëzimi i buxhetit komunal qytetarët duhet ta dinë që Komunës së Podujevës në vitin 2021 i kanë mbete si të pashpenzuara rreth 2 milion e gjysmë euro, dhe a e kemi ne atë mirëqenie të ngritur të qytetarëve dhe a nuk ka pasë nevojë qytetari dhe Komuna se ku t'i adresoj dhe ku t'i shpenzoj si dhe cilat projekte t'i realizoj ato mjete për përmirësimin e jetës së qytetarëve, pra kjo është shqetësimi numër një.
Ndërsa tek pasqyrat vjetore financiare që janë prezantuar para Kuvendit, e potencova edhe në KPF dhe po përsërisë sërish, madje po e lexoj dhe nuk po e them diçka përmendësh, këtu në raport auditori konstatohet; *po ashtu procesi i raportimit në Komunë është përcjellë me mangësi, kjo është e vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare.*
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, ndoshta po e zgjatim paksa mirëpo dua t'i jap edhe dy përgjigje, u diskutua dhe ndoshta u shterë debati lidhur me çështjen e Kontratës Kolektive të cilën e vërtetë është se e kanë nënshkruar institucionet, mirëpo në institucione janë disa përfaqësues politik të cilët institucionin e kanë përdorë për përfitime elektorale dhe ajo Konstantë është nënshkruar në prag të zgjedhjeve dhe këtë e mbaj mend shumë mirë.
Tek çështja tjetër sa i përket raportit financiar, në vetë këtë raport thuhet se arsyeja përse ky raport është i pa kualifikuar dhe pozitiv, është se pasqyrat financiare paraqesin gjendjen materiale të sakt, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit publik, dhe gjatë fazës së hartimit disa çështje teknike të cilat u lexuan nga parafolësi, janë përmirësuar, dhe nëse do të ishte ashtu siç e paraqiti parafolësi raporti nuk do të ishte pozitiv (romani nuk lexohet vetëm dy rreshta por duhet të lexohet komplet për ta ditë kuptimin).
Sa i përket asaj që u tha se këto të gjetura po paraqiten me injorancë, unë ju them se këto janë të gjetura dhe janë të sakta dhe ne kemi bërë një letër konfirmim sipas të cilës i kemi pranuar këto të gjetura si dhe e kemi ndërtuar një plan të veprimit që këto të gjetura t'i zbatojmë gjatë vitit 2022 e që shpresojmë dhe punojmë që t'i përmirësojmë.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, pa dashur të zgjati debatin por që në fillim kur e thotë drejtori, Zyra Kombëtare e Auditimit këtij radhe ka kritere strikte, në një formë kalon prej kompetencës së tij dhe në një formë hynë dhe e kontrollon auditorin se kur paska rregulla strikte dhe kur paska "llastik', pra drejtori hynë në diçka që nuk na përket neve, as nuk kemi autoritet dh as nuk jemi ne ata.
Një qeverisje e mirë, naze e ka ligjin, llogaridhënien dhe transparencën, dhe tani e pyes drejtorin e DBF, a do të duhej që ne si anëtar të Kuvendit e në veçanti si Komitet për Politikë dhe Financa, dhe që është obligim ligjor ta kemi planin e punës së prokurimit, planin dhe raportin e punës së auditorit të brendshëm, raportin e performancës, e që po ti debatonim këto në Kuvend sigurisht se shumë lehtë do ta kuptonim dhe do të debatonim për raportin e Auditorit të jashtëm. Kështu që ajo kur e thotë drejtori i DBF-së, kriteret strikte, nuk po mund ta kuptoj çka nënkuptojmë me kritere strikte, madje unë kam menduar se Auditori gjeneral ka kritere të cilat vlejnë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, madje me këtë në një formë drejtori po del në kundërshtim sepse po e potencon se nuk ka

bërë asgjë ai (auditori) që ka qenë i anës tonë, në të njëjtën kohë po e thotë vazhdimisht kritere strikte.

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, e thash, kritere strikte sepse ka pas auditim në tërë Republikën e Kosovës shumë serioz, që ka zgjatë dhe që ka pas mostra më shumë qoftë tek pasqyrat financiare, qoftë tek keq klasifikimet qoftë tek regjistrimet e pasurisë, për herë të parë auditori i ka kualifikuar në raport, dhe në bazë të materialitetit që ka pasë për tërë Republikën e Kosovës dhe si rezultat i këtyre kritereve që kanë qenë të reja në një aspekt në procesin e auditimit e që pjesa dërmuese e Komunave për herë të parë kanë dalë me raport negativ, jo që në Kosovë është bërë ndoshta më keq se viteve të kaluara në ato Komuna, mirëpo për shkak të kritereve thuhet se kanë dalë me raport negativ të auditorit, pra kjo është çështja strikte.

Për pjesë të tjera të raportit të auditorit sigurisht se do të jenë pjesë e diskutimit në mbledhjet e ardhshme, por sot jemi duke diskutuar për raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit e që normalisht që auditim është bërë edhe tek çështjet e prokurimit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

(*Pra diskutimet përfunduan për këtë pikë të rendit të ditës dhe si pikë mund të konsiderohet e përfunduar*)

## 3. Raporti Financiar janar - qershor 2022

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, raportin në fjalë e keni pranuar si material së bashku me thirrje e kësaj mbledhje, raport në të cilin janë paraqitur të gjitha shpenzimet e bëra përgjatë kësaj periudhe në bazë të planifikimit të buxhetit që ka qenë 23,449.521.00€, andaj janë paraqitur të gjitha shpenzimet e bëra për këtë periudhë kohore gjashtë mujore.
Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,654,762.00€, për mallra dhe shërbime mbi 1 milion e 35 mijë euro, dhe kështu me radhë.
Diçka që ndoshta në pamje të parë mund të vërehet janë investimet kapitale ku nga rreth 6,949,000.00€ të planifikuara, janë shpenzuar vetëm 1,014,607.00€ e që sigurisht se në pamje të parë duket një trend jo i mirë i realizimit të investimeve kapitale mirëpo e vërteta është se kryesisht Komuna e Podujevës buxhetin për këtë vit nuk e ka pasë të miratuar deri në muajin prill e që normalisht se edhe procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratave në këtë gjashtëmujor kanë zgjatur.
Ky raport është për gjashtëmujorin e parë të vitit, mirëpo sa për informimin e juaj vetëm në muajin korrik janë shpenzuar afër 1 milion euro tek investimet kapitale, do të thotë se komplet shuma e investimeve të bëra në gjashtëmujorin e parë tek investimet kapitale, janë investuar afërsisht vetëm në muajin korrik, pra përgjithësisht është trend i mirë në investimet kapitale por edhe tek kategoritë tjera dhe besojmë dhe punojmë që të kemi një balancim sa më të afërt të buxhetit.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, sot po debatojmë për raportin financiar gjashtëmujor si një prej obligimeve ligjore që e ka Ekzekutivi i Komunës të paraqes para Kuvendit të Komunës si organ i cili mbikëqyrë gjegjësisht monitoron shpenzimet dhe menaxhimin e buxhetit.
Në mbledhjen e KPF-së e kam ngritur si shqetësim që për mendimin tim është i arsyeshëm, dinamikën e shpenzimit të buxhetit. Ne si anëtar të Kuvendit të komunës që jemi një prej mekanizmave të kontrollimit dhe monitorimit të shpenzimit të buxhetit, kur kemi para vetës raportet periodike financiare do ta ndihmonte shumë diçka që nuk e kemi, dhe atë, ne nuk e kemi planin e punës së Ekzekutivit, nuk e kemi një plan të punës së Zyrës së prokurimit dhe si rrjedhojë e kësaj ne nuk kemi se kujt t'i referohemi për dinamikën e zhvillimit të projekteve dhe shpenzimit të buxhetit, shto kësaj edhe raportimet e mangëta siç ishte raportimi i Kryetarit që ka qenë dy herë në vit, dhe nga ajo që kemi sot para vetës duhet ta trajtojmë vetëm duke bërë krahasimin e shifrave por jo pse kemi diçka tjetër të krahasojmë.
Shuma për investime kapitale në Komunën e Podujevës sipas buxhetit fillestar është rreth 7 milion euro, dhe kur ja shtojmë edhe të hyrat e bartura nga vitit i kaluar bëhet rreth 8 milion euro dhe sipas këtyre shifrave deri në këtë datë apo deri në fund të muajit korrik janë shpenzuar vetëm 14% e buxhetit, ndërsa nëse i referohemi buxhetit së bashku me të hyrat vetanake rezulton se për 7 muaj janë shpenzuar vetëm 12%, dhe kjo i bie se Ekzekutivi i Komunës po mburret me raportin, mirëpo vetëm në 5 muajt e ardhshëm duhet t'i shpenzoj edhe rreth 85% të buxhetit.
Me dinamikën e kësaj qeverisje, në vitin e kaluar kanë tepruar buxhet afër 2 milion e gjysmë euro, kurse për këtë vite të shohim dhe shpresojmë të mos ketë mbetje të buxhetit sepse është në dëm të qytetarëve, dhe diçka që është në dëm të qytetarëve mua më bënë të preokupohem.
Tek kategoritë tjera buxhetore, për mallra dhe shërbime kemi rreth 40% të buxhetit të shpenzuar dhe kjo sigurisht se për këtë kategori zhvillimi i proceduarve janë tjera dhe më të lehta dhe ndoshta edhe mundësitë për t'u fshehur diçka nëpërmes tyre janë më të mëdha kështu që shkojnë përpara, pastaj për paga dhe mëditje nuk kemi çfarë të diskutojmë sepse ato janë fikse dhe s'ka si të mos shpenzohen.

Shqetësuese është edhe çështja e shpenzimit të buxhetit në fund të vitit, çështje kjo e cila edhe në raportin e auditorit për vitin e kaluar thuhet se në 4 mujorin e fundit të vitit janë shpenzuar më shumë se 4 milion euro, do të thotë për katër muaj janë shpenzuar më shumë se 4 milion euro, dhe atë me logjikën, të bëjmë çka të bëjmë por të mos mbetet buxhet (në një formë me "akshampazar", me pagesa, avanse, pa mbikëqyrje të projekteve se a janë realizuar apo jo) dhe krejt më shqetësuese ka qenë tek bashkëfinancimi gjegjësisht tek donacionet, e që dihet se për të përfituar një donacion një OJQ ajo duhet të bëhet ose me shpallje publike në mënyrë që të garojnë OJQ-të ose përmes Kuvendit të Komunës, kurse neve na ka ndodh që për 12 orë i'u është bashkëngjitur bashkëfinancimi OJQ-së pa pasë vendim as të njërës a tjetrës.
Ndoshta isha shumë sipërfaqësor dhe duhet të jem më konkret dhe t'iu referohem shifrave gjegjësisht shqetësimeve që kam dua të filloj t'i cekë në bazë të të dhënave që na janë ofruar kemi ndryshim të shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak në një mori të kategorive dhe po e filloj nga faqe 5 e raportit ku më bëri përshtypje shpenzimi për kompjuter me më pak se 1000€ janë shpenzuar 21,355.00€ në këtë gjashtëmujor, mandej për pajisje tjera, e që për të qen një raport i kuptueshëm në rend të parë duhet ta ketë komponentën që ta bëjë të kuptueshëm atyre që duhet t'iu paraqitësh, në këtë rast neve anëtarëve të Kuvendit dhe në këtë aspekt ju lus që cili prej anëtarëve të Kuvendit mund ta kuptoj se në bazë të këtij raporti që e posedojmë të gjithë, pajisje tjera, shuma e shpenzuar 144,277.00€, çka pajisje tjera, përse nuk ka një sqarim tjetër, dhe kjo ka ngritje në krahasim me këtë periudhë të vitit të kaluar ku kemi pasë 50,000.00€, do të thotë kemi trefishim, pastaj furnizim për zyrë 31,134.00€ dhe sërish në krahasim me vitin paraprak ka shumëfishim të shpenzimeve sepse ka qenë rreth 18,000.00€, po ashtu kemi furnizimin me ushqim dhe pije në shumë 102,355.00€ ndërsa në vitin paraprak ishin vetëm 6,026.00€, unë nuk jam shumë profesional në matematikë dhe matematika ime nuk dinë të llogaritë se sa është përqindja e shpenzimit më e madhe, por si shifër di ta lexoj. Karburant për vetura shuma e shpenzuar 47,641.00€, dhe çka është interesant se për regjistrimin e automjeteve kemi 2,295.00€ dhe krejt në rregull, por për sigurim të automjeteve nuk kemi asnjë shumë të shpenzuar, çka i bie kjo.
Diçka që është duke i përcjellë raportet financiare qoftë periodike qoftë vjetore, qoftë të kësaj qeverisje qoftë të qeverisjeve të mëparshme meqë po kanë qejf t'i përdorin edhe ato të mëparshmet, është diçka shumë e dyshimtë që ne për çdo vit, pavarësisht kush është në pushtet, buxhetor krenohemi duke thënë vazhdimisht se në mandatin tonë kemi shtruar NN km asfalt, por çfarë na ndodh neve është se asnjëherë nuk janë duke u pakësuar rrugët që shtrohen me zhavorr dhe kjo do të ishte normale që sa më shumë rrugë shtrohen me asfalt aq edhe zvogëlohen rrugët me zhavorr, ndërsa krahasimi me vitin e kaluar është se deri tani në këtë vit kemi 141,581.00€ ndërsa në vitin paraprak 29,000.00€.
Ku e thash që raporti në rend të parë duhet të jetë i kjartë për neve ngase ai që e harton e di që e kupton, shembull, çfarë kuptoj unë me shpenzimin ku thuhet, rrethojat, dhe vlera e shpenzuar është mbi 15,000.00€, ku, çka, pse, dhe tani unë e di që mund të jepet shpjegim mirëpo është dashtë jepet shpjegim me raport, dhe kjo që e them nuk është referat ashtu siç po e quan nga vendi drejtori i DBF-së sepse për një raport financiar komponenta e parë e një raporti është se duhet të jetë i kjartë për atë që i'a paraqet, kurse ky që na është përcjellë, për mua nuk është i kjartë, dhe nuk jemi të gjithë ekonomistë këtu.
Pastaj kemi ndërtimin e rrugëve lokale, e që më parë e ceke një shifër tjetër kurse në një fa tjetër të raportit i është bashkëngjitur edhe një shifër tjetër shpenzuese ku thuhet ndërtimi i rrugëve lokale dhe shuma është 291,941.00€, po ashtu në vitin paraprak njëjtë ka qenë 372,000.00€.
Mandej për kanalizime, edhe këtu vazhdimisht ka lavdërime sepse punët e vogla ashtu janë për lëvdata, mirëpo kur nuk mendojmë se çfarë i kemi bërë ambientit, dhe sërish kanalizimet zënë një

vend prioritar në shpenzimet e këtij gjashtëmujori (lehtësim i ndokujt që ka nevojë për ndonjë kanalizim e taksirat për ata që janë afër lumenjve) dhe pse më doli kjo shprehje “taksirat” paska e pakontrolluar, dhe tani po nxitem paksa nga kjo dhe po e shtroj një pyetje të drejtpërdrejt për drejtorin e DBF-së, çka është bërë me kolektorin për të cilin mungon kodi buxhetor i ndërtimit të kolektorit që ka qenë i paraparë vite më parë dhe jeni në dijeni se Komuna e Podujevës ka hyrë në obligime financiare ndërkombëtare dhe çka është puna me atë kolektor, ne nuk po e shohim që është kryer dhe pyesim përse nuk është kryer si dhe a jemi ne tani të veprojmë apo të bëhet “sehirë” madje ta heqim edhe nga kodi buxhetor dhe ato mjete të cilat kanë hyrë në llogari dhe për të cilat kemi hyrë borxh e që duhet t’i paguajmë sepse janë borxhe ndërkombëtare për një projekt të cilit i kemi duartrokite të gjithë që rregullon çështjen e ambientit, dhe i njëjti të pezullohet në gjysmë, do të doja nga drejtori i DBF-së që pa politikë nëse ka sqarim të na tregoj se çfarë është puna këtij projekti sepse të paktën për mua është shumë shqetësuese.
Nuk po zgjati më shumë duke marrë për bazë dhe duke respektuar kolegialitetin, përkatësisht dikë nga Ekzekutivi i cili nga vendi po më thotë “bollë”, mirëpo nga kjo “bollë” që po e përfundoj tani, sigurisht se do ta vazhdoj pas diskutimeve të ë tjerëve.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, falënderoj parafolësin mirëpo është mirë që në të ardhmen të deklaroheni se për jeni duke diskutuar në emër të Grupit që i takon. E them këtë ngase vërejta disa anëtar të Kuvendit të cilëve në një formë i’u pengoi diskutimi i gjatë i parafolësit pa u deklamuar se është duke diskutuar në emër të Grupit që i takon.
**z.Naim Çunaku**, lidhur me atë që Kryesuesi e ceku paraprakisht, theksoi, vetë fakti që dikush nga një Grup i anëtarëve të Kuvendit e merr fjalën i pari nënkupton se është duke diskutuar në emër të atij Grupi dhe kjo nuk ka dilemë. Edhe përkundër kësaj, Kryesuesi i Kuvendit është ai që duhet ta specifikoj në fillim këtë, përkatësisht të fton se kush dëshiron fjalën në emër të Grupit NN.
**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i’u përgjigjur parafolësit, theksoi, mua nuk më pengon fare dhe shumë me kujdese të dëgjova, mirëpo e vërejta se të tjerëve i’u pengoj kohëzgjatje e diskutimit dhe për këtë edhe e thash që të deklaroheni në fillim të diskutimit, përndryshe mua nuk më pengon fare dhe në asnjë moment nuk të pengova i nderuar Çunaku.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, sa i përket kësaj teme ndoshta do të ishte mirë që kryesuesi i Kuvendit të mos shikon shumë disponim tonë si anëtar të Kuvendit por ta zbatoj Rregulloren e punës së kuvendit sepse shpeshherë po ndodh të ketë diskutime jashtë rendit të ditës, koha për përdoret pa nevojë si dhe po tejkalohet koha e lejuar si dhe gjithashtu po bëhen replika pa u përmendur emri, kështu krejt çka ka nevojë në këtë aspekt është që të zbatohet Rregullorja e punës.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, kam disa pyetje për drejtorin e DBF-së, lidhur me disa rritje të shpenzimeve që janë bërë për të njëjtën periudhë gjashtëmujore që janë bërë në vitin 2021 dhe tani në vitin 2022, dhe atë, kemi kodin buxhetor 13250 që janë shpenzime telefonike e që në vitin 2021 kanë qenë 1,860.00€ kurse në vitin 2022 janë bërë shpenzime në shumë 2,446.00€, pastaj kemi kodin tjetër buxhetor 11900 që është për pagesa për vendimet gjyqësore ku në vitin 2021 kanë qenë 40,000.00€ kurse në vitin 2022 janë bërë shpenzime 334,000.00€ e që kjo dëshmon se si po qeveriset në këtë Komunë. Mandej kemi kodin buxhetor 13460 shërbime kontraktuese të tjera
(*për shkak të problemeve të vogla shëndetësore me zërin, kërkon nga Kryesuesi që t’i jepet fjala sërish më vonë*).
**z.Arjant Topanica**, theksoi, shkurtimisht do t’i cekë me përqindje disa rritje të shpenzimeve të cilat pothuajse mund t’i vëren gjithsecili besoj, dhe atë, tek shpenzimet për pagesat nga vendimet gjyqësore u përmend disa herë se për çfarë bëhet fjalë mirëpo si përqindje apo si vlerë që në këtë periudhë të vitit Komuna e Podujevës është dashtë të paguaj 838% vlerë të parasë më shumë se në vitin e kaluar, mandej kemi shpenzimet për ujë, që janë rritur mbi 80%, shpenzimet kontraktuese

janë rritur 50%, pastaj si kod që është shpenzimet tjera që janë shpenzime nën vlerën 1000.00€, kemi rritje 184%, furnizimet për zyrë janë rritur 70%, tek furnizimet për ushqim dhe pije kemi rritje 1600% në krahasim me vitin e kaluar dhe për këtë jemi në dijeni se në këtë vit ka inflacion dhe çmimet janë rritur mirëpo nuk ka inflacion 1600% te asnjë produkt. Gjithashtu tek derivatet për gjenerator nga 50€ që ka qenë periudhën e njëjtë të vitit të kaluar tani në vitin 2022 kemi të shpenzuara 5400.00€ apo 10000% rritje të shpenzimeve për derivate, andaj për të gjitha këto që janë në vlera më të mëdha do të doja sqarime dhe arsye përse janë rritur.
Tek shpenzimi i mjeteve buxhetore të destinuara për investime kapitale nga rreth 8 milion euro sa janë të parapara, deri në këtë periudhë të vitit janë shpenzuar vetëm rreth 1 milion euro.
**znj.Donjetë Sheqiri**, vazhdon, tek kodi buxhetor 13506 pajisje tjera mbi 1000€ e që në këtë periudhë të njëjtë kohore me vitin e kaluar ka rritje të shpenzimeve në vlerë 120,000.00€, andaj a mund të na tregoj përse dhe çfarë janë këto pajisje tjera.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, duke bërë një përmbledhje të të gjitha këtyre që u ceken do të mundohem të japë të gjitha përgjigjet në formë të përmbledhur.
U cekë se suficidi për vitin e kaluar ka qenë 2.5 milion euro, edhe pse debati është për raportin financiar gjashtëmujor i vitit 2022, mirëpo meqë është e pa sakt atëherë më duhet ta them se suficid në vitin 2021 kanë qenë 921,000.00€ dhe kjo po lidhet me një çështje që në buxhetin e vitit 2021 ka qenë një klauzolë investive e që e kam sqaruar edhe më parë në vlerë 1,121,000.00€ që ka pasë të bëjë me kredinë me shtetin Austriak për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza, projekt ky i cili edhe u përmend nga parafolësi, dhe rrjedhimisht për përmbylljen e asaj kontrate janë nevojitur vetëm rreth 363,000.00€, do të thotë se ato mjete nuk ka pasë mundësi të shpenzohen dhe që e vërteta tjetër është se edhe ajo shuma rreth 321,000.00€ nuk është shpenzuar në vitin 2021 për shkak të disa problemeve pronësore por që është duke u shpenzuar tani në këtë vit, pra ka filluar të shpenzohet nga muaji korrik dhe janë shpenzuar afër 100,000.00€ dhe pjesa tjetër po shpresojmë të shpenzohet gjatë këtyre muajve në vijim në mënyrë që të përmbyllet ajo kontratë për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza deri në fshatin Lluzhan afërsisht aty ku, pra e kam cekë edhe më parë se kolektori ka qenë shumë i shtrenjtë dy herë mbi çmim dhe nuk është dashur t'i duartrokitesh në atë kohë (i drejtohet z.Naim Çunakut), por nejse ndoshta nuk je mirë me matematikë ashtu siç e potencove dhe ndoshta për atë i ke duartrokitur.
Tek shpenzimet për mallra dhe shërbime po ashtu u tha një detaj, fshehje apo diçka të tillë që u tha se ka mundësi të fshehët diçka, mirëpo ti je asambleist qe një kohë të gjatë (i drejtohet sërish z.Naim Çunakut) dhe trendi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime kryesisht është trend linear për arsye se nevojat për mallra dhe shërbime janë të përditshme, ndërkohë që tek investimet kapitale është një logjikë paksa më tjetër për arsye se zakonisht periudha e parë shkon me proceduat e prokurimit që fillojnë nga fillimi i vitit dhe po ashtu është faza e dimrit ku në muajt janar, shkurt, mars dhe pothuajse gjysmën e prillit nuk mund të punohet, dhe për këtë e ceka se tani kemi filluar me një trend shumë të madh për arsye se siç e ceka sa është shpenzuar buxhet për 6 muaj, janë shpenzuar tani vetëm në muajin korrik, kështu që ajo që i përmenduri e potencoj, fshehje dhe të ngjashme, as nuk qëndrojnë dhe është paksa jo korrekte të thuhet pa asnjë argument, përndryshe nëse ke ndonjë argument thuaje konkretisht e jo në formë të përgjithësuar ashtu.
Tek pajisjet tjera, mund të them se kategorizimet se si bëhen për shpenzime dhe siç bëhet kodifikimi i tyre është në bazë të një plani kontabël e që e kemi diskutuar edhe më parë se për çdo shpenzim është një kod të ciline paraqet plani kontabël dhe e vërteta është se atë plan kontabël nuk bënë Komuna e Podujevës por është nga Ministria e Financave dhe ka disa shpenzime për të cilat shkojnë me një kod më të përgjithësuar, do të thotë nuk ka një kod specifik i cili e përcakton atë shpenzim në mënyrë shumë specifike, shembull, tek kodi pajisje tjera mund të blesh një aparat fotografik e të

ngjashme, por nuk ka një kod specifik që e vë atë aparat por e vë në kodin, pajisje të tjera, apo shembull, furnizimi me kabinete të shkencave natyrore që është bërë, nuk ka ndonjë kod specifik që mund të vëhet ky furnizim por kategorizohet tek kodi, pajisje të tjera.
Furnizimet me ushqim dhe pije, u tha se ka një rritje tepër të madhe e që është e vërtetë ajo, mirëpo në kuadër të kësaj është furnizimi me shujta për nxënësit e klasës I-rë deri në klasë të V-të, do të thotë në vitin 2021 nuk ka pasë por në vitin 2022 janë ato dhe normalisht ato e kanë koston dhe është afër 20,000.00€ në muaj.
Karburant për vetura, u cek shuma e shpenzuar mirëpo ne jemi dëshmitar të asaj se ka një rritje të çmimeve të naftës dhe ato i përcakton berza dhe normalisht ka pasë ngritje dhe kemi kosto tjera.
Lidhur me shpenzimet telefonike, kjo sigurisht se kur te marrim raportin përfundimtar për vitin 2022 kjo çështje do të jetë afërsisht e njëjtë me shpenzimet e bëra në vitin 2021 sepse kryesisht janë të ngjashme por arsyeja pse e kemi këtë është se ta zëmë në vitin 2021 fatura ka mund të paguhet në fillim të muajit korrik dhe nuk është përfshirë në raportin e gjashtëmujorit të parë për ata edhe kemi këtë diferencë mirëpo në fund do të jenë shpenzime të ngjashme sikurse në vitin 2021.
Për shpenzimet sipas vendimeve gjyqësore konsideroj se u konsumua kjo temë në diskutimet e mëparshme. Pra këto ishin disa përgjigje në mënyrë të përgjithshme për çështjet e ngritura nga parafolësit, shpresoj se nuk kam harruar ndonjë çështje.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës për disa shpjegime që i bëri e në veçanti falënderoj që po tregon aq miqësi duke më treguar se kur të duartrokas e kur jo, mirëpo kur e potencova se projektit në fjalë i kam duartrokitur është se në të gjitha hulumtimet që bëhen në tregun e Komunës tonë për gjitha këto vite nga paslufta e deri tani, një prej problemeve kryesore që e rëndon jetën qytetare, përjashto këtë fazën e fundit me pandemi dhe me këto ngritje çmimesh që po ndodhin, ka qenë çështja e degradimit të ambientit jetësorë, dhe kur e potencova atë e pata parasysh sysh edhe historinë ku gjyshërit tanë na kanë mësuar që nuk bënë t'i ndotim në asnjë formë lumenjtë por duhet të përkujdesemi për ato, mirëpo në këto vitet e pasluftës, sigurisht ka shumë prej neve këtu që jetojmë në brigjet e lumenjve dhe jeni në dijeni se në çfarë gjendje ka qenë atëherë dhe çfarë është tani, prandaj kur është në shprehje një plan për ndërtimin e një kolektori të jeni të bindur se nuk më ka bërë përshtypje fare çmimi sepse nuk kam qenë njëri prej atyre që vendos për çmim, por si projekt ka qenë i mirëseardhur dhe për këtë e vendosa aksentin, madje i nderuar drejtor i DBF-së, sa për njohurinë tënde e që sigurisht të tjerët janë në dijeni që unë nuk kam qenë pjesë e asaj partie që e ka bërë atë projekt, do të thotë unë nuk kam telashe që projekteve të mira t'iu duartrokas kurdo herë që paraqiten, madje me qejfe do t'iu duartrokisja edhe ty (i drejtohet drejtorit të DBF-së) mirëpo nuk po më jep mundësinë sepse nuk je në nivel të duartrokitjeve.
Vazhdimisht po ndodh që drejtori i DBF-së paraqet shifra tjera dhe pastaj jep arsyetime jo ashtu jo kështu, unë nuk po shpikë asgjë por vetëm po i referohem Zyrës Kombëtare të Auditimit si një prej autoriteteve më kredibile që mendoj se është, dhe mbetjet e pashpenzuara në vitin 2021 e pranuam apo jo ne mund të renditet vit kampion i mos shfrytëzimit të buxhetit.
Po ashtu drejtori i DBF-së e potencoj se buxhetin për vitin 2022 e kemi miratuar në prill, nuk qëndron kjo sepse buxheti është miratuar në muajin janar dhe atë në një seancë të jashtëzakonshme, madje edhe në atë kohë ju kam pyetur përse po e miratoni me procedura të jashtëzakonshme kur kemi mundësi deri në muajin prill, por ne në janar e kemi miratuar dhe mos na e thuaj se e kemi bërë në prill, mos na thuaj se nuk kanë mbetur afër 2 milion e gjysmë euro prej shpenzimeve kapitale të pashpenzuara duke e cekur klauzolën investive, e them këtë sepse këtu kemi buxhetin fillestar, buxhetin final dhe buxhetin e shpenzuar, dhe këtë po e potencon auditori, jo unë, dhe jam i prirur t'i besoj një institucioni sikurse që është auditori i jashtëm, plus shto kësaj që sipas juve ka punuar në mënyrë strikte, skam si të mos i besoj.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, gjithashtu edhe unë dëshiroj të ndërlidhem te suficidi buxhetor ngase drejtori i DBF-së deklaroj se vetëm 900,000.00€ janë suficid, mirëpo i nderuar drejtor 900,000.00€ janë suficid vetëm tek grandi qeveritar, 800,000.00€ janë tek të hyrat vetanake dhe mbi 1 milion euro donacione dhe suficidi total po arrin shumën mbi 2 milion euro dhe këtë çështje e keni të paraqitur edhe në raportet e mëhershme financiare.
Pra ju drejtor kërkuat argumente, por argumente janë vetë numrat dhe kolegu parafolës i ceku vetëm numrat që ju na i keni sjellë me raportet e mëhershme.
Tek kategoria mallra dhe shërbime ju e potencuat se janë shpenzime ditore dhe është shpenzuar buxheti mbi 40%, kurse tek projektet kapitale vetëm 15% dhe u arsyetuat se deri në muajin prill nuk po mund të fillohet me fillimin e punëve për realizimin e projekteve shkaku i kushteve atmosferike, atëherë ne e dimë se vetëm në muajin nëntor mundemi të punojmë në realizimin e projekteve dhe tani po mbetet që 85% e buxhetit për investimet kapitale duhet të realizohet brenda këtyre tre muajve që kanë mbetur, dhe për këtë do të doja të dijë se si do ta arrini këtë kur kanë mbetur vetëm edhe tre muaj. Ishte edhe një kod për ujësjellës e që në vitin 2022 është afër 80,000.00€ kurse në vitin 2021 ka qenë 12,000.00€, çfarë arsyetimi mund të më jepni për këtë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, edhe njëherë po e përsërisë, kur jepen përgjigjet e fundit nga drejtori atëherë më nuk ka çfarë të diskutohet tutje ngase pastaj po kalohet në replika.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, po ndërlidhem sërish me çështjen e kolektorit që ka qenë ngase kjo po ndërlidh tri çështje, suficidin, votimin në atë kohë si dhe çështjen e duartrokitjes që po përmendet. Fillimisht dua të them se është dashtë të duartrokitet kur është votuar Korniza Afatmesme Buxhetore sepse ky projekt tani realizohet me 1.5 milion euro e jo me 5 milion euro, do të thotë më mirë ka qenë t'i duartrokitet kësaj dhe besoj se është më e arsyeshme. Për çështjen e suficidit ju sqaroj se kanë qenë të planifikuara në buxhet 1 milion 125,000.00€ dhe në bazë të kontratës që ka qenë me Qeverinë Austriake për tu përmbyllur ai projekt janë nevojitur vetëm 321,000.00€, andaj ato mjete vetëm kanë qenë të planifikuara në buxhet por nuk kemi pasë të drejtë t'i shpenzojmë ato sepse ato mjete që kanë qenë të planifikuara përmes marrëveshjes së kredisë me Qeverinë Austriake të shpenzohen për çështje të tjera, dhe fillimisht ka qenë e ditur se ato mjete kanë figuruar vetëm si numër rrjedhimisht dhe nuk e di përse është futur në atë mënyrë sepse buxheti i vitit 2021 është miratuar në vitin 2020 dhe ne nuk kemi qenë në atë kohë në pushtet prandaj edhe nuk e di arsyen përse ka ardhur deri në këtu, andaj e them se për mua ka qenë e çuditshme.
Te çështja e investime kapitale, u përmend edhe çështja e planit të prokurimit, për këtë vit mund të them se kanë mbetur vetëm edhe një ose dy projekte të pa proceduara në prokurim, të gjitha projektet janë në fazën e lidhjes së kontratës ose në fazën e vlerësimeve, do të thotë janë në përfundim dhe tani jemi në muajin korrik dhe po besojmë se muaji gusht do të na gjej me ët gjitha kontratat e nënshkruara dhe do të fillojnë punët. Tani nuk ka shumë projekte, madje 2-3 projekte janë milionëshe kurse të tjerat janë me vlera më të vogla 70,000.00€ 80,000.00€ dhe janë projekte të cilat fazën e realizmit dinamik e kanë 30 ditë, 60 ditë nga momenti i lidhjes së kontratave, përjashtimisht ndonjë çështje që mund të ketë ndikim të jashtëm apo që ndonjë operator mund të jetë i pa përgjegjshëm që nuk i kryen punët apo çështje të tjera, përndryshe të gjitha këto kontrata të investimeve kapitale janë të realizueshme.
Sa i përket çështjes së ujësjellësit, ju them se edhe këto shpenzime të ujit kryesisht janë proporcionale, por në këtë raport financiar reflektohen në raport se kur janë likuiduar pagesat, kështu që për këtë më saktësisht përse është kjo diferenca mes vitit 2021 dhe këtij viti ka të bëjë vetëm me këtë çështje.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, në qoftë se ka mundësi meqë sot është e premte dhe shumë asambleistë e falin Xhumanë, t'iu mundësohet që nga 12:00 deri në 13:30 të marrim pauzë, dhe për këtë kërkoj mirëkuptimin e juaj.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, e hedh në votim kush jeni që të shkojmë në pauzë nga ora 12:30 deri në ora 13:30.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, i nderuar Kryesues, ne patëm një propozim për pauzë që e ceku kolegu z.Naim Çunaku, e që ishte nga ora 12:00 deri në ora 13:00 ose 13:30, andaj meqë ishte propozim i parë do të duhej të hedhet në votim sipas radhës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kolegu z.Naim Çunaku e bëri propozimin për pauzë dhe doli jashtë kështu që nuk di tani se si të veproj. Ne shpesh herë duhet të gjejmë gjuhë të përbashkët mes vete dhe as unë e askush nuk jemi që ta pengojmë ndokënd që të shkon dhe at kryen një rit fetar që e pëlqen dhe që është i interesuar të shkoj. Pra të bëhemi më kolegial dhe ta mirëkuptojmë njëri tjetrin. Unë e hedha në votim një propozim dhe sërish e propozoj që të shkojmë në pauzë nga ora 12:00 deri në ora 13:30.

*Me mbështetjen e shumicës së anëtarëve, Kuvendi shkon në pauzë për një orë e gjysmë dhe atë deri në ora 13:30*
Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:45

**Kryesuesi i Kuvendit**, konstatoi kuorumin ku aktualisht prezent në sallë ishin 25 anëtarë/e të Kuvendit, dhe në vazhdim para se të vazhdohet me punë sipas rendit të ditës, me kërkesë të anëtares së Kuvendit znj.Tringa Sfishta, i jepet fjala jashtë rendit të ditës.
**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit dhe gjithë Ju të pranishmit tjerë, për shkak të ngjarjes që ka ndodhur sot kërkova fjalë rasti dhe ju lus për vëmendje.
Edhe sot në vazhdën e aksidenteve me keqardhje shumë herë me fatalitet sikurse rasti i ditës së sotme që sa i dhimbshëm aq tronditës humbja e 2 bashkatdhetarëve tanë në këtë aks rrugorë magjistralja Podujevë-Prishtinë të cilën dikur faktori ndërkombëtar e quanin "rruga gjarpri", me të vërtetë është bërë më e rrezikshme se vetë gjarpri dhe lirshëm mund ta quajmë "rruga e vdekjes", deri kur, pse ndodh kjo dhe a mjafton të shikojmë dhe të bëjmë sehire apo të ndërmarrim ndonjë veprim në shenjë solidariteti dhe proteste, solidaritet me atë që e pësuan dhe protestë ndaj mos gatishmërisë për përfundimin e kësaj rruge.
Me sinqeritetin më të madh njerëzor ky shqetësim nuk do të duhej të merr ngjyrim politik e as të adresoj fajësi askujt sepse vdekjet nuk kanë ngjyrim politik, nuk kanë parti, andaj pa parti dhe pa ngjyrim politik ju ftoj 1 minutë heshtje për të rënët e fundit, atyre dje e që me keqardhje kjo do të vazhdoj deri sa nuk bëhet asgjë në këtë rrugë.

*Mbahet 1 minutë heshtje në shenjë solidariteti me familjen e dy viktimave – mërgimtar nga aksidenti i ndodhur në mëngjesin e datës 29.07.2022 në magjistralen Podujevë-Prishtinë.*

**znj.Tringa Sfishta**, vazhdoi, në shenjë revolte lidhur me mos veprimin e drejt finalizimit të këtij projekti, të dielën duke filluar nga 12:00 tek rrethi i fshatit Siboc do të organizojmë protestë prej 30 minutave duke bllokuar qarkullimin në këtë magjistrale, andaj ftojmë të gjithë anëtarët e Kuvendit, Deputetët Llapjan të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe qytetarët e Komunës së Podujevës, të na bashkohen në këtë revoltë të dielën në ora 12:00 tek rrethi i fshatit Siboc në magjistralen Podujevë-Prishtinë.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës, unë në emër të Grupit të LVV-së shpreh shqetësimin për sulmin që i është bërë asambleistit të Grupit tonë Xhevdet Maloku gjatë pjesës së parë të seancës nga asambleisti i Grupit të LDK-së Ekrem Rrahamni.
Kërkoj nga Grupi i LDK-së që të distancohen nga këto sjellje, do të thotë nga sulmi verbal dhe fyerjet që i ka pësuar si dhe gjithashtu kërkoj të kërkoj falje sepse në njërën anë në disa seanca po përdoren disa fraza të nxjerra nga disa kontekste sikurse që janë "bishti i sakicës" , "dhuna"  e të ngjashme, ndërsa në anën tjetër në vazhdimësi është duke u zhvilluar dhunë ndaj asamblistëve tanë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, lidhur me çështjen e ngritur nga parafolësi, theksoi, sigurisht që e keni parë se unë si Kryesues i Kuvendit gjithherë kam qenë që të mos kalohet në probleme private dhe personale por gjithherë të diskutohet për tema të cilat na takojnë.
Gjithashtu falënderoj anëtaren e Kuvendit znj.Tringa Sfishta e cila na e përkujtoj një rast jo të mirë dhe tragjik e që po ndodhin raste të tilla shpeshherë në rrugën Podujevë-Prishtinë. Ndjejë shumë keqardhje për atë familje ku dy prindër kanë vdekur dhe janë lënduar fëmijët e tyre në aksident të mëngjesit të sotëm, shprehim ngushëllime familjes. Jemi në dijeni se rruga Podujevë-Prishtinë është shumë në gjendje të keqe dhe si pasojë ka sjellë shumë viktima e sidomos gjatë sezonit të verës kur bashkatdhetarët kalojnë nëpër këtë rrugë e cila për ata është pothuajse e panjohur sepse janë bërë riparime dhe po shkakton viktima pothuajse për çdo vit, kështu që shprehim ngushëllime dhe ndajmë dhimbje bashkë me familjen që ka humbur dy anëtarë dhe fëmijëve të lënduar i'u dëshirojmë shërim sa më të shpejt.

## 4. Propozim vendimi për caktimin e normave të tatimit në pronë për vitin 2023

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti propozimin në fjalë, ndër të tjera theksoi, caktimi i normave tatimore sipas këtij propozim vendimi është bërë në bazë të Ligjit për tatim në pronë dhe në këtë ligj janë të përcaktuara minimumet dhe maksimumet e normave tatimore për çdo kategori të pronave për të cilat ne mund ti tatimojmë dhe normalisht këto janë tek të hyrat vetanake por që përcaktohen me Ligjin për tatimin në pronë.
Normat tatimor sipas këtij propozim vendimi pothuajse janë në minimumin e tyre që përcaktohen me ligj, përjashtimisht tek një kategori, dhe janë të njëjta me vitin e kaluar përjashtimisht tek kategoria për objekte industriale ku tatimi në pronë është ulur nga 0.2% në 0.15% me qëllimin që sa do pak të stimulohen bizneset prodhuese Llapjane.
**z.Burim Hasani**, nga Grupi i këshilltarëve të AAK-së, theksoi, pasi që jemi në një gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, kërkoj që pika 4 e rendit të ditë, tek neni i propozim vendimit të lirohen nga tatimi në pronë të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, përkatësisht tek pika 1.1 për njësi të parcelës bujqësore, pika 1.2 për njësi bujqësore të objekteve, pika 1.3 për njësi pyjore, po ashtu edhe pika 1.4 për njësi rezidenciale. Prandaj sërish po e përsërisë që pasi jemi në një gjendje të rëndë ekonomike-sociale, do të kërkoja nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që të më përkrahin dhe që viti 2023 të mos tatimohet për këto pika që i ceka.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, në emër të këshilltarëve të Grupit të LDK-së shprehë gatishmërinë në mbështetjen e plotë të propozimit të kolegut parafolës nga radhët e AAK-së. Pra si Grup i këshilltarëve e mbështesim në plotni.
Duke pasë parasysh se drejtori i DBF-së i ceku disa tarifa të cilat janë të caktuara nga një instancë tjetër dhe e vërteta e madhe është se a jemi ne në minimumin e asaj tarife, si dhe bazuar në atë që e shprehu kolegu parafolës se në gjendjen e tanishme në Kosovë dhe me vetë orientimin e partisë në pushtet unë besoj se duhet të mbështetet kjo çështje për lehtësimin e sa do pak të jetës së qytetarëve, gjegjësisht në ruajtjen e mirëqenies së tyre.
**z.Kasib Bashota**, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës për të cilën edhe drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse e ceku se këto tarifa janë të përcaktuara në bazë minimale nga niveli qendrorë, andaj si Grup i japim mbështetje.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, natyrisht se jemi në dijeni se Komunës i duhen mjetet buxhetore për të mbijetuar, por duke marrë parasysh edhe gjendjen e rëndë ekonomike që janë qytetarët Llapjan dhe e gjithë Kosova, pra kemi një rritje enorme të çmimeve, është mirë që drejtori i DBF ta bëjë edhe njëherë kalkulimin e normave në mënyrë që ky vit të jetë më shumë solidar në mbështetje të qytetarëve tanë sepse ashtu e kështu gjendjen e kanë shumë të rëndë, prandaj e them që është mirë drejtori ta shqyrtoj edhe njëherë këtë propozim vendim, përndryshe e mbështesë propozimin e anëtarit të Kuvendit nga radhët e AAK-së.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, tatimi për pronën e paluajtshme përcaktohet Ligji për tatimin në pronë dhe dihet qartë se ligjet miratohen nga Parlamenti i Republikës së Kosovës, do të thotë se ne si asamble komunale nuk jemi kompetent ta hedhim poshtë një ligj.
Përveç dispozitave tjera që i përmban Ligji për tatimin në pronë, përcakton edhe limitet minimale dhe maksimale të cilat duhet të tatimohet prona.
Për njësitë e parcelave bujqësore, edhe pse është e përcaktuar me ligj, kjo normë tatimore nuk është duke u aplikuar tatimi, do të thotë bëhet fjalë për parcelat bujqësore që shërbejnë për të mbjella, ndërsa për njësitë tjera përcaktohet norma tatimore dhe ne në bazë të vendimit të vitit të kaluar tek objektet e njësive industriale ka qenë 0.2 kurse ne e kemi ulë në minimum 0.15 dhe për bindjen time dhe ndoshta për bindjen e shumë të tjerëve për objekte industriale me qëllim që ta stimuluar

prodhimin ndoshta do të ishte ideja që ta ulim në 0.1 ose 0.5, mirëpo ligji e ka këtë minimum nga 0.15 deri në 0.5, dhe është në kompetencën tonë që të propozojmë dhe e Kuvendit të Komunës që të miratoj normat tatimore dhe të përcaktoj minimumin apo maksimumin, e që ne jemi në minimum.
Po ashtu edhe një sqarim tjetër që besoj se është i vlefshëm, në rast se nuk miratohet ky propozim vendim, Ministria e Financave i aplikon normat tatimore të cilat janë aplikuar në vitin e kaluar, do të thotë në momentin që nuk miratohet deri më 31 dhjetor 2022, fillojnë aplikohen normat tatimore sikurse në vitin e kaluar, e që i bie se janë më të larta, përkatësisht tek kategoria e objekteve industriale për 0.05% e që tani është 0.2, kështu që vetëm është në kompetencën e Komunës se a dëshiron t'i lë normat tatimore sipas vendimit të vitit të kaluar apo dëshirojmë të miratojmë këtë propozim vendim, për tjera gjëra nuk ekziston mundësi.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, nuk kuptova drejtorin parafolës për normat e përcaktuara tek parcelat bujqësore, çfarë deshi të thotë, a është detyrim që duhet të paguhet sepse parashihet në vendim, dhe këtë e them sepse mund të thuhet tani se nuk paguhet por pastaj mund të futemi në borxhe si qytetar, pra a është i liruar apo jo qytetari për këtë kategori.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, sqarim parafolësit, theksoi, këto i përcakton ligji, mirëpo tek çështjet e parcelave bujqësore edhe pse është e përcaktuar me ligj ky minimum prej 0.15 dhe ne duhet ta inkuadrojmë në propozim vendim, Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave nuk është duke e aplikuar ende tatimin për toka bujqësore që janë të mbjella. Do të thotë në vitin 2022 nuk ka tatim për toka bujqësore e nuk do të ketë besojmë as në vitin 2023, mirëpo meqë është e përcaktuar me ligj edhe ne është dashtë ta parashohim në propozim vendim, por besojmë se nuk do të aplikohet.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ne kemi një propozim të dhënë nga anëtari i Kuvendit z.Burim Hasani, mirëpo sipas asaj që e ceku drejtori i DBF-së, ne nuk kemi të drejtë ligjore që ta heqim krejt tatimin në pronë, do të thotë ne duhet të angazhohemi që normat tatimore t'i përcaktojmë në minimumin e limiteve të përcaktuara me ligj si hapësirë se si dëshirojmë të caktojmë.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, sqarim shtesë, theksoi, meqë po insistohet tani të vëhet në votim propozimi i anëtarit të Kuvendit z.Burim Hasani, në qoftë se ky Kuvend merr një vendim të tillë krejt çka mund të arrihet është ngjallja e konfuzionit tek tatim paguesit dhe ata ta konsiderojnë veten se janë të liruar nga tatimi në pronë, ndërkohë që atyre do t'iu aplikohet tatimi në pronë e që është sistem tatimor të cilin e menaxhon Ministria e Financave, pro krejt çka është e Komunës është delegimi i të drejtës që të mbledh këtë tatim dhe ta konsideroj si të hyrë vetanake dhe ta përdorë për qëllime të vet Komunës, andaj në rast se ngjallet ai konfuzion dhe qytetarëve i'u ngarkohet tatimi do të ndodh që nuk do ta paguajnë dhe pastaj do të marrin edhe penalitete e të cilat janë shumë të mëdha të cilat i përcakton Ministria e Financave e që janë deri në 20% të borxhit për një vit.
Prandaj me këtë që u propozua ne vetëm mund t'iu ngjallim konfuzion qytetarëve dhe t'i fusim në borxhe, obligime dhe penalitete deri në 20% të vlerës së tatimit, kështu që unë e them që këtë çështje nuk do të duhej t'ju bëhet qytetarëve, për të mos thënë politike.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, t'ju them të drejtën unë nuk jam që të krijohet konfuzitet tek qytetarët, pra as nuk jam që të mbrohet as drejtori parafolës dhe askush tjetër, mirëpo nëse është ashtu siç u tha ne nuk kemi nevojë të veprojmë në kundërshtim me ligjin.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, e dëgjova Kryesuesin e Kuvendit se në cilësi të pozitës që ka deklaroj se nuk është që të krijoj konfuzion, por unë i them se nëse Kryesuesi është që të mos krijohet konfuzion, atëherë aplikoje Rregulloren e punës së Kuvendit dhe nuk ka kurrfarë konfuzioni.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse është e mundur të takohen shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe të konsultohen mes veti se si të veprojmë tutje ngase askush nuk e besoj që është për shkeljen e ligjeve, kjo është me rëndësi.

**z.Valon Demolli**, theksoi, nuk e shoh të arsyeshme të takohen shefat e Grupeve të këshilltarëve, por vetëm kërkoj ta vëni në votim propozimin e kolegut z.Burim Hasani, kaloj, nuk kaloj.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se çdo vendim i Kuvendit të Komunës vlerësohet nga Ministria e Pushtetit Lokal në aspektin e ligjshmërisë, dhe në këtë aspekt nuk dëshiroj që të na kthehet ky vendim dhe asnjë tjetër shkak i mos ligjshmërisë, pra edhe neve na kontrollon Ministria.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, tek pjesa hyrëse e këtij propozim vendimi është se në çka është i bazuar e që janë Ligji për vetëqeverisje lokale, ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, andaj nëse ndokush ma shpjegon mua se si ka mundësi që asambleja komunale ta hudhë poshtë një ligj, të na e shpjegoj. Kjo po dihet se është lojë politike ku pastaj të dilet tek qytetarët dhe t'iu thuhet se ne po dëshirojmë t'ju lirojmë prej tatimit.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, në bazë të rregullores së punës së Kuvendit secili propozim, çfarëdo qoftë ai duhet të vëhet në votim, nëse kalon është në rregull.
Sa i përket asaj që e ceket se e kthen Ministria përkatëse këtë vendim për jo ligjshmëri, nuk është hera e parë që Ministria i kthen vendimet këtij Ekzekutivi si të paligjshme.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, i bëjë thirrje propozuesit që të konsultohet edhe njëherë me zyrën ligjore, dhe mos të bëhet politike kjo çështje si dhe të mos e marrim ne si modalitet LVV-së gjithherë kundër, kundër çështjeve të partisë tjetër, dua të them se ne duhet të jemi pak më të mençur, kur është mirë duhet t'i përkrahim e jo si këta (LVV) dhe mos ta marrim një metodologji të tyre të punës sepse nuk është mirë për neve. Kështu që i nderuar asambleist (i drejtohet z.Burim Hasanit) konsultohuni edhe njëherë me zyrën ligjore në mënyrë që të mos dalim ndesh me ligjin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, për çdo propozim që japim natyrisht se duhet të jetë i bazuar në ligj.
**z.Burim Hasani**, theksoi, unë e pata si ide dhe si kërkesë për Kuvendin e Komunës që të merret një vendim i tillë, pra nuk ishte fjala për vendimin si tërësi por vetëm pikat që i specifikova në fillim të debatit për këtë pikë të rendit të ditës, pra nuk propozova për objektet biznesore por vetëm për pikat që kanë të bëjnë me tokat bujqësore dhe ato pyjore.
Nëse lejohet me rregulla dhe me ligj si dhe në konsultim edhe me drejtorin e DBF-së dhe zyrën ligjore, nëse lejohet me ligj do të ishte mirë për qytetarët të mos tatimoheshin ato prona pasi që jemi në një gjendje të rëndë ekonomike, nëse nuk lejohet atëherë të vazhdohet sipas propozim vendimit ngase edhe ashtu kemi përqindjen më të vogël të tatimit.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, tatimi për tokat bujqësore është në ligj por nuk janë tatimuar në vitin 2022 dhe besojmë se nuk do të tatimohen as në vitin 2023, ndërsa tokat pyjore janë tatimuar në vitin 2022 e besojmë se do të tatimohen edhe në vitin 2023, kurse kategoritë tjera po e them me sinqeritetin më të madh nuk mund të ndërhyjmë, krejt çfarë kemi mund të bëjmë është se këtë propozim vendim të mos e sjellim fare në Kuvendin e Komunës, por ideja jonë ka qenë që t'i ulim normat tatimore në limitin e lejuar me ligj e që janë për objektet industriale.
Pra në rast se nuk miratohet ky propozim vendim apo në rast se nuk do ta propozonim në Kuvend, nga muaji janar 2023 aplikohen normat tatimore të cilat janë aktuale sipas vendimit të Kuvendit të Komunës që është miratuar në vitin 2021, por madje edhe nëse fare nuk ka vendim të Kuvendit të Komunës këto norma tatimore aplikohen në bazë të ligjit dhe atë në minimumin e tyre.
**z.Burim Hasani**, theksoi, atëherë unë e tërheqë propozimin në mënyrë që të mos aplikohen vlera / norma më të larta në vitin që vjen.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, theksoi, ndoshta harrova të cekë se tokat bujqësore janë të liruara dhe nuk tatimohen kurse objektet bujqësore po. Megjithatë falënderoj parafolësin për propozimin e dhënë e që ndoshta edhe ne do ta përkrahnim lirimin e ndonjë tatimi, mirëpo ligji e kufizon kështu dhe në një aspekt nuk kemi rrugë tjetër.

**z.Burim Hasani**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit nëse veç ashtu thuhet me ligj, unë e tërheqë propozim e dhënë në fillim të diskutimeve për këtë pikë të rendit të ditës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, falënderoj këshilltarin parafolës për konstruktivitetin e treguar, andaj meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim vendimin sipas materialit përkatës të kësaj pike të rendit të ditës përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.
*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 15 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe 11 vota të PËRMBAJTURA (1 nuk mori pjesë në votim), miratohet propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

5. **Propozim Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës**

**znj.Saranda Stublla**, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, dokumenti i rregullores në fjalë është i njëjti me draft rregulloren e përgatitur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe ka qenë model për Komunat dhe si draft i ka kaluar të gjitha procedurat e diskutimit publik ku edhe keni mund ti shihni raportet nga diskutimet publike.
Dokumenti është i përgatitur në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, prandaj i propozoj Kuvendit të Komunës për miratim të kësaj propozim rregulloreje.
**znj.Sebastina Vokrri**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, e mbështesim dhe e përkrahim propozim rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
**z.Valon Demolli**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, meqë drejtoresha e DPKGJ e ka fjalën e parë në Kuvend, edhe ne si Grup i këshilltarëve e përkrahim propozim rregulloren në fjalë.
**z.Gazmend Islami**, në emër të subjektit OBKD, theksoi, e përkrahim dhe mendojmë se çdo herë kur është diçka mirë për Komunës duhet përkrahim dhe duhet të jemi pozitiv.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, kam një propozim, tek neni 14 pika 5 ku thuhet, *publikimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda 7 ditëve nga dita e nënshkrimit të kontratës*, të ceket edhe vendi i publikimit, pra në ueb faqen e komunës, në objekt të Komunës, për shkak se të jetë më transparent.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, në seancën e muajit shkurt nëse ju kujtohet ish drejtoresha e DPKGJ ka dhënë premtim publik në këtë foltore të këtij Kuvendi që listën e të gjitha pronave dhe gjendjen e tyre në Komunën e Podujevës do ta publikoj deri në fund të muajit mars, por kjo nuk ka ndodhë, andaj dëshiroj ta pyes drejtoreshën aktuale të DPKGJ se a mund të zotohet që atë listë të plotë e jo vetëm të atyre pronave që janë shfrytëzim ta publikoj, pra të na jep këtu një premtim publik, dhe përse nuk është mbajtur premtimi i kaluar.
**znj.Saranda Stublla**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, tani për tani nuk jam e informuar se a është publikuar apo jo lista e cekur dhe për këtë do të konsultohem me zyrtarët përkatëse nëse është publikuar, nëse jo atëherë do të fillojmë me procedurat përkatëse për publikim.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, falënderoj drejtoreshën për përgjigjen, mirëpo në bazë të ligjit, të gjitha pronat, qoftë ato që janë në shfrytëzim qoftë ato që nuk janë si dhe gjendje e tyre duhet të jenë transparente në ueb faqen e Komunës, andaj a mund ta marrim një afat kohor të caktuar se kur DPKGJ do t'i publikoj këto të dhëna në ueb faqen e Komunës.
**znj.Saranda Stublla**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, duke i'u përgjigjur parafolëses, theksoi, nuk mund të jap afat të caktuar për shkak se nuk jam e informuar se a është publikuar apo jo lista e cekur. Unë do të marrë informata dhe nëse nuk është publikuar atëherë diskutojmë pastaj se kur mund të përgatitet dhe publikohet ajo listë.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, i kam parë disa prona që janë publikuar, mirëpo ne nuk kemi kërkuar që të publikohen vetëm ato prona që i keni dhënë në shfrytëzim por kemi publikimin e të gjitha pronave të Komunës së Podujevës, jo vetëm ato që janë në shfrytëzim, por edhe ato që nuk janë dhënë fare në shfrytëzim dhe që nuk dihet fare se si është gjendja e tyre sot.

**z.Vigan Salihu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, sa i përket pronave për dhënie në shfrytëzim është online katalogu i tyre dhe ato prona që janë aty nuk është se janë dhënë në shfrytëzim por janë të paraqitura si mundësi për t'i dhënë në shfrytëzim dhe përveç kësaj ato prona janë të cekura edhe me vendim të këtij Kuvendi.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, faleminderit drejtor mirëpo besoj se është kompetente që të përgjigjet drejtoresha e DPKGJ. Jam duke e cekur shumë kjartë, nuk po kërkoj listë për pronat që do të jepen apo që janë dhënë në shfrytëzim, por po kërkoj të gjitha pronat në pronësi të Komunës së Podujevës, të publikohen në faqen e Komunës së Podujevës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, jemi duke diskutuar për diçka që është potencuar X herë në këtë Kuvend, madje qysh nga fillimi i funksionimi të këtij Kuvendi dhe problemet me pronat komunale e që edhe Ligji për vetëqeverisje lokale në një prej shtyllave kryesore të Kuvendit përkatësisht Kryetarit të Komunës e ka përkujdesjen për pronat komunale, dhe atë që po e kuptoj nga anëtarja parafolëse kolege znj.Donjetë Sheqiri kërkesë e saj është se a mund ta merre një datë të publikimit të pronave komunale, edhe pse kur janë miratuar këto prona gjegjësisht pronat për këtë vit kalendarik, e kemi marrë një premtim prej një drejtoreshe që ka qenë aktuale në DPKGJ e cila ka bërë një premtim publik në foltore se do të bëjë përpjekje dhe na ka siguruar që të gjitha pronat komunale do të jenë të publikuara në ueb faqen e Komunës, në çfarë gjendje janë, kush dhe me çfarë autorizimi i shfrytëzon, pra sa e kuptova këtë e dëshiroj znj.Donjetë Sheqiri. Pra të mos kthehemi tek ato prona që janë të publikuara sepse janë po ato që ky Kuvend ka vendos t'i jap në shfrytëzim, mirëpo propozimi i znj.Donjetë Sheqiri është i një natyre më të gjerë, pra ka të bëjë me publikimin e të gjitha pronave komunale.
**z.Florent Hasani**, theksoi, pyetje për drejtoreshën e DPKGJ, a është bërë ndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore në fshatin Lluzhan aty ku është ndërtuar një betonjerkë.
**znj.Saranda Stublla**, U.D. drejtoresh e DPKGJ, përgjigje parafolësit, theksoi, nuk kam informacione lidhur me këtë por mund të marrë informacione deh t'ju njoftoj për këtë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, përgjigjet mund të jepen edhe në mbledhjen e radhës, nuk është e obliguar t'i përgjigjeni domosdo sot.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, lidhur me ndërrimin e destinimit të pronave nga pronë bujqësore në ndërtimore, varësisht prej klasës së tokës, nuk është askush kompetent përveç Kuvendit të Komunës dhe nëse nuk e kemi votuar ne nuk ka pas se si të shndërrohet ajo pronë nga bujqësore në ndërtimore. Jam në dijeni se ka ndodhur ndërtimi dhe është ashtu siç e cekur kolegu z.Florent Hasani, mirëpo më bëri përshtypje përgjigjja, nuk e di a është shndërruar apo jo,
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të gjithë nga pak kemi përvojë në Kuvend, mirëpo ndryshimi i destinimit të tokave nga bujqësore në ndërtimore duhet të kaloj në Kuvendin e Komunës, mirëpo për sqarime tjera shtesë fjalën e ka drejtori i Drejtorisë përkatëse.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, sa i përket pyetjes për shndërrimin e tokës nga bujqësore në tokë ndërtimore, para rreth një muaji ju si Kuvend e keni votuar Hartën Zonale e cila përcakton për çdo parcelë se për çfarë do të shfrytëzohet, banim, bujqësi, ndërtim, pylltari apo çfarëdo qoftë tjetër.
Në qoftë se është brenda zonës ndërtimore, ndërrimi i destinimit jepet me pëlqim urbanistik, pra DPUMM e jep pëlqimin, pastaj në procedurë pagesën e lëshon Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kurse pjesën e ekzekutimit e kryen Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe gjeodezisë, do të thotë është një procedurë këtu por pa qenë në zonën e ndërtimit nuk mund të kryhet ndërrimi i destinimit i tokës bujqësore.
Përndryshe sa i përket veprimeve të ndryshme që mund të merren pa i kaluar procedurat e tilla nuk i takojnë DPUMM. Pra besoj se isha i kjartë në sqarimin rreth procedurave.

**z.Florent Hasani**, theksoi, unë kërkoj përgjigje kurdo që është e munduar nga ndokush prej Ekzekutivit të Komunës ngase ndërtimi i cekur më herët ka ndodhur në tokë bujqësore.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor i DPUMM, ndërtimi në fjalë ka ndodhur para se të miratohet Harta Zonale, do të thotë Harta Zonale e ka gjete fakt të kryer atë ndërtim.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, kam kërkesë për drejtorët e drejtorive që këto punë t'i marrin shumë seriozisht për shkak se për çdo gjë dhe për çdo shkelje do të paditen në prokurori dhe për këtë jua jap fjalën se për çdo gjë që jemi duke parë sikurse që po ndodh me këto ndërtimet pa leje sikur për ndërtimet e hoteleve që kanë filluar në fshatin Batllavë, edhe në fshatin Shamalluk, do të thotë pa leje ndërtimore, mos mendoni se ne do të heshtim, madje unë personalisht ju garantoj se çdo shkelje që do të bëhet do t'i ndjekë penalisht ata të cilët po i mbyllin, qoftë Drejtoria e Inspeksionit e cila ka për detyrë të dal të bëjë inspektime. Ligji është i barabartë si për të pasurit ashtu edhe për të varfrit, prandaj duhet të jemi të njëjtë, qoftë ai që është milioner qoftë ai që nuk ka asnjë cent.
Unë ju them drejtorëve të Drejtorive që ta marrin seriozisht punën e tyre, unë i respektoj secilin për punën që bëjnë dhe për punë të mira jua heqë kapelën, por nuk jeni vasal të askujt dhe nuk duhet të mbyllni sytë nëse e vëreni se diçka nuk është në rregull, e them këtë sepse këto ndërtimet që janë bërë e të cilat i kam publikuar edhe para 2 - 3 javëve për rastin e Batllavës, madje kam bërë kërkesë zyrtare edhe në Ministrinë përkatëse dhe pres përgjigje nga ata. Ne nuk do të heshtim për këto rate dhe mos të mendoj askush se ndokush që është milioner ka edhe të drejtë të ndërtoj pallate pa leje duke diskriminuar rajonin e Batllavës duke e bërë qendër të peronave të cilët janë bërë superfuqi të parasë. Prandaj ju lus të jeni të sinqertë dhe të jeni të drejtë sepse për këtë jeni zgjedh, por nuk jeni zgjedh këtu as për humor as për të thënë këtu nuk e di, e di, se di a ka, a ka leje, llogaridhënien do ta jepni ju në fund.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, meqë nga parafolësi u përmenden ndërtimet që janë duke u bërë në pjesën e Batllavës, ju them se së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit ne kemi mbajtur takime të shumta me Ministrinë përkatëse. Është një Udhëzim Administrativ sipas të cilit vëhet liqeni i Batllavës dhe pjesa përreth si zonë e mbrojtur, konkretisht është kompetencë edhe Drejtorisë së Inspeksionit normalisht, mirëpo pjesë e përgjegjësisë e që ndoshta është pjesa dërmuese është e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sepse në momentin që shpallet zonë e mbrojtur, kompetencat kryesore i marrin Ministria e cekur.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, i nderuar drejtor i DPUMM, personi i cili ka ndërtuar hotelin aty lartë që është ndërtuar është i njëjti që ka ndërtuar betonjerkën në ato prona që u diskutuan, prandaj nuk guxojmë që ne t'i mbyllim sytë dhe herë t'ia hedhim fajin Ministrisë e herë Komunës.
Ne e dimë se kah e ka shtrirjen territori i Komunës së Podujevës dhe Batllava është pjesë e Komunës së Podujevës, pjesa në fjalë është zonë e mbrojtur dhe këtë e dimë, mirëpo nuk ka fuqi që e ndal Inspeksionin e Komunës së Podujevës që të shkoj dhe të inspektoj çdo rast dhe çdo shkelje sepse edhe ashtu i ngarkon ligji, prandaj unë vetëm ju bëra thirrje si miq e koleg që jemi që të mos bini desh me ligjin ngase nuk kam qejf që asnjërin prej juve t'iu shohë prapa grilave.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bëri ta marrë fjalën përgjigja e drejtorit të DPUMM, mirëpo drejtori në fjalë në një pyetje pak përpara iu referua Hartës Zonale, ndërsa në pyetjen tjetër për ndërtimet që i potencoi kolegu iu referua një diçka të Ministrisë sipas të cilës është zonë e mbrojtur, andaj dëshiroj ta di se a është shpall zona ku janë duke u ndërtuar, zonë e mbrojtur, si dhe ajo pjesë ku janë duke u bërë ndërtime a është e rregulluar me Hartën Zonale, e mos ta bëjmë edhe kështu edhe ashtu, por nëse është zonë e mbrojtur dihet kush e përcakton që është zonë e mbrojtur, dhe dihet deri në sa metra është zonë e mbrojtur, nëse nuk i përket asaj zone dhe është e rregulluar me Hartë Zonale a ka tejkalime që i parasheh Harta Zonale, pra kjo është ajo që duhet të japësh përgjigje.

**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket ndërtimeve mund të ketë tejkalime të caktuara, kurse sipas Hartës Zonale është e përcaktuar një pjesë përreth liqenit të Batllavës si zonë e banimit, jo zonë turistike. Normal është se lejet ndërtimore lëshohen prej DPUMM çdo herë duke respektuar Hartën Zonale që ju e keni miratuar. Konkretisht në zonë e parë dhe të dytë janë rregulla më strikte për ndërtim, kurse në raste eventuale në parcelat që janë në zonën e tretë dhe brenda zonës së ndërtimit normalisht se lëshohet leja duke i respektuar kushtet.
Tek pjesa e inpektimeve nuk do të doja të ndalesha sepse nuk është kompetencë e imja, por për hir të transparencës dhe për shkak të takimeve që kemi mbajtur me të vetmin qëllim me drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit që ta mbrojmë sa më shumë që mundemi atë hapësirë.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, pyetje për drejtorin e DPUMM ngase kam marrë shumë ankesa rreth kthimit të përgjigjeve palëve e që është afati ligjor 30 ditë dhe ka shumë ankesa që nuk po iu kthehet përgjigje brenda afatit ligjor. Pra palët të cilat drejtohen tek DPUMM po ankohen sepse nuk po i'u kthehen përgjigje për kërkesat e tyre, afati ligjor është 30 ditë kurse ju drejtor nuk po i'u kthen përgjigje brenda atij afati ligjor.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, theksoi, zakonisht të gjitha lëndët shqyrtohen në afatin kohorë që janë, ndoshta ndokujt mund të mos i pëlqej përgjigja e DPUMM dhe mund të ankohet në procese tjera, mirëpo fundja unë jam organ ekzekutiv, Hartën Zonale ju si Kuvend e keni miratuar dhe unë atë jam duke e aplikuar për qytetarët, dhe nuk është se unë mund të bëjë diçka dallime në këtë aspekt.
**z.Florent Hasani**, theksoi, Inspektorati i Komunës duhet të deklarohet përse nuk ndërmerr masa ndaj mbindërtimeve dhe ndërtimeve pa leje.
**z.Leutrim Krasniqi**, U.D. drejtor i DPUMM, theksoi, për këtë pjesën që e ceku parafolësi nuk është në kompetencë timen. Mirëpo edhe njëherë i them këshilltarit z.Qëndrim Softolli besoni se lëndët shqyrtohet në afatin përkatës kohor, normal ka edhe punë të mëdha në DPUMM sepse është një prej drejtorive më të ngarkuara ndoshta, andaj kjo mund edhe të jetë arsyeja që mund të vonohet ndonjë lëndë 1 javë, mirëpo çdo lëndë shqyrtohet.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike konsiderojmë se debati përfundoj, mirëpo ishte një propozim konkret nga anëtari i Kuvendit z.Xheved Maloku të cilin e ftoj ta saktësoj edhe njëherë propozimin tij para se ta hedh në votim.
**z.Xhevdet Maloku**, theksoi, propozimi ishte që te nenin 14 pika 5 të saktësohet se ku bëhet publike listat përkatëse, në ueb faqe, në objekt të Komunës apo kudo që parashikohet.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë e hedh në votim propozim rregulloren përkatëse sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe duke përfshirë edhe propozimin e dhënë nga parafolësi z.Xhevdet Maloku.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga *25 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 24 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (1 nuk mori pjesë në votim), miratohet propozim Rregullorja sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje me plotësim ndryshimin, që paragrafit 5 të nenit 14 t'i shtohet edhe pjesa e fjalisë që specifikon se ku publikohen dokumentet e tilla, në këtë rast ueb faqen zyrtare të Komunës.*

6. **Propozimet për zëvendësimin e 2 (dy) anëtarëve të Komitetit për Komunitete (pas dhënies së dorëheqjes nga dy ish anëtar/e të Komitetit nga radhët e Komuniteteve jo shumicë)**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra kemi të bëjmë me zëvendësimin e dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete pas dhënies së dorëheqjes së dy anëtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, përkatësisht për shkaqe të ndryshme nga komuniteti ashkali ish anëtarja znj.Albina Avdiu ka dhënë dorëheqje dhe është propozuar të zëvendësohet me znj.Naile Ahmeti, kurse nga komuniteti rom z.Muhamet Sadiku ka dhënë dorëheqje dhe është propozuar të zëvendësohet me z.Selver Rama, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e vë në votim këtë propozim për zëvendësimet sipas asaj që e paraqita.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, pyetje rreth procedurës së zëvendësimit përkatësisht rreth këtyre dy emrave të rinj, a kanë aplikuar në Komunë apo vetëm i kanë sjellë emrat.
**Kryesuesi i Kuvendit**, sqarim parafolëses, theksoi, nuk është që vetëm i kanë sjellë emrat mirëpo kanë aplikuar dhe i kanë nënshkrimet e komuniteteve përkatëse dhe kush do që dëshiron mund të vije në zyrë dhe ti shikoj por të njëjtat ju janë përcjellë edhe materialin e kësaj pike.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, tek komunitetet jo shumicë, Komuna e jonë e shohë si një diskriminim të madh që i bëhet komuniteteve jo shumicë dhe këtë e ndjejë shpirtnisht sa herë që kaloj në ato lagje ku ata jetojnë. Për këto shakat sikur kjo tani erdhën dy të tjerë sepse janë dorëhequr dy të tjerë, unë nuk e di a konsultohet ndokush me atë komunitet dhe këtë e them ngase kam qenë 2-3 herë tek ato shtëpi dhe ata persona, madje këtë e ndërlidh edhe me veten sepse si fëmijë kam qenë refugjat në Gjermani dhe mbajë mend mirë si më kane shkolluar, dhe si më kanë trajtuar, prandaj në këtë aspekt Komuna jonë duhet të jetë shembull dhe sigurisht se do ta ketë përkrahjen qoftë edhe nga unë që ta ketë një komision i cili kontakton më shpesh me ato komunitete në mënyrë që ata ti integrojmë që të jenë sa më aktiv në jetën publike në Komunën e Podujevës, qoftë në Komunë, qoftë me punësime në shëndetësi dhe të mos i shohim vetëm si "sharragji" sepse edhe ata janë njerëz, kanë gjak kanë mendje, edhe ata e falsin gjuhën Shqipe, prandaj është mirë që si Komunë të veprojmë sepse kjo na qetë faqe të bardh të gjithëve.
Do të kisha shumë dëshirë që pushteti të formon një komision i cili do të ndihmonte në integrimin e komuniteteve jo shumicë, ngase integrimet që bëhen ad-hoc vetëm sa për të parë ndokush se i kemi të integruar në rregull është, mirëpo unë e përsërisë që ndihem keq sa herë që shohë me sharrë duke shkuar të prajnë dru, pra të pa integruar, të pashkolluar, fëmijët e tyre bredhin rrugëve, andaj si Komunë është në nderin tonë t'iu ndihmojmë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, Komiteti për Komunitete është organ i këtij Kuvendi sikurse që është Komitetit për Politikë dhe Financa. Në Komitetin për Komunitete përfaqësohen të gjitha komunitetet jo shumicë dhe shumica e Komitetit është nga radhët e komuniteteve jo shumicë, në këtë rast 5 prej 9 anëtarëve të Komitetit janë nga radhët e komuniteteve jo shumicë, kështu që shqetësime e komuniteteve janë ata që i shprehin në Komitet për Komunitete.
Po ashtu Komuna e Podujevës e ka edhe Zyrën për komunitete dhe kthim dhe shef i Zyrës është z.Liman Zeqiri, kështu që nuk besoj se Komuna ka lënë anash ashtu siç u tha këto komunitete dhe që nuk e besoj se nuk është në kontakt të vazhdueshëm, mirëpo edhe unë pajtohem që ndoshta nuk kemi bërë aq sa duhet sepse janë një komunitet që jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike, "sharragji" ka shumë prej tyre por binduni se të tillë ka edhe shumë prej komunitetit shumicë-Shqiptar dhe për këtë jemi në dijeni të gjithë thuajse.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, të mos merret për të keq ajo që e potencova sepse unë e përmenda jetën time se si jam trajtuar në një shtet normal dhe e ndërlidha me shtetin tonë ku jemi rreth 99% Shqiptar e që kërkova të trajtohen komunitetet jo shumicë që në një të gjitha aspektet jemi të barabartë.
Me sharrë "sharriti" dhe unë, mirëpo është mirë të trajtohen qoftë në shkollim, qoftë në përparësi tjera në mënyrë që të sa do pak të integrohen dhe t'i shohim edhe at ndokund qoftë profesor, qoftë mësues dhe t'i frymëzojmë paksa sepse si do që të jetë është një komunitet që jeton me neve.
**Kryesues i Kuvendit**, theksoi, besoj se të gjithë pajtohemi që të gjithë së bashku duhet të bëjmë më shumë për komunitetet jo shumicë.
Meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin për zëvendësimin e dy anëtarëve në Komitetin për Komunitete, dhe atë sipas prezantimit në hyrje të kësaj pike të rendit të ditës. Vlen të theksohet se znj.Albina Avdiu e cila ka dhënë dorëheqje punon si gazetare në Radio Televizionin e Kosovës është një vajzë e cila është e ngritur shumë në aspektin profesional dhe shkollor kështu që për shkak të angazhimeve ka dhënë dorëheqje e që ndoshta do të ishte dëshirë e imja që ajo të vazhdonte të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete po për shkak të angazhimeve dhe punëve që ka nuk ka mundur të vazhdoj.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri nga 23 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me vendim miratohet ndryshimi dhe plotësimi i përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas Vendimit nr.prot.01-020/02-0030731/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, të datës 29 prill 2022, dhe atë:*
***znj.Naile Ahmeti**, (komuniteti ashkali) emërohet në vend të znj.Albina Avdiu, e cila ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtares së Komitetit për Komunitete, dhe*
***z.Selver Rama**, (komuniteti rom) emërohet në vend të z.Muhamet Sadiku, i cili ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anëtarit të Komitetit për Komunitete.*

## 7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, e paraqiti informatën në fjalë, ndër ë tjera theksoi, në bazë të Planit të punës së Kuvendit, keni kërkuar një informatë të përgjithshme për arsim, përkatësisht për periudhën e vitit shkollor 2021/2022. Duke u bazuar edhe në informatat paraprake për periudhën kalendarike të vitit shkollor, po ju paraqesim një informatë përmbledhëse e cila e ka bazën tek plani i punës në bazë të të cilit edhe kemi zhvilluar aktivitete të Drejtorisë së Arsimit, Drejtori e cila në funksion të përgatitjes për çdo periodë të fillimit të fillim vitit të ri shkollor ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për mbarëvajtjen e procesit mësimor në përudhën e parë dhe të dytë të vitit shkollor.
Shikuar në përgjithësi periudhat e vitit shkollor 2021 dhe 2022 në Komunën e Podujevës kanë përfunduar me sukses dhe gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë në të katër nivelet e arsimit parauniversitar, por edhe punët dhe detyrat e tjera të paraqitura gjatë këtij vitit në këtë interval kohor.
Duke marrë parasysh informatat e detajuara nuk dëshiroj t'ju marrë kohë shumë për arsye se planifikohen të gjitha aktivitetet e realizuara, çështja e bursave për studentë, investimet në shkolla, realizmi i projekteve të cilat janë prezantuar edhe nga vetë Kryetari i Komunës në këtë gjashtëmujor të parë të këtij viti, sigurimi i transportit të nxënësve, shërbimi psikologjik dhe pedagogjik nëpër shkolla, ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore, rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, instalimi i kamerave të sigurisë, pastaj sfidat me të cilat jemi ballafaquar ka qenë sërish Pandemia në fillim të vitit shkollor, incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve që janë të rëndomta, dëmtimet e objekteve të disa shkollave nga perona të panjohur pas përfundimit të orarit mësimor, lokalet afër shkollave, qentë endacak, komunikacioni e kështu me radhë. Megjithatë Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me të gjitha organet relevante me aq sa ka pasë mundësi ka ndërmarrë masat e nevojshme. Në kuadër të shumë aktiviteteve janë organizuar edhe gara komunale dhe ndërkombëtare dhe për fat të mirë Komuna jonë në shumicën prej tyre ka treguar sukses të veçantë.
Pa dashur t'ju marrë kohë më shumë pres vërejtjet dhe sugjerimet e juaja, në vazhdim.
**z.Qëndrim Softolli**, në emër të Grupit të LDK-së, theksoi, të them se jam i kënaqur që në pretendimet tona që i kemi ngritur në seancën e jashtëzakonshme po merren dhe i potencojnë institucionet e shtetit, nuk po mundem sepse as unë si asambleist i opozitës nuk ndihem mirë kur për çdo javë e kemi nga një shkrim për shkalleje, parregullsi, ndikime politike dhe anulim të konkurseve nga Drejtoria e Arsimit. Më vie mirë se pretendimet tona të ngritura në atë seancë dolën të vërteta sepse me to po merret prokuroria e shtetit dhe disa prej tyre janë potencuar edhe në raportin e auditorit, po gjithashtu më vie keq për gjendjen në të cilën është katandisur Komuna e Podujevës dhe Drejtoria e Arsimit në këto dy vite. Drejtori goxha trim por edhe recidivist në shkeljen e ligjeve, ja kam thënë në atë seancë se është duke bërë shkelje të proceduarve në konkurse dhe me ligje jo adekuate, nuk po i lë zyrës së personelit procedurat por ato po i udhëheqë vetë, dhe a dini përse, sepse vetë i bënë komisionet, vetë jua cakton pikët, vetë e bënë komisionin e ankesave dhe vetë e cakton listën e pritjes, listë kjo e cila është sikurse lojërat e kurdisura. Nga këto janë bërë minimum 100 punësime jo ligjore nga kjo Drejtori, shembull, në Raportin e Auditorit në të cilin ka marrë pjesë një (shok) mik i drejtorit dhe i cili është bërë komplet për qejf të pushtetit, tema e arsimit është prekur krejt sipërfaqësisht, por një fakti nuk ka mundur t'i ik dhe e ka potencuar duke thënë se janë bërë 141 punësime, dhe për këtë unë e pyes drejtorinë Drejtorisë së Arsimit, sa procedura të konkursit janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe dhe sa persona janë punësuar, e që sipas neve janë rreth

40, do të thotë 100 persona kanë hyrë në punë sipas asaj listës që e ka bërë drejtori me komisionet e veta të dëgjueshëm.
Si mund të flitet për cilësi në arsim kur politizohen dhe pastaj anulohen edhe konkurset për punëtorë në Çerdhe, deri në atë nivel bie ndikimi politikë i qeveris aktuale. Si mund të flitet e proklamohet infrastrukturë kur shkelen kriteret të cilat i vë vet në konkursin për tutorë e që këtu ka qenë një Organizatë partnere dhe paramendojeni se duke parë shkeljet, përfaqësuesja e asaj organizate është tërheqë nga komisioni dhe nuk e ka nënshkruar listën e të pranuarve.
Si mund të flitet për arsim të lartë cilësor kur dihet se në çfarë gjendje e ka sjellë drejtori në fjalë me të gjitha ato shkelje që u potencuan më lartë, paramendojeni profesori i shkollave të mesme nuk mund të fokusohet në cilësi kur ju jua keni përgjysmuar norma, për dy vende të lira orët ndahen në 4 vende kurse ata mbesin as të punësuar e as të papunë, por mbesin të lidhur me drejtorin dhe të shantazhuar politikisht me ato pak orë që i kanë.
Në Komunën e Podujevës mjerisht dhe fatkeqësisht në krye të ekzekutivit i kemi dy mësimdhënës dhe në vend që të jenë shembull i mirë ata po e bëjnë të kundërtën, pra janë shembull i keq. Ku është vlera e një mësimdhënësi sot kur për mësimin e tij vendosni ju dhe përmes politikës e degradoni një mësimdhënës të mirëfilltë, madje edhe duke i ndërhyrë në punën e tij profesionale.
Po kthehem edhe njëherë tek raporti i Auditorit ku përgjigja e Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi ishte se i pranon të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit, me shkeljet në fjalë, mirëpo tani shtrohet pyetja se a janë duke vazhduar shkeljet e njëjta e që faktet tregojnë se po. Këtu kam një konkurs të shpallur javë më parë nga Drejtoria e Arsimit (prezanton konkursin) i cili është në kundërshtim të plotë me rregullativën ligjore në fuqi, dhe këtë mund ta fokusoj edhe kamera, e para ka të bëjë me bazën ligjore konkretisht me nenin 17 ku një institucion është i obliguar që proceset, veprimet dhe procedurat përmes Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në rastin konkret kemi të bëjmë me Zyrën e personelit të Komunës së Podujevës ku konkursi në fjalë nuk është shpallur nga zyra e personelit. Për kualitetin e investimeve në cilësi e digjitalizim fakt i gjallë është që tani testi Pisa ka dështuar dy herë sepse nuk kanë qenë funksional kabinetet.
Janë vendosur kënde të lojërave nëpër shkolla aq kualitet sa që janë dëmtuar ende pa u përuruar, është një kontratë rreth 35,000.00€ për këto lodra të rrethuara me goma të qitura jashtë përdorimit e që ka akte ligjore që e ndalojnë këtë.
Për fund, ne jemi në mbështetje të secilit projekt në arsim, por mbi të gjitha jemi për meritokraci në punësim sepse vetëm ashtu ngrisim cilësinë e që dorën në zemër kjo ishte edhe kërkesë e juaja deri sa erdhët në pushtet, por tani e keni harruar dhe po e shkeleni çdo ditë e që fatkeqësisht nuk kam besim që kjo mund të arrihet me një drejtor i cili i fut duart në menaxhimin e shkollave, në pranimin e nxënësve në Gjimnaz, e deri tek vlerësimi dhe notimi i tyre, transferimi i nxënësve e që është skandal në vete.
Edhe një kërkesë e kam që ditarët mundësisht t'i sjellëni me kohë e jo sikurse në vitin e kaluar deri në gjysmë të vitit shkollor.
**znj.Qëndresë Hajrizi**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, Lëvizja Vetëvendosje dhe subjekti ynë politik, informatën e sjellë për arsim me planin e punës e konsideron një informatë reale dhe të domosdoshme për të na mbajtur të informuar neve si asambleistë dhe qytetarët tanë. Drejtoria e Arsimit e ka të publikuar në fillim vit planin e punës në bazë të të cilit zhvillon aktivitete nga sfera e saj, shikuar në përgjithësi periudha e vitit 2021/2022 në Komunën e Podujevës ka filluar me sfida dhe me gjendjen e pandemisë duke u përfunduar me sukses. Na gëzon fakti për të arriturat në të gjitha fushat, por posaçërisht në fushën e arsimit pasi kjo sferë na prek të gjithëve dhe duhet të punojmë të gjithë së bashku në ngritjen e cilësisë në arsim.

Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore i potencoj edhe drejtori i DKA-së dhe inkurajojmë të vazhdohet edhe investime tjera duke përfshirë çdo shkollë të Komunës tonë, të shtohet numri i vizitave nga zyrtarët përkatës me qëllim të monitorimit të procesit arsimor, me theks të veçantë hartimi i planit komunal për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës, të vazhdoj edhe më tutje bashkëpunimi me partner ndërkombëtar me qëllim të përfitimit të shumë projekteve që ofrojnë partnerët ndërkombëtar, të bëhet fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse, udhëheqëse dhe profesionale të shkollave duke u bazuar në Rregulloren e re tani më të miratuar nga asambleja komunale, të vazhdohet me ofrimin dhe zgjerimin e shërbimit psikologjik dhe pedagogjik nëpër shkolla, të koordinohen Drejtoritë në shërbime publike me qëllim të ndërtimit dhe rregullimit të trotuareve për këmbësor sidomos atyre afër shkollave.
**z.Gazmend Islami**, në emër të subjektit OBKD, theksoi, shqetësime e mia për shkollat në Komunën e Podujevës i kam shpreh shumë herë dhe siç e dini në mbledhjen e fundit kam sjellë disa fotografi si një pasqyrë reale të gjendjes se si janë shkollat. Ende shkollat e mesme, madje edhe sot po të shkojmë atje janë dyert e hapura, do të thotë dy shkollat naltë atje (në pjesën veriore të qytetit) nuk kanë as qelës të mbylljes dhe qëndrojnë të hapura, do të thotë lozin fëmijët, ka gra atje, ka bërllog etj, dhe për këtë nuk po e fajësoj krejt drejtorin e DKA-së por duhet të punohet më shumë në këtë drejtim, pra pasqyra e shkollës së pari është oborri e që janë në gjendje katastrofike por që Kryetari i Komunës e mori me të keq që i prezantova fotografitë, në vend që Kryetari të jetë shembull, pra një asambleist i zgjedhur nga populli ofron një dëshmi dhe që i thotë Kryetarit prina ti ne po vijmë pas teje dhe e mbledhim bërllogun bashkë, por çfarë bënë Kryetari i shqyen fotografitë prej mllefit apo ku ta di unë, por është zgjedh Kryetar dhe tani po i'a shohim fytyrën çdo ditë e më shumë se çfarë kryetari është. Më vie shumë keq për shumë miq të mi që po i shohë këtu që nuk po e marrin guximin asnjë prej tyre që të dal dhe ta thotë të vërtetën, unë e di që një ditë pëlcet dhe nuk do të shkoj gjatë kjo do të pëlcet, por kur të pëlcet do të pëlcet shumë keq sepse dikush që vie në vitin 2019 dhe bëhet shefi i atyre të cilët e kanë mbrojtur dinjitetin e këtij vendi, me burg, me gjak, me protesta e me gaz, ku janë ata, prej kujt po frikësohen, prej askujt apo prej dikujt që ka ardhur në vitin 2019 dhe tani po i'u shkel me të dyja këmbët, mua po më vie keq dhe seriozisht po ndihem shumë i dëshpëruar prej miqve të mi, prej atyre që i kam parë nëpër burgje, i kam parë duke i rrahur policia, duke i ngreh zvarrë dhe i kam parë të gjakosur, pra prej tyre më vie keq sepse prej atij (Kryetarit) nuk ka çfarë më vie keq sepse ai më thoshte mua në vitin 2017 (pse po flet me këta të Vetëvendosjes, se këta janë stalinista).
Për shkollat profesionale drejtorit të DKA-së unë kam mundësi t'i ofroj bashkëpunim sepse e di që sigurisht drejtori nuk e din mirë se si funksionojnë shkollat profesionale, pra i duhet ndihmë.
Unë ofroj edhe ekspert të cilët vijnë falas prej Gjermanisë, qoftë për 1, 2, 3, 4, muaj për t'iu ndihmuar rreth punës së shkollave profesionale sepse mënyra se si funksionojnë shkollat profesionale në Kosovë dhe sidomos në Komunën tonë është më mirë të them asgjë nuk është ajo, apo të them është si humor, njerëzit dalin prej shkollës marrin një diplomë dhe nuk dinë çka janë, as nuk është murator, as elektricistë as asgjë, pra është njeri pa dije, andaj në këtë drejtim do t'i propozoja drejtorit të DKA-së që nëse dëshiron t'i ndihmojmë që për vitet e ardhshme bashkërisht shkollën profesionale ta bëjmë shembull në gjithë Kosovën, ndihmën e ke falas prej neve, si bëhet bashkimi mes kompanisë dhe shkollës, sa herë duhet të shkohet në shkollë dhe sa herë në kompani, qysh bëhet pagesa dhe forma se si bëhet tamam një ekspert i fushës së vet kur të del prej shkollës profesionale. Pra kjo do të thotë diçka sepse nuk do t'i lenim njerëzit rrugëve. Në Gjermani nuk studiojnë as 50% por rreth 30%, të tjerët janë me shkolla profesionale sepse bëhen të zotit e vetit për drejtimin që e kryejnë në shkollat profesionale janë të përgatitur për tregun e punës, kurse këta tanët nuk janë të përgatitur për asgjë.

Pra kjo ishte sugjerim i imi, kam edhe shumë gjëra tjera për t'i thënë por meqë nuk është prezent këtu Kryetari i Komunës nuk po mundem ta zgjasë më shumë, ndërsa Nënkryetaren e Komunës nuk mund ta atakoj sepse kjo nuk ka bërë asgjë do të thotë po qëndron rehat, por i them kësaj që vazhdoni ju të vjetrit se më mirë ju bie.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, dua të ndërlidhem paksa për punën e tenderëve në Drejtorinë e Arsimit sepse për këto gjërat tjera që ishin keqpërdorime qoftë me 141 të punësuar jashtëligjshëm duke anashkaluar plotësisht Zyrën e personelit.
Gjatë shfletimit të një specifikimi teknik të një tenderi që e ka qitë drejtori i DKA-së në vlerë 179,000.00€ në të cilin kishte shumë pika që nuk po u dike sa çfarë janë por 2 ose 3 prej tyre pa qare më duhet t'i cekë, specifikimi teknik është ky (e prezanton të shtypur), jo që e kam bërë unë por ky është dokument i specifikimit teknik në të cilin shkruan, shembull, tush bateri 2500 copë për shkolla mirëpo në Komunën e Podujevës sa e di unë janë rreth 40 shkolla andaj sipas një përllogaritjeje i bie që 74 tush bateri për çdo shkollë, unë nuk e di se ku shkojnë këto dhe nuk e di çfarë nevojiten tush bateri për shkolla kur në anën tjetër në specifikime ka edhe çeshme për ujë të ftohtë dhe çeshme për ujë të ngrohtë dhe tush bateri, andaj nuk e di përse dhe për çfarë janë porositur gjithë këto tush bateri e që në total këto arrijnë shumën 19,260.00€.
Pastaj kemi të porositura nxemse për termo 2.5 kw-3.5 kw, por unë nuk e di as ku janë ato termo, çfarë i duhen ato nxemse apo për ku parashihen. Mandej janë porositur stufa dhe unë nuk e di se ku i ka paraparë t'i dërgoj ato tash në këtë kohë kur vet drejtori në raportet dhe informatat e thotë se shkollat janë me ngrohje qendrore.
Po ashtu janë porositur flamuj, shembull flamuri i Kosovës kushton 10€ në këtë pikë, kurse flamuri Kombëtar 1 cent, e që goxha mu duken të ndërlikuara këto çështje, dhe këtë edhe e them edhe duke parë facebook-un e drejtorit të DKA-së kur para rreth 2 viteve e potencon se drejtorët e komunës po bëjnë "tuxharet" me drejtorin e prokurimit, kurse ky tani të gjithë i ka lëvizur andej e këndej por vetëm atë të prokurimit nuk e ka lëvizur fare, prandaj tani pyes, a është "tuxhar" ai person apo jo, dhe a po të dëgjon ty tani dhe a po bëni marrëveshje me atë.
**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, pyetje për drejtorin e DKA-së, dhe atë, në shkollën "Lasgush Poradeci" në fshatin Dumnicë gjendja e fusha sportive është katastrofale, andaj pyes drejtorin e DKA-së se a e ka në plan kjo Drejtori që ti ndërtoj ato fusha sportive, nëse po kur do të ndodh sepse ato fusha që janë nuk i plotësojnë as kushtet elementare, përndryshe mund edhe ta shihni në foto që e posedoj këtu në telefonin tim se në çfarë gjendje është fusha e volejbollit në shkollën e fshatit Dumnicë (paraqet fotot) vetëm bari dhe 2 shtylla, kurse fotoja tjetër është gjendja e fushës së futbollit. Pra nëse do të investoni në këto fusha të sportit në shkollën e fshatit Dumnicë, kur do të ndodh ajo.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, duke ju falënderuar për vërejtjet dhe sugjerimet e juaj, unë po e filloj t'iu përgjigjem dhe të jap sqarime duke filluar nga diskutimi i fundit për të ardhur tek parafolësi i parë. Vërtetë është se gjendje është ashtu në fushat e sportit në shkollën e fshatit Dumnicë dhe ashtu e kam gjet, por në këtë vit nuk kemi të planifikuar investime në fusha sportive për shkak të një kontrate të lidhur ndër vite dhe e cila ka krijuar pengesa dhe për të cilën nuk jemi përgjegjës, mirëpo duhet t'i jepet një epilog i caktuar dhe për vitin e ardhshëm të planifikohen fusha sportive mirëpo duke i'u dhënë prioritet fushave sportive brenda hapësirave shkollore të cilat jemi në dijeni se si i kemi gjete dhe në çfarë gjendje janë.
Sa i përket çështjeve të ngritura nga z.Ekrem Rrahmani, specifikimet dihet qartë se drejtori nuk merret me këtë çështje de atyre detajeve që i potencoi, do të thotë janë zyrtarët përkatës në kuadër të Drejtorive dhe kjo kontratë nuk është vetëm kontratë e Drejtorisë së arsimit por është edhe e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe e Drejtorisë së Administratës, kështu që kjo

mund të jetë arsyeja që është ai numër i madh i atyre çeshmeve që u përmendën, dhe sa jam në dijeni unë është një kontratë dy vjeçare e që nënkupton se mund të shpenzohen edhe ato pasi që bënë pjesë Shëndetësia, Administrata dhe Arsimi. Pra edhe njëherë e ceka se specifikimin e tyre e bënë eksperti që është brenda Komunës, por nuk ka të drejtë drejtori të bëjë specifika brenda Komunës sepse është konflikt interesi, mirëpo ne iniciojmë procedura në bazë të kërkesave që marrim nga shkollat dhe vazhdohet tutje. Sa i përket stufave, fatkeqësisht ka shkolla që janë me stufa dhe tani nuk po e fajësoj as të kaluarën as të tashmen por gjendja është e tillë, për një vit nuk mund të bëhen të gjitha me efiçiencë, por dal nga dal do bëhen dhe fati është i mirë se ka një vullnete prej Kryetarit të komunës dhe prej Lëvizjes Vetëvendosje për ta orientuar buxhetin në arsim dhe këto të mira i shihni ju për çdo dit dhe do t'i shihni edhe ditëve në vijim.
Asambleisti z.Gazmend Islami i përmendi disa sugjerime të duhura e që i kemi biseduar bashkërisht më herët dhe jam i hapur për çdo bashkëpunim të mundshëm për shkollimin profesional dhe e vërtetë se kemi nevojë kështu që jemi të hapur për çdo bashkëpunim të mundshëm sidomos për përvojat e juaja që i keni treguar shumë herë në këtë pikë.
Gjithashtu pati disa sugjerime edhe nga asambleistja znj.Qëndresë Hajrizi rreth fushës së shërbimit psikologjik dhe vizitave në shkolla e të cilat do t'i kemi parasysh edhe pse kemi realizuar vizita por do t'i intensifikojmë sërish.
Sa i përket çështjeve të potencuara nga z.Qëndrim Softolli, anulimi i konkurseve kanë një shpjegim dhe një sqarim për çfarë janë anuluar dhe natyrisht janë shqip të shkruara për çka janë anuluar dhe janë publike nuk janë të fshehta. Raportit të Auditorit paksa po i jepni një ngjyrim jo bash real, të jemi shumë të sinqertë, pra në raportin e auditorit është një e gjetur dhe ajo është publike, ku thuhet se Komuna për zhvillimin e procedurave të rekrutimit ka respektuar Ligjin e arsimit parauniversitar dhe Udhëzimin Administrativ, ndërsa ka anashkaluar sistemin informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore-SIMBNJ, pra duhet të bëheni real dhe nëse nuk e dini duhet të pyesni, çka nënkupton ky lloj menaxhimi, e që për disa konkurse të cilat nuk kanë qenë me urgjencë siç është zgjedhja e drejtorëve, ne i kemi bërë publikimin ashtu siç e parasheh dhe siç e ka dhënë sugjerimin auditori sepse nuk e kemi pasë për ngutë zgjedhjen e drejtorëve, mirëpo janë disa raste paksa më specifike, dhe tani në këtë vit të gjitha rekomandimet e auditorit i kemi zbatuar, vetëm një shembull, në shkollën e fshatit Herticë një mësimdhënëse e ka kërkuar pushimin, deri sa i kemi zhvilluar procedurat ashtu siç i parasheh Ligji që është 1 muaj njoftimi publik, mandej edhe 15 ditë afati i konkursit, ajo mësimdhënëse veç është kthyer nga pushimi, dhe kjo nënkupton se nga kjo humbin nxënësit humbin ata.
Listën e pritjes nuk e kam shpikë unë, madje tani së fundmi është edhe me vendim të Ministrisë së Arsimit në të cilin shkruhet qartë se lista e pritjes është me ligj që mund të shfrytëzohet, pra për herë të parë, dhe për këtë bëhuni real sepse ueb sajt aty është dhe mund të hyni të shfletoni prej vitit 2017 listat, a ka ndodh të publikohen listat qoftë të atyre të pranuarve qoftë atyre që janë në renditje, si dhe në rast se ka ndodh që nga ato lista ne të marrim ndonjë nga fundi ashtu siç ka ndodh më hercët e që jeni në dijeni, dhe ta qesim në fillim, atëherë ballafaqohemi me argumente. Pra lista e pritjes është publike dhe ajo është duke u zbatuar, kurse e vërtetë është se auditori ka thënë se kjo ndikon në menaxhim jo të mirë të proceseve dhe veprimeve, por nganjëherë edhe të krijon vështirësi sepse çështja e pushimeve mjekësore dhe pushimeve të lehonisë tek mësimdhënëset, ata që kanë punuar në arsim e dinë shumë mirë që është paksa më specifike. Pra kjo që kërkohet me SIMBNJ nënkupton që të publikohet njoftimi publik, si dhe për komisionet intervistuese mos po mendoni që Zyra e personelit duhet të vijë në zyrat e LDK-së dhe ti merr emrat e anëtarëve, jo anëtarët e komisionit këtu merren këtu në Komunës sepse nuk ka tjetër ku t'i merr. Në rregull është se janë procedura këto mirëpo këtu prezent e kemi edhe menaxherin e personelit dhe jemi në dijeni se çfarë stafi ka

aktualisht ku gjithsejtë janë 4 persona, Drejtoria e Arsimit ka një varg të konkurseve, dhe unë si Avni Fetahu nuk është se jam duke ndier ndonjë relaks aty sepse kur del konkursi dhe aplikojnë 56 persona dhe duhet të pranohen vetëm 5 nuk është e lehtë ajo, do të thotë nuk është ndonjë vetëkënaqësi aty sikurse që po e konsideroni ju, mirëpo proceset nuk mund t'i lëmë në gjysmë.
Te çështja e ndarjes së orëve, duhet të bëheni më real dhe ta shihni më real procesin e jo vetëm të thoni kinse unë kam shpallë vetëm për dy norma kurse janë bërë 4 norma, ju e dini se një profesor që ka qenë në shkollën ekonomike është bërë zëvendës drejtor e që i cili i ka pas 20 orë. Pastaj jeni në dijeni se për fat të keq ka ndërruar jetë një drejtoresh e shkollës dhe është shtuar numri i orëve, prandaj nuk mund të thoni se keni shpall me kaq orë kurse i keni marrë me kaq orë, mirëpo ne i kemi marrë prej listës së konkursit, asgjë nuk kemi bërë më shumë.
U cekën edhe ndërhyrjet kinse unë kam ndërhyrë diku, mirëpo nëse është ashtu është mirë të ceken për çfarë ndërhyrjesh bëhet fjalë kinse unë kam ndërhyrë tek ndonjë profesor apo ndokund tjetër, ndërsa tek testi pisa që ka dështuar, goxha është e çuditshme kjo çështje sepse ende pa dal rezultatet e testit pisa të thuhet se ka dështuar, nuk e kapë truri askund këtë çështje, ndërsa ato dezinformata që i keni hedh ju duke thënë se nuk ka pasë kompjuter e gjëra tjera të ngjashme, mirëpo zyrtarët e arsimit të cilët e kanë pasë detyrë ta organizojnë këtë janë ndier tepër të kënaqur me kompjuterët që i kemi marrë prej shkollës "Enver Maloku" dhe i kemi sjellë në shkollën "Shaban Shala" ku është zhvilluar testi pisa, por që 2 nxënës kanë hezituar të marrin pjesë sepse kanë menduar se po dështojnë shumë dhe është dashtë të shkohet dhe t'ju realizohet testi në fshatin Dobratin, çfarë ka të keqe kjo, andaj kjo është bërë temë që për dy nxënës që është dashtë të shkohet t'ju realizohet testi pisa e që është menaxhim i Ministrisë, kurse unë kushtet ju kam ofruar.
Për çështjen e ditarëve të shkollave mund t'ju them se vitin e kaluar për herë të parë kanë qenë në kohë të gjithë, pra ajo që u tha është gënjeshtër dhe nga ka ardhë ajo informatë nuk e di.
Po ashtu edhe tek çështja e transferimeve të mundshme të nxënësve e që e keni bërë edhe temë mediatike sepse si temë prokuroriale nuk ka asgjë këtu, për atë punë edhe jeni në opozitë, të jemi shumë të kjartë sepse për herë të parë po e përmend mënyrë kronologjike ngjarjen e që ju është dashtë vetë të pyesni dhe do të isha shumë i hapur para juve, nxënësja Dafina Ferizi ka qenë kandidate e mundshme potenciale për tu regjistruar në njërin prej drejtimeve në mjekësi, edhe ndërkohë ajo ka qenë në listën pritëse në mesin e 8 të tjerave, të gjitha janë pranuar dhe për asnjë zhurmë nuk keni bërë, vetëm për një fëmijë të cilën unë mandej e kam njohur se është e një familje të varfër, sepse po të ishte e ndonjë politikani nuk do ta përmendeshit fare ju, por për fat të keq familje e varfër, por si do që të jetë në atë periudhë kohore Avni Fetahu ka qenë asambleist, mirëpo e ka marrë një vendim e ndjera drejtoresha e shkollës e që edhe unë po të isha në vendin e saj ashtu do të veproja, dhe prej presionit të madh të prindërve ajo e ka vendos "pa hile dhe pa sherr" dhe ata 8 persona i ka inkuadruar në drejtimet e mjekësisë që kanë qenë në listën e pritjes e njëra prej tyre edhe Dafina Ferizi, dhe pastaj çfarë ka ndodh është se kanë dashtë ta bëjnë politike këtë çështje ai klubi që për fat të keq ekziston aty në atë shkollë dhe që kanë dashtë të bëjnë politike dhe e kanë thirr inspektoratin arsimor i cili ka ardhë dhe e ka vlerësuar gjendjen dhe me të drejtë ka thënë se pa marrë parasysh procedurat që nuk janë ndjek mirë, që ka vërejtje, fëmija nuk bënë të mbetet pa shkollim, shumë i qartë, dhe unë pa dashur të ndërhyjë, me rekomandim të tyre i'u kam thënë se këto janë kërkesat dhe nxënësja nuk bënë të mbetet e pa notuar, është bërë një komision i cili e kanë notuar dhe e kanë mbyllë lëndën dhe kaq është kjo çështje, pra ajo vajzë ka qenë pjesë e listës pritëse që është pranuar në mesin e 8 nxënësve tjera e që për asnjë nuk keni ngritur zërin por vetëm për atë.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, fillimisht dua të them se shkelja e ligjit për zyrtarët publik që drejtori parafolës e ka shkelur për të gjitha procedurat dhe tani po vazhdon ta shkel ende edhe pas gjetjeve të Zyrës së Auditimit. Ligji për zyrtarët publik, neni 67 i - organizmi i konkursit, paragrafi 1 thuhet,

themelimi i marrëdhënies së punës për një Nëpunës të shërbimit publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur të organizuar sipas këtij ligji, pastaj në paragrafin 5 thuhet, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë procedurat e konkurrimit organizohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, pra është organi i veçantë për këtë, do të thotë sërish jeni recidivist i shkeljeve ligjore. Drejtori e potencoj se ka qen asambleist kur ka ndodhur transferi i nxënëses, mirëpo unë ju them se ashtu është ke qenë asambleist në atë kohë por e keni ushtruar detyrën e drejtorit e që edhe kjo ka qenë shkelje, madje edhe atëherë kam reaguar për këtë çështje, por nëse auditori nuk i ka parë gjitha këto çështje besoj se prokuroria do t'i sheh. Pastaj ti drejtor ke shpall konkurs për pranimin e mësimdhënësit për 10 orë, kur aktualisht keni mësimdhënës të drejtimit të njëjtë me përgatitje të kompletuar me 10 orë, do të thotë nuk ke tentuar t'i plotësoni orët mësimdhënësit që është i punësuar aktualisht por ke shpall konkurs, nëse mundesh arsyetojeni këtë. Listën e pritjes nuk e ke të rregulluar me asnjë ligj dhe këtë e ke shpikë ti drejtor sepse ligjërisht nuk ka listë të pritjes.
Anulimi i konkursit për tutor, drejtori e tha se shqip është dhe ne e dimë këtë dhe shumë qartë është, ku anëtarja e komisionit nga Organizata që e ka sponzorizuar këtë nuk e ka nënshkruar pasi ka gjete shkelje, dhe këtë ti drejtor e dinë shumë mirë. Tani nëse i ke bërë gjitha këto shkelje për të gjitha këto punësime dhe nuk e ke ndjekur Ligjin për zyrtarët publik, Auditori të ka dhënë vërejtje kurse ti sërish po vazhdon njëjtë pasi që ky konkursi i fundit është shpallur më datë 26 korrik 2022, pra ty drejtor nuk është duke ta ndie fare për këto, por ka të tjerë që merren me këtë çështje.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, kërkoj mirëkuptim që më parë harrova ta potencoj se Organizatat VORAE dhe ajo Perde Home, herën e parë e ka nënshkruar testin me shkrim që ka qen dhe herën e dytë kur është mbajtur intervista me gojë e kanë kryer intervistën dhe atë ditë për shkaqe familjare ajo anëtare e komisionit nuk ka qenë, dhe kjo është publike në ueb-sajt të Komunës, kështu që ajo që e tha parafolësi është dezinformatë. Më vie keq dhe si shprehi e kam edhe kur kamë qenë mësimdhënës që nxënësve vetëm njëherë jua kam shpjeguar kurse herën e dytë nuk jam marrë shumë me atë çështje, prandaj shikojeni mirë edhe njëherë se konkursi i fundit dhe në tërë këtë vit konkurset janë publikuar përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nëse nuk dinë të hysh (i drejtohet z.Qëndrim Softollit) eja të tregoj se si hyhet sepse edhe kompjuterin e njoh, dhe do ta shohësh se prej këtij viti të gjitha janë të publikuara e që kanë qenë edhe në vitin e kaluar, me përjashtim të disave që kanë qenë në pushim të lehonisë e që është dashtë shpejt të intervenohet për të mos i lënë nxënësit pa mësim.
Sa i përket listës pritëse, nëse më lejoni unë mund ta lexoj vendimin e qartë ku lista pritëse është me vendim të Ministrisë së Arsimit, vendim të cilin gjatë kësaj mbledhje, ndoshta në pikën të ndryshme do t'jua sjellë me numër të protokollit.
**z.Qëndrim Softolli**, pyet, na trego drejtor kur e ke marrë atë vendim dhe kur e ke përdorë ti.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, vazhdoi, lista pritëse është përdorur në vazhdimësi dhe është zyrtarizuar si çështje, madje edhe në konkurs çdo herë e kemi vë se lejohet lista pritëse sepse ajo është proces paksa më i komplikuar se sa që e mendon ti, shembull, të vie në moment që ndokush shkon në pushim të lehonisë dhe tani nxënësit nuk mund të lihen pa mësim, andaj duhet të angazhohen nga lista pritëse, por jo të merren sikurse viteve të kaluara ku nga fundi i kanë marrë dhe i kanë vë aty ku kanë pasë dëshirë, por ajo listë që është publikuar në ueb-sajt, ajo duhet të respektohet.
Sa i përket Prokurorisë, Agjensionit Kundër Korrupsion, mediave, të gjitha dërgoni dhe ne jemi të hapur dhe jemi duke u marrë që çka do që kërkojnë informata jua përcjellim dhe ballëhapur jam në këtë çështje, madje asnjë ves nuk e kam për këtë çështje, mirëpo edhe politikën e kuptoj sepse në një kohë as facebook-un tim nuk goxonit të ma shfletoni kurse tani po i shikoni shkrimet e mia dhe kjo

më bënë përshtypje që po i'u pëlqejnë kështu që unë edhe atëherë kam qenë konkretë dhe jam edhe tani andaj nuk ka asgjë diçka që unë po ndryshoj prej qëndrimeve të mia.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, të më flas drejtori parafolës për parime ia humb vlerën dhe kuptimin edhe vet fjalës parim. Se sa keni qenë i dëgjueshëm dhe trim e dim të gjithë sepse të kam pas koleg në atë kohë. Sa i përket asaj që ta shfletoj facebook-un t'ju them të drejtën nuk bie as ndërmend që ekziston. Nuk kam diçka më shumë edhe pse drejtori hyri në detaje të panevojshme me deklarime duke thënë ma shikoni facebook-un, pastaj duke thënë a dini apo jo të përdorni kompjuterin, por nëse ti ke mbete me na vlerësuar "paskemi shkuar posht" me një fjalë.
Sa i përket asaj që drejtori e tha se kam qen andej, kam qenë guximtar, kam qenë parimor, beso se të gjithë të njohim se kur zëri nuk të është dëgjuar prej Kryetarit të mëparshëm, ke qenë më dëgjueshmi, madje edhe në media e pati pranuar ish Kryetari se ti drejtor je një super servil, dhe është një fakt i patjetërsueshëm, andaj nuk kemi nevojë të hymë në histori por jemi duke diskutuar për aktualen dhe për të gjitha ato gjetje i keni të evidentuara dhe kallximet penale për të gjitha ato shkelje, prandaj Prokuroria merret me atë punë.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, dua të ndërlidhem tek Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore-SIMBNJ për të cilin drejtori i Drejtorisë së Arsimit e potencoj se është përdorur dhe është shfrytëzuar, ndërsa tek gjetjet e auditorit thuhet se në proceduar e konkursit në sektorin e arsimit është respektuar Ligji për arsimin parauniversitar dhe Udhëzimi Administrativ, por është anashkaluar SIMBNJ, prandaj gjetja e auditorit thuhet diçka ndryshe nga ajo që u tha më herët nga drejtori, ndërsa për ta përdorur atë sistem besoj se të gjithë dimë.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, të jemi të qartë se nuk bëhet fjalë a dini apo jo ta përdorni, unë po ju tregoj shqip që në vitin e kaluar për çështjen e drejtorëve të shkollave e kemi publikuar. Fillimisht duhet ta dimë se çka nënkupton SIMBNJ, ju tregoj se nënkupton se konkursin duhet ta publikojmë dhe ai të qëndroj për 1 muaj si njoftim publik duke publikuar edhe datat duke sqaruan në vet njoftimin se nga NN data për 14-15 dit tjera për konkurs, kaq ka punë dhe tjetër gjë nuk është paraparë në të Sistem, pra edhe auditori ka thënë se kjo ka ndodh shkaku i ndryshimeve që ndodhin shpesh në arsim e sidomos zëvendësimet për pushimet e lehonisë, edhe ata e kanë ditë që nuk është bash proces i lehtë ky, kështu që kjo është arsyeja.
Çështja tjetër, i nderuar Qëndrim Softolli, unë nuk jam as t'ju shes moral politik juve e as asgjë, qëndrimet e mia në lidhje me ish subjektin tim politik kanë qenë të qarta, madje aq më pak teje nuk pres unë ndonjë mburrje e që tani po t'ju them mbylle telefonin dhe nga 10 themelues të LDK-së përmendi vetëm 3 emra prej tyre, nuk din të mi tregosh, madje nuk e din as kur është themeluar LDK, kështu që ti mos më shit moral politik mua duke më përmend se ku kam shkuar e tek jam shkuar sepse qysh kam diskutuar me Agimin atë e din vetëm ai, dhe ia kam sqaruar qartë çdo gjë dhe kam qenë shumë konkret me të, madje kam qen shef i grupit të këshilltarëve të LDK-së dhe e di sa vështirë ka qenë sepse është dashtë për të gjitha temat me diskutuar unë nga ikja juaj që as temat nuk i marrshi për t'i diskutuar, kështu që leje atë çështje.
**z.Qëndrim Softolli**, nga vendi ndërhyri duke theksuar, mirë që dole këtu sepse edhe këtu të prita sepse ku unë i kam pasë kundërthëniet për ish pushtetin që ka qenë në atë kohë aktual, ti ke qenë ai që e ke rregulluar e ke lëmuar dhe i ke qëndruar në vijë ish Kryetarit z.Agim Veliu. Pra për ata ju kemi ikë temave sepse kur ne kemi thënë se nuk është në rregull, ti ke dal dhe e ke mbrojtur duke thënë se në rregull është.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kërkoj nga dy parafolësit që të ndalemi pak dhe të kthehemi në temë sepse nuk është mirë të kalohet në çështje personale duke u shprehur këtu se nga keni qenë dhe në cilin subjekt politik sepse nuk është duke na interesuar asnjërit prej neve.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, unë ku kam qenë edhe jam tani, por nuk jam shtegtar politik.

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, tema e dy parafolësve nuk është problem i qytetarëve dhe atyre që na përcjellin live tani, mirëpo qytetarëve i'u intereson se si ne po i zgjedhim problemet e tyre dhe si po i paraqesim në Kuvend, prandaj unë mendoj se jemi duke e tepruar paksa duke u marrë njëri me tjetrin për çështje personale dhe lëvizjet nëpër parti politike e që është e drejtë e çdo qytetari dhe nuk dëshiroj të merrem me atë çështje, andaj ju lus të qëndrojmë në temë.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, edhe njëherë dëshiroj të merrem me atë çështje sepse anëtari i Kuvendit në fjalë e potencoi një çështje dhe më duhet t'i përgjigjem me argumente, të jemi të qartë, qëndrimet e mia për fat të mirë janë të regjistruara dhe janë në procesverbale, nëse e gjeni ndokush që një shef i grupit të këshilltarëve siç kam qenë i LDK-së, nuk e kam votuar as buxhetin për shkak të mos investimeve në arsim, dhe këto janë publike, andaj nëse e konsideroni si servilitet ju këtë atëherë në rregull, si të doni, mirëpo unë e di qysh kam mbrojte dhe qysh kam diskutuar, kurse të drejtën nuk ia mohoj (fjala është për ish Kryetarin e Komunës) që më ka lutur të bëhem drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, por nuk e kam pranuar.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, jemi të zgjedhur këtu që të mundohemi të bëjmë diçka më mirë, më drejtë, t'ju japim qytetarëve tanë jetë më të mirë dhe shkollim më cilësor. Kush çfarë ka bërë e dimë të gjithë, andaj përse kemi nevojë të hymë në tema personale, kush, çka, tek, si, në fakt ne tani e dimë ku është ky zotëria (z.Avni Fetahu) dhe e dimë ku ka qenë e që tani as nuk mund ta bëjmë më të mirë e as më të keç sepse është ky që është. A ka dallavere, ka plotë, a ka të këqija ka plotë, madje edhe ti drejtor e din që ka, dhe kur e them këtë e ka parasysh se ne të gjithë e njohim njëri tjetrin, edhe në pushtetin e kaluar ka pas, edhe këtu ka plotë, por dua të them se ne duhet t'i ikim këtyre gjërave dhe të mundohemi të përmirësohemi, e aq më shumë se që përmirësohemi i bëjmë nderë edhe vetës, edhe Komunës por edhe qytetarëve tanë, ngase po të fillojmë e të flasim për dallavere dhe të lëshohemi në detaje, kush, çka, si, të gjithë njihemi mes vete sepse ose jemi miqësi, tezaka, shoqëri etj, janë gjëra që i dimë të gjithë por përse i fshehim në maskat tona është diçka tjetër, mirëpo i dimë, e që mëritë do të ishte sikur të mund t'i ikim atyre, të përmirësohemi dhe të mos i bëjmë ato që i kemi bërë. Pra posa jemi zgjedh, jemi njerëz më energjik, pastaj kemi këtu njerëz që kanë kontribuuar shumë, prandaj është mirë t'i mbyllim këto privatësi sepse mua më pengojnë shumë këto gjëra siç ishte ajo rreth përdorimit të kompjuterin e të ngjashme e që nuk është mirë të hyhet në ato gjëra sepse të gjithë kemi kryer ngapak shkollim, të gjithë dimë shkrim lexim, por po të hyhet t'jua shikohet statuset në facebook del që gjysma këtu as gjuhën shqipe nuk e njihni dhe kur e them këtë e bazoj në atë çfarë lexoj unë ku dhe si përdoren (presjet, ë-jat, q/ç-jat, gj/xh-jat, dhe shumica nuk e din ku vjen pyetje pikëpyetja e as pikëçuditsja), mirëpo si do që të jetë unë jam për shkollim cilësor dhe që të jepet kontributi prej çdo njërit për të mirën e këtij vendi, nëse merremi me thashetheme dhe me shpifje nuk na qon përpara askund kjo.
**z.Kasib Bashota**, theksoi, ne jemi para qytetarëve dhe të zgjedhur prej qytetarëve, andaj nuk po më pëlqen ky debati personal as i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit as i diskutuesve përkatës nga ana e LDK-së. Nuk ka njeri pa mangësi por të mos kthehet debati në personale sepse jemi këtu për të mirën e qytetarëve dhe për gjëra të mira.
Tani ne mund t'i themi drejtorit se jemi duke parë ndryshime në shkolla, investime e që ka nevojë vendi të ketë investime e sidomos arsimi i cili ka një buxhet të jashtëzakonshëm dhe po presim që shkollat të jenë model në Llap.
**znj.Arjeta Abazi**, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili në informatë e ka paraqitur se ka mbi 500,000.00€ buxhet për investim në shkolla, mirëpo dua ta di konkretisht për shkollën "Shaban Shala" duke qenë në dijeni se viteve të kaluara parafillorët nuk i kanë pasë as kushtet elementare për mbajtjen e mësimit, shembull, janë ulur në ulëset e të rriturve, nuk kanë pasë mjete konkretizime, kanë mbajte mësimin nëpër klasat ku njëherë kanë mbajtur mësimin parafillorët

e pastaj klasat e para e tutje, andaj do të doja për hir të opinionit dhe qytetarëve ta dimë kur do të bëhet ky investim dhe a do të jenë të gatshëm të fillojnë në shtator mësimin parashkollorët me kushtet që i'u takojnë atyre.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, përgjigje parafolëses, theksoi, lidhur me investimet në shkolla e posaçërisht në shkollën "Shaban Shala" jemi dëshmitar të gjithë se me çfarë intenziteti janë duke punuar kompania përkatëse për të cilën zhvilluar proceduar e tenderimit nga Komisioni Europian ku ata janë duke e rregulluar hapësirën e jashtme për të vazhduar me hapësirën e brendshme. Kemi një kontratë të veçantë edhe ne si nivel komunal dhe presim të bëjmë ndërhyrje në këtë shkollë edhe brenda hapësirave dhe në ndarje të klasave aty ku është e nevojshëm për të krijuar atë ambient që u potencua nga parafolësja edhe pse paska është specifike çështja e inventarit ngase nga ky vit po jemi të detyruar që në bazë të një kontrate që është e nivelit qeveritar, vetëm të bëjmë kërkesën për inventar dhe në atë pjesë të inventarit nuk ka strukturë të ulëseve çfarë kërkon projekti sikurse që e kemi bërë me projektin "Shpresë Kosova" me Organizatën Caritas, kështu që jemi në përpjekje ta gjejmë një modalitet që me një tender të veçantë ashtu siç kërkohet dhe të bëjmë zgjidhje për të gjitha klasat parafillore.
Kemi filluar me disa TV-Monitor për të vazhduar në vitin e ardhshëm edhe me tabelat e mençura që do të krijojnë një ambient më të mirë edhe për parafillorët por në të njëjtën kohë edhe jemi në përpjekje të kurojmë nga muaji shtator sidomos këto dy shkollat (Shaban Shala dhe Naim Frashëri") mësimin kabinetik e që nënkupton që mësimdhënësi të qëndroj në klasë, nxënësit të shkojnë aty që do të thotë se edhe bëhet ruajtja më e mirë dhe do të krijohet hapësirë për parashkollorët.
**z.Valon Demolli**, theksoi, ka edhe një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, tek rasti i asaj zonjës Dafina Ferizi e cila është transferuar në fund të gjysmë vjetorit të parë, do të thotë një javë pa përfunduar gjysmë vjetori, andaj qysh e potencoj drejtori që kjo nxënëse kjo nxënëse nuk ka qenë në 8-shen e parë por në fund të listës së të papranuarve, mirëpo ja ku e keni edhe vulën në këtë dokument ku thuhet, njoftohen mësimdhënësit se nxënësja Dafina Ferizi të notohet sepse DKA ka mundësuar transferimin e saj. Pra nga pozita e asamblistit ke dhënë vendime në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, meqë përmendët vulën atë mund ta shihni me vëmendje që është vulë e shkollës së mesme ekonomike dhe në këtë aspekt të menaxhimit unë nuk mund t'i qëndrojë mbi kokë secilit në shkolla se çka bon me vula. Isha shumë konkret, e ndjera ka ndërruar jetë dhe nuk është në këtë botë më (fjala është për ish drejtoreshën e shkollës ekonomike), por po të isha në vendin e saj dhe unë ashtu do të veproja dhe nuk do ta leja asnjë fëmijë të përjashtohet sepse kanë qenë në listë dhe nëse ata 8 të tjerët kanë bë që të transferohen, nuk ka pasë të keqe as e përmendura, e që nuk e di a ka qenë e fundit apo ku ka qenë por që ka qenë në mesin e tyre, as nuk ka ndonjë lidhje familjare me atë vajzë e as nuk e njoh kush është, mirëpo kur është ardhë me kërkesë të qartë prindi i saj dhe e kam parë gjendjen e varfër çfarë e ka dhe gjitha tjerat, e kam respektuar por unë nuk e kamë bërë krye në vete këtë sepse kanë ardhë nga Ministria të cilët i kanë dhënë rekomandimet dhe me të drejtë kanë thënë që sipas Ligjit nxënësja nuk guxon të mbetet e pashkolluar. Ajo nxënëse nuk faj që nuk janë zhvilluar proceduar nga kujdestarja e klasës.
Për këtë çështja kam ndier keqardhje, madje kam ngritur komision disiplinor për mësimdhënës me të cilët kam punuar dhe jam detyruar që përmes komisionit të dënohen në pagë e që muajin e kaluar ata mësimdhënës kanë marrë pagë më pak, kështu që nëse do të kisha ndonjë interferim unë në atë çështje, nuk do t'i zhvilloja këto procedura të komisioneve. Pastaj është ngritur edhe komisioni i ankesave dhe e kanë dërguar në shkallën e dytë e që i kam inkurajuar sepse i kam pasë kolegë dhe i'u kam thënë se nëse mendoni se ju është bërë e padrejtë, mund të vazhdoni edhe në Gjykatë.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, dëshiroj të ndalem tek siguria në shkolla, sidomos në shkollat e qytetit, rrahjet mes nxënësve, përdorimi i armëve të ftohta, shitja dhe konsumi i pijeve alkoolike përreth shkollave, andaj a është duke ndërmarrë Drejtoria e Arsimit ndonjë veprim për parandalimin e këtyre dukurive qoftë përmes Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi qoftë përmes instancave tjera, andaj kërkoj të njoftohemi më në detaje sepse kohëve të fundit janë dyfishuar këto raste dhe është shumë shqetësuese.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, ajo që e potencoj parafolësja është shumë e vërtetë, sidomos në shkollën ekonomike për shkak të numrit të nxënësve tani të përzier siç janë në mjekësi, bujqësi, juridik etj, e që janë duke u krijuar disa zënka më shumë se në shkollat tjera.
Stafi i policisë ju e dini se në çfarë gjendje është ke që janë 2 policë civil të cilët e monitorojnë këtë proces. Rrahjet e shpeshta po ndodhin për fat jashtë oborreve të shkollave dhe nuk po krijojnë ndonjë hapësirë që ndërmarrin veprime vetë ato shkolla.
Rregullorja në fjalë për të cilën me shumë kompetencë e thoshte z.Qëndrim Softolli se është e kundërligjshme, vlerësimi është sjellë tani së fundmi zyrtarisht se asnjë problem ligjor nuk e ka ajo rregullore, dhe e njëjta nga muaji shtator fillon së zbatuari dhe ajo rregullore do ta shihni se do të na e mundësoj të gjithë neve qoftë si prindër qoftë si mësimdhënës, qoftë si asambleistë, qoftë si drejtorë, ta monitorojmë procesin më mirë. Rregullorja nuk ka pas qëllim që t'i fusim në grushte drejtorët ashtu siç e potenconit por tani do të bindeni se është shumë funksionale sepse ashtu funksionon në të gjitha shkollat në nivel të Kosovës, e që njëjta shpresoj se do të na përmirësoj gjendjen në masë të madhe sepse parasheh masa të qarta që nga nxënësi deri tek drejtori i shkollës.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, dua t'i them drejtorit të Drejtorisë së Arsimit se meqë e keni kaq zemrën e mirë dhe jeni kaq bamirës, bamirësia së pari niset prej shtëpisë tënde, tani në lagje, pastaj në qytet dhe në fund fshatrave. Ju e dini shumë mirë se në fshatin ku jetojmë ne së bashku me drejtorin, ka shumë nxënës që kanë nevojë për shkollim. E përkrahi shumë atë që drejtori e potencoj që t'iu ndihmohet njerëzve që kanë nevojë, mirëpo i them drejtorit që fillimisht të niset nga shtëpia e tij, lagjja e tij, fshati i tij, pastaj të del në qytet dhe në fshatra.
Shumë do të doja që drejtori ta ketë zemrën aq të mirë edhe pse dyshoj në këtë, por po ta ketë unë personalisht do ta përkrahi, mirëpo e di që jo sepse nuk është kjo çështje vetëm sot.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, falënderoj parafolësen bashkëvendase e imja, posaçërisht familje e juaj e cila ka dëshmuar ndër vite për punët e mira që ka bërë dhe atë nuk e mohon askush e që kam respekt për atë, mirëpo sa i përket shkollës së fshatit nuk është se nuk janë bërë investime por kemi dashtë të tregojmë një qasje më ndryshe paksa, nuk kemi dashtë të veprojmë në Shtedim sikurse që ka ndodh në Bradash të ndërtohet edhe një shkollë dhe të bëhen dy, por kemi dashtë të tregojmë një gjë të mirë që të fillohet me të gjitha shkollat njëjtë, e jo të themi se kjo është e vendit tim dhe të bëhen investimet aty. Edhe përkundër nivelit të shkollimit që jemi në dijeni të gjithë çfarë është nëpër fshatra e çfarë është në qytet, unë fëmijët i kam në atë shkollë të fshatit dhe as nuk kam bërë asnjë dallim diçka, kështu që kjo është tëra.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, nuk e kisha fjalën për shkollën e fshatit Shtedim sepse ajo në gjendje shumë të mirë për momentin, mirëpo e kisha fjalën për nxënësit dhe rrethin e që jemi në dijeni shumë mirë që ka shumë të tillë që t'iu jepet "suport" atyre në fshat që kanë nevojë dhe që janë të varfër ashtu siç e potencoj drejtori e që është në dijeni shumë mirë për ata që kanë nevojë, prandaj e thash që nëse do të veproje ashtu do të përkrahja, dhe për këtë temë nuk hyhet në ngjyra politike.
**znj.Arjeta Abazi**, theksoi, dëshiroj të kthehem sërish tek rasti i asaj vajzës që u përmend më herët me emër e mbiemër dhe që u sqaruam, por që fillimisht do të kërkoja që kushtet materiale të mos përmenden këtu publikisht me emër e mbiemër sepse ajo vajzë mund të ndihet keq. Mandej nuk do të doja të pranohet në një drejtim të caktuar një vajzë për hir të asaj se është "gjynah" dhe nuk i ka

kushtet ngase sigurisht që kanë qenë kushtet dhe kriteret e caktuara të aplikimit dhe e njëjta ka mundur të shkoj në një drejtim tjetër të caktuar të cilin ka munduar ajo ta arrit.
Kështu ka ndodhur edhe me bursat e studentëve, e që mendoj se nuk duhet të ngatërrohen rastet sociale me bursa apo me regjistrim në një drejtim të caktuar siç është rasti në fjalë ku dikujt i pëlqen mjekësia dhe duhet të dërgohet patjetër duke u thirr në atë se është "gjynah". Pra nuk e njohë atë vajzë dhe atë familje, por mua nuk po më duket në rregull që së pari të përmenden kushtet sociale e mandej të thuhet e dërgova atje sepse ka qenë në listë të pritjes dhe se është "gjynah" e që secili prej neve do ta bënte ashtu, mirëpo po t'iu hymë "gjynaheve" mendoj se ka shumë "gjynahe' dhe shumë parregullsi, por do të doja të shkohet në mënyrën e drejtë e që edhe do të duhej të shkohej.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, lidhur me atë që drejtori i Drejtorisë së Arsimit e tha se kam ngritur komisionin i cili i ka dënuar disa mësimdhënës, dua ta di se a është detyrë e këtij drejtori të ngritë komision i cili pastaj shkon edhe dënon atje me dosllaki sikurse në "partinë e punës" , apo është komision i shkollës që e cakton dhe e voton shkolla si komision për dënime dhe jo dënime.
E them këtë se drejtori në fjalë i ka dërguar disa letra atje në atë shkollë me nënshkrime e me vulë false e të cilat pastaj ka shkuar dhe i ka tërheqë, por që t'ia lëmë prokurorisë e cila është duke u marrë me këtë rast, mirëpo qysh dhe pse ky drejtor të formoj komision duke u bazuar në atë se i ka pas koleg deri tani dhe ka punuar me ata mësimdhënës kurse tani ata që i ka më shokë i qet në komision dhe t'i dënoj ata tjerët që nuk e kanë dëgjuar drejtorin, nuk shkon kjo punë kështu.
Pra është komisioni i shkollës, përse ky drejtor të bëjë komisione.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, formimi i komisioneve rregullohen me procedura ligjore dhe Drejtoria e Arsimit duhet të ketë komisionin disiplinor dhe atë të ankesave, ndërsa komisioni që u përmend nga parafolësi duhet të bëhet pikërisht brenda shkollës me këtë Rregulloren të cilën e refuzonit ju disa dhe e cila i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe që është vendim zyrtar se e njëjta është brenda kornizave ligjore. Çështjen në fjalë nuk e kemi bërë me inat sepse aty kanë qenë edhe profesor të subjektit të LVV-së, kështu që nuk ka të bëjë diçka me dallime, por për fat i kanë thirrë vetë ejani shikoni gabimet dhe i'a pafshin hajrin. Pajtohem me asambleisten parafolëse se nuk duhet të potencohet dikush me emër e mbiemër, por po më vie keq që atë e ka përdoruar partia juaj, për fat të keq ka qenë ajo e para që e ka publikuar dhe për këtë e them sepse jam i informuar në detaje. I vetmi gabim ai asaj nxënëseje ka qenë që nuk ka bërë kërkesë për transferim, dhe nuk ka shkuar ajo në atë drejtim për shkak të "gjynahit" sepse po të mos ishte në listë të pritjes, kushedi kush dhe çka po të, ishte nuk do të mund të hynte aty. Vendimin e ka marrë drejtoresha e ndjerë që ka qenë e asaj shkolle, dhe mendoj se ka marrë vendim të drejtë sepse nuk ka bërë dallime, i ka marrë gjithë ata që kanë qenë në listë të pritjes e që Ligji e mundëson që klasa mund të rritet deri në 32 nxënës por jo më shumë, e ajo drejtoresh i ka marrë dhe i ka shpërndarë ata 8 nxënës/e që kanë qenë në atë listë e që në mesin e tyre ka qenë edhe nxënësja në fjalë e që as kjo e as të tjerat nuk kanë bërë kërkesë, prandaj krejt këto i kanë bërë një grup i ish pastrisë time të cilët deshtën ta bëjnë politike këtë çështje, por për fat të keq, u munduan, e benën por sërish në dëm të nxënëses sa për ti dalë emri e mbiemri, e që t'ju them të drejtën unë edhe emrin kur e kam përcjellë në atë kohë e kam ngatërruar e kam shkruar "Dafina Zeqiri" sepse nuk është që e kam njohur.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i them drejtorit se ka aty mësimdhënës që janë dënuar për mos notim atë nxënëse por ka që janë dënuar edhe që e kanë dënuar dhe dënimet i kanë marrë të njëjtë, andaj tani shtrohet pyetja ai komision cilin dënim e ka hënë me të drejtë e cilin pa të drejtë. Unë i njohë të paktën dy persona ku njëri prej tyre është dënuar që nuk e ka notuar atë nxënëse e që ti drejtor pastaj ke formuar tjetër komision dhe je shkuar e je munduar që ta notosh tinëz a çfarë ke bërë e dinë ti mirë këtë, kurse tjetri mësimdhënës është dënuar që e ka notuar atë nxënëse, andaj tani dëshiroj ta dijë se cili dënim është i ligjshëm.

**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, theksoi, nuk e kam marrë asnjëherë në jetë rolin e gjykatësit dhe nuk mund të përgjigjem në pyetjen e parafolësit sepse vendimet e komisionit disiplinor kanë qenë shumë të pavarura e që nuk e kam idenë se kon e kanë dënuar më shumë e kënd më pak, por ata vetëm e kanë respektuar ligjin ngase janë ankuar tek komisioni i ankesave e që ky komision sërish i ka refuzuar.
**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, pyetje për drejtorin parafolës, në fshatin Shajkoc a është ndjekur procedura e konkurrimit për një vend pune me gjuhë angleze si pozitë e që është pranuar.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, përgjigje parafolëses, theksoi, është zhvilluar procedura e konkursit dhe ajo që është pranuar aty ka qenë pjesë përbërës e konkursit, ka qenë pjesë përbërës e atij lokaliteti ku vepron dhe punon dhe realisht ku jeton e që është e martuar, mirëpo pa dashtë t'i jap ngjyrime politike e them se nuk është bash e lehtë që dikush që është duke pritur 10 vite radhazi si e diplomuar, është e atij vendi, kurse të merret në punë dikush nga një fshat tjetër dhe t'i bëhet zgjidhje atij fshati, ngase pastaj mund të krijohen konflikt. Pra ajo ka qenë pjesë përbërëse e konkursit.
**z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, edhe unë dua t'i them disa fjalë sepse kur flitet për arsim besoj se e kam përvojën e gjatë ku me 01 shtator i bëjë 35 vite përvojë pune në arsim, që do të thotë se arsimin e kam përjetuar në shumë faze, qoftë para luftës kur na kanë larguar prej shkollave por edhe pas luftës kur jemi kthyer në shkolla. T'ju them të drejtën e kem shumë për obligim të bëjmë për arsimin e sidomos ne që jemi këtu, jo vetëm të flasim por të bëjmë diçka e që t'ju tregoj tani se unë vetit i kam dhënë detyrë që të vizitoj çdo shkollë ku mbahet mësim në Llap e që një gjë të tillë do t'jua kërkoja edhe juve si anëtar të Kuvendit, e pastaj të flasim e jo sikurse tani që flasim vetëm përmes facebook.
Unë e di se ka shumë parregullsi nëpër shkolla, ka probleme e telashe të ndryshme, por ne jemi që t'i zgjidhim ato, madje vijmë nganjëherë edhe në pozita që duhet t'iu ndihmohet ndonjë nxënësi.
Nuk dëshiroj ta zgjati por është mirë të punojmë për arsim, t'i vizitojmë shkollat, dhe pastaj normal të kërkojmë nga drejtori i DKA t'i realizoj investimet dhe t'i rregulloj çdo herë shkollat dhe t'i bëjë më atraktive për nxënësit.
Problemi më i madh në shkolla është që nxënësit nuk po e dojnë shkollën, kjo është me rëndësi dhe kjo është temë, por jo nuk është me rëndësi se a po e bëjmë 1 kompjuter më shumë a më pak, prandaj e them që problemi kryesor është që t'i bëjmë shkollat e mira në mënyrë që nxënësit tanë t'i dojnë ato dhe të shkojnë me dëshirë në shkollë, andaj kjo më duket si më e rëndësishmja.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, në rend të parë i nderuar Kryesues jua kam lakminë që je Kryesues dhe po e merr fjalën sa herë që po dëshiron dhe nuk po kush t'jua matë as kohën e diskutimit e që për një pikë të rendit të ditës ke të drejtë të diskutosh aq sa kam të drejt unë si anëtar i Kuvendit, asgjë më shumë, ndërsa sa i përket përvojës tuaj të gjatë në arsim i nderuar Kryesues, në të kaluarën ka qenë një sektorë i institucioneve që ka ndarë dekorata dhe mirënjohje dhe nuk ju është ndarë në atë kohë sepse po del se nuk e ke merituar sepse përndryshe do të të ndahej edhe ty (kjo që e potencova të merret si shaka jo diçka tjetër).
Gjithashtu këtu në sallë ajri është bërë paksa i zënë dhe kemi nevojë për një pauzë të shkurtër të paktën 10 minuta me qëllim të ajrosjes sepse po shihet se edhe temperaturat janë të nxehta dhe se qe 3 orë jemi pa dal nga salla, andaj kërkoj pauzë, kujt t'i rrihet mirë, kujt nuk i rrihet të shkon mirëpo ne nuk është mirë të "dhunohemi" duke qëndruar në këtë ajër dhe kaq gjatë në sallë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, përgjigje parafolësit rreth dekoratave, theksoi, dekorata nuk kam marrë sepse asnjëherë nuk kam qenë me partinë në pushtet.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, Kryesuesi e tha se nuk ka qenë në pushtet dhe nuk ka marrë dekorata, e unë i them që tani është në pushtet dhe ta shfrytëzoj këtë duke marrë 5 dekorata dh të njëjtat t'i vendos në gjitha anët.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, për të mos marrë shumë kohë edhe unë e kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, objekti i shkollës së vjetër në fshatin Sfeqël që është shumë i dëmtuar qoftë brenda ashtu edhe jashtë, edhe pse sakt nuk po e di se cilës drejtori i takon, mirëpo a parashihet ridestinimi i atij objekti sepse ai tani më nuk është as shkollë sepse nuk ka asgjë në të.
Po ashtu pyetja tjetër është se a parashihet ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e fshatit Sfeqël sepse është një ndër shkollat e mëdha në Komunën e Podujevës e cila nuk ka sallë të brendshme të edukatës fizike.
**z.Avni Fetahu**, U.D. drejtor i DKA, përgjigje parafolëses, theksoi, objekti në fjalë i ish shkollës në fshatin Sfeqël i ka dy alternativa. Kemi pasë një Organizatë e cila ka shpreh gatishmëri që atë objekt ta bëjnë një qendër rinore mirëpo nuk kemi mund të arrijmë deri në finalizim, është një opsion për të mund të shndërruar në Çerdhe me investime konkrete. Ndërsa sa i përket sallës së edukatës fizike, për këtë vit nuk ka planifikim mirëpo për vitet në vijim prioritet është të krijohen salla të mbyllura të edukatës fizike për shkak të motit që mbizotëron në Kosovë sepse është e pamundur ta realizojnë plan programin profesorët e edukatës fizike me këtë gjendje çfarë e kanë, pra prioritet i kemi mirëpo ta keni parasysh se ato kërkojnë edhe investime, por fillojmë me shkollën "Enver Maloku" për të vazhduar me shkollat tjera.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, diskutimet për këtë pikë të rendit përfunduan, shkojmë në pauzë 10 minuta.

*Pas kërkesave për një pauzë të shkurtër me qëllim të ajrosjes së sallës, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë për 10 minuta, përkatësisht deri në ora 16;00.*

*Pas pauzës prej 10 minutave, Kryesuesi i Kuvendit vazhdon mbledhjen duke konstatuar kuorumin ku në sallë aktualisht prezent janë 21 anëtar/e të Kuvendit.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, siç jeni në dijeni në mbledhjen e mbajtur një ditë më parë të KPF-së janë shtuar edhe 4 pika të rendit të ditës, 3 prej tyre me propozimin e drejtorit të drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, dhe 1 pikë me propozimin e anëtares së Kuvendit znj.Mrika Thaçi, kështu që vazhdojmë me shqyrtimin tyre sipas konstatimeve të rekomanduara nga KPF.
Pra për pikat në vijim janë pika të ngjashme dhe kanë të bëjnë me projekte të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht me financat e projekteve përkatëse, andaj fjalën do t'ia kaloja drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth rregullores së punës së kuvendit, pikat e shtuara nuk u adresuan që të marrin vendin aty ku duhet si pika të para pasi që ishin pika shtesë të propozuara për seancën, dhe tani jemi në një situatë ku deri tani Kryesuesi i Kuvendit punoj sipas rendit të ditës ashtu siç e ka pasë të propozuar dhe pikat shtesë i la në fund, shtrohet pyetja, përse tani këto pika po vë para pikës Të Ndryshme, meqë veç fillove kështu i nderuari Kryesues.

8. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin "Furnizimi dhe montimi i serrave".**

9. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin "Furnizimi me mekanizëm bujqësor".**

10. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri, për projektin "Furnizimi me mëshqerra"**

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF-së, paraqiti fjalën hyrëse rreth tri pikave të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, me qëllim që të mos e marrë fjalën tri herë dhe që të dinamizojmë punën për këto tri propozim vendime për shtim të buxhetit në tri projekte të fushës së bujqësisë sipas propozimeve përkatëse, projekte të cilat normalisht janë prokuruar nga Komuna  Podujevës mirëpo marrin pjesë edhe fermerët përfitues me një shumë buxhetore participim 30% të vlerës së projektit, dhe asnjëherë këto participime nuk kanë kaluar përmes Kuvendit të Komunës por janë ndjekë procedurat përmes rregullores së subvencioneve, është bërë participimi dhe është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm, është dërguar në Ministrinë e Financave e cila ato mjete i ka alokuar mjetet financiare nga participimi dhe në fund është bërë pagesa Operatorit Ekonomik që ka fituar tenderin për projektet përkatëse, mirëpo këtë vit Ministria e Financave na ka obliguar që pjesën e participimit të buxhetit nga participimi i përfituesve të kaloj përmes Kuvendit të Komunës me vendim, e që siç e ceka kemi tri propozim vendime të cilat po besoj keni mund t'i lexoni dhe analizoni, ku shuma e participimit me 30% të vlerës së projektit në këtë rast shuma për projektin e furnizimit me mëshqerra është 60,588.00€, pastaj për projektin furnizim dhe montim i serrave shuma e participimit është 36,236.8€ si dhe për projektin e furnizimit me mekanizëm bujqësor 36,141.00€, prandaj ju ftoj t'i mbështetni këto bartje nga participimi i qytetarëve sepse përndryshe pastaj kemi problem në realizimin e këtyre subvencioneve në fushën e bujqësisë.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, propozimet e këtyre tri vendimeve për shtim të buxhetit me kod të ri buxhetor si praktikë e re e ndërhyrjes në buxhetin e Komunës dhe baza ligjore në të cilën janë thirr këto propozim vendime më jep mendimin tim dhe Grupit të anëtarëve të LDK-së si dhe pas konsultimeve që kemi pasë edhe me njerëzit e lëmisë përkatëse në Grupin tonë, bazën ligjore nuk e shohim që e mundëson një aktivitet të tillë çfarë po kërkohet, aktivitet i cili bënë ndërhyrje gjegjësisht rritë buxhetin e Komunës e që po t'i grumbullosh këto tri propozim vendime reflekton mbi 132,965.00€.
po mundohem që shkurtimisht të lexoj atë në çfarë është bazuar, me qëllim që ndokush të thotë se diskutimi im ishte krejt përmendësh, dhe atë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bazë të nenit 13 pika 1.1 e Rregullores së MAPL-së për hartimin dhe publikimin e akteve të komunës, tani kjo Rregullore faktikisht nuk ka të bëjë me buxhetin asgjë sepse është ligji përkatës për buxhetin dhe për menaxhimin e bushtit qoftë të nivelit lokal qoftë të atij qendrorë, dhe të marrësh për bazë një Rregullore të MAPL-ës për ta proceduar një vendim të tillë dhe të bazohesh në nenin 13 pika 1.1, për mua dhe për mendimin tim e Grupit të LDK-së është jo në rregull.
Po ashtu po e citoj një nen tjetër të rregullores së cekur për të treguar se si bëhet një akt i Komunës, përkatësisht nenin 14 i asaj Rregulloreje sepse natyra e kësaj është nxjerrja e akteve të komunës dhe procedurat e dërgimit deri në fund, ndërsa ne kemi propozim vendime që kanë refleksion buxhetor, pra neni 14 i Rregullores së cekur e thotë dhe cakton, proceset e hartimit të akteve komunale, hartimi i projektit fillestar, për të qenë në rregull një akt komunal duhet t'i kaloj edhe këto procedura, e që

caktohen proceset e hartimit të akteve komunale hartimin e projektit fillestar, konsultimin e brendshëm të autoriteteve lokale, vlerësimin e ndikimit financiar të aktit të propozuar, vlerësimin e projektit pas konsultimeve, pastaj konsultimi publik parasheh forma shtesë të konsultimeve me shkrim dhe elektronik në intervista, panele dhe forma tjera siç janë publikimi i projekt aktit në tabelën e shpalljeve, ueb faqen e komunës, gazetë, takim me grupe të interesit dhe takim me qytetar, mandej finalizimi i projekt aktit pas marrjes së komenteve nga konsultimi publik, miratimi në Kuvend. Do të thotë pasi t'i kalon këto faza duhet të sjellët në Kuvend, a kemi ne këtë jo, a po thirremi në këtë po, prandaj nuk e di se si mund të thirremi në një diçka që thotë diçka tjetër.
Po vazhdoj tutje sepse propozimet në fjalë thirren edhe në Ligjin për vetëqeverisje lokale, dhe tani çka përcakton ky ligj dhe në këto nene që janë bazuar këto propozim vendime, neni 11 aktet komunale, Kryetari i Komunës ka të drejtë të miratimit të akteve dhe të ndërmarr masa për zbatimin e tyre brenda fushës dhe kompetencës, a e kemi këtë propozim prej Kryetarit të Komunës, jo, dhe nuk po dëshiroj t'ju lodhi më shumë, mandej është neni 12.2 ku thuhet çdo akt tjetër i nevojshëm apo i duhur për funksionimin efikas të komunave, pastaj kemi nenin 40 funksionimi i Kuvendit të Komunës, do të thotë ka të bëjë me funksionalitetin e Komunës e jo me ligj mbi menaxhimin.
Tani po referohem bazë ligjore që thirren këto propozim vendime e që është ligji për menaxhimin e financave publike, neni 64.4 dhe neni 17 i cili parasheh shpenzimin e parave publike, fundja a janë këto para publike përderisa kemi kërkuar si donacion, mandej neni 38 i cili rregullon pagimin e prioriteteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore, prejardhja dhe rishqyrtimi, e që do të thotë se krejt bëhet fjalë për hartimin e buxhetit.
Për e përmbylli me këtë se duke pasë për bazë këto që i ceka, nenin 2 të propozim vendimeve, ku takstativisht thuhet, *projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit mes Komunës dhe përfituesit të subvencionit*, shtrohet pyetja, a kemi ne të bashkëngjitur një Memorandum të tillë që ka ndodh.
Pa dashur të dal në anën politike, kjo për mua dhe për mendimin e njerëzve tanë të fushës lë shumë dyshime që jemi duke bërë një diçka, gjegjësisht që jemi duke marrë një vendim që është kompatibil me ligjet në fuqi, madje në një formë unë e kam lexuar se kjo çështje është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, dhe në nenin përkatës të Rregullores së cekur që jeni thirr, është vërtetë që Kryetari i përcakton Drejtoritë, mirëpo për akte tjera i përcakton ashtu siç përcaktohet në nenin përkatës që e lexova më parë, andaj krejt kjo na bënë, jo me qëllim të pengimit dhe madje ndoshta më lehtë do ta përkrahnim që participimi i qytetarëve në subvencione të mos ndodhte fare por të realizohen projektet, se sa të hymë në këtë formë të realizimit të projekteve me bashkëfinancim.
Grupi i anëtarëve të LDK-së, me qëllim që të mos jetë kundër, abstenon për këto propozim vendime dhe atë duke u bazuar në parimin 1 duke konsideruar se nuk kanë mbështetje të mirëfilltë ligjore.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, dua ta pyes drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, rreth çështjes së participimit, shembull tek rastet kur përfituesit janë në skemën sociale dhe janë njerëz që mund të mos kenë asnjë të ardhur e që shembull tek projekti për Mëshqerra është dashtë t'i japin ata 500 - 600€ nëse nuk gaboj si participim, ku t'i marrin ata persona ato shuma të mjeteve, prandaj pyes se a lejohet me ligj që këto raste që vërtetë janë të rënda dhe që nuk kanë asnjë të punësuar dhe që nuk kanë mundësi të participojnë, a ekziston mundësia e lirimit të kësaj kategoria nga participimi. E them këtë sepse nuk mund të jetë njëjtë një fermer i cili shembull mund t'i ketë 15 lop e që edhe një e merr subvencion dhe i bënë 16, sikurse një person i cili është në gjendje jo të mirë financiare e që ndoshta i ka bërë me mund 2-3 lop , dhe tani njëjtë të participojnë me 500 – 600 €.
Nuk jemi kundër kësaj dhe çdo gjë që është në të mirën e qytetarëve duhet të përkrahet, mirëpo çdo herë duke marrë parasysh personat që janë me gjendje të rëndës ekonomike dhe sociale ngase 30% e shumës për një Mëshqerrë e cila kushton rreth 2000€ është goxha shumë e madhe, sikurse që kemi

rastin edhe tek Serrat e që sa jam në dijeni unë është dashtë të shtyhet afati i aplikimit sepse nuk ka pasë kërkesa të qytetarëve për serra e që në pamje të parë duket si projekt i dështuar, dhe që mendoj se Drejtoritë përkatëse duhet të fillojnë të mendojnë për projekte tjera sepse siç po shihet shembull tek projekti i serrave nuk ka interesim, nuk janë profitabile dhe normal pastaj peronat po ikin nga këto. E them këtë edhe përkundër punës së mirë të drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rurar e që çdo herë e potencoj se këtë Drejtori e vlerësoj me notën 10.
**z.Bahri Blakçori**, theksoi, besoj se drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e arsyetoj jashtëzakonisht shumë mirë këtë, prandaj në emër të Grupit të LVV-së përkrahim këto propozim vendime për shtim të buxhetit dhe kod të ri për këto tri projekte sipas propozimeve përkatëse.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, mund të procedojmë me votim.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, nuk mora përgjigje nga drejtori, dhe kërkoj që para se të hedhet në votim, të më jap përgjigje për pyetjen që e shtrova paraprakisht që ishte për disa persona me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale të mos e bëjnë pagesën e participimit prej 30%.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF-së, përgjigje parafolësit, theksoi, në thirrjet publike për këto projekte nuk është paraparë lirimi nga participimi, do të thotë se të gjithë përfituesit e këtyre subvencioneve janë të obliguar të participojnë, prandaj meqë nuk janë paraparë në thirrjet publike tani në këtë fazë që jemi nuk mund të lirojmë askënd nga participimi.
Për vitin e ardhshëm mund të diskutojmë këtë çështje që rastet e caktuara të lirohen, mirëpo ato duhet të parashihen në thirrjet publike, përndryshe do të bëheshin shkelje në hapa.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë diskutimet përfunduan dhe nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, i vë në votim një nga një propozim vendimet përkatëse sipas pikave 8, 9 dhe 10 të rendit të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 11 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe 9 vota të PËRMBAJTURA, miratohet* ***propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim dhe montim i serrave",*** *sipas materialit përkatës të paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe dërguar me konstatimet e rekomanduara.*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 13 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe 8 vota të PËRMBAJTURA, miratohet* ***propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësorë",*** *sipas materialit përkatës të paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe dërguar me konstatimet e rekomanduara.*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent aktualisht në sallë, me 12 vota PËR, asnjë votë Kundër dhe 9 vota të PËRMBAJTURA, miratohet* ***propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim me mështerra",*** *sipas materialit përkatës të paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe dërguar me konstatimet e rekomanduara.*

## 11. Diskutim lidhur me furnizimin me ujë të pijes

**znj.Mrika Thaçi**, në cilësinë e propozueses së kësaj pike të rendit të ditës, e paraqiti fjalën hyrëse. Ndër të tjera theksoi, unë po nisem nga thënia, uji është jetë dhe nisur nga kjo thënie nuk do të thotë se i ke thënë të gjitha. Sot po flasim për furnizimin me ujë, respektivisht për mungesën e furnizimit me ujë të pijes. Në këtë kohë të recesioneve të shumta të krijuara nga situatat t'i quaja globale si pandemia Covid-19, lufta në Ukrainë si më të theksuarat, reflektuan në ngritjen e çmimeve të produkteve bazë si të energjisë, naftës, miellit, vajit, produkteve higjienike si gjenerator të ngritjeve zinxhirore të çmimeve të shportës së domosdoshme për jetë, tani shto kësaj edhe mungesën e ujit në temperatura të larta të stinës së verës, në kohën e ardhjes së bashkatdhetarëve në vendlindje, mungesa e ujit e ka rënduar së tepërmi jetën dhe mirëqenien e qytetarëve në Komunën tonë. Vështirësitë në furnizim me ujë, reduktimet pa kriter, pa kurrfarë konsultimi me qytetarë, thënia uji është jetë na shpie në konkluzion se vërtetë na është krijuar një jetë aspak e mirë për jetë të dinjitetshme, vërtetë gjendje e rënduar. Dje në mbledhjen e KPF-së propozova që në këtë seancë të Kuvendit ta trajtojmë mungesën e furnizimit me ujë të pijes në Komunën tonë si pikë të veçantë të rendit të ditës. besoj se duhet trajtuar me urgjencë dhe konform nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Andaj të nderuar kolegë bashkërisht të shohim mundësitë për të bërë sa do pak në kuadër të kompetencave dhe mundësive tona. Fundja ne jemi të thirrur dhe kompetentë për adresimin e nevojave dhe shqetësimet e tyre. Na obligon besimi i marrë dhe zotimi ynë në përfaqësim, të adresojmë çështje dhe të kërkojmë zgjidhje. Unë besoj shumë dhe pres përkrahjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit që ta trajtojnë problemin e furnizimit me ujë të pijes në Komunën tonë.
**znj.Arjeta Abazi**, theksoi, desha të ndërlidhem me pikën e rendit të ditës të cilën e ka propozuar dje në mbledhjen e KPF-së znj.Mrika Thaçi. Vërtetë është shqetësuese dhe është e papranueshme që çështjet elementare si puna e furnizimit me ujë të pijes të futet në rend të ditës pas kohës. Kjo tregon për seriozitetin me të cilën e trajton qeverisja lokale një temë e cila është vitale për qytetarin. Paramendo sot qytetarët e Komunës së Podujevës, veçmas ata që jetojnë në qytet por edhe në fshatrat përreth në gjithë këtë vapë përballen çdo ditë me reduktime të mëdha të ujit. Kjo bëhet akoma më shqetësuese kur i shtojmë faktin që ka familje, sidomos ato që jetojnë në ndërtesa kolektive që të vetmin burim e kanë ujësjellësin. Megjithatë në këta muaj të verës kur rriten nevojat dhe konsumi mund të arsyetohet ndonjë reduktim eventual, por i pa pranueshëm është fakti që në shumë pjesë të qytetit reduktime ka pas edhe gjatë muajve të kaluar, do të thotë edhe gjatë muajve maj dhe qershor. Kjo është papërgjegjësi e Kompanisë së Ujësjellësit në rend të parë por edhe e Komunës që nuk i ka koordinuar angazhimet e përbashkëta për të siguruar furnizim të rregullt, sidomos në sezonin e verës kur edhe mërgata jonë gjendet në vendlindje. E di se do të thoni se investimet në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit nuk janë kompetencë e jona por e Kompanisë por e di se kështu ka qenë edhe më parë, kur në debatet publike dhe takimet me qytetarë premtoni zgjidhje të problemit të furnizimit me ujë, madje brenda një viti të mandatit që shkoi. Duke mos dashur që ti jap kahje politike çështjes jetike siç është uji, dua të shfrytëzoj rastin dhe të ju ftojë për rritje të koordinimit dhe të angazhimeve të përbashkëta, në mënyrë që sa më shpejtë të sigurohet furnizimi i rregullt me ujë për qytetarët e Podujevës. Ne si Grup i LDK-së do të jemi në mbështetje të secilës iniciativë në këtë drejtim.
**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, edhe ne ndajmë së bashku këtë shqetësim, mungesën e ujit të pijshëm. Vërtetë është temë e ndjeshme dhe duhet diskutuar, por se sa ky diskutim do të ketë peshë dhe rëndësi besoj se gjithsecili nga ju jeni në dijeni, por edhe nëse nuk keni njohuri të mjaftueshme besoj se do ta kuptoni se ujësjellësi është në kompetencë të KRU "Prishtina". Kur e theksoj si kompetencë, nuk

nënkupton se duhet ta heqim përgjegjësinë tonë. Unë do ju informoj për hapat që ka ndërmarrë Komuna në vazhdimësi në funksion të sigurimit të ujit të pijshëm. Në periudhën e fundit gjashtë mujore kemi mbajtur gjashtë takime me zyrtarë të KRU "Prishtina ", dhe nga ato takime pesë janë zhvilluar direkt me Kryeshefin Ekzekutiv të Kompanisë së cekur. Këto takime kanë pas për qëllim që të bëhet një koordinim më i mirë në mes KRU "Prishtina" dhe Komunës dhe në të vërtetë ka pas koordinim dhe vullneti që të bëhet furnizimi me ujë ka qenë i dyanshëm, por problemet nuk vijnë si rezultat i punës së Kompanisë. Në bazë të statistikave që ne i kemi marrë në këto takime kemi ardhur në përfundim se rrjeti që shtrihet nga Ujësjellësi në fshatin Shajkoc të ujit deri te rezervarët e ujit te parku ka humbje të mëdha, madje është konstatuar se janë mbi 70% e humbjes së ujit.
Kjo nënkupton sasi e madhe e ujit që humbet si rezultat i kyçjeve ilegale dhe rrjedhave të pakontrolluara dhe të paidentifikuara të ujit dhe këtë e kemi vërtetuar. Ne kemi bërë një inspektim të përbashkët me Kompaninë e ujësjellësit për të bëtë identifikimin e këtyre, megjithatë Kompania ka mungesë të pajisjes/aparatit për identifikimin e ujit. Shprehjen keqpërdorim e ujit e them me keqardhje sepse nuk do të doja ta përmendja, mirëpo të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa i rëndësishëm është uji, sepse të gjithë jemi banorë të këtij vendi dhe konsumues të këtij burimi të ujit. Ju mund ta vëreni se kur ka reshje shiu të mjaftueshme dhe kur nuk kemi nevojë për ujitje nuk ka reduktime të ujit. Kjo nënkupton që uji nga rrjeti i ujësjellësit keqpërdoret për ujitje, dhe ky konstatim është më se i saktë. Gjatë takimeve të mbajtura me Kompaninë e ujësjellësit, Kompania në fjalë e ka autorizuar një inxhinier të KRU-së që të merret vetëm me Podujevën, sa i përket kësaj çështjeje. Pra fjala është të bëhet identifikimi i kyçjeve ilegale dhe të krijohet një mundësi për furnizim më të mirë të ujit. Ne si autoritet komunal në bashkëpunim dhe koordinim me zyrtarin e cekur i kemi ndjekë të gjithë hapat që mund të vie deri te ulja e reduktimeve, sa që kemi vizituar edhe Ujësjellësin dhe nga aty u konstatua se rrjedhin $80m^3$ ujë për sekondë gjë që është e mjaftueshme për furnizim të qytetit, por në rezervuarët e ujit të qytetit shihet se ata janë nën minimumin e sasisë së ujit dhe në këtë rast gypi i cili bënë furnizimin me ujë i qytetit, ai është i mbushur me vetëm 30% të sasisë së ujit me të cilin furnizohet qyteti. Dhe si përfundim, si rezultat i këtyre gjashtë muaj angazhimesh për rregullimin e kësaj çështjeje na është thënë se është një projekt ka një kohë dhe i cili është ndërprerë për arsye të ndryshme që një operator ekonomik i ka pas për furnizim të gypit dhe fatmirësisht edhe pas presionit që i ka bërë KRU-ja, dhe presionit nga ana e Komunës, e që Kryetari në këtë çështje ka qenë shumë i përkushtuar për të bërë zgjidhje, tashmë veç se e keni parë se ditën e djeshme kanë filluar punimet për vendosjen e gypit të ri në gjatësi prej 2 km, i cili do ta ketë kyçjen te "Lagja e Dëshmorëve" për furnizimin e rezervuarit të qytetit, rezervuar i cili ka kapacitet për $3000m^3$ ujë e që i ka edhe dy rezervuar ndihmës me kapacitet me nga 1500 m3 ujë. Gypin e ri kemi filluar ta vendosim që dje bashkë me KRU-në, e që është financim nga CDI apo Zyra Zvicerane. Edhe këtë verë mendoj se do ta kemi gjendjen e njëjtë sepse mundësi të tjera nuk ka. Sa i përket shtrirjes së gypit falë bashkëpunimit të mirë të qytetarëve kemi arritur të dakordohemi të mos kemi asnjë problem gjatë procesit të vendosjes së gypit dhe shpresojmë që në afatin sa më të shkurtër kohor do të vendoset gypi dhe furnizimi me ujë do të jetë i mjaftueshëm. Në koordinim me KUR kemi ardhur në përfundim pjesa ku edhe kanë filluar punimet për vendosjen e gypit të ri është pjesa e cila ka shkaktuar humbjen më të madhe të ujit. Unë ju falënderoj që ngritët këtë temë, sepse sikurse theksova në fillim ky ka qenë edhe shqetësim i ynë sepse bashkë ndjejmë dhe të gjithë bashkë këtu po jetojmë, pra edhe për ne po ka reduktime, e jo vetëm për ata qytetarë që janë duke na dëgjuar. Me shpresën që së shpejti do të bëhet një zgjidhje dhe nuk do të ketë më reduktime, ju bëjmë thirrje për mos keqpërdorimin e ujit të pijes, t'i ndalim këto keqpërdorime dhe të zbusim të paktën 70% të keqpërdorimit të ujit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, furnizimi i qytetit të Podujevës me ujë është një problematikë e gjatë kohore, në vazhdimësi është folur shumë se do të bëhet zgjidhje, do të mundohen për zbutjen e problemit të furnizimit me ujë. Nuk kisha dashur të keqkuptohem nga Drejtori i DSHPMSH por ne nuk jemi këtu për të konstatuar situata se çfarë është gjendja. Konstatimin e situatave e bëjnë më së miri vet qytetarët të cilët ballafaqohen me problemin e ujit. Këtu deri sa të trajtohet si temë dhe si pikë e veçantë, në këtë rast në Kuvendin e Komunës , ne do të jemi ata që duhet t'i japim zgjidhje, e jo të konstatojmë situatë. Një pjesë e mirë e juaja e dini që kjo problematikë përmendet më së shumti në kohën e fushatave, sepse e dinë që është një problem dhe dukuri që më së shumti e mundon qytetarin. Pa qëllim për të bërë fajtor kryesor Komunën në këtë rast, mirëpo Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si adresë e parasheh Komunën dhe thënia që nuk është kompetencë e Komunës nuk qëndron sepse Ligji në fjalë këtë e parasheh si kompetencë të Komunës, citoj: "Neni 17 pika f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin..." .
Në fazën e fillimit të funksionimit si shtet kur kemi pas menaxhimin nga OKB, gjegjësisht shtylla IV e UNMIK-ut që atëherë ndoshta me qëllimin janë krijua këto kompanitë regjionale, por kompania regjionale është edhe kompani e jona, sepse ne kemi në ato kompani asete dhe anëtarë të komisioneve. Në fund të fundit duhet ti dalim zot vetes sepse komplet ai furnizim bëhet përmes Komunës tonë ndërsa jemi një prej komunave që kemi furnizimin më të rëndë me ujë, dhe në anën tjetër t'i furnizojmë pesë komuna, çështja është se problemin duhet zgjedhur tani autoritetet tona, dhe ky nuk është problem i tanishëm. Në projekt buxhetet tona çdo vit kemi pothuajse shifra të larta të investuara në furnizimeve me ujë për qytetarë, dhe çfarë ndodhë, ato asete kalojnë drejtpërsëdrejti në menaxhim të KUR "Prishtina". Në një formë kisha dashur të bëhen përpjekje dhe të ngritet zëri konform hises që e kemi në kompaninë e furnizimit me ujë dhe Komuna e Podujevës duhet të trajtohet me prioritet në këtë. Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Shajkoc, qysh atëherë është paraparë një gyp jo i mjaftueshëm për furnizimin me ujë për komunën dhe ka pas si alternativë puset në fshatin Peran, këtë kështu e kam lexuar. Nëse në atë kohë janë lypë alternativa dhe nëse ne një farë forme jemi të pamundësuar për ndikim në KUR, që dua të them se duhet të shtojmë përpjekjet me qëllim që të marrim vendin meritor atëherë nuk guxojmë të mjaftohemi me atë që është kompani regjionale dhe kështu trajtohemi. Fundja ligji na obligon që ne të bëjmë përpjekje për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm dhe në një të ardhme të afërt, e pse jo edhe prej tani që u ngrit ky shqetësim mundohemi ti shohim alternativat e mundshme për furnizimin e qytetarëve me ujë. Ne gjithherë kemi pas në programet e tona alternativa, duke e ditur gjendjen dhe këto alternativa gjegjësisht këto premtime që i kemi dhënë për furnizim me ujë për qytetarin e Komunës së Podujevës, kështu që po të ishin angazhuar alternativat kishte për të qenë një tjetër gjendje. Ne kemi një burim të ujit që vjen nga fshati i propozuesit, ku janë mbledhur edhe mjete dhe që nga ajo ditë janë në buxhetin e Komunës, dhe e tëra kjo duke neglizhuar. Është koha e fundit dhe po apelojmë të mundohemi të bëjmë atë që është në kompetencën tonë, fundja t'i reduktojmë investimet kudo qofshin dhe të investojmë aty ku është më e rëndësishme, në këtë rast për ujë të pijes.
**znj.Marigona Lahu**, **Nënkryetare e Komunës**, theksoi, çështja e ujit të pijshëm është shqetësuese edhe për mua, sepse si banore e qytetit nuk mbaj mend verës kur kemi pas ujë pa reduktime. Jam tridhjetë e një vjeçare dhe tërë këto vite gjithherë verës kemi pasur reduktime të ujit. Sa i përket aspekteve teknike veçse e sqaroi Drejtori i DSHPMSH z.Bahri Selimi, por çka më bëri të dal dhe të reagoj është diskutimi i zotëri Çunakut. Sikurse jeni në dijeni, tash KRU "Prishtina" ka një bord të ri i cila nuk ka më shumë se një muaj që është zgjedhur dhe nuk e di sa keni qenë në dijeni se Komuna e Podujevës ka pas një përfaqësues në Bordin e KRU-së dhe sa ka qenë përfaqësuesi i Komunës i angazhuar nuk jam në dijeni. Po besoj se Bordi i ri do të ketë fokusin te çështja e ujit të pijshëm.

Gjithashtu fokus te çështja e ujit ka edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Fatkeqësisht Kosova është një vend i cili nuk ka burime të mjaftueshme ujore dhe për këtë arsye jo vetëm Komuna e Podujevës por të gjitha komunat kanë probleme me ujin e pijes. Nga ajo që kam dëgjuar, Qeveria është në negociata me Bankën Botërore për financimin e një sistemi të ujitjes i cili besoj se do të ndikojë në parandalimin e këtyre keqpërdorimeve që bëhen nga ana e qytetarëve tanë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kur thuhet 70 % uji humbë është me të vërtetë shqetësuese, por a duhet të ndalemi dhe të shikojmë kah humb uji, a duhet të ndërtohen kapacitete dhe autoritete për luftimin e atyre dukurive, apo të mbetet në ndërgjegje të çdo kujt. E di se nuk është lehtë për ta bërë, sepse natyra e ujit dhe tubacioneve që kalojnë është e tillë, mirëpo ne duhet të shtojmë përpjekjet tona. Atë që dëgjova prej Nënkryetares veç se e theksova në fillim, se ne e kemi hisen në KRU dhe çfarë bëjnë personat e caktuara për të mbrojtur interesat. E kemi rastin e Prishtinës, ndërtuan ujësjellës të ri prej furnizimit të sistemit Ibër Lepenc, shtrohet pyetja a ka ndryshuar diçka për Komunën tonë. Po të kishim një angazhim ndryshe besoj që edhe me krijimin e alternativave, në veçanti duke luftuar dukuritë negative të keqpërdorimeve të ujit të pijes. U fol për inspeksionin e Kompanisë, por ne kemi edhe inspeksionin komunal dhe kemi rregulloren për ndëshkimin e keqpërdorimeve të ujit dhe duhet ti vejmë në funksion të gjitha këto për një furnizim më të mirë me ujë. Duhet të veprohet.

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, pajtoj me konstatimet për gjendjen e rëndë të furnizimit me ujë të pijes. Kjo gjendje nuk është krijuar sot por ka njëzet vite. Ne e dimë që kemi probleme me ujë të pijshëm. Unë vij prej një fshati që kemi ujësjellësin ka pesëmbëdhjetë vite të cilin e ka ndërtuar pas lufte organizata CDF, por fare s'kemi pas ujë. Po ashtu kemi puset e që janë në fshatin Obrançë e jo në fshatin Peran siç u theksua, megjithatë prapë nuk kemi ujë, ky është realiteti. Ka qenë një projekt te Vrella e fshatit Revuçë dhe ka dështuar. Projekti për vendosjen e gypit të ri sikurse e përmendi Drejtori i DSHPMSH, mendoj se plani dinamik prej 240 ditë që të realizohet projekti është një periudhë e gjatë kohore, është dashur një kohë më e shkurtër, ky proces duhet përshpejtuar. Humbja e ujit, përkatësisht keqpërdorimi prej 70% kjo çështje duhet zgjidhur dhe ka mundësi të zgjidhet. Mund të sigurohet/blihet pajisja/aparati për gjetjen e ujërave rrjedhëse. Kështu që nëse zgjedhim problemin e 70% të humbjes së ujit, atëherë do të bëhet zgjidhja e problemit të ujit dhe nuk do të kishim nevojë për investime tjera. Pra dua të theksoj se nuk jemi vetëm për të konstatuar por për të vepruar. Kërkesa është që Drejtoria përkatëse të merr veprimet që i takojnë, ose të sigurojë/blej një aparat dhe të angazhojë personelin në terren të konstatojnë dhe të evidentojnë keqpërdorimet e ujit.

**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, për të mos e zgjatur, ndoshta nuk u kuptuam si duhet kur ishte fjala te çështja e kompetencave. Nuk theksova se ne nuk e kemi kompetencë, por potencova që çështja e furnizimit me ujë është kompetencë e drejtpërdrejtë e KRU "Prishtina", po ashtu i prezantova të gjitha bashkëpunimet dhe koordinimet që ne si autoritet komunal i kemi zhvilluar me Kompaninë. Kjo nënkupton që ne kemi përdorë të gjitha kapacitetet tona për të ardhur deri te zgjidhja e këtij problemi. Sa i përket kompetencës, KRU ka kompetencën kryesore në këtë çështje, megjithatë ne investojmë në zgjerim të rrjetit me mjete që ndahen nga Komuna dhe që aprovohen nga ana e juaj. Pra ne investojmë në zgjerimin e rrjetit por asnjëherë këtë nuk kemi të drejtë ta bëjmë një gjë të tillë pa koordinim me KRU-në. Fjala vjen në fazën e punimeve është zgjerimi i rrjetit në rrugën " Ibrahim Demolli", aneks i rrugës " Skënderbeu" dhe projekti prej fshatit Shajkoc që vazhdon deri në rrugën tej shkolle. Pra këto janë projekte aktuale që janë në proces të punimeve. Sa i përket veprimit, unë veç se ju njoftova se kemi filluar me veprime. Që ditën e djeshme kur kemi filluar me ndërrua gypin, ky është veprimi, nuk ka pas veprim tjetër. Për sanimin e këtyre humbjeve duhet ndërruar gypin i cili përveç kyçjeve ilegale ka edhe rrjedha të shumta. Është një gyp i vjetër prej asbesti i cili u vendos në kohën e sistemit komunist dhe ai po ndërrohet

dhe po vendoset një gyp që është shumë më i mirë edhe në aspektin shëndetësor dhe po eliminohen komplet rrjedhat dhe kyçjet ilegale. E potencova se është filluar me këtë pjesën në gjatësi prej dy km dhe projekti do të vazhdoj sipas bisedimeve që kemi me KRU-në deri në Ujësjellës. Neve na mbetet që të jemi të kujdesshëm sepse në po të njëjtin gyp që po e ndërrojmë prapë mund të ketë kyçje ilegale. Inspeksioni i Komunës dhe inspeksioni i KRU së bashku kanë dalë në terren, por është problem identifikimi i kyçjeve ilegale sepse ato mund të bëhen edhe gjatë natës, sepse gypi kalon nëpër prona private dhe publike. Unë vetëm desha të ju informoj se veprimet kanë filluar dhe së shpejti qytetarët e komunës së Podujevës nuk do ta kenë më problemin e furnizimit me ujë. Megjithatë sikurse e potencoi edhe Nënkryetarja, Kosova ka mungesë të burimeve të ujit. Në këtë aspekt është duke u iniciuar edhe një projekt, sigurisht keni dëgjuar, fjala është për projektin e digës në fshatin Pollatë i cili edhe pse është shumë i kushtueshëm, niveli qeveritar veç se kanë filluar bisedimet. Ne kemi pas një takim me zyrtarë të ministrisë, kemi biseduar për këtë çështje, por kur do të fillojë është çështje që do të vendoset nga ministria përkatëse. Ky projekt konsiderohet shumë i kushtueshëm që nuk mund ta përballojë as vet Ministria, dhe intenca është që të shkohet përmes një kredie. Projekti ka për qëllim jo vetëm furnizimin me ujë për Komunën e Podujevës por edhe për shumë qytete tjera, sikurse aktualisht është duke e bërë furnizimin KUR.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, afati apo plani dinamik prej 250 ditësh për shtrirjen e gypit të ri, konsideroj se është i gjatë, pyetja është pse koha e punimeve duhet të jetë aq e gjatë.
**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, gypi i ri i cili do të vendoset është i profilit___ 650, ndërsa plani dinamik është paraparë në bazë të projektit të CDI-së dhe këtu nuk ka çasje Komuna. Në kuadër të këtij projekti është duke u bërë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit edhe për fshatin Orllan dhe po ashtu janë edhe disa fshatra tjera të Komunës siç janë Dumnica, Llausha pjesa e epërme, pra ky është projekt i vjetër dhe është në vazhdimësi nga CDI.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, duhet të jemi të bindur se me shqiptimin e tiketave me gjoba ndaj keqpërdoruesve të ujit besoj se në afatin një mujor nuk do të ketë 70% humbje të ujit por do të kthehen sigurisht në 30%. Mendoj se Komuna e Hanit të Elezit ka blerë ato pajisje/ aparatura që saktë detektojnë kyçjet ilegale. Në pjesën ku unë banojë nga gypi i ujësjellësit derdhet uji nëpër ara dhe nuk intervenon askush për ta sanuar. Pra ka ara ku vazhdimisht rrjedh uji i pijes që nuk e keqpërdorë askush por ka shpërthye gypi dhe nuk merret askush me të dhe këto në një masë të madhe janë duke ndikuar në këtë gjendje
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, besoj se kjo temë u diskutua mjaftë dhe nuk po besoj se këtu mund ta zgjedhim këtë problem. Drejtori i Drejtorisë përkatëse theksoi se kanë ndërmarrë hapat, andaj na mbetet të shohim rezultatet. Gjithashtu propozoj që nëse shihet e nevojshme të bëhet edhe blerja e një aparati për identifikimin e kyçjeve ilegale në rrjetin e ujësjellësit.
Prandaj meqë nuk ta lajmëruar tjerë për ë marrë fjalën e konsideroj të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

*(Nga Kryesuesi i Kuvendit, konstatohet i përfunduar diskutimi rreth kësaj pike të rendit të ditës, dhe njëkohësisht e përfunduar si pikë e rendit të ditës)*

## 12. Të ndryshme

**znj.Arjeta Abazi**, theksoi, në bazë të disa ankesave të qytetarëve mora fjalën rreth shtegut të biçiklistëve i cili ende nuk ka përfunduar me ngjyrosje, edhe pse sa po shoh unë nuk janë prezent në sallë personat/zyrtarët kompetentë, pra përse nuk ka përfunduar ngjyrosje e atij shtegu, si dhe përse po lejohet që ajo pjesë të shfrytëzohet për parkingje, do të thotë në atë shteg po parkohen veturat ose po anashkalohen. Çështje tjetër është se në atë rrugë ku gjendet shtegu i biçiklistëve, përkatësisht nga kafe bar 'Pranvera 99" deri tek rrethi te "Shqiponja" ku lidhet me magjistralen Podujevë-Prishtinë, brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore kanë ndodh disa incidente ku janë goditur disa fëmijë në rrugë. Prandaj këto janë ankesa të qytetarëve të cilët më kanë kërkuar ta ngris si çështje në Kuvend. Si çështje tjetër është edhe në Sheshin e qytetit ku po ka skuter, dhe pse janë caktuar rregulla nga ana e Komunës, mirëpo po zbatohen dhe po ndodh të ketë incidente të vogla e që po shkaktojnë pasiguri të madhe për fëmijët që gjinden në shesh.
Pra për këto tri kërkesa apo si çështje që i ngrita, do të doja përgjigje.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, kemi parë se ka më shumë se një vit që semaforët në rrugën "Zahir Pajaziti" nuk janë funksional dhe tani meqë rruga "Skënderbeu" është në punime atëherë po ka shumë ngarkesë në rrugën nga kafe bar 'Pranvera 99" deri tek rrethi te "Shqiponja" ku lidhet me magjistralen Podujevë-Prishtinë, madje mu tek semaforët tek rruga lidhëse po ka probleme shumë të mëdha madje edhe aksidente e që ka shumë ankesa prej qytetarëve që asaj pjese t'i bëhet një zgjidhje, ose të aktivizohen semaforët ose ashtu siç e shohin të arsyeshme ekspertët e fushës së komunikacionit në këtë rast.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, zakonisht nuk bëjë lëvdata mirëpo tani dëshiroj të bëjë një lëvdatë për z.Bahri Selimin drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit sepse kjo drejtori është me një gamë bukur të gjerë të shërbimeve, kështu që e shohë se është njëri prej drejtorëve më aktivë, dhe pyetja ime në këtë rast është se para rreth 1 muaji kemi qëndruar te Shkolla "Xheladin Rekaliu" ku në të dy anët e asaj rruge mungojnë trotuaret dhe shpeshherë nxënësit rrezikojnë etën duke lëvizur në atë rrugë, prandaj duke qenë në dijeni se më 01 shtator fillon viti shkollor a mund të presim se gjatë këtij muaji dhe muajit gusht të përfundon ndërtimi i atyre trotuareve.
**z.Gazmend Islami**, theksoi, fillimisht më vie keq që të zgjedhurit ata që i kanë marrë votat po ikin dhe nuk po qëndrojnë deri në fund, pra vetëm po nënshkruhen dhe nuk po qëndrojnë deri në fund në mbledhje si të tillë nuk po bëhen të sinqertë as me qytetarët e as me neve si anëtar të Kuvendit që po qëndrojmë në sallë më gjatë.
Meqë është hera e parë që mund të foli pak më gjatë, kam disa shqetësime për të cilat do të doja të ishte prezent këtu Kryetari i Komunës por që fatkeqësisht nuk është prezent dhe që deri në muajin shtator nuk mund të shihemi me të. Sa herë kam marrë pjesë në mbledhje unë kam ngritur probleme për të cilat unë kam menduar se është e drejtë dhe është për të mirën e qytetarëve, mirëpo në çdo fjalim timin sa herë që unë kam marrë pjesë në diskutim, Kryetari i Komunës i cili e donë shumë mërgatën m ka ofenduar çdoherë duke më etiketuar se unë jetoj jashtë Kosovës dhe vie këtu "sa për sy e faqe". Pra nëse mendojnë Vetëvendosja dhe Kryetari që mërgata është zemra e Shqiptarëve, çelësi i Shqiptarëve dhe është gjithçka që bëjnë për këtë vend, si është e mundur që një Kryetar i Komunës të më ofendoj e që është edhe raciste, për shkak se unë një pjesë të jetës time e kam kaluar në Gjermani, pra çdo shqetësim që unë e kam ngritur për të mirën e këtij vendi, për çka ekzistojnë të gjitha incizimet, ai më ka ofenduar në frymën më të keqe duke më thënë se ti vie prej mërgatës, por kur po ju duhet mërgata për vota, për mjete financa dhe për të tjera po thoni se në rregull jemi, mërgata më e mira. Për atë po dua të them se ju vet asamblistët e LVV-së që e keni marrë votën e qytetarëve nuk keni nevojë t'i bëheni avokat Kryetarit që nuk është këtu, por ju duhet ta ngritni zërin së pari, shembull, pse, sa herë e kam ndihmuar unë LVV-në e që ti (i drejtohet njërit prej anëtarëve

të Kuvendit nga radhët e LVV-së) ndoshta nuk ke qenë fare në LVV, dhe sa herë e kam ndihmuar me mjete si mërgatë e që sa herë ju ka dashtë i kemi ndihmuar, prandaj është e padrejtë dhe e pamoralshme që një njeri i tillë të më ofendoj mua në këtë formë, për çka më vie shumë keq që nuk është prezent këtu në sallë.
Shqetësimet që jam duke i marrë tek personeli që punojnë në Komunë, ka filluar një fushatë të egër ndaj punonjësve që punojnë në administratë duke i'u bërë ndërrime, duke dërguar atë të shëndetësisë në inspektorat, dhe atë tjetrin aty, pra është një lojë kamikazësh e që nuk ka ndodhur kurrë në Komunën tonë e që besoj se edhe është e kundërligjshme kjo sepse tani nëse një perona i cili ka punuar ndoshta 5 vite apo 10 vite në shëndetësi dhe tani ta dërgosh në prokurim apo anasjelltas është shumë e keqe, dhe këto shqetësime i kam marrë prej punonjësve.
Mendoj që duke filluar prej Nënkryetares së Komunës e cila është një veterane e Vetëvendosjes dhe këta tjerët që i njoh dhe që janë këtu, nuk duhet bash kështu që një perona të jetë "peranador" ngase ne jemi zgjedhë këtu për t'i ndihmuar qytetarët, nuk jemi zgjedh këtu për t'ia bërë "pekej", ne jemi zgjedh këtu për të mirën e qytetarëve por nuk jemi zgjedh këtu që një njeri të sillet sikur despot e që kjo nuk na bënë nder as neve po as juve. Për çdo gjë çka është e keqe duhet t'i thuhet stop, mjaft më se nuk shkon kështu më tutje. Unë mendoj se Kryetari e ka devijuar dhe mbanë në mend që do të vije dita që kur të pëlcet tek ju do të pëlcet më keq se tek "karriket e LDK-së". Pse e them këtë, e them sepse njerëzit të cilët e kanë ndërtuar me mund, me gjak, me djers për ë ardhur këtu dhe për tu përfaqësuar në këtë Kuvend në vitin 2013 kur kanë vrapuar me çanta për të marrë një votë, ata që ju përfaqësojnë dhe atë që janë ardhur në vitin 2019 ta diskojnë edhe jetën edhe punës se si duhet të punoj ty që je i zgjedhur në këtë Kuvend, prandaj unë nuk e kom me të keq për askënd, por e kam fjalën që çdo njëri prej nesh duhet ta mbaj peshën për çka është zgjedh këtu, nëse Kryetari bënë gabim ne duhet ti themi se është gabim, ne duhet të jemi të bashkuar. Nuk jam për të prishur punë, por jam për jo diskriminim as punëtorëve ngase kjo është lojë "zik-zake", ishte z.Ajet Potera drejtor por nuk bëri ai, erdh tjetri z.Bedri Maçastena as ky nuk bëri, çfarë është puna që veç tek Inspektorati nuk po i pëlqen diçka, madje as ky aktuali nuk është duke i pëlqyer diçka, çfarë është duke u fshehur aty tek Inspektorati pas asaj Drejtorie, asgjë tjetër, por vetëm i ka telashet e mëdha me padronët e politikës dhe mafisë së ndërtimeve në Komunën e Podujevës.
Ne nuk do të heshtim për këto, ju thash edhe më herët, por do të ndjek çdo hap ligjor, do të thërras konferencë për shtyp dhe jam duke mbledhur materiale për ndërtimet pa leje që bëhen nën hije me bekimin e Kryetarit i cili i mbyll dy sytë. Një fukaraje nëse e ndërton një shtëpi tre kate shkojnë dhe ia rrënojnë, kurse ai që ka financa nuk është problem sepse i mbyllim sytë për të, prandaj nuk po e zgjati më shumë meqë Kryetari nuk është prezent këtu sepse po të ishte do të kisha shumë dëshirë por meqë nuk është këtu po më vie shumë keq, por ju bëjë thirrje të gjithëve veteranëve të Vetëvendosjes ta prekin kokën pak sepse ata e dinë shumë mirë qysh kanë ardhur deri këtu, me çfarë mundi dhe me çfarë djerse keni ardhur këtu për të qeverisur, por kur të shkoni njëherë nuk do të ktheheni më kurrë sepse ai që po i'u prinë juve është ardhur në qershor ose korrik të vitit 2019, është ardhur dhe është bërë prijës i juaji dhe po jua udhëheqë politikat e që e dini se po i udhëheqë, tmerrësisht në kundërshtim me programin dhe statutin e juaj, dhe për ata që jeni thirre këtu.
Ai të më tregoj mua këtu se vije unë prej mërgate, sa herë e kam pritur unë zotëri Albin Kurti në shtëpinë time, me qindra herë, pastaj zotëri Glauk Konjufcën, zotëri Liburn Aliun, zotëri Xhelal Sveqlën dhe çdo njëri ka qenë në konak timin dhe unë e di se si i kemi ndihmuar, kurse ky të vije në vitin 2019 dhe të më tregoj mua, e që u ardhë dhe u bë "puthadorë" këtu, mirëpo ky nuk është bash askushi fare, mbajeni në mend që do të vije koha që ju që jeni mbrojtësit më të mëdhenj të tij e që ndoshta u e keni mirë e unë jam gabim, por do të vije dita që ju do të pendoheni më shumë se të gjithë ne që e kemi ditë që është i sojit të tillë.

**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, për Ekzekutivin e Komunës nuk po marrë përgjegjësi të flasë sepse ka këtu që janë më kompetentë, mirëpo kjo ngërsyrja për të fol për Lëvizjen Vetëvendosje po e shohë si pozitive, por kam frikë shumë që duke u marrë me Vetëvendosjen shumë, ka rrezik disave t'iu shuhen partitë e tyre, kështu që është mirë të merren pak më shumë me parti të tyre, neve të na lënë t'i kryejmë punët tona, dhe kaq.
**z.Gazmend Islami**, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, shprehja e përdorur ngërsyje, është vetëm kur ngërsyhet qeni dhe askush tjetër, do të thotë kjo është teknologji e dobët dhe kjo tregon se jeni profesor i keq dhe nuk ke logjikë të mirë të ndërtimit të asaj çfarë donë të thuash.
Askush kurrë nuk është duke u marrë me Vetëvendosjen, dhashtë Zoti 11 milion anëtar i bënë dhe 70% të fitoreve i bënë, por unë vetëm të tregova sepse ti je i vonë këtu, shumë i vonë, por ju tregova që e keni një Kryetar për "faqe të zezë", asgjë tjetër nuk thash, mbajeni mend.
**z.Ardi Hasani**, theksoi, i nderuar zotëri Gazmend Islami, nuk e di përse të ka rrokë kaq me siklet dhe përse po e trajton sot këtë punën e qasjes së Kryetarit karshi mërgatës ashtu qysh po e thua ti. Unë mendoj se ai (Kryetari i Komunës) nuk e ka pasë në këtë mënyrën çfarë je duke e thënë ti, por ti je ka dëshiron të bësh pak më shumë filma, si dhe zbute pak sepse përnjëmend nuk po të ka hije, sinqerisht po, sepse rolin e mërgatës por edhe tëndin personal dhe të vëllezërve tuaj nuk mund ta humb askush dhe këtë gjë e dim secili prej nesh por e din edhe ti, prandaj mos e kthe diskutimin në personale si dhe zbuti pak se nuk po të ka hije.
**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, u mundova të mbaj shënime për secilën pyetje dhe çështje të ngritur që bie në fushën e Drejtorisë që unë e udhëheqë andaj edhe po mundohem të jap përgjigje tani mirëpo nëse ka interesim për përgjigje apo sqarime shtesë jam i hapur për secilin që t'i pres në zyrë apo edhe përmes shkëmbimit të e-mail adresave.
Sa i përket pyetjes dhe çështjeve të ngritura nga znj.Arjeta Abazi lidhur me shtegun e biçiklistëve dhe disa aksidenteve të ndodhura në atë rrugë, sa i përket ngjyrosjes së shtegut të në fjalë ju them se aq sa është ngjyrosur aq ka qenë sasia e paraparë në projektin e shenjëzimit horizontal dhe vertikal që lidhet me këtë çështje, pra në specifikacion të projektit janë të ndara ngjyrat se sa do të shpenzohen dhe brenda asaj të mundshmes që ka qenë ngjyra e kuqe ka mbërri deri aty, por shtegu është i papërfunduar për shkak të neglizhencës së Operatorit Ekonomik dhe për këtë ne kemi bërë shumë vërejtje me shkrim dhe kemi shumë e-maile nëpërmes menaxherëve të projektit të cilët kanë shkëmbyer me Operatorin në fjalë i cili është nga Prizreni me të cilin është lidhur Kontratë qysh moti dhe është kontratë 2 ose 3 vjeçare nëse nuk gaboj, prandaj për shkak të neglizhencës dhe papërgjegjësisë së tij ka mbetur ende i papërfunduar ai shteg, mirëpo ju them këtu se edhe ajo pjesë që është përfunduar nuk do t'i pranohet, dhe i është bërë kërkesë që të ri ngjyroset nga fillimi sepse e kemi parë të gjithë dhe askush nuk mund të thotë se ai shteg është i ngjyrosur mirë përderisa e shohim se ka shumë laramani të ngjyrës në atë shteg, andaj e thash se ne bashkërisht me menaxherët e projektit dhe me mbikëqyrësit e menaxherëve e kemi obliguar atë Operator që pjesa e shtegut deri aty ku ka mbërri të ri ngjyroset, kurse pjesa tjetër e shtegut do të ngjyroset me projektin e radhës që ne do ta iniciojmë tani në këtë vit dhe sigurisht që do të lidhet kontrata në fund të këtij vitit ose në fillim të vitit të ardhshëm. Sa i përket aksidenteve kemi informata se fatkeqësisht kanë ndodhë disa aksidente të vogla të disa biçiklistëve gjatë qarkullimit të tyre për çka jemi munduar që gjithherë të jemi në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë sepse kjo është kompetente për mbajtjen e rendit sepse inspektorët e Komunës nuk kanë të drejtë të shqiptojnë gjoba të trafikut, dhe fatkeqësisht kjo ndërlidhet edhe me pyetjen tjetër rreth parkimit të automjeteve në shtegun e biçiklistëve për çka shumë herë e kemi ngritur këtë shqetësim sepse vërtetë është shumë keq kur shohim veturat e parkuara në shteg e që edhe për këtë çështje disa herë kemi bërë koordinim me Policinë që të ndërmerren masa në mënyrë që shtegu i biçiklistëve të jetë i lirë për qarkullim, mirëpo Policia

arsyetohet kinse nuk kanë staf të mjaftueshëm ashtu siç kemi kërkuar që njësiti i Policisë që është me biçikleta të qëndrojnë në shteg në shumicën e kohës së tyre, por si duket në mungesë të stafit kërkesa jonë nuk ka rezultuar pozitivisht. Pavarësisht kësaj ne kemi menduar t'i vendosim disa barriera apo disa pengesa të cilat në mënyrë të dhunshme e ndalojnë automjetin të parkohet apo të hyjë në shteg të biçiklistëve mirëpo arsyeja përse nuk i kemi vendosur në fillim është se nuk kemi dashur të krijojmë probleme të qasjes së bizneseve përgjatë asaj rruge ku ka shumë biznese e që do të kufizoheshin ato biznese në një formë dhe këtë na e kanë thënë në takimet që kemi pasë, mirëpo siç po duket ne do të detyrohemi të vendosim pengesa dhe në një të ardhme të afërt me kontratën e re që do ta lidhim do të parashihen edhe pengesa me qëllim të ndaljes së parkimit të automjeteve nga ata vozitës të papërgjegjshëm të cilët e pengojnë lëvizjen e lirë të biçiklistëve.
Sa i përket pyetjes së z.Arjant Topanicës, lidhur me semaforët të cilët nuk janë funksional e që puna e tyre nëse mund të them është bërë temë interesante dhe që shpesh bisedohet për këtë, mirëpo këtu hapur ju them se semaforët nuk kanë defekte dhe janë në gjendje të mirë dhe janë në rregull ashtu siç janë vendosur në fillim, por i kemi ndal ne qëllimisht dhe arsyeja e ndaljes së tyre ka qenë edhe kërkesë e qytetarëve. Unë e di që ata semaforë sa herë që janë lëshuar në funksion vetëm kanë ngritur tollovi në trafik dhe nuk e ka zbraz dhe nuk e kanë rregulluar komunikacionin, për çka e kemi provuar përmes testimeve, dhe tani kemi ardhur në një situatë ku kërkohet të bëhet një ri strukturim i tyre dhe në këtë fazë duhet të përfshihet edhe shtegu i biçiklistëve në ristrukturim sepse domosdo na detyron sepse matësi/sekondari i tyre na ka paraqitur këtë problem. Ne kemi biseduar me shkollën teknike-drejtimi i trafikut rrugor dhe bashkërisht me nxënësit do t'i bëjmë matjet e sakta se si do ta vendosim kohë matësin apo sekondarin dhe këtë do ta bëjnë nxënësit e cekur së bashku me mësimdhënës dhe me neve si Komunë, e që do të jetë një përvojë e mirë edhe për ata nxënës por do të jetë një gjë e mirë edhe për neve në këtë aspekt. Prandaj e them se kur do që ju e vlerësoni ne mund t'i lëshojmë në funksion semaforët, mirëpo vetëm tani sa janë mërgimtarët për pushime në Kosovë mund ta merrni me mend se çka do të bëhet nëse veç i lëshojmë ata semafor.
Sa i përket pyetjes së z.Artrit Mulliqit, është e vërtetë se mungesa e trotuareve në rrugën në drejtim të shkollës "Xheladin Rekaliu, është shqetësim i përbashkët, mirëpo shumë shpejt do të fillojmë me fazën e punimeve dhe fatmirësisht kemi kontratë të lidhur për mirëmbajtjen e trotuareve, por fatkeqësisht ende nuk ka mbërri me fillimin e punimeve në këto trotuare dhe shpresoj shumë se pas përfundimit të disa punëve që është duke i bërë kompania përkatëse për mirëmbajtjen dhe renovimin e trotuareve, do ta vazhdohet me trotuaret në rrugën e shkollës "Xheladin Rekaliu" sepse vërtetë e dim se është në gjendje të keqe.
Pra këto ishin sqarimet dhe përgjigjet në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga ana juaj, mirëpo sërish edhe njëherë ju ftoj secilin që çfarëdo që keni urdhëroni bashkërisht i trajtojmë në zyrë apo në forma tjera.

*Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje duke i'u uruar pushim të mirë muajin gusht meqë me planin e punës nuk ka të planifikuar mbledhje të Kuvendit, përveç ndonjë rrethane urgjente apo të jashtëzakonshme.*

**Mbledhja përfundoi në ora 17;30**

**Procesverbalin e mbajtën;**
**Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0062837/22** **Kryesuesi i Kuvendit**
**Podujevë, datë, 29 korrik 2022** **Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal i mbajtur më 12 shtator 2022, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,**

**E mbajtur me rastin e ndarjes së titullit QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës për z.Halil Kastratin themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës.**

Mbledhja filloi në orën 11;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës.
Në mbledhje të pranishëm ishin këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës së në vijim; (*Valon Demolli, Edona Shabani, Arjant Topanica, Donjetë Sheqiri, Ilir Koprani, Ekrem Rrahmani, Fahri Hasani, Fitim Muçolli, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Sebastina Vokrri, Drita Pajaziti, Qëndresë Hajrizi, Ragip Fetahu, Xhevdet Maloku, Ardi Hasani, Haki Rudari, Bahri Blakçori, Burim Hasani, Gazmend Islami)*,
ndërsa munguan,
(*Demokrat Hodolli, Arnisa Sylejmani, Arjeta Abazi, Adnan Zymeri, Qëndrim Softolli, Naim Çunaku, Tringa Sfishta, Florent Hasani, Kasib Bashota, Bashkim Syla, Endritë Murati, Mimoza Abdullahu, Mrika Thaçi, Arbnor Fazliu)* - Lista e nënshkrimeve.
Në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës së Podujevës, (*Antoneta Ejupi-DA, Fatlum Osmani-DBF, Avni Fetahu-DKA, Leutrim Krasniqi-DPUMM, Saranda Stublla-DPKGJ, Pajtim Balaj-DKRS, Bahri Selimi-DSHPMSH, Fatmir Rudari-BPZHR*).
Gjithashtu, me ftesë të Kryetarit të Komunës, në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta, z.Fadil Mulliqi, z.Ilaz Islami, z.Kadri Balaj.
Përfaqësues të Këshillit të Bashkësisë Islame-Podujevë, z.Idriz Bilalli dhe z.Besim Llalloshi.
z.Isak Shabani Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës-dega Podujevë dhe Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Gjithashtu me ftesë të Kryetarit të Komunës, në mbledhje gjithashtu të pranishëm ishin edhe z.Halil Kastrati dhe përfaqësues tjerë nga Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", (z.Bled Latifi, z.Berat Kabashi, z.Tafil Oraca, z.Shkelzen Kastrati, z.Gentrit Latifi, z.Rinor Hakaj).
Në mbledhje pjesëmarrës ishin edhe media të shkruara dhe elektronike dhe një numër qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

## 1. Hapja e mbledhjes

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë mbledhje Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës e cila organizohet me rastin e ndarjes së titullit QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës për z.Halil Kastratin themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës.

Jeni në dijeni se në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Podujevës të mbajtur më 30 qershor 2022, në propozim të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, kemi marrë Vendim unanim që z.Halil Kastratin, themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", ta shpallim QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës, në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit dhe të mirësisë në Komunën e Podujevës.
Ndihma e Hoxhës së nderuar, për shumë familje janë shpëtim dhe lehtësim për ta jetuar jetën më mirë në këtë kohë krize globale që e ka përfshirë edhe Komunën tonë.
Në emër të Kuvendit të Komunës dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës i jemi mirënjohës dhe falënderues zotëri Halil Kastratit për veprimtarinë e tij humane dhe mirësinë për qytetarët Llapjan.
Edhe njëherë, faleminderit i nderuar Hoxhë Halil Kastrati.

2. **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**
    - **Ndarja e titullit QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës, dhe dhënia e dekoratës z.Halil Kastratit**

**z.Shpejtim Bulliqi**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, e nderuara Nënkryetare e Komunës, drejtor të Drejtorive, të nderuar asamblistë,
I nderuar kryetar i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" z.Halil Kastrati, dhe ju të nderuar pjesëtarë të organizatës "Jetimat e Ballkanit", të nderuara media dhe të dashur qytetarë, të respektuar klerik fetar, familjarë të Dëshmorëve, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, ju faleminderit për pjesëmarrjen e juaj në këtë seancë Solemne të Kuvendit të Komunës.
E kemi thirrur këtë seancë solemne me qëllim që t'i ndajmë titullin QYTETAR NDERI, një humanisti të madh e një qytetari të devotshëm të Kosovës, i cili i ka ndihmuar dhe po ndihmon përmes Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" shumë familje shqiptare në të gjitha trojet tona.
Ky është Hoxha i nderuar Halil Kastrati, me të cilin sot si Komunë e Podujevës kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm në fushën e humanizmit.
Për ata që nuk e njohin mirë Hoxhën dhe Shoqatën e tij, po e lexoj një pjesë të biografisë së tij, dhe atë;
Halil Kastrati ka lindur me 17 prill të vitit 1975 në Prizren, rrjedh nga një familje atdhetare e patriotike, ai është vëllai i Dëshmorit Besnik Kastrati. Shkollën fillore dhe të mesme e përfundoi në qytetin e Prizrenit, ndërsa si i ri u largua nga vendlindja për t'i vijuar studimet në drejtimin teologjik ne Damask te Sirisë dhe në Jemen. Pas përfundimit të fakultetit teologjik, ai përfundoi edhe fakultetin e psikologjisë në Prizren.
Ne vitin 2000, Kastrati migroi në Itali ku u përballë me shumë vështirësi të jetës, gjatë kësaj kohe i lindi ideja që të hapë një kuzhinë humanitare për njerëzit në nevojë.
Si i ri ushtroi detyrën e Imamit në Zvicër dhe Itali. Vlen të theksohet se Kastrati themeloi Xhaminë e parë Shqiptare në qytetin Kasaloldo të ltalisë.
Në vitin 2009, Halil Kastrati u kthye në Kosovë për të vazhduar jetën në vendlindje. Duke e parë gjendjen e popullit të tij, shpirti i tij fisnik e bujar nuk e lejoi të bënte një jetë të rëndomtë, por filloi misionin e tij për t'i ndihmuar familjet e varfëri dhe personat e sëmurë. Ai themeloi Organizatën "Jetimat e Ballkanit" dhe që nga viti 2009 e strukturoi drejt funksionalizimit te një Organizate që sot njihet si Shoqata më kredibile në trojet Shqiptare dhe më gjerë.
Që nga themelimi e deri më tani, Shoqata "Jetimat e Ballkanit" kanë bëre me strehë mbi 1350 familje, kane ndërtuar shtëpinë e të moshuarve në fshatin Gjinoc të Suharekës ku pritet të strehohen deri në 250 të moshuar, ndërsa aktualisht ajo shtëpi ka rreth 80 banorë.

Aktualisht në tri qytete janë kuzhinat humantare aktive ku gjatë ditës ushqehen rreth 750 persona.
Po ashtu Hoxhë Halil Kastrati ka dhënë një kontribut të çmueshëm edhe në Komunën tonë.
Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" me vet-iniciativë si dhe në bashkëpunim me Komunën e Podujevës kanë realizuar një mori aktivitetesh të ndryshme humanitare për personat në nevojë, duke filluar nga ndërtimi i shtëpive për familjet skamnore, shpërndarjen e pakove ushqimore, trajtimin e personave me sëmundje të rënda e të tjera me radhë.
Në Podujevë janë ndërtuar 80 shtëpi të reja, ku 48 prej tyre janë në bashkëfinancim me Komunën e Podujevës, ndërsa pjesa tjetër me vet-iniciativë dhe financim të Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", janë shpërndarë deri më sot mbi 2500 pako me produkte ushqimore e higjienike, raste të ndihmuar për shërim janë mbi 10 persona të cilët janë financuar për tu shëruar brenda dhe jashtë vendit, janë ndarë dhjetëra bursa për fëmijë jetim dhe studentë me gjendje të rëndë ekonomike.
Komuna e Podujevës është shumë falënderuese ndaj Hoxhës dhe Shoqatës së tij, për bashkëpunimin e jashtëzakonshëm që e kemi pasur në vazhdimësi.
I zgjedhur nga qytetarët e Komunës së Podujevës si Kryetar i Komunës kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të qytetarëve dhe institucionit të Komunës së Podujevës t'i ndaj titullin QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës z.Halil Kastrati themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës.
Ju faleminderit, dhe shfrytëzoj nga rasti që të ftoj zotëri Halil Kastratin ta pranon dekoratën me titullin QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës.

*Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi në mënyrë solemne i dhuron dekoratën me titullin QYTETAR NDERI i Komunës së Podujevës, z.Halil Kastratit, themelues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për kontributin e dhënë në fushën e humanizmit në Komunën e Podujevës, për çka në shenjë mirënjohjeje dhe respekti pritet me një duartrokitje nga të pranishmit.*

*Pas solemnitetit të dorëzim pranimit të dekoratës, z.Halil Kastrati ftohet për një fjalë rasti.*

## 3. Fjalë rasti e z.Halil Kastrati, themelues dhe përfaqësues i Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit".

**z.Halil Kastrati**, theksoi, i nderuar Kryetar i Komunës, i nderuar Kryesues i Kuvendit, e nderuara zonja Nënkryetare e Komunës, drejtor dhe drejtoresha të Drejtorive të Komunës së Podujevës, Kuvendar, familje të Dëshmorëve, të nderuar të pranishëm dhe i nderuar Bled Latifi, me të vërtetë sot jam i emocionuar sepse sa është privilegj për mua si Halil dhe stafin dhe Shoqatën që unë e udhëheqë, njëkohësisht është edhe përgjegjësi më e madhe për neve.
Ky çmim, ky nderë dhe ky titull është për të gjithë Shqiptarët të cilët kanë ndarë kafshatën nga djersa e tyre për të kthyer shumë buzëqeshje në shumë familje nevojtare në Kosovën tonë dhe në trojet tjera Shqiptare, e që me të vërtetë është se unë po i prijë këtij karvani humanitar, por realisht dhe faktikisht meritorët kryesor janë njerëzit donator Shqiptarë ku do që janë të cilët po mundohen të kryejnë këtë vepër humanitare, dhe mandej përveç donatorëve është stafi im dhe i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" që janë djem të rinj të cilët kanë sakrifikuar rininë e tyre dhe kanë marrë mision të shenjtë këtë vepër humanitare si synim i imi dhe i stafit tim e që pasha Zotin nuk e kemi nisur të marrim tituj nëpër Kuvende të ndryshme të shqiptarisë, por synimi i vetëm është ta gjejmë një mirënjohje dhe një titull tek Zoti, kjo është më e rëndësishmja dhe synim i yni sepse puna jonë është punë me emocione, nuk është lehtë t'i qëndrohet lotit të nënës përballë, ofshamës së babës.

Janë mbi njëmijë e peseqind familje që janë bërë me shtëpi, veç gjokset tona e dinë se çfarë mbajmë brenda, sa e sa skenarë, sa e sa histori, madje ndoshta na shihni duke u ushqyer por faktikisht shumë herë kafshatat na mbesin në fyt ngase dikush dëshiron të të nderoj mirëpo në atë moment të shfaqet ndonjë skenar dhe të mbetet buka në fyt, andaj e them se gjokset tona mbajnë situata shumë të rënda e që janë disa skenarë që ne do t'i bartim me vete kur të dalim para Zotit.
Mirënjohës prej tokës në qiell të gjithë atyre që na kanë besuar që ne t'i prijmë këtij karvani të humanizmit, mirënjohës dhe falënderues për të gjithë Ju Kuvendar të cilët keni ngritur dorën të na dhuroni motiv por edhe forcë që ne të mos ndalemi.
Faleminderit Llapjan që prej ditës së parë të themelimit të Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" kemi pasë Llapjan donatorë dhe të mirë e që njëri prej tyre është edhe Bled Latifi i cili është prezent këtu për të cilin do të doja një duartrokitje nga ne këtu. Faleminderit Bashkësi Islame, Zoti ju ruajt dhe nderoftë. Faleminderit i nderuar Kryetar i Komunës dhe të gjithëve që sot më keni nderuar, por faktikisht unë po marrë përgjegjësi më të madhe për Llapin tani e tutje, Zoti ju shpërbleftë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, duke falënderuar Hoxhë Halil Kastratin i uroj shumë suksese në rrugën e tij bamirëse së bashku me bashkëpunëtorët.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, i nderuar Hoxhë Halil Kastrati, Ju falënderoj shumë për fjalët e mira, dhe me këtë rast shfrytëzoj rastin të përshëndes dhe falënderoj për pjesëmarrje edhe Deputetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Isak Shabani.
E ceku edhe Hoxha i nderuar se një individ i veçantë në këtë rast e që mendoj se meriton ta ketë një Mirënjohje të veçantë për krejt angazhimin e tij, e që e gjithë anëtarësia dhe njerëzit që punojnë në këtë Shoqatë të gjithë meritojnë Mirënjohje të veçantë, por kësaj radhe kemi vendos që z.Bled Latifin ta vlerësojmë me një Mirënjohje në emër të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, dhe me këtë ftoj Bled Latifin për marrjen e Mirënjohjes.

*Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi gjithashtu me solemnitet dhuron Mirënjohje z.Bled Latifit, në shenjë respekti për bashkëpunimin, angazhimin, punën dhe kontributin e tij në Shoqatën bamirëse "Jetimat e Ballkanit, për çka pritet me një duartrokitje nga të pranishmit.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, edhe njëherë falënderojmë Hoxhë Halil Kastratin dhe gjithë bashkëpunëtorët e tij për gjitha angazhimet dhe kontributin e tyre në Komunën e Podujevës duke shpresuar që ky bashkëpunim të vazhdoj.
Po ashtu ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, dhe me kaq e konsideroj të përfunduar këtë seancë.

**Mbledhja përfundoi në ora 11;30**
**Procesverbalin e mbajti**
**Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0078695/22**
**Podujevë,** **Kryesuesi i Kuvendit**
**12 shtator 2022** **Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal i mbajtur më 29 shtator 2022 në mbledhjen e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.**

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në mbledhje të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç z.Arjant Topanica dhe z.Gazmend Islami të cilët munguan.
Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive (*DBF, DPKGJ, DKA, DPZHE, DBPZHR, DA,*)
Në mbledhje i pranishëm ishte edhe përfaqësuesi mediave lokale, përfaqësues të KFOR, disa zyrtarë komunal dhe një numër i qytetarëve.

## Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 33 anëtar/e të Kuvendit ndërsa tani për tani mungojnë 2.
Para kësaj mbledhje siç dihet kemi mbajtur edhe mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhje nga e cila të gjitha pikat e parapara i janë rekomanduar Kuvendit për këtë mbledhje, me një vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit, që drejtorët e Drejtorive që paraqesin pika për mbledhje, të jenë prezent në mbledhjen e KPF-së dhe duke pasë qëndrim që herëve tjera ato pika nuk do t'i rekomandohen Kuvendit, kjo për shkak se disa drejtor të drejtorive që kanë paraqitë pika për shqyrtim kanë munguar në mbledhje të KPF-së, kështu që kemi bërë lëshime kësaj radhe duke i rekomanduar për mbledhjen e Kuvendit.
Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës.
**z.Valon Demolli**, në emër të Grupit të LDK-ës, theksoi, nisur në faktin që partia në pushtet duke u thirrur në arrogancën e numrave, dhe ky koalicion i cili nga 35 anëtarë ka vetëm 17 zyrtarisht të deklaruar dhe të tjerët i përjashton. Praktika e kësaj forme refuzuese në vazhdimësi ndaj bashkëpunimit të Grupeve të asamblesë fletë për jo gatishmëri ndaj bashkëpunimit për qeverisje të mirë dhe të qëndrueshme në interes të qytetarëve.
Karakteristika e kësaj qeverisje përveç mos bashkëpunimit, shkeljeve ligjore, pa synim dhe pa vizion, me veprime ad-hoc ka shkuar deri në atë masë që edhe mjetet e informimit nuk janë sot prezent këtu. Prandaj sot në shenjë proteste ne Grupi më i madh opozitar, e që në foltore është kërkuar të mos quhemi të tillë, duhet ta lirojmë sallën.
**znj.Mrika Thaçi**, theksoi, duke u bazuar në atë që u tha më parë nga kolegu im parafolës, por duke u bazuar edhe në faktin që AAK nuk është pjesë e ndonjë koalicioni, unë sot i ftoj edhe kolegët nga radhët e AAK-së që t'i bashkohemi opozitarizmit.

*Grupi i këshilltarëve të LDK-së, dhe përfaqësuesja e AAK-së znj.Mrika Thaçi, lirojnë sallën.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, lidhur me mos prezencën e mjeteve të informimit sot, unë nuk kam ndonjë informatë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, unë e përcjella me vëmendje diskutimin e kolegut parafolës dhe ajo që u tha nga ai nuk qëndron asnjëra, pra as nuk qëndron arroganca e numrave e as nuk qëndrojnë shkeljet ligjore, përkundrazi thirrja e mbledhjes për buxhetin e Komunës është diçka obligim ligjor që neve na imponon dhe që ne duhet ta respektojmë, prandaj duke u nisur nga kjo por edhe nga fakti që ndër të tjera kemi edhe një pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me buxhet, mendoj se vazhdimi i seancës do të ishte forma më e mirë, e mbi të gjitha ka kuorum dhe duhet vazhduar me pikat e rendit të ditës. Secili e ka qëndrimin e vet, qoftë pozitë qoftë opozitë, por mbi të gjitha ne si Grup i LVV-ës e kemi në interes qytetarin, prandaj propozoj që të vazhdojmë me mbledhje sipas pikave të rendit të ditës, duke marrë parasysh edhe faktin që ka kuorum për këtë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra Grupi i LDK-së dhe një anëtare e Grupit të AAK-së liruan sallën, të pranishëm në sallë janë 19 anëtarë të Kuvendit kështu që kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë.

*Konstatohet se nga numri prej 35 anëtarëve të Kuvendit, 19 anëtar/e janë prezent dhe ka kuorum të mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes.*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi duke pyetur nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me renin e ditës, nëse jo atëherë e hedhi në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 19 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të ditës, përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 28.09.2022*

1. **Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, jemi në dijeni se kjo pikë është më e rëndësishmja që brenda 1 viti sjellët në Kuvendin e Komunës, kështu që për prezantim dhe detaje tjera fjalën e ka drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2023 është i hartuar duke u bazuar në procedurat ligjore dhe Qarkoret Buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave. Materialin e kësaj pike të rendit të ditës e keni marrë me kohë, por edhe nga mbledhja e KPF-së i është rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, mirëpo tani dëshiroj t'i jap disa sqarime rreth disa ndryshimeve për dallim nga materiali që ju është dërguar, ndryshime të cilat kryesisht janë teknike.
Pasi është përcjellë në Kuvend propozim vendimi së bashku me materialin përkatës, më datë 21.09.2022 janë dërguar disa argument dhe disa rekomandime nga Ministria e Financave të cilat duhet t'i zbatojmë por që duhet bërë disa ndryshime të cilat janë kryesisht në emërtime të projekteve dhe që nuk kanë kurrfarë ndryshimesh në vlerat e projekteve, as si buxhet total, as si vlerë e

projekteve e as ndryshim i vlerës financiare të programeve, andaj në vazhdim më lejoni t'i paraqes ndryshimet të cilat duhet të bëhen në dokument, por që duhet të paraqiten edhe në këtë mbledhje.
-Në propozim vendim, është krijuar programi për shërbime rezidenciale, ne kemi buxhet 160,000.oo€ për ndërtimin e shtëpive rezidenciale, është me Qarkore Buxhetore, pra është një projekt i domosdoshëm të cilin duhet ta zbatojmë për arsye se ashtu thuhet në Qarkoren Buxhetore, mirëpo meqë është krijuar programi për shërbime rezidenciale atëherë duhet që në propozim vendimin përkatës, në kuadër të grantit qeveritar të krijohet / përfshihet edhe programi për shërbime rezidenciale në shumë 160,000.oo€, shumë kjo e cila zbritet nga shuma e ndarë për administratë komunale i cili bëhet 12,249,700.oo€, dhe njëkohësisht edhe në tabelën e propozim vendimit në faqen 2 shtohet edhe programi për shërbime rezidenciale në shumë 160,000.oo€ duke u bërë edhe ndryshimet përkatëse të shumave buxhetore, konkretisht tek investimet kapitale të Administratës komunale ku shuma e propozuar zvogëlohet për 160,000.oo€.
-Ndryshim tjetër është tek subvencionet në Bujqësi, e që nuk ka ndonjë ndryshim tek vlerat e financimit por ka vetëm ndryshim tek burimet e financimit për këto tri vite, do të thotë një pjesë e këtyre subvencioneve në Bujqësi tani bëhen edhe nga granti qeveritar.
-Tek projekti i ndërtimit të rrugës lidhëse nga magjistralja Podujevë-Prishtinë deri tek rruga "Vëllezërit Frashëri" ka vetëm një ndryshim në strukturën e fondit të burimit të burimit të financimit ku 591,005.oo€ janë nga granti i përgjithshëm dhe 658,995.oo€ janë nga të hyrat vetanake, mirëpo vlera e këtij projekti është ajo që edhe e keni në propozim vendim, do të thotë nuk ka kurrfarë ndryshimi tjetër.
-Tek projekti për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në qytet, ka një ndryshim në emërtim dhe që bëhet fjalë për vitin 2023 për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr."Skënderbeu" e që kështu duhet të jetë emërtimi i ri i projektit.
-Tek projekti, ndërtimi, shtimi dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet, në pozicionin nr.26, riemërohet, rregullimi i hapësirave publike përgjatë lumit Llap në qytet, projekt ky i cili ndryshon në të gjitha vitet vetëm si emërtim, do të thotë nuk bëhet fjalë për kurrfarë ndryshimi të vlerës së projektit.
-Tek Infrastruktura publike, në projektin nr.1, te ndërtimi i trotuareve në qytet për vitin 2023, riemërohet si, ndërtimi i trotuareve në qytet nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr."Hakif Zejnullahu". Pastaj te projekti në pozicionin nr.2 , zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve, riemërohet si projekt zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap në qytet. Te projekti me pozicion nr.4, ndriçimi publik në qytet, riemërohet si projekt i ndriçimit publik në rr"Hakif Zejnullahu", si dhe në kulturë, tek projekti monumente kulturore, riemërohet si projekti për ndërtimin e Shtatores së Ademi Demaçit.
-Në projektet e vitit 2024, projekti i urbanizmit me pozicion nr. 2 riemërohet si projekt për asfaltimin e rrugëve në qytet nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr."Xhemalj Mustafa". Projekti i unazës së qytetit ka vetëm një ndryshim tek fondi i burimit ndërsa vlera e projektit mbetet e njëjtë.
-Te infrastruktura publike në vitin 2024, projekti për ndërtimin e trotuareve riemërohet si projekt për ndërtimin e trotuareve nga rr."Zahir Pajaziti" deri tek rr."Skënderbeu". Projekti në pozicionin nr.2 riemërohet si projekt për rregullimin dhe zgjerimin e lumit Llap nga Sekiraça deri në fshatin Siboc, mandej projekti në pozicionin nr.4 riemërohet si projekt për ndriçimin publik në qytet nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr."Skënderbeu".
-Tek projektet e vitit 2025, tek urbanizmi, projekti në pozicionin nr.1, riemërohet si projekt për asfaltimin e rrugëve në qytet nga rr."Besnik Restelica" deri në magjistrale. Pastaj në infrastrukturë publike, projekti në pozicionin nr.1, riemërohet si projekt për ndërtimin e trotuareve nga rr."Bedri Bajrami" deri në magjistrale. Projekti në pozicionin nr.2, riemërohet si projekt për zgjerimin dhe

rregullimin e shtratit të lumit Llap nga fshati Sivboc deri në fshatin Lluzhan, si dhe projekti në pozicionin nr.4, riemërohet si projekt për ndriçimin publik në qytet nga rr.”Ali Ajeti” deri në magjistrale.
Pra nuk bëhet fjalë për kurrfarë ndryshimi të vlerës së projekteve, as te natyra e projekteve, as te vlera financiare e as te programet, mirëpo bëhet fjalë për buxhetin e njëjtë i cili ju është dërguar, por vetëm disa ndryshime të cilat kryesisht janë teknike e që normalisht buxheti duhet të aprovohet me këto propozime ndryshime që i paraqita.
Nuk dëshiroj t’ju marrë më shumë kohë, mirëpo vlen të ceket se buxheti i vitit 2023 është buxheti më i madh në historinë e Komunës së Podujevës, prej 27,406,567.oo€, afër 4 milion euro më i madh se buxhetit i vitit 2022.
Fushat prioritare që jepen në këtë buxhet është arsimi, ekonomia, shëndetësia, projektet e mëdha zhvillimore të infrastrukturës, do të thotë kemi rritje të madhe apo 17 herë në krahasim me buxhetin e vitit 2021 për arsim, tek projektet kapitale, gjithashtu kemi rritje tek subvencionet në të gjitha kategoritë e subvencioneve si arsim, shëndetësi, bujqësi, kulturë-rreth 5 herë më shumë buxhet, si dhe në fushën e ekonomisë ku ka rritje të madhe të buxhetit.
Meqë materialin e keni marrë me kohë dhe sigurisht se do të ketë edhe diskutime tjera, mirëpo ju ftoj që ta miratoni këtë propozim buxhet të komunës për vitin 2023 dhe planifikimet buxhetore për vitet 2024-2025, duke përfshirë edhe ndryshimet e paraqitura që janë kryesisht teknike, e që është një prej dokumenteve më të rëndësishme që miraton asambleja komunale gjatë një viti.
**znj.Qëndresë Hajrizi**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, buxheti për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet 2024 dhe 2025 është një prej dokumenteve kryesore që aprovohen në asamblenë komunale. Buxheti për vitin 2023 në bazë të analizave tona është përpiluar në bazë të procedurave buxhetore të përcaktuara me ligj dhe me Qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave. Ky buxhet i cili është më i madhi në historinë e Komunës së Podujevës dhe përveç kësaj i ka adresuar edhe prioritetet kryesore ku duhet të investohet me qëllim të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të Komunës së Podujevës, dhe ky buxhet si asnjëherë më parë i prioritetizon arsimin ku ka një rritje të madhe të buxhetit, shëndetësinë ku janë të planifikuara investime të mëdha kapitale dhe rritje të buxhetit në furnizim me barna, kulturën ku ka një rritje të madh të buxhetit 5 herë nëse krahasohet me të kaluarën, bujqësinë ku kemi dyfishim të buxhetit për bujqit tanë, projekte madhore infrastrukturore ku ky buxhet i jep drejtim zhvillimit të Komunës së Podujevës duke i zgjedhur prioritetet e duhura që janë për zhvillim, gjithashtu buxhet që siguron barazi ku çdo sektor është i përfshirë dhe ka një shpërndarje të drejtë territoriale ku çdo lagje dhe fshat është i përfshirë në këtë buxhet. Andaj ne si LVV e mbështesim këtë buxhet me bindje se ofron më të mirën në të mirë të qytetarëve.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, sot po diskutojmë për buxhetin e vitit 2023 i cili është 27,406,567.oo€, apo afër 4 milion euro më i madh se buxheti aktual. Nga granti qeveritar 25,600,074.oo€, kurse nga të hyrat vetanake janë 1,806,493.oo€ apo 400,000.oo€ më shumë se buxheti aktual. Për shpenzime kapitale janë planifikuar afër 9,208,144.oo€, dhe në Drejtorinë e Urbanizimit dhe atë të Shërbimeve publike ka ngritje të buxhetit për investime kapitale, gjithashtu edhe në arsim i është dhënë prioritet ku nga shuma prej 594,218.oo€ është ngritur në 1,660,000.oo€. në Bujqësi gjithashtu kemi një ngritje ku nga 430,000.oo€ në 700,000.oo€, pastaj në Zhvillim ekonomik nga 140,000.oo€ në 300,000.oo€, në Kulturë Rini dhe Sport nga 100,000.oo€ në 250,000.oo€, andaj ne si Grup i PDK-së do të votojmë pro këtij buxheti dhe gjithashtu nga Ekzekutivi i Komunës kërkojmë që të punoj me intensitet sa më të lartë me qëllim që suficidi në fund të vitit të jetë sa më i vogël.

**z.Burim Hasani**, në emër të Grupit të AAK-së, theksoi, pasi që edhe ne si Grup nga radhët e AAK-së jemi pro votimit për propozim vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës i cili është për vitin 2023 dhe po ashtu i cili parashikon edhe projektet buxhetore për vitet 2024 dhe 2025, dhe meqë kemi një rritje dhe një dyfishim të buxhetit i cili prek sferën e shëndetësisë, arsimit, bujqësisë dhe sferat tjera, ne jemi për dhe do ta votojmë këtë buxhet.
**z.Florent Hasani**, theksoi, kam pyetje për të cilën pres përgjigje nga ndokush, u përmend Shtatorja e Adem Demaçit, andaj pyes se ku do të jetë lokacioni për vendosjen e Shtatores.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit unë nuk e di se ku është parashikuar ai lokacion dhe se në këtë legjislaturë të Kuvendit nuk është marrë ndonjë vendim për lokacionin.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, është përcaktuar lokacioni dhe nëse nuk gaboj ai është në hapësirën e parkut në afërsi të objektit të vjetër të Komunës
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, është mirë që të jenë prezent në sallë edhe drejtorët e Drejtorive përkatëse në mënyrë që të na japin përgjigje konkrete. Besoj që edhe Komuna e Podujevës e ka një obligim të veçantë ndaj figurës së Adem Demaçit dhe vendosja e një përmendoreje është shumë me rëndësi.
**z.Florent Hasani**, theksoi, mendim i imi është se vendi më adekuat do të ishte aty ku e ceku edhe Kryetari i Komunës, përkatësisht lokacioni përballë objektit të vjetër të Komunës sepse figura e Adem Demaçit e meriton një vend në qendër të qytetit.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në rregull është por në këtë pikë jemi duke diskutuar për buxhetin, andaj në një prej mbledhjeve të radhës mund ta paraqesim si pikë të rendit të ditës dhe të diskutojmë për lokacion.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, sot para vetës kemi një dokument shumë të rëndësishëm të Komunës i cili përcakton edh zhvillimin e përgjithshëm për vitet e ardhshme, mirëpo unë kam vetëm një sugjerim të vogël për drejtorin përkatës, që në këtë projekt buxhet është ndarë një shumë e caktuar për gjelbërimin dhe rregullimin e parqeve vetëm brenda qytetit e nuk duhet të jetë kështu por të shikohen edhe alternativat që të zgjeron parqet edhe në periferi duke përfshirë edhe pjesën veriore të qytetit siç janë pishat e fshatit Kërpimeh, Metehi dhe Dobërdol e që mund t'i jep një impakt pozitiv zhvillimit të qëndrueshëm qytetit tonë. Pra të kemi mundësi që të bëjmë një qytet më të gjerë apo policentrik siç quhet në zhargonin profesional, dhe të mos fokusohemi vetëm brenda qytetit.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, sa për informacionin e juaj, ju njoftoj se tash më janë proceduar projektet për investime te pishat e fshatit Dobërdol dhe te pishat e fshatit Shakovicë që të bëhen staza për t'iu krijuar kushte për rekreacion qytetarët tanë, dhe besoj se do të realizohen që është financim i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, siç e ceku edhe më parë drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, një nga prioritetet e buxhetit për vitin 2023 do të jetë edhe shëndetësia ku nga 27,406,567.oo€ sa do të jetë buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2023, për shëndetësi nga grandi qeveritar do ti kemi 3,330,767.oo€ si dhe nga të hyrat vetanake 72,000.oo€, pra në krahasim me buxhetin e vitit 2022 do të kemi rritje të buxhetit për afër 300,000.oo€ në sektorin e shëndetësisë.
Përveç pagave në shumë 1,917,80.oo€ që merr shumicën e buxhetit, pjesa tjetër e buxhetit për shëndetësi do të destinohet për furnizim me barna dhe reagesna në të cilën kemi rritje të buxhetit, në pajisje mjekësore me oksigjen dhe materiale tjera përcjellëse të cilat nevojiten për mbarëvajtjen e punëve në kuadër të QKMF-së dhe Ambulantave tjera në Komunën e Podujevës.
Sa i përket projekteve madhore në shëndetësi në vitin 2023 do të kemi ndërtimin e QKMF-3 në bashkëfinancim me Chatar, furnizim me pajisje mjekësore, blerje të autoambulancës si dhe renovim të objekteve shëndetësore.

Komuna e Podujevës synon dhe është duke punuar për krijimin e një sistemi primar shëndetësor efikas që ofron shërbime primare cilësore. Shumë punë janë bërë në rritje të buxhetit dhe në investime në objekte si dhe në infrastrukturë, mirëpo sfidë mbetet mos mundësia e punësimit të një numri më të madh të nivelit shëndetësorë personel i mesëm dhe të lartë, mirëpo shpresoj që tani pas takimit të Kryetarit të Komunës me Ministrinë e Shëndetësisë që kishte një ditë më parë, të na mundësohet rritja e stafit shëndetësorë në spitalet tona.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, më shumë se gjysma e territorit të Kosovës është e mbuluar me tokë bujqësore, ndërsa përqindja që jeton në viset rurale arrin në mbi 60%. Bujqësia gjithashtu konsiderohet si një nga sektorët më kyç për zhvillim si nga ana e autoriteteve lokale e qendrore, po ashtu edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtar. Mjetet që investohen në zhvillimin e bujqësisë rriten nga viti në vit dhe krahas vitit 2022 për sektorin e bujqësisë që kanë qenë të ndara 430,000.oo€ subvencione ku prej tyre 130,000.oo€ subvencione për perimkulturë, 50,000.oo€ për bletari, 120,000.oo€ për blegtori, si dhe 130,000.oo€ për mekanizëm bujqësor, ndërsa për vitin 2023 qeverisja e Komunës së Podujevës i ka dhënë rëndësi të madhe buxhetimit të sektorit të bujqësisë duke rritur buxhetin nga 430,000.oo€ sa ka qenë, në 700,000.oo€ që do të thotë se ka rritje afër 60% apo dyfishim të buxhetit. Nga 700,000.oo€ të ndara shuma prej 558,995.oo€ do të jenë grand qeveritar kurse 141,005.oo€ do të jenë nga të hyrat vetanake. Subvencione për perimkulturë do të jenë 200,000.oo€, subvencione për bletari do të jenë 20,000.oo€, subvencione për blegtori do të jenë 280,000.oo€, subvencione për mekanizëm bujqësor janë ndarë 100,000.oo€ si dhe subvencione për pemëtari janë 100,000.oo€, andaj LVV e mbështet dhe e përkrahë këtë projektbuxhet duke shpresuar në rritjen e përkrahjes së bujqve dhe fermerëve edhe në sfera tjera.
**z.Bahri Blakçori**, theksoi, buxheti i Komunës së Podujevës i prezantuar para neve anëtarëve të Kuvendit, nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, mendoj se është një buxhet i planifikuar mirë dhe mbi të gjitha gjithëpërfshirës duke marrë për bazë nevojat specifike të qytetarëve. Me këtë buxhet ashtu siç u potencua kemi rritje të konsiderueshme të investimeve në arsim duke krijuar mundësi që të kemi infrastrukturë më të mirë shkollore , kabinete të shkencave të natyrës, kabinete të TIK, salla dhe fusha sportive por edhe shumë e shumë projekte tjera që kanë të bëjnë me arsimin.
Shpresoj që edhe në vitet në vijim kjo rritje në fushën e arsimit të vazhdoj me qëllimin që të krijohen kushte dhe mundësi për ngritjen e nivelit të cilësisë në arsim.
Rritje të konsiderueshme të investimeve përveç arsimit kemi edhe në sektor tjerë siç është shëndetësia, bujqësia, kultura rinia e sporti, por edhe në sektor të tjerë. Mendoj se me këtë buxhet përmes projekteve të ndryshme do të synohet të realizohen të gjitha kërkesat e nevojshme të qytetarëve tanë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, për Grupin e këshilltarëve të LVV-së buxheti vjetor paraqet një dokument të rëndësishëm për Komunën ku mënyra e planifikimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së tij ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të Komunës tonë dhe në zhvillimin e tërësishëm.
Të nderuar të pranishëm, për Grupin e këshilltarëve të LVV-së dhe analizës që i kemi bërë qoftë bashkërisht qoftë personalisht jemi ardh në përfundim se projektbuxheti i Komunës për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024 dhe 2025, si dhe pas analizës së bërë konstatojmë se projektet në buxhet shprehin kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Podujevës, shfrytëzohet potenciali i tërësishëm për zhvillimin ekonomik, pra ky buxhet është hartuar dhe planifikuar në mënyrë të mirë, me pjesëmarrje të qytetarëve dhe në mënyrë transparente, dhe kur e them këtë e ka parasysh se ka pas disa debate me qytetarë edhe në Komunë por edhe në fshatrat siç ishte Sfeçla, Lluzhani, Orllani, Gllamniku, Kërpimehu dhe ndonjë tjetër që ndoshta mund ta harroj. Prandaj duke i nisur nga ko mendoj që ky buxhet ashtu siç e thash edhe në fillim, realisht është një dokument shumë i

rëndësishëm dhe duhet gjithsesi ta japim edhe kontributin tonë në mënyrë që këtu kemi prioritete dhe kërkesa të qytetarëve.
Sa i përket kësaj më duhet ta përmend edhe një çështje, janë 654 milion euro më shumë që i'u shpërndahen Komunave nga Ministria e Financave, apo nëse marrim me përqindje kemi 15% më shumë buxhet se sa në vitin 2022, informatë të cilën ndoshta më sakt e dinë Kryetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, por kështu e kam marrë në aspektin zyrtar, pra po e përsërisë se për vitin 2023 kemi 654 milion euro më shumë për të gjitha Komunat e Kosovës.
Nëse hyjmë më tutje dhe e analizojmë buxhetin, vërejmë në një rritje ku për vitin 2023 si Komunë kemi një buxhet prej 27,406,567.oo€, dhe nëse e analizojmë buxhetin për vitin 2024 kemi një rritje ku buxheti do të jetë 29,260,509.oo€, pastaj në vitin 2025 buxheti do të jetë 30,423,342.oo€, pra nëse i marrim vitet 2023, 2024 dhe 2025 realisht kemi një rritje të madhe të buxhetit e që mendoj se është interes i qytetarëve, pa dallime politike.
Nëse e analizojmë pastaj buxhetin, e që unë e analizoj dhe e shtjelloj në përgjithësi si dhe e zbërthej, atëherë shkojmë tek prioritetet e Drejtorive, po ashtu mendoj se duhet pasuar kujdes dhe unë vazhdimisht e përsërisë një kërkesë që shpërndarja e projekteve të jetë për të gjithë qytetarët, të mos kemi koncentrim të projekteve por të kemi shpërndarje të projekteve nëpër vende dhe zona të ndryshme.
Nëse e analizojmë buxhetin tek projektet nëpër drejtori unë do të ndalem tek dy apo tri Drejtori, shembull, tek Drejtoria e infrastrukturës i nderuar drejtor z.Bahri Selimi kemi ndërtimin e trotuareve në qytet në vlerë 450,000.oo€ por është mirë që ndërtim të trotuareve të kemi edhe nëpër fshatra për arsye se nëpër disa fshatra më shumë rrezikohet jeta e këmbësorëve që janë nxënës dhe qytetarë ndoshta se sa në qytet, megjithatë është një projekt shumë i mirë me një vlerë të madhe në shumë 450,000.oo€ por ndoshta është mirë që në kuadër të kësaj të kemi edhe trotuare në fshatra të ndryshme.
Edhe një çështje të cilën dua ta ngrisë është tek Drejtoria e Shëndetësisë kemi renovim të objekteve shëndetësore me një vlerë prej 50,000.oo€ e që është në rregull por që ndoshta do të ishte mirë ta dinim se cilat janë ato objekte që do të renovohen, si dhe tek Drejtoria e Arsimit kemi projekt për përmirësimin e infrastrukturës fizike shkollore në vlerë prej 565,000.oo€ e që mendoj se është shumë e mirë, por megjithatë i nderuar drejtor ndoshta do të ishte mirë të specifikohen paksa për cilat shkolla bëhet fjalë.
Pra në përgjithësi kemi një buxhet që është në interes të qytetarëve, prandaj edhe Grupi i LVV-së vendosi të rrinë të qëndrojë dhe të vazhdoj me pikat tjera të rendit të ditës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, fton nëse ndokush dëshiron fjalën, meqë nuk pati, e hedh në votim propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2024-2025, përfshirë ndryshimet e propozuara nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe financave.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 19 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025, me ndryshim plotësimet e propozuara nga drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse. (të cilat teknikisht do të rregullohen dhe sjellën po kjo Drejtori).*

## 2. Propozim Vendimi për ri-alokimin e investimeve kapitale të Komunës për vitin 2022

**z.Fatlum Osmani**, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, lidhur me këtë bëhet fjalë për rialokim bukur të madhe të mjeteve financiare dhe arsyeja e kësaj është se ka disa vonesa për realizimin e projektit të rrugës nga Xhamia, dhe këto mjete duhet të barten në rr."Skënderbeu" në mënyrë që ky projekt të përfundoi këtë vit, dhe një pjesë të tyre në projektin për rrugë dhe rrugica të qytetit.
Vetëm një korrigjim duhet të bëhet në propozim vendim, dhe atë në nenin 1.1 ku bëhet fjalë për kodin buxhetor i cili duhet të korrigjohet dhe të jetë 51911 (jo ashtu siç është në propozim vendim 49283) pra bëhet fjalë për një çështje teknike e cila duhet të korrigjohet, do të thotë që ky propozim vendim duhet të votohet me këtë korrigjim.
**z.Xhevdet Maloku**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës për rialokimin e investimeve kapitale për vitin 2022, përkatësisht rialokimin e mjeteve në projektin për zgjerimin, ndërtimin dhe asfaltimin e rr."Skënderbeu" me infrastrukturë përcjellëse, si dhe për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në qytet, ne si Grup i asambleistëve të LVV-së e mbështesim këtë propozim vendim duke parë intensitetin e punëve në këtë rrugë dhe që përmes kësaj të synohet të përfundojnë punimet sa më shpejt.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve të PDK-ës edhe kur kemi qenë në opozitë e kemi votuar rialokimin e mjeteve financiare me qëllim të realizmit të projekteve të Komunës dhe që suficidi të jetë sa më i vogël.
Edhe në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave lidhur me zgjerimin e rrugëve në qytet, në shumë 172,750.oo€, përndryshe ne jemi Për, që të miratohet ky propozim vendim.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin përkatëse përfshirë edhe korrigjimin e numri të kodit ashtu siç e ceku drejtori i DBF-së.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për ri-alokimin e investimeve kapitale të Komunës për vitin 2022, me ndryshimin e propozuara nga drejtori i DBF-së në fjalën hyrëse, dhe atë; në nenin 1 paragrafi 1.1 pika 1 të propozim vendimit ku figuron ......."kodi-49283", ndryshohet në kodi-51911....*

3. **Propozim Rregullorja për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës**
    **- Raporti nga diskutimet publike**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës edhe ne si Zyrë e Kuvendit kemi pas presione nga biznese të ndryshme lidhur me orarin e punës. Po ashtu kemi edhe disa peticione / kërkesa të cilat kanë ardhur e që njëri prej tyre ka ardh me vonesë dhe nuk është i kompletuar, pra është sjellë pas afatit sa dokumenti ka qenë në konsultim publik, i cili gjithashtu ju është dërguar edhe shefave të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit.
Gjithashtu unë kam pasë një takim edhe me një përfaqësuese të frizerkave e cila është deklaruar se ditën e martë nuk punojnë dhe këtë e kanë vendosë bashkërisht si shoqatë, por dita e diel të jetë ditë pune për këtë fushë. Pra kjo ishte sa për informimin e juaj, ndërsa për çështje tjera e hapim debatin.

**znj.Adelinë Stublla**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, si rezultat i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, propozoj që të hiqen të gjitha përkufizimet për ditët e mos punës së operatorëve ekonomik që veprojnë në Komunën e Podujevës, ndërsa për ditët e mos punës të përcaktohen dhe ta kenë një tabelë njoftuese, si dhe tek neni 4 paragrafi 1.3, riemërimi i festave të bëhet sipas ligjit për festat zyrtare.
Ditët e mos punës të përcaktohen dhe
**z.Vigan Salihu**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, para vetës keni një propozim Rregullore për orarin e punës së bizneseve në Komunën e Podujevës, dokument i cili ka ardhur si rezultat i Grupit punues në përbërje të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve politike ku pastaj janë mbajtur edhe debatet publike si dhe është hartuar raporti përmbyllës lidhur me këtë propozim Rregullore, andaj propozoj që ky draft i Rregullores të votohet.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, edhe ne jemi që kjo propozim Rregullore të kaloj duke përfshirë ndryshimet e propozuar nga znj.Adelinë Stublla.
**z.Haki Rudari**, theksoi, kjo Rregullore është diskutuar nga shumë grupe të ndryshme dhe nga grupe të këshilltarëve andej e këndej, prandaj është mirë që kemi ardhur në këtë përfundim, mirëpo më duhet të them diçka tjetër, më 30 qershor të këtij viti Kuvendi ka marr vendim për themelimin e komisionit nga përfaqësues të Partive politike dhe përbërja e tij ka qenë prej 9 anëtarëve, komision i cili ka mbajtur 2 takime punues. Në takimin e parë që është mbajtur, sipas të gjitha gjasave kanë qenë të gjithë të pranishmit për arsye se këtu specifikohet, mirëpo në takimin e dytë të mbajtur më 12.08.2022 sa unë kam informata nga 9 anëtarët e komisionit, kanë marrë pjesë vetëm 5 prej tyre, do të thotë 4 janë "avulluar". Pastaj në takimin e radhës që është mbajtur më 28.08.2022 nga ora 10;00 në sallën e Kuvendit komunal kanë marrë pjesë vetëm 3 anëtarë të komisionit, (pra prej 9 në 5 dhe mandej prej 5 në 3), dhe prej aty është marrë vendim që të mbahen 2 debate me qytetar dhe grupe të bizneseve e që pastaj në takimin që është mbajtur me biznese me datë 28.08.2022 kanë marrë pjesë vetëm tre, ndërsa në takimin publik që është mbajtur me 29.08.2022 ka marrë pjesë vetëm një person dhe atë vetëm drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, andaj mendoj se kjo nuk është në rregull për arsye se ky Kuvend e ka formuar një komision prej gjitha partive politike e që mendoj se kjo është shumë e mirë dhe me një transparencë të madhe, por të njëjtën kohë kemi paksa ikje nga detyra dhe përgjegjësitë e marra si komision.
Megjithatë u tha edhe nga kolegia parafolëse se e përkrahim, e që edhe unë e përkrahi këtë Rregullore në mënyrë që qytetarët të mos pësojnë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, pyeti nëse ndokush është i interesuar ta marrë fjalën, por me që nuk kishte të lajmëruar, theksoi se e hedh në votim propozim Rregulloren sipas kësaj pike të rendit të ditës duke

përfshirë edhe propozim ndryshimet e dhëna nga anëtarja e Kuvendit znj.Adelinë Stublla të cilat ndoshta do të ishte mirë t'i kishim me shkrim, mirëpo nëse nuk gaboj propozimet ishin që tek neni 4 pika 1.3 festat zyrtare të riemërtohen sipas ligjit për Festat zyrtare, si dhe të gjitha kufizimet tjera për ditën e diele të hiqen për bizneset, por që nga kjo konsideroj se nuk përfshihet nenit 15 i cili është i rregulluar në mënyrë të veçantë e që ka të bëjë me barnatoret, si dhe çështje tjera të cekura.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Rregullorja për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe ndryshim plotësimet e propozuara, dhe atë;*

- *Festat zyrtare të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 1.3 të kësaj rregulloreje të riemërtohen sipas Ligjit për festat zyrtare.*
- *Të bëhet heqja e të gjitha kufizimeve për ditët e mos punës së bizneseve, me përjashtim të nenit 15.*
- *Bizneset të vendosin orarin e tyre të punës duke përfshirë edhe ditën e mos punës, nëse ato vet caktojnë ditë të mos punës.*

(Teksti i Rregullores të riformulohet, përkatësisht të spastrohet sipas këtij konstatimi)

**4. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL 2023-2025**

**z.Vigan Salihu**, U.D. drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ky dokument është hartuar duke u bazuar në Udhëzuesin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal i përgatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale sipas të cilit Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal ku në mënyrë të precizuar përcaktohet edhe fusha e zhvillimit ekonomik lokal.
Ne si Drejtori kemi zhvilluar të gjitha procedurat ashtu siç është praktikë edhe në komunat tjera ku këto Strategji hartohen nga kompani të specializuara, andaj kërkojmë nga Kuvendit që ta votoni Për, që ky dokument të vëhet në diskutim publik si dhe kërkoj që gjatë periudhës së diskutimeve publike të jepen sugjerime, propozime dhe rekomandime në mënyrë që në fund të procesit të kemi një dokument sa më kualitativ.
Kohëzgjatja e diskutimit publik propozoj të jetë nga data 05 tetor 2022 deri më 05 nëntor 2022, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 13 tetor 2022 duke filluar nga ora 13;30.
**z.Xhevdet Maloku**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal ka një rëndësi të madhe se cilat janë prioritetet dhe objektivat e Komunës që të zhvilloj ekonominë në nivel lokal, zhvillimin e ambientit dhe të bërit biznes dhe aktiviteteve bujqësore, zhvillimin dhe përmirësimin e aktiviteteve arsimore, shëndetësore, mirëqenies sociale, urbanizmit, turizmit dhe kështu me radhë. Sipas të dhënave statistikore në këtë draft Komuna e Podujevës ka strukturë të moshës relativisht të re ku rreth 49.5% janë nën moshën 24 vjeçare ndërsa vetëm 5.8% i takojnë grup moshave jo aktive për punë. Kjo draft Strategji ka paraparë në mënyrë mjaft të qartë objektivat se si duhet përkrahur bizneset, bujqit, arsimin, shëndetësinë dhe të gjitha fushat që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve të Komunës së Podujevës.

Tek objektivat rreth zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të ambientit të të bërit biznes, krahas programeve që janë dhënë në këtë draft vihet si prioritet përkrahja sa më e madhe në fushën e inovacionit dhe teknologjisë e që është e ardhmja e ekonomive të çdo lloj kategorie, andaj duke pasë parasysh statistikat që i ceka më lartë që Podujeva ka strukturë moshore relativisht të re, ta shfrytëzojmë në inkurajimin e tyre drejt bizneseve inovative të cilat janë tërheqëse për rininë tonë.
Po ashtu jashtëzakonisht është e mirëseardhur Strategjia ku synohet përmirësimi i cilësisë në menaxhimin dhe mësimdhënien nëpërmes vlerësimit sipas metodologjisë 360° (shkallë) ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, pastaj mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit. Po ashtu duke pasë parasysh arsimin në shoqërinë moderne, ne si Grup nga radhët e LVV-së e përkrahim vënien në diskutim publik të këtij draft dokumenti.
**z.Bashkim Syla**, në emër të Grupit të PDK-së, theksoi, edhe ne e përkrahim këtë draft Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal që ky dokument të vëhet në diskutim publik, ndërsa kontributin tonë do ta japim përmes diskutimit publik.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025, përfshirë edhe propozimin e drejtorit të Drejtorisë sa i përket kohëzgjatjes dhe datës së diskutimit publik.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL 2023-2025, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 13 tetor 2022 nga ora 11;30.*

5. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban**

**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozimi, theksoi, Plani Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban është një plan strategjik nga fusha e trafikut dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe që të siguroj cilësi më të mirë të jetesës.
Mibiliteti i Qëndrueshëm Urban është një sferë e re e veprimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës dhe edhe pse kjo është praktikë në Bashkimin Evropian, deri më tani shumë qytete Evropiane kanë zbatuar Plane të tilla urbane dhe kanë ndërmarrë një sërë aktivitetesh të ndryshme në këtë drejtim.
Komisioni Evropian mbështet në mënyrë aktive miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban dhe jap udhëzime të vazhdueshme rreth hartimit të këtij lloji të planifikimit, siguron promovimin e praktikave të mira si dhe mbështetjen dhe edukimin e profesionistëve në këtë sferë.
Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Podujevës bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë si dhe në parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mobilitetin e qëndrueshëm urban dhe mbështet në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor,

Ligjin për transportin rrugor, Ligjin mbi rrugët, Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për policinë dhe në Ligjin e planifikimit hapësinor.
Duke u bazuar në rëndësinë e madhe që ka Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, ju ftoj ta miratoni dhe njëkohësisht kërkoj nga ana juaj ta mbështetni me votën tuaj për t'i dhënë mundësi diskutimit publik me që rast do të përfshihen qytetarët për të dhënë kontributin e tyre si dhe për këtë plan kërkoj edhe konstibutin e juaj duke dhënë vërejtje dhe sugjerime në fazën e diskutimit publik, ndërsa propozoj që diskutimi publik të zgjasë 30 ditë dhe atë nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022 ndërsa data e organizmit të debatit me qytetar të jetë 11.10.2022 duke filluar nga ora 17:00 në sallën e Kuvendit.
**z.Adelinë Stublla**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, ne si grup nga radhët e LVV-së e përkrahim dhe e mbështesim draftin në fjalë, si dhe të gjitha idetë tona do t'i cekim gjatë debatit me qytetarë.
**z.Arbnor Fazliu**, theksoi, po ashtu edhe ne si Grup nga radhët e AAK-së e mbështesim këtë propozim dhe njëkohësisht jamë shumë i lumtur që vije nga fusha e transportit dhe jamë shumë i lumtur që bëhet kjo.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar për të marr fjalën, e hedh në votim propozim vendimin përkatës duke përfshirë edhe propozimet e drejtorit të Drejtorisë përkatëse sa i përket kohëzgjatjes së diskutimit publik. Pra meqë ky dokument është sjellë për mbështetje nga ana e Kuvendit që i njëjti të del në diskutim publik e pastaj të sjellët sërish në Kuvend për miratim final, është mirë që ne sot ta përkrahim.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 11 tetor 2022 nga ora 17;00.*

6. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Bonuset e Zonimit**

**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i SHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozimi, theksoi, në fakt këtë propozim e ka sjellë z.Leutrim Krasniqi drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i cili edhe do të duhej ta sqaronte tani, mirëpo për shkak se nuk ka pas mundi t'i shmanget një takimi shumë të rëndësishëm në Prishtinë, më ka autorizuar mua të paraqes atë që ai e ka planifikuar ta paraqesë sot para juve.
Siç e dimë Harta Zonale paraqet një dokument të planifikimit hapësinor që detajisht përcakton kushtet zhvillimore për tërë territorin e Komunës, dhe se një dokument të tillë veç se e kemi miratuar këtë vit. Pjesë inkoorporuese e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës si dhe Udhëzimit Administrativ për hartimin e Hartës Zonale të komunës janë edhe bonuset e zoonimit të cilat janë stimuj që jepen nga Komuna në këmbim të një përfitimit publik, pra bonuset e zonimit jepen me qëllim për rritur hapësirat publike, për përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve, ofron ruajtje të sipërfaqeve kulturore dhe historike, ruan tokat bujqësore, krijon ndërtesa prej të cilave

përfiton komuniteti, përmirëson vendbanimet joformale si dhe ofron mundësi të tjera nga Komuna të cilat janë në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal.
Duke marrë parasysh këtë aspekt, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, së bashku me Grupe punuese kemi hartuar këtë Draft Rregullore për bonuset e zonimit, dhe meqë kjo draft Rregullore është e para në nivel vendi nuk do të thotë që është e përkryer, andaj për këtë arsye inkurajoj anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët që të japin sugjerime dhe mendime lidhur me këtë rregullore e cila do t'i nënshtrohet diksutimit publik dhe atë nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022 ndërsa debati publik me qytetar mbahet më 12.10.2022 duke filluar nga ora 17;00, në sallën e Kuvendit.
**z.Florent Hasani**, në emër të Grupit të LVV-së, theksoi, e mbështesim këtë propozim vendim për vënie në diskutim publik të draft Rregullores në fjalë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, atëherë e hedhim në votim, duke përfshirë edhe propozimin rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Bonuset e Zonimit, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 12 tetor 2022, nga ora 17;00.*

7. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi**

**z.Bahri Selimi**, U.D. drejtor i SHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sa i përket këtyre draft rregulloreve/vendimit nga pikat 7, 8 dhe 9, po mundohem tani që ndoshta t'i paraqes sqarimet e nevojshme për të tria këto drafte në mënyrë që të mos marrë kohë duke e marrë fjalën për secilën veç e veç, ngase pothuajse kemi të bëjmë me çështje të njëjtë dhe janë si rrjedhojë e Planit të mobilitetit, prandaj edhe i kemi vendosur të gjitha para Kuvendit në mënyrë që të japim hapësirë dhe rrugë për diskutime publike dhe krejt në fund për t'i miratuar gjatë këtij viti dhe për të filluar me zbatimin e tyre në fillim të vitit të ardhshëm, nga 01 janari.
Sa i përket kohëzgjatjes së diskutimeve publike për këto tri propozime sipas pikave 7, 8. Dhe 9 janë si në vijim:
-Për draft Rregulloren për transportin e udhëtarëve me automjete taksi, propozoj që diskutimi publik zgjatë 30 ditë dhe atë nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse debati me qytetar mbahet më 14.10.2022 nga ora 17;00, në sallën e Kuvendit.
-Për draft Rregulloren për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës, propozoj që diskutimi publik zgjatë 30 ditë dhe atë nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse debati me qytetar mbahet më 25.10.2022 nga ora 17;00, në sallën e Kuvendit.
-Për propozim Vendimin për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit, propozoj që diskutimi publik zgjatë 30 ditë dhe atë nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse debati me qytetar mbahet më 28.10.2022 nga ora 17;00, në sallën e Kuvendit.
Pra për secilin prej këtyre drafteve jam i gatshëm t'iu përgjigjem veç e veç, mirëpo i paraqita që të tria me qëllim që të mos marrë kohë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, drejtori parafolës e paraqiti fjalën hyrëse për tri draftet e dokumenteve sipas pikave 7, 8 dhe 9 të rendit të ditës dhe njëkohësisht i paraqiti edhe propozimet për kohëzgjatjen e diskutimeve publike si dhe çështjeve tjera përkatëse, andaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, i hedh në votim veç e veç propozim vendimet për vënie në diskutim publik, përfshirë edhe propozimet rreth kohëzgjatjes së diskutimeve publike.
**z.Haki Rudari**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, pavarësisht se drejtori parafolës i paraqiti tri pikat përkatëse të rendit të ditëm përnjëherë, mendoj se votimi duhet të bëhet ndaras për secilën pikë veç e veç.
**Kryesuesi i Kuvendit**, përgjigje parafolësit, theksoi, edhe unë ashtu e potencova dhe ashtu ish duke vepruar, mirëpo vetëm isha duke thënë se në qoftë se ndokush dëshiron fjalën për secilin propozim mund ta kërkoni dhe të diskutoni.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 14 tetor 2022, nga ora 17;00.*

8. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 25 tetor 2022, nga ora 17;00.*

9. **Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, miratohet propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit, me plotësimet e propozuara rreth kohëzgjatjes dhe datave të diskutimit publik, dhe atë; që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 30 ditë, nga data 05.10.2022 deri më 05.11.2022, kurse diskutimi publik me qytetar të mbahet më 28 tetor 2022, nga ora 17;00.*

## 10. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB për vitin 2021

**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera, theksoi, meqë para vetës keni Informatën në fjalë rreth aktiviteteve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021, unë nuk do të doja të marrë kohë më shumë, por gjithsesi jam i hapur për ndonjë sqarim eventual që mund të keni, prandaj meqë Informata ju është dërguar me kohë të gjithëve dhe keni pas kohë të mjaftueshme ta lexoni dhe analizoni të gjitha aktivitetet e trajtuara në mbledhje e të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me çështjen e sigurisë brenda për brenda Komunës së Podujevës.
Kemi bërë përpjekje që takimet të jenë të rregullta dhe që të shoshiten të gjitha këto probleme duke raportuar nga organet kompetente të sigurisë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, e dëgjuam Kryetarin e Komunës, rreth informatës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mirëpo unë shkurtë dua të them se në të ardhmen e që parashihet edhe me Udhëzim të vije dhe të raportoj apo të jep një informatë në Kuvendin e Komunës edhe Komandanti i Policisë, është me Rregullore, parashihet edhe me Udhëzim, andaj do të ishte mirë që në të ardhmen të bëhet edhe kërkesë zyrtare në emrin tim personal, për arsye se kemi disa çështje në Komunë e të cilave nuk mund t'iu ikim, kemi shumë vjedhje, kemi shumë aksidente në komunikacion, kemi shumë probleme nëpër oborre të shkollave apo siguria në shkolla, dhe në këtë drejtim mendoj se ndoshta do të ishte shumë mirë në njërën prej seancave të radhës të vije edhe Komandanti i Policisë në Podujevë dhe të raportoj në Kuvendin e Komunës, e që edhe njëherë po e përsërisë se është obligim.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, me kënaqësinë më të madhe, në qofte se e vlerësoni të nevojshme, në seancën e radhës pa problem mund ta ftojmë Komandantin e Stacionit të Policisë. Zyra ligjore ta ketë parasysh që ftesa t'i bëhet me kohë Komandantit të Policisë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se fillimisht është mirë ta konsultojmë Komandantin e Stacionit të Policisë në Podujevës, se kur ai ka kohë dhe pastaj mund ta përfshijmë këtë çështje si pikë të rendit të ditës në njërën prej seancave të radhës së Kuvendit.
Nga përvoja ime në kuvend jam në dijeni se në të kaluarën Komandanti i Stacionit të policisë ka dhënë informata në Kuvendin e Komunës, dhe besoj se edhe ky që është aktualisht Komandant nuk heziton ta bëjë një gjë të tillë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, sa më kujtohet në vitin 2016 i kemi bërë kërkesë si Kuvend dhe në atë kohë është ardhë Komandanti i Stacionit të Policisë dhe ka dhënë një informatë si dhe ka qenë një bashkëbisedim shumë i sinqertë dhe shumë në interes të qytetarëve.
Realisht unë kam shumë kërkesa që ndoshta do t'i drejtohesha Komandantit, por në mungesë të tij po më pamundësohet t'i paraqesë ato, po të ishte prezent do t'i paraqisja.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se edhe kjo pikë e rendit të ditës përfundoj, dhe vazhdojmë me pikat e radhës.

*Kryesuesi i Kuvendit e konstaton të përfunduar këtë pikë e rendit të ditës*

11. **Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, për vitin 2022 - Kalendari i aktiviteteve të rregullta**

**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, e paraqiti propozim Planin e Punës së KKSB për vitin 2022, theksoi, para vetës e keni propozim planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, plan i cili është hartuar nga një grup punues të cilit i ka prirë një përfaqësues apo kryesues i një OJQ-je dhe qëllimi ka qenë që brenda për brenda këtij plani të punës të përfshihen të gjitha ato veprimtari dhe aktivitete të cilat duhet të kryhen brenda kësaj periudhe kohore, duke filluar nga analiza e problemit, objektivat dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren, akterët që duhet të përfshihen në gjithë këtë proces, si dhe monitorimi i vlerësimit të përmbushjes në dy periudha kohore gjashtëmujore.
Në këtë draft i kemi përfshirë të gjitha aktivitetet që parashikohen por njëkohësisht është përfshirë edhe periudha kohore kur duhet të ndërmerren të gjitha këto veprime, prandaj nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë paqartësi eventuale, jam i gatshëm t'ju jap përgjigje konkrete edhe pse janë të detajizuara brenda për brenda këtij plani të punës.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, vetëm desha një sqarim i cili sigurisht është një gabim teknik tek kalendari i aktiviteteve të rregullta, konkretisht tek pika 26 thuhet; formimi i grupit punues për përgatitjen e planit të punës për vitin 2022 e cila është e paraparë në muajin dhjetor, e që mendoj se do të duhet të jetë për vitin 2023.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim plan të punës së KKSB-së për vitin 2023, përfshirë edhe korrigjimin e gabimit që e paraqiti parafolësi.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 19 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, me vendim miratohet propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, për vitin 2022, me korrigjimin e gabimit teknik, dhe atë; na kalendarin e aktiviteteve të rregullta ku thuhet, .....“ngritja e grupit punues për hartimin e planit të punës për vitin 2022”, të korrigjohet viti, të bëhet 2023.*

12. **Matja e performancës së Komunës për vitin 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është sjellë me insistimin e Nënkryetares së Komunës znj.Margionë Lahu, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, sa i përket performancës komunale për vitin 2022, ajo është në nivelin 55.27%. kjo përqindje e performancës është më e ulët, madje më ulët se mesatarja e performancës së Komunave të Kosovës në nivel vendi që ka qenë 57%. Si ilustrim po ju paraqes disa perfomanca të disa Komunave në nivel vendi, shembull, Skenderaj e ka pas 59% perfomancën, Prizreni 60%, Peja 59%, Obiliqi 67%, Mitrovica e Jugut 67%, Lipjani 65%, Gjilani 60%, kurse Deçani performancën e ka pas 68%. Se çfarë i ka ndaluar të shënohet një performancë më e mirë në vitin 2020 Komunën e Podujevës, mund ta dinë vetëm ata që kanë udhëheqë në atë kohë.
Në bazë të asaj se çfarë performance tregojnë Komunat gjatë vitit 2019, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Agjencia Zvicrrane e Zhvillimit, në bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, përmes projektit Demos kanë bashkuar skemat e grandev duke krijuar një grand të vetëm që synon përmirësimin e performancës e Komunave në qeverisje demokratike, menaxhim komunal dhe ofrim të shërbimeve. I quajturi grandi i performancës

komunale ka pasë një buxhet vjetor 4.5 milion euro, e që edhe pse mundësitë për ë përfituar nga ky grand kanë qenë të barabarta për të gjitha Komunat e Kosovës, për shkak të performancës së ulët të treguar nga ana e Komunës së Podujevës, ne si Komunë nuk kemi fituar nga ky grand.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, është e vërtetë se matja e performancës së Komunës së Podujevës është nën nivelin e Komunave tjera, mirëpo krahas kësaj është edhe një tabelë ku tregon se në cilat fusha ka çaluar Komuna e Podujevës, do të thotë ka shumë rubrika dhe shumë fusha që ka 0%, andaj me përmirësimin e tyre unë mendoj se në të ardhmen Komuna mund ta ngrisë nivelin dhe të jetë përfituese e grandeve në shumë fusha tjera.
Shembull, kemi hapësirat për aktivitete sportive për numër të banorëve që është 0%, për auditim të brendshëm për raportim para Kuvendit të Komunës është 0%, pra janë kështu disa fusha ku matja e performancës së Komunës së Podujevës është vlerësuar 0%.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka nevojë të votohet, dhe meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar këtë pikë dhe kalojmë në pikën e radhës.

*Kryesuesi i Kuvendit e konstaton të përfunduar këtë pikë e rendit të ditës*

13. **Ndryshimi i përbërjes së Komisionit Komunal të aksionarëve të ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë (*pas ofrimit të dorëheqjes nga njëri prej anëtarëve të Komisionit nga radhët e Kuvendit të Komunës - bashkëngjitur në material*)**

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, siç dihet anëtar i këtij Komisioni ka qenë z.Fitim Muçolli i cili për arsye personale ka dhënë dorëheqje. Gjithashtu në mbledhjen e KPF-së është diskutuar kjo çështje dhe nga Grupi i LVV-ës është propozuar që i përmenduri të zëvendësohet nga anëtari i Kuvendit z.Kasib Bashota, andaj urdhëroni nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht ndryshimin e përbërjes së Komisionit sipas asaj që u cek.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 18 vota Për, nga të pranishmit në mbledhje, me vendim miratohet propozimi për ndryshimin përbërjes së Komisionit Komunal të aksionarëve të ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë, dhe atë;*
*Në vend të z.Fitim Muçolli, ish anëtar i komisionit, nga radhët e Kuvendit të Komunës, i cili ka paraqitur kërkesën për dorëheqje, emërohet z.Kasib Bashota, anëtar i Komisionit Komunal të Aksionareve në Ndërmarrjen Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.*

14. **Të ndryshme**

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalë, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje*

**Mbledhja përfundoi në ora 11;45**

**Procesverbalin e mbajtën;**
**Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0084060/22** — **Kryesuesi i Kuvendit**
**Podujevë, datë, 29 shtator 2022** — **Hilmi Hoxha**

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h), ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja c) dhe 40.2 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neneve 2.1, 8 si dhe Kreu II dhe Kreu III të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 dhe nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

**P R O P O Z O N**

## RREGULLORE
## PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

### I.
### Dispozitat e përgjithshme

**Qëllimi**
**Neni 1**

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e taksave, tarifave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor, mënyra e caktimit dhe arkëtimit të tyre si dhe kriteret tjera për zbatimin e kësaj Rregulloreje në territorin e Komunës së Podujevës.

### II.
### Taksat, tarifat dhe gjobat komunale
**Neni 2**

**1.** Taksat administrative komunale.
**2.** Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare.
**3.** Taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe shërbime profesionale.
**4.** Taksat për leje për ndërtim dhe rrënim të ndërtesave dhe strukturave tjera.
**5.** Tarifat për shërbime publike.
**6.** Taksat në transaksion të pasurisë së paluajtshme.
**7.** Taksat për regjistrimin vjetor të automjeteve motorike.
**8.** Tarifat për shërbime dhe produkte kadastrale.
**9.** Taksat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.
**10.** Bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore.
**11.** Tarifat dhe taksat administrative në lëmin e arsimit.
**12.** Taksa dhe tarifa tjera komunale.
**13.** Gjobat nga trafiku.
**14.** Gjoba për ndërhyrje pa leje në infrastrukturë publike.
**15.** Gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.
**16.** Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen do të caktohen sipas Drejtorive përkatëse.

**Neni 3**

**1.** Obligues të taksave dhe tarifave komunale sipas kësaj Rregulloreje janë personat juridik dhe personat fizik.

**2.** Obligimi për pagesën e taksës dhe tarifës komunale fillon në momentin e shfrytëzimit të së drejtës, sendeve dhe shërbimeve përkatëse.

**3.** Obligimi i taksës komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe për shërbime profesionale fillon prej datës së regjistrimit të subjektit në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës.

| | Taksat e paisjeve motorike(gjobat në trafik, regj i auto., agjens.i pyjeve) | 20,342 | 263,077 | 1,293 | 152,482 | 72.53% |
| | Lejet për ndërtesa | 50,000 | 120,026 | 240 | 19,497 | 515.61% |
| | Taksat tjera komun.(aktiv.gjeo. dhe shërb e inspektimit) | 42,667 | 119,541 | 280 | 117,817 | 1.46% |
| | Takse per mbeturina | | | #DIV/0! | | |
| 1.1.3 | Ngarkesat komunale | 346,950 | 253,466 | 73 | 190,424 | 33.11% |
| | Ngarkesat regullatore | | | #DIV/0! | | #DIV/0! |
| | Të hyrat nga qiraja(shfryt.i pronës komunale) | - | 110,699 | #DIV/0! | 75,538 | 46.55% |
| | Bashkë-pagesat për arsim | 75,000 | 80,534 | 107 | 48,970 | 64.46% |
| | Bashkë-pagesat për shëndetësi | 72,000 | 62,234 | 86 | 65,916 | -5.59% |
| | Ngarkesat tjera komunale | 199,950 | | - | | #DIV/0! |
| 1.1.4 | Të hyrat tjera(të ardhurat tjera-taksat administrative) | 65,722 | 38,884 | 59 | 49,481 | -21.42% |
| 1.1.5 | Gjobat e gjykatës | | 19,940 | #DIV/0! | 400 | 4885.00% |
| 1.1.6 | Shitja e aseteve | | | #DIV/0! | 5,470 | -100.00% |
| 1.1..7 | Te hyrat nga kultura | | 300 | | | |
| | Gramet dhe donacionet | | 167,393 | #DIV/0! | 55,923 | 199.33% |
| | Vendore | | 129,385 | #DIV/0! | 55,923 | 131.36% |
| | Të huaja | | 38,008 | #DIV/0! | | #DIV/0! |
| 1.1.7 | Konfiskim i garanciont te tenderit | | | | | |

Te hyrat nga donacionet nuk jane kalkuluar si te hyra vetanake.

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 11, 12.2 shkronja d) 14.1 dhe 17 shkronjat c) dhe f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 26 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2; nenin 14; 15 paragrafi 2.4; 17 dhe 19 paragrafët 1.3 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit të datës 19.10.2022, Kuvendit të Komunës, i,

***P r o p o z o h e t***

**VENDIM**
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E STACIONIT TË AUTOBUSËVE - PODUJEVË**

**Neni 1**

**1.** Me këtë vendim caktohet lokacioni me destinim për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës, si në vijim:
*Paluajtshmëria e evidentuar në Certifikatën pronësore me nr.08-942/06-0088795/22 datë 18.10.2022, në Njësinë kadastrale parcelë P-71712062-01541-2, Pronë e Komunës, me sipërfaqe prej 20000m², Zona Kadastrale Podujevë, sipas Certifikatës pronësore, kopjes së planit dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij vendimi.*

**Neni 2**

Lokacioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, është në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës-Hartën Zonale (shfrytëzim për infrastrukturë të transportit rrugor) dhe i njëjti caktohet në funksion të interesit të përgjithshëm, përkatësisht për realizimin e projektit të planifikuar në bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës.

**Neni 3**

Nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës, zbatimin e vendimit e bëjnë, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

**Neni 4**

**1.** Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
**2.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.prot.01-353-36607 i datës 29 prill 2016 për ndërtimin e objektit të palestrës së sporteve në Podujevë.

**Nr.prot.** 02-353/01-0083310/22
**Podujevë, datë:** 19.10.2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-01541-2

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/06-0088795/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 18.10.2022 - 09:08 |
| Komuna / Opština / Municipality: | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Podujevë / Podujevo / Podjevë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar në datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71712062-01541-2 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 20000 | RDPP-2005 | 20.04.2016 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar në datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| HAVOLLËT-FIDANISHTJA E POSHTME | | | 20.04.2016 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E PODUJEVËS

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Povrsina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land | 20000 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Podujevës** | 600534946 | PODUJEVË / PODUJEVO / PODIJEVË / | | NUHI GASHI | **1/1** | RDPP-2005 | 20.04.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Podujevë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71712062-01541-2 | Parcelë / Parcela / Parcel | 20000 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1280

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 18.10.2022
Koha/ Vreme/ Time: 09:11:58
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtor/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

# INFORMIM

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjës së Mjedisit (DPUMM) e Komunës së Podujevës pas shqyrtimit të kërkesës, ju informon se:

Duke u bazuar në Harten Zonale 2022-2030 të Komunës së Podujevës e miratuar me Vendimin nr.prot 01-020/02/0030654/22 në Kuvendin e Komunës (data: 29.04.2022) konfirmuar në aspektin e ligjshmërisë përmes Shkresës nr 020-402/7 (data: 20.05.2022) nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës si dhe e publikuar në Web faqe të komunës më 27.05.2022.

Pas verifikimit të kërkesës në QGIS të të dhënave në formatin *Shape file, DPUMM vjen në konstatim se:

| | |
|---|---|
| Numri i Protokolit: | 07-351/05-0088996/22 |
| Parcela: | 01541-2 |
| Zona kadstrale: | Podujevë |
| Komuna: | Podujevë |
| Destinimi: | Ndërtimor-Banim ( Q2J B1 ) |
| Zonë e mbrojtur: | Jo |

Përfundimisht, ju informojmë se ndërtimi i stacionit të autobusëve në këtë parcelë është konform Hartës Zonale Komunale që përfshihet në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara,më saktësisht në infrastrukturën e transportit rrugor,( stacion i autobusëve ).

Përshkrimi shtesë: (2) dy kopje të pjesës grafike: (1) një Kopje nga QGIS (Shapefile) dhe (1) një kopje nga gjeoprotali-Kosovë. Përcaktimi është bërë në bazë të pikave kordinative të parcelës që gjendën në gjeoportalin e Kosovës.

Data e shqyrtimit: 18.10.2022.

Drejtor:

Leutrim Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË/O


01541-2
PAECELA ME NR:01541-2 ZK PODUJEVË
Q2J B1 / K.2.5- BONUS 4.0
ZONË NDËRTIMORE ( BANIMI)



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT**

**Për: z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**

**Lënda: Propozim për Kuvendin e Komunës**

I nderuar Kryetar,

Në kuadër të planifikimeve është paraparë edhe ndërtimi i Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës, dhe atë në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë si dhe me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kemi evidentuar lokacionin për ndërtimin e Stacionit, lokacion i cili është në harmoni me dokumente të planifikimit hapësinor dhe i cili konsiderojmë se është mjaft i përshtatshëm.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, planifikon që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës të procedojmë këtë çështje.

Andaj bashkëngjitur gjeni propozim vendimin përkatës i cili pas nënshkrimit nga ana Juaj, do të procedohet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

*Vlen të theksohet se parcela përkatëse në bazë të një vendimi të vitit 2016 është caktuar për lokacion të ndërtimit të palestrës së sporteve në Podujevë, Vendim i cili duhet të shfuqizohet.*

**Me respekt**
**Podujevë, 19.10.2022**

**Drejtori**
**Bahri Selimi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Në mbështetje të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja e) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafi 1.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, për mbledhjen e caktuar më 31 tetor 2022, i,

*Propozohet*

**V E N D I M**

**Për mbrojtjen e vlerës së natyrës: "Ushton Lumi" në Popovë - Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur**

**Neni 1**

Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës "Ushton Lumi", në fshatin Popovë - Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur (këtu e tutje: Peizazh i Mbrojtur).

**1.1.** Peizazhi i Mbrojtur përfshinë sipërfaqen prej 92 hektar.

**1.2.** Peizazhi i Mbrojtur ka pamje karakteristike dhe me vlerat natyrore të rralla jo vetëm për territorin e Komunës së Podujevës por edhe më gjerë.

**Neni 2**

Peizazhi i Mbrojtur gjendet zonën Kadastrale Popovë, në parcelat: nr.P-71712063-01597-0; P-71712063-00040-0; P-71712063-00304-0; P-71712063-00301-0 dhe P-71712063-00314-0 me sipërfaqe 92 ha (sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi).

**Neni 3**

Peizazhi i Mbrojtur sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së V-të, Peizazhi i Mbrojtur (Protection Landscape).

**Neni 4**

Për Peizazhin e Mbrojtur përcaktohet regjimi i mbrojtës i shkallës së V-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat, ndalohet:

a) Ndërhyrje dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallur i mbrojtur
b) Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme
c) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur
d) Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur
e) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
f) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
g) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Peizazhit të Mbrojtur
h) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera
i) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike
j) Ndërrimi i kulturës
k) Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Peizazhit të Mbrojtur

**Neni 5**

**1.** Peizazhi i Mbrojtur dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Peizazhin e Mbrojtur.

**2.** Në Peizazhin e Mbrojtur lejohen;

Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Peizazhit të Mbrojtur nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Peizazhit të Mbrojtur si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Peizazhit të Mbrojtur

**Neni 6**

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Podujevës, përmes Drejtorisë përkatëse.

**1.** Komuna është e detyruar që:

a) Peizazhin e Mbrojtur ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes

b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Peizazhin e Mbrojtur mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Peizazhit të Mbrojtur në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura

**Neni 7**

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Peizazhit të Mbrojtur

**Neni 8**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr. prot.** 01-352/04-0089591/22
**Podujevë, datë:** 20/10.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO - PODUJEVË

**Drejtori**
**Neutrim Krasniqi**




*Harta e Peizazhit të Mbrojtur "Ushton lumi", në Popovë*

*Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova*

***Komuna e Podujevës*** ***Opština Podujevo*** ***Municipality of Podujeva***

**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit**

## RAPORT I DISKUTIMIT PUBLIK

Diskutimi publik për arsyesëhmërin profesionale për "*Ushton lumi*" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës në kategorinë e peizazhit të mbrojtur" ka qenë i publikuar në faqen e komunës nga data 08.07.2022 -08.08.2022, si dhe më datën 26.07.2022 nga ora 10:00 është mbajtur debati publik, në sallën e kuvendit komunal të Podujevës

Debatin publik e hapi dhe e udhëhoqi z.Sami Behrami, zyrtar nga Instituti për Mbrojtje të Natyrës i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përveç zyrtarëve të komunës dhe përfaqësuesit të fshatit Popovë, qytetarë tjerë nuk kishte.

Konsatim: Nga diskutimi publik dhe debati publik nuk ka pasuar asnjë ndryshim.

Zyrtari i Mbrojtës së Mjedisit

Rizah Muçolli

Podujevë

Më: 20.10.2022

**Republika e Kosovës**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**
**Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit**
**Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës**

# Arsyeshmëria profesionale për shpalljen e zonës " Ushton lumi" në Popovë si zonë të mbrojtur të natyrës.



Prishtinë, 2022

Grupi punues për përgatitjen e arsyeshmërisë/ propozimit profesional për shpalljen e zonës " Ushton lumi" në Popovë të komunës së Podujevës si zonë të mbrojtur të natyrës.

Sipas, Vendimi 24/AMMK/2021, datë 31.03.2021, anëtar të këtij Grupi punues janë:

| | |
|---|---|
| **Sami Behrami,** | IKMN, kryesues |
| **Qenan Maxhuni**, | IKMN, zëvendës kryesues |
| **Nexhmije Kamberi**, | IKMN, anëtare |
| **Sami Sinani,** | DMMU, anëtarë |
| **Fitim Humolli**, | Universiteti i Prishtinës, anëtarë |
| **Elez Krasniqi,** | Universiteti i Prishtinës, anëtarë |
| **Rizah Muqolli**, | Komuna e Podujevës, anëtarë |
| **Vigan Salihu,** | Komuna e Podujevës, anëtarë |
| **Ejup Babatinca**, | Komuna e Podujevës, anëtarë |

Me këtë rast dëshirojm të falënderojmë edhe prof. Muhemet Murati përfaqësues i fshatit Popove, per shoqerimin e tij gjate vizitave dhe per pershkrimin historik

**PËRMBAJTJA**


HYRJE....................................................................................................................4
BAZA LIGJORE ...…………………………………..............................................................…….…..4
OBJEKTIVAT……………………...………….........................................................................6
PAK HISTORI PËR ZONËN.................................................................................................7
KARAKTERISTIKAT FIZIKO-GJOEGRAFIKE……………...................................................11
Pozita gjeografike...................................................................................................11
Ndërtimi gjeologjik................................................................................................12
Tektonika.................................................................................................................13
Relievi.....................................................................................................................15
Klima.......................................................................................................................16
Vecorit pedologjike.....................................................  ..........................................22
Vecorit hidrologjik...................................................................................... ...24
BIODIVERSITETI..............................................................................................................26
Flora.......................................................................................................................26
Vegjetacioni............................................................................................................29
Fauna……….................……......…………………...………………........................32
VLERAT PEIZAZHORE TË ZONËS USHTON LUMI......................................... ...............36
Vlerat e trashëgimis natyrore me karakter hidrologjik............................................39
Vlerat e trashëgimis natyrore me karakter gjeomorfologjik....................................42
Vlerat e trashëgimis natyrore me karakter spelpologjik  ......................................42
VEPRIMTARIA EKONOMIKE TEK ZONA USHTON LUMI........................... ...............46
ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI ME ZONËN.................................... ........................50
PËRFUNDIM........................................................................................................................52
LITERATURA……………………………...………........................................ ....................56
SHTOJCA...............................................................................................................................57




Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 1. HYRJE

Zona e propozuar për mbrojtje “Ushton lumi”, në fshatin Popovë, komuna e Podujevës është e pasur me vlera natyrore të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik, peizazhor, edukativo-arsimore, kulturor, turistik etj. Gjithashtu pjesa përreth rrjedhës lumore është e pasur me biodiversitet të përbërë nga llojet e ndryshme të florës dhe faunës të ujërve të ëmbla.

Kjo zonë paraqet vlerave natyrore e estetike të veçanta dhe me rëndësi shumë dimensionale prandaj është zonë e rëndësishme për mbrojtje dhe promovim. Për shkak të vlerave natyrore , formës dhe pamjes së bukur që ka, propozohet të shpallet zonë e mbrojtur, sipas kritereve të IUCN-së, në kategorinë e pestë (5-të) të mbrojtjes **“Peizazh i Mbrojtur”.**

Përveq vlerave të trashëgimis natyrore, zona është e pasur edhe me vlerat të tarshëgimis kulturore të cilat e pasurojnë edhe më tepër dhe e bëjnë edhe më të rëndësishme vënjen nën mbrojtje të kësaj zone.

## 2. BAZA LIGJORE

Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233, përcakton kushtet dhe kriteret të cilat duhet të plotsohen një zonë për  shpalljen zonë e mbrojtur nga aspekti i vlerave të natyrës.

Bazuar në nenin 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233 për përmbajtja e propozimit për shpallje, paragrafi:

1. Propozimi i aktit për shpallje bazohet në propozimin profesional të cilin e harton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, me të cilin përcaktohen  vlerat e zonës e cila propozohet të mbrohet, mënyra e administrimit me atë zonë, si dhe propozimi i organit i cili nxjerr aktin për shpallje për sigurimin e mjeteve për administrimin me zonën e mbrojtur.
2. Baza profesionale përmban përshkrimin detal të veçorive të vlerave të zonës e cila mbrohet, vlerësimi i gjendjes së asaj zone, pasojat që dalin nga nxjerrja e aktit për shpallje, veçanërisht në të drejtën e pronësisë dhe veprimtaria ekonomike e


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

hasur, si dhe vlerësimi i mjeteve të duhura për zbatimin e aktit për shpallje të zonës së mbrojtur.

3. Për propozimin e shpalljes së zonës së mbrojtur informohet publiku. Me informim të publikut nënkuptohet qasja publike në aktin e propozuar për shpalljen e zonës së mbrojtur dhe bazën profesionale me dokumentacionin hartografik.

4. Procedurën e qasjes publike në shpalljen e parqeve kombëtare, parqeve të natyrës, rezervatit strikt dhe zonën e veçantë i organizon dhe e udhëheqë Ministria, kurse procedurën e qasjes publike për shpalljen e zonave tjera të mbrojtura: - monumentin e natyrës, peizazhin e mbrojtur dhe monumentin e arkitekturës së parqeve e organizon dhe e udhëheqë kuvendi komunal.

5. Qasja e publikut zgjatë më së paku tridhjetë (30) ditë.

6. Propozuesi i aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur ka detyrim që të deklarohet për propozimet që kanë dalë nga qasja e publikut, kurse vërejtjet e parashtruara nga debati bëhen pjesë përbërëse e dokumentacionit në të cilin bazohet propozimi për shpallje.

7. Lajmërimi për qasjen publike shpallet në mjetet e informimit publik dhe në ueb faqen e Ministrisë dhe përmban shënimet, dokumentacionin hartografik dhe dokumentacion tjetër lidhur me zonën e propozuar për vënie në mbrojtje, afatin kohor për shqyrtim, datën e përfundimit të pranimit të komenteve dhe referencat e organit i cili i pranon komentet.

Sipas Nenit 21 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233 akti i shpalljes së zonës së mbrojtur duhet të përmban: emrin dhe kategorinë e zonës së mbrojtur, kufijtë hapësinor të zonës së mbrojtur, shenjen e përmasës se paraqitjes hartografike, gjegjësisht shenja tjetër të lokacionit

Në bazë të Nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233 një zonë merr statusin e mbrojtjes paraprake nëse:

1. Për atë zonë Instituti në bazë të arsyetimit profesional përcakton se ka karakteristikat e zonës së mbrojtur dhe/ose është filluar procedura për marrjen nën mbrojtje, përcaktohet se është nën mbrojtje paraprake me nxjerrjen e vendimit për mbrojtjen paraprake. Vendimin për mbrojtjen paraprake e nxjerr Ministria.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

2. Me vendimin për mbrojtjen paraprake përcaktohet zona e mbrojtur, masat dhe kushtet e mbrojtjes dhe përcaktimi i afatit i cili nuk mundet të jetë më i gjatë se dy (2) vjet nga dita e nxjerrjes.

3. Për kohën sa zgjat mbrojtja paraprake e vlerës së natyrës aplikohen dispozitat e këtij ligji.

## 3. OBJEKTIVAT

Zona e propozuar për mbrojtje "Ushton lumi" paraqet vlera të veçanta natyrore, hidrologjike, peizazhore dhe të biodiversitetit, si dhe karakteristikave tjera që duhet të merret nën mbrojtje ligjore.

Qëllimet që synohen të arrihen pas shpalljes së kësaj pjese zonë të mbrojtur janë:

- Mbrojtja dhe promovimi i vlerave natyrore të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik, peizazhor, edukativo-arsimore, kulturor, turistik etj., me të cilat disponon zona;
- Mbrojtja e ekosistemit ujore dhe diversitetit biologjik, menaxhimi i qëndrueshëm i tyre si dhe marrja e masave për revitalizimin e vlerave natyrore të dëmtuara në këtë zonë ;
- Shfrytëzimi racional i vlerave natyrore përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit të zonës për të ndaluar degradimin e saj ;
- Ndërmarrja e veprimtarive të përshtatshme të ruajtjes dhe menaxhimit, me qëllim të rivendosjes së kushteve ekologjike në ekosistemin ujor;
- Realizimi i hulumtimeve kërkimore-shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet ndërkombëtare në zhvillimin e zonës me synim ruajtjen e natyrës, zhvillimin e turizmit dhe promovimin e prodhimeve vendore;
- Promovimi i vlerave dhe zhvillimi ekomomik i zonës së vegjetacionit të pyjeve në komunën e e Podujevës;
- Promovimi i vlerave turistike dhe atyre edukative-arsimore në zonën "Ushton lumi"



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

# 4. PAK HISTORI PËR ZONËN

## 4.1. Historiku i fshatit dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të zonës

Fshati Popovë shtrihet rreth 10 km në perëndim të Podujevës. Përveç me fshatra të Podujevës, kufizohet edhe me fshatra të Komunës së Mitrovicës dhe të Vushtrrisë. Rrjedhimisht ka lidhje të drejtpërdrejt me fshatra të Shalës së Bajgorës.

Fshati shtrihet në luginën e lumit Kaqanoll, njëri ndër lumenjtë më të pasur me ujë në Llap. Lugina përgjatë lumit, në të dy anët (lindore e perëndimore) kufizohet me male në të cilat ka burime uji (kroje) të shumta. Shquhet për bukuritë natyrore, me peisazhe të bukura, ujëvara me bukuri të rralla, monumente natyrore e trashëgimi të pasur kulturore. Për nga siperfaqja është njëri ndër fshatrat më të mëdhenj në Komunën e Podujevës me një sipërfaqe me mbi 17 kilometra katror, ndërsa sa i përket popullsis pothajse është i braktisur plotsisht.

Fshati përbëhet prej lagjeve: Murati, Hoxha, Sinani, Fazliu, Rexha, Maksuti, Maçastena, Hyseni, Përvetica, Segashi, Bajqinovci dhe Potoku. Tani shumica e lagjeve janë të pabanuara për shkak të shpërnguljeve të vazhdueshme të banorëve, sidomos pas luftës së fundit në Kosovë.

**Mikrotoponimet** më karakteristike të fshatit janë Guri i Bardhë, Kalaja, Guri i Sokolit (Kërrshi i Sokolit), Ushtolumi, Kërrshi i Pelave, Pusi i Shkumës, Kodra e Madhe, Shpati i Blinit, Rrezja, Kërrshi i Bajqinovcëve, Suka e Kodralive, Rrahishta, Orrnica, Ligata, Lugu i Kishës, Gurina, Përroi i Korrizit, Guri i Piramidës, Trojet etj.

Duke pasur parasysh pozitën gjeo-strategjike në të cilën shtrihet fshati, i shtrirë në luginë dhe malet përreth, me ujë të bollshëm, me tokë e livadhe të mira, gjurmët e mbetura nga e kaluara, mund të supozojmë se ky vendbanim është i vjetër.

Në të kaluaren njihet për numrin e madh të mullinjëve me ujë që shërbenin për bluarjen e drithrave, sharra për përpunimin e drurit (prerjen e dërrasave) e gjithashtu kishte edhe puntori që shërbenin për përpunimin e zhgunit me të cilin bënin veshje.

Në veri të fshatit ndodhet Kalaja [1](gjurmë të saj), në një pozitë strategjike, në lartësi dominuese nga ku mund të kontrolloheshin të gjitha lëvizjet përreth, me mbrojtje shume të mire natyrore, në mes dy objekteve natyrore, Gurit të Bardhë në lindje dhe Gurit të Sokolit në jug-perëndim të cilët mund të kenë qenë pika mbrojtëse të Kalasë.

[1] Në mjaftë raste haset edhe emërtimi "Keshtjella".

(këto objekte natyrore kanë edhe rëndësinë e tyre historike sepse si në luftërat kaçake ashtu edhe në luftën e U.Ç.K-së ishin pozita të rëndësishme lufte ku u zhvilluan shume beteja).

Kalaja e Popovës, besohet se i takon periudhës dardane mirpo, se cilës kohë i takon, cili ishte roli dhe rëndësia e kësaj kalaje, në mesin e fortifikimeveve të asaj kohe, kjo mund të vërtetohet vetem pas hulumtimeve nga institucionet kompetente.

Në pjesën perëndimore të kalasë gjenden gjurm të shkritores për shkrirjen e metaleve dhe varret e Kalasë.Në pjesën lindore të fshatit ekziston Suka e Kodralive një lokalitet i vjetër arkeologjik nga ku mund të kontrollohet thuajse e gjithë hapësira e Llapit e më gjerë.

Në fshat ekzistojnë gjurmët e tri objekteve kishtare njëra në kala, njëra në lagjen Segashi dhe e treta pran lagjes Maçastena, të cilat i takonte besimit të krishterë- ritit katolik. Kjo është konstatuar me rastin e rekogniscimit të vendgjetjeve në vitin 1986.[2] Në disa pjese të fshatit ekzistojnë gjurmë të vorrezave të vjetra të cilat nuk dihet se cilës periudhë i takojnë të cilat gjithashtu duhe të jenë objekt hulumtimi.

Një veçori karakteristike për fshatin ishte edhe ndërtimi i kullave, si objekte banimi e që ishin të numërta. Ka mbetur e pa rrënuar vetem njëra prej tyre, në lagjen Murati dhe është në gjendje mjaftë të mire.

Nga ky fshat ishte edhe mendimtari Tahir ef. Popova (1856-1949), i cili gjatë shek. XIX kishte hapur Mejtepin në Popovë. I njohur edhe për përkthimin në gjuhën shqipe.

Në të gjitha periudhat e historisë kombëtare, për shkak edhe të pozitës gjeografike e strategjike që kishte, fshati Popovë njihet si vend i organizimit të kuvendeve kombëtare, lëvizjeve e kryengritjeve çlirimtare.

**Kuvendi i Ushto lumit** (Ushtorekës) i mbajtur në vitin 1843, u organizua për të kundërshtuar Reformat e Tanzimatit, reforma që kishin filluar të zbatoheshin nga pushteti osman. Në Kuvend morën pjese paria e Llapit, përfaqësues nga Shala e Bajgorës dhe viset tjera. Këtu u vendos për organizimin e kryengritjes kundër pushtetit osman. Udhëheqës i përgjithshëm i kryengritjes u zgjodh Hoxhë Popova. Pas shtypjes së kësaj kryengritje, dënohen me vdekje dhe ekzekutohet nga pushteti osman Hoxhë Popova, Kurt e Mustafë Rashani.[3]

**Kuvendi Gjithëkombëtar dhe ngritja e Flamurit**- njëri nga personalitetet e dalluara të luftës për çliririm nga Perandoria Osmane dhe krijimin e shtetit shqiptar ishte edhe Hys

[2] Dr. Fehmi Pushkolli. Llapi gjatë historisë. Prishtinë: 1998.
[3] Grup autorësh. Trashëgimia Etnokulturore e Llapit. Prishtinë: 1995.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

R.Popova. U inkuadrua në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe kishte takime të shpeshta me udhëheqësit e saj, si Hasan Prishtina e Hoxhë Kadriu. Nën drejtimin dhe organizimin e tij më 26.dhjetor 1909 u mbajtë Kuvendi Kombëtarë në Popovë.
Në kuvend u moren vendime të rëndësishme historike siç ishin:

- fillimi i kryengritjes së përgjithshme kundër Perandorisë Osmane për çlirimin dhe krijimin e një shteti shqiptar,
- për përdorimin zyrtar të flamurit shqiptar,
- për hapjen e shkollave shqipe,
- për përdorimin e alfabetit shqip të Manastirit,
- për botimin e librave e gazetave në gjuhën shqipe etj.[4]

Në pllakën e ngritur pran vendit ku gjindej Kulla e tij në Popovë shkruan: *Këtu në Keshtjellën e Hys R.Popovës, më 26.XII.1909 u mbajtë Kuvendi Gjithëkombëtar shqiptar dhe u ngrit Flamuri. Dy ditë më vonë, më 28.XII.1909 të njëjtit e ngrehin Flamurin në Kodërflamur. Flamurin e ngritën Hys R.Popova, Islam Ukë Bulliqi, Shaban Kapuqi-Mihaliqi.*
Hys Popova ishte pjesëmarrës i shume kuvendeve të organizuara anembanë trojeve shqiptare, pjesëmarrës i shume betejave për çlirim, kundër Perandorisë Osmane dhe më pas kundër Mbretërisë Serbo-Kroatro-Sllovene.
Gjatë periudhës së Lëvizjes Kaçake, fshati Popovë kishte një rol të rëndësishëm duke qenë vatër e zhillimeve organizative e luftarake të saj. Edhe gjatë kësaj kohe Hys Popova shquhet si njëri nga udhëheqësit dhe organizatorët e saj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe si luftëtarë e udhëheqës të Lëvizjes Kaçake shquhen edhe vëllezërit Bajqinovci po nga fshati Popovë.
Me qëllim të organizimit të kryengritjes së përgjithshme kundër forcave pushtuese serbe, paria e Llapit thirri **Kuvendin e Popovës në qershor të vitit 1919** ku morën pjesë përfaqësues nga Llapi e Shala si dhe përfaqësues të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Azem Bejta dhe Dan Deroci. Kuvendi i Popovës miratoi vendinin për vazhdimin e kryengritjës antiserbe për çlirimin e Kosovës dhe që çetat të bartnin flamurin kombëtar shqiptar. [5]
Hys Popova me bashkluftëtar e vazhduan luftën kundër pushtuesve serb deri më 15.7.1924 kur vritet gjatë luftimeve në Galicë, betejë në të cilën plagoset dhe merr plagë vdekjeprurëse edhe udhëheqësi i Lëvizjes Kaçake, Azem Bejta. Sot varri i Hys Popovës gjendet pranë varrit të Azem Galicës në Galicë.

[4] Mr. Avdi Gjata, albaniaPress.com, publikuar më 10.dhjetor.2012
[5] Dr. Fehmi Pushklli. Llapi gjatë historisë. Prishtinë: 1998, fq. 126


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Popova si fshat kryengritës shpeshherë pagoi edhe çmim të lartë, siç ishte edhe me rastin e operacionit ushtarak serb, të janarit të vitit 1921 i njohur, si "Rrëfia", ku ishin djegur tërsisht 55 shtëpi dhe ishin vrarë një numër i madh i banorëve. [6] Gjithashtu ky fshat ishte edhe vatër e rezistencës shqiptare pas mbarimit të Luftës Dytë, Botërore e udhëhequr nga Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH).

Gjatë Epokës së Ushtrisë Çlirimtare, në kuadër të Nënzonës-Zonës Operative të Llapit, fshati Popovë ishte shëndrruar në një nga bazat më të fuqishme të operimit dhe organizimit të luftës, seli e institucioneve e formacioneve të ndryshme të Z.O.Ll-it. Gjithashtu ishte vendëstrehim i mijëra banorëve të zhvendosur nga fshatra të Podujevës po edhe të komunave tjera. Pëveç me armë të tjera fshati u sulmua edhe me aeroplan, më 4 prill 1999 ku vriten 11 civil e plagosen rreth 40 të tjerë.

Në Popovë ishte vendosur spitali ushtarak i Z.O.Ll-it,në lagjen Potok (15 shtator 1998-30 prill 1999) në objektin i cili më heret ishte shkollë, kurse gjatë muajve maj dhe qershor 1999, deri në hyrjen e trupave të NATO-s në lagjen Murati.

Pra, fshati Popovë, në bazë të dëshmive materiale, mund të themi se ka qenë në vazhdimësi një vendbanim i rëndësishëm në kohëra të ndryshme historike, që nga koha antike e deri më sot dhe si i tillë duhet t'i kushtohet një rëndësi dhe vëmendje më e madhe nga institucionet përkatëse, të bëhen hulumtime të duhura, sepse sipas këtyre dëshmive paraqet një pasuri arkeologjike.

[6] Po aty.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

# 5. USHTON LUMI, VEQORITË FIZIKO – GJEOGRAFIKE

## 5.1. Pozita gjeografike

Zona e mbrojtur Ushton lumi gjendet në pjesën veri-lindore të Kosovës. Me një sipërfaqe prej 92 $km^2$, i takon njësisë morfologjike, masivit malor të Kopaonikut ndërsa me shtrirjën e tij gjendet në territorin e komunës së Podujevës (Fig.1.). Në aspektin hidrografikë zona Ushton lumi i takon ujëmbledhësit të lumit Kaçandoll ndarsa ky, atij të lumit Llap i cili nëpërmjet Sitnicës e Ibrit kalon territorin e Kosovës. Duke qenë në epiqndër të zonës së mbrojtur lumi na bëhet protagonisti kryesor prandaj edhe diskutimi për të bëhët i pashmangshëm.

Lumi i Kaqandollit paraqet degën e djatht më të rëndësishme të lumit Llap. Burimi i tij paraqitet në pjesën juglindore të Maleve të Kopaonikut në lartësi mbidetare 1224 m. Në territorin e kësaj zone (përafërsishtë në mesë burimit dhe grykderdhjës) ndodhet edhe fshati malor Popova me sipërfaqe 17.6 $km^2$.

***Pikërisht këtu në Popovë ndodhet vendi i quajtur Ushton lumi i cili në fakt është i tillë dhe arsyeton emërimin e tij.***




*Fig. 1. Pozita e zonës së mbrojtur Ushton lumi në Kosovë*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 5.2. Ndërtimi gjeologjik i zonës

Përbërja litostratigrafike në këtë pellg manifestohet me paraqitjen e formacioneve të ndryshme në aspektin e përbërjes (struktura, tekstura, përbërja mineralogjike, fortësia, tretshmëria kimike, etj.) dhe moshës së tyre . Nga analiza e hartës gjeologjike të Kosovës në shkallë 1:200 000 (KPMM, 2006), përpunuam dhe shfaqëm hartën gjeologjike të pellgut duke dhënë një pasqyrë për formacionet si dhe kohën e shkëmbinjve ndërtues të këtij peisazhi.

Në hapsirën e pellgut të lumit Kaçandoll hasen shkëmbinjtë të moshave të ndryshme, duke filluar nga mosha palezoike deri tek kenozoiku.

**Formacionet e palezoikut** – shkëmbinjtë më të vjetër që i takojnë kësaj ere konkretisht paleozoikut të sipërm, përfaqësohen nga rreshpet e gjelbra që ndërtojnë në masë të vogël pjesën perëndimore të pellgut.

**Formacionet e mezozoikut** – paraqiten në tri periudha: triasike, jurasike dhe kretake. Periudha triasike e mesme përfaqësohet me fragmente të serpenitniteve (të formuar nga copëtimi i shkëmbinjëve në zonën e thyrjes së Grashticës për shkak të trysnive të mëdha) të paraqitura në formacione të kretakut që ndërtojnë pjesën më të madhe të pellgut të përbëra nga: konglomerate, gëlqerorë, mergele, straje dhe flish. Shkëmbinjtë e jurasikut të sipërm përfaqësohen me selikatet metasedimentare, filite, gnejse, bazalte. Shkëmbinjët e juarsikut, si filitet, janë formuar me metamorfizëm të ulët të argjilorëve, ndërsa gnejset me metamorfizëm të rërës.

**Formacionet e kenozoikut** – pjesa e sektorit të epërm të bazës së shtratit të lumit përfaqësohet nga shkëmbinjtë të neogjenit, si: konglomerat, ranorë, mergelë, etj., kurse pjesën e poshtëm me shkëmbinjë të kuaternarit me aluvione (zhavorrë, rërë, argjilë) dhe deluvione (alevorite).


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Fig. 2. Mosha dhe formacionet gjeologjike të zonës Ushton lumi dhe rrethinës së tij*

### 5.3. Tektonika

Tektonika, si proces përcaktues i veçorive të strukturave të relievit, ka ndikim edhe në këtë pellg. Në aspektin e makro strukturave pellgu i takon sistemit rrudhosës alpin të segmentit perëndimor të Mesdheut lindor. Më saktësisht pellgu shtrihet në zonën tektonike të Vardarit, përkatësisht në tri nënzonat e Vardarit (KPMM, 2006 a). Njësia e Vardarit ka shtrirje VVP-JJG me gjatësi qindra kilometra nga deti Egje deri në pellgun e Panaonisë, duke ndërtuar bazën (tabanin) e pjesës lindore të Kosovës. Me këtë shtrirje tektonike lidhen trajta tejet të ndryshme të deformimeve të tyre, përfshirë strukturat rrudhosëse dhe ato shkëputëse.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Fig. 3. Harta topografike tek lokacioni i "Ushton lumi", në Podujevë*



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

## 5.4. Relievi i zonës

Format relievore të pellgut të Llapit janë përcaktuar nga veprimi i forcave të brendshme dhe të jashtme, të cilat kanë krijuar një reliev të larmishëm me specifika ineresante. Këtë morfologji larysish e përbënë masivi i Kopaonikut.

Kopaoniku – ka shtrirjen gati meridionale me një nuancim të leht (VP-JL) me gjatësi rreth 40 km dhe gjerësi mesatare 6 km në kuadër të pellgut. Përfaqëson malet kryesore me pikën më të lart: Bajraku (1790m).

Përgjithësisht këto vargmale veçohen për një reliev me element alpin, me vlera të mëdha të thellësisë dhe dendësisë së copëtimit, të cilat kanë përcaktuar kontraste morfologjike mjaft të shprehura midis rrëpirave të vargjeve malore dhe luginave ndarëse mjaft të thella. Në drejtim veri-jug rrjedh lumi Kaçandoll i cili kishte krijuar luginën lumore me po të njëjtin emër.

Orografia e kësaj hapësire karakerizohet me një pjerrtësi të relievit i cili vlërësohet se në Malin Kopaonik sillet nga $20^0$– $30^0$ pra me një pjerrtësi mesatarisht të rrëpirët ndërsa në drejtim të zonave fushore bie deri në $1^0$.




*Fig. 4. Harta e relievi i zonës Ushton lumi dhe periferia e tij.*

## 5.5. Klima e zonës

Klima është faktor i rëndësishëm natyror e cila nëpërmjet elementeve dhe dukurive meteorologjike, ndikon në proceset natyrore, në aktivitetin ekonomik dhe jetën e përditshme të njerëzve prandaj dhe pikërisht nevoja për njohjen e saj është e domosdoshme.

Veçoritë e përgjithshme klimatike në zonën e mbrojtur "Ushton Lumi" përcaktohen nga pozita gjeografike, relievi (lartësia, ekspozicioni) , pozita ndaj masave tokësore më pak ujore dhe kushtet lokale mjaft specifike të vendit si : ekspozicioni i theksuar jugor, drejtimi i shtrirjes së luginës V-J, kushtet hidrografike-gjarpërimi i lumit midis zonës së mbrojtur, mbulesa bimore e shprehur me masë të lartë drunore dhe e shoqëruar me kullota dhe klultura të pjesshme bujqësore.

Në mungesë të të dhënave më të afërta klimaterike duhet të pranojmë se është evidente që në zonën e mbrojtur " Ushton lumi" mbizotëron klima e mesme kontinentale me disa element krejt lokal të cilët krijojnë mikro klimë përgjat shtratit dhe luginës së thellë e gjatësore të lumit Kaçandoll. Kjo është e pranishme sepse shpatiet e luginës janë mjaft të pjerrta dhe se lugina është mjaft e ngushtë, pothuaj e tipit kanionik dhe kësisoj pasdita është jasht ndikimit direkt të rrezeve të diellit. Ndërsa përtej saj është evidente freskia që sjell lumi gjatë stinës së verës me gjithë e cila me gjithë praninë e vegjetacionit drnor dhe atij të lagështisë, tipike e zonës janë tregues të mjaftueshëm për mikroklimë në territorin e zonës Ushton lumi.

### 5.5.1. Temperaturat e Ajrit

Temperaturat oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute.

Temperatura mesatare është 9,6$^{o}$C, muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare -2,1$^{o}$C, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20,1$^{o}$C. Muaji më i ftoftë me temperaturë ekstreme është janari me -27,2$^{o}$C, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37$^{o}$C. Amplituda më ekstreme për ketë periudhe është 64,2$^{o}$C.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

*Tabela 1. Temperaturat sipas muajve*

| | Podujevë | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | Temperat. mesatare | Maks. absolut | Minim. absolut | Amplituda |
| I | -2,1 | 13,5 | -27,2 | 40,7 |
| II | -0,6 | 17,5 | -25,5 | 43,0 |
| III | 3,5 | 24,0 | -20,0 | 44,0 |
| IV | 9,3 | 26,0 | -4,5 | 30,5 |
| V | 13,5 | 31,0 | -2,0 | 33,0 |
| VI | 17,8 | 34,0 | -1,5 | 35,5 |
| VII | 20,1 | 37,0 | 3,0 | 40,0 |
| VIII | 20,1 | 36,5 | 2,0 | 38,5 |
| IX | 16,1 | 34,6 | -2,0 | 36,6 |
| X | 10,4 | 29,5 | -6,5 | 36,0 |
| XI | 5,7 | 20,5 | 13,6 | 34,1 |
| XII | 1,4 | 18,0 | 19,0 | 37,0 |
| **Vjetore** | 9,6 | 37,0 | -27,2 | 64,2 |
| **Dimri** | -0,4 | 18,0 | -27,2 | 45,2 |
| **Pranvera** | 8,8 | 31,0 | -20,0 | 51,0 |
| Vera | 19,3 | 37,0 | -1,5 | 38,5 |
| Vjeshta | 10,7 | 34,6 | 13,6 | 48,2 |
| Per.vegje. | 16,2 | 37,0 | -4,5 | 41,5 |

*Tabela 2. Lagështia mesatare relative e ajrit sipas muajve*

| | Lagështia mesatare relative e ajrit në % | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | Vjetore |
| 84,0 | 84,2 | 83,1 | 76,0 | 75,3 | 73,0 | 72,5 | 72,5 | 75,3 | 79,8 | 86,8 | 87,0 | 79,1 |

Burimi: PZHK 2016

Në tabelë shihet se muajt e ngrohtë kanë lagështi relative më të vogël, ndërsa muajt më të ftohtë lagështi relative më të lartë. Lagështia relative e ajrit dhe temperatura e ajrit kanë rendësi bioklimatike. Zakonisht gjatë muajve të verës kjo dukuri ndodhë në periudha të shkurtëra kohore, kur janë temperaturat e larta dhe shpejt fillojnë të zbresin.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

### 5.5.2. Reshjet

Niveli i ujërave në këtë hapësirë varet drejtpërdrejt nga reshjet. Sasia vjetore e reshjeve është 697 mm që është nën mesataren e Kosovës për ketë periudhë (784mm). Muaji më i lagësht është maji (77,5mm) ndërsa muaji më i thatë gushti (42,3mm).

Si shihet në tabelë gjatë periudhës vegjetative bien gati 50% e sasisë së reshjeve. Prej stinëve vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thatë me 147,9 mm. Nëse kalkulojmë sasinë e reshjeve me madhësinë e territorit të komunës së Podujevës del se mesatarisht bien 432 mil m3 ujë. Kjo është vlerë mesatare dhe duhet pasur parasysh se pika monitoruese është në pjesën e ultë. Me që territori i kësaj komune shtrihet në pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë, atëherë sasia e reshjeve duhet te jetë më e madhe.

Reshjet oscilojnë dhe të rëndësishme janë rastet kur kjo sasi është maksimale dhe minimale ngase çrregullojnë ekuilibrin natyrorë në territorin që bien. Maksimumi absolut maksimal është 256mm në muajin maj që paraqet 36% të sasisë mesatare. Kjo komunë jo rrallë përfshihet nga moti i lig. Muaji me minimum absolut është gushti me 0 reshje dhe korriku me vetëm 0,4mm (40 mililitra për $m^2$), që tregon se ndodhin thatësi.

Përkundër këtyre variacioneve ekstreme te sasia e reshjeve është shumë i rëndësishëm intensiteti i tyre. Mesataret mujore vjetore e shumëvjeçare fshehin në vete shpërndarjen e tyre. Sipas të dhënave në tabelë shihet se ka raste kur bien pa ndërpre edhe deri në 60mm në muajin tetor. Kjo është sasi relativisht e madhe në raport me mesataren vjetore.

Në praktikën klimatologjike analizohet raporti i temperaturave dhe sasisë së reshjeve për të bërë klasifikimin e muajve të thatë, të lagësht, mesatarisht të lagësht etj. Sipas kalkulimeve në bazë të vlerave mesatare për këtë territor, asnjë muaj nuk kualifikohet i thatë, korriku, gushti dhe shtatori konsiderohen muaj mesatarisht të thatë, ndërsa të gjithë të tjerët rangohen si muaj të lagësht.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

*Tabela 3. Sasia e reshjeve në milimetra*

| Muajt | Reshjet mesatare mm | Sasia absolute maksimale mm | Sasia absolute minimale mm | Maksimumi absolut ditor |
|---|---|---|---|---|
| I | 69,1 | 75,5 | 2,6 | 25,5 |
| II | 53,0 | 118,2 | 3,0 | 27,0 |
| III | 42,3 | 108,4 | 12,5 | 26,0 |
| IV | 55,6 | 80,0 | 17,0 | 41,2 |
| V | 77,5 | 256,0 | 26,8 | 48,6 |
| VI | 64,0 | 124,0 | 17,2 | 47,5 |
| VII | 48,4 | 124,0 | 0,4 | 55,2 |
| VIII | 35,5 | 82,4 | - | 53,0 |
| IX | 46,0 | 149,2 | 13,5 | 30,0 |
| X | 72,9 | 163,2 | 1,4 | 60,0 |
| XI | 75,4 | 129,5 | 16,0 | 56,0 |
| XII | 57,4 | 149,7 | 3,0 | 28,0 |
| Vjetore | 697,1 | 988,7 | 401,4 | 60,0 |
| Dimri | 179,5 | | | |
| Pranvera | 175,4 | | | |
| Vera | 147,9 | | | |
| Vjeshta | 194,3 | | | |
| Per.vegje | 315,5 | | | |

Bora si reshje e zakonshme e kësaj ane ka rëndësi të madhe, ngase akumulon rezerva uji dhe ushqen ujërat nëntokësorë. Në territorin e kësaj komune nuk ka ndonjë qëndrim afatgjatë të borës.

Mesatarisht me borë janë 26 ditë, ndërsa me mbulesë bore janë 48,4 ditë, ose një muaj e gjysmë. Pjesa më e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka ditë me mbulesë bore më së shumti është shkurti me 11,7 ditë. Shtresa maksimale e borës është mjaft e lartë edhe pse e rrallë megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Ne muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 96 cm që jep sinjal të çartë se mund të paralizoj të gjitha aktivitetet.

*Tabela 4. Sasia e reshjeve të borës*

| Muajt | Ditë me borë | Ditë me mbulesë bore | Lartësia max. e shtresës së borës cm |
|---|---|---|---|
| I | 7 | 16 | 28 |
| II | 7,3 | 11,7 | 96 |
| III | 3,7 | 7,9 | 30 |
| IV | 1,3 | 0,5 | 5 |
| V | 0,3 | - | - |
| VI | - | - | - |
| VII | - | - | - |
| VIII | - | - | - |
| IX | - | - | - |
| X | 0,4 | - | - |
| XI | 2,3 | 3,8 | 30 |
| XII | 3,7 | 8,5 | 20 |
| Vjetore | 26,0 | 48,4 | 96 |
| Dimri | 18,0 | 36,2 | 96 |
| Pranvera | 5,3 | 8,4 | 30 |
| Vera | - | - | |
| Vjeshta | 2,7 | 3,8 | 30 |
| Per. vegje | 1,6 | 0,5 | 5 |

Burimi: PZHK, 2016

### 5.5.3. Erërat

Më evidentet janë erërat veriore, jugore dhe më pak verilindore. Në grafik, drejtimet janë të shprehura në promil në mënyre që të eliminohet numri jo i njëjtë i ditëve gjatë muajve.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Grafiku 1. Drejtimi dhe kahja e erërave*

Shpejtësi më të madhe mesatare kanë regjistruar erërat veriore dhe jugperëndimore. Për të gjitha erërat shpejtësia mesatare sillet 3-4 m/s (Fig. 7), ndërsa maksimalja është paraqitur te erërat jugore deri 18,9 m/s.




*Grafiku 2. Shpejtësia mesatare e erërave për rajonin e Llapit me rrethinë*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

### 5.5.4. Vranësira

Shpreh shkallën e mbulueshmërisë me re të qiellit, duke ndikuar edhe në bilancin klimatik. Zakonisht vranësirat në pellgun e Llapit rastisen më shumë gjatë pjesës së ftohtë, sesa asaj të ngrohtë të vitit. Gjatë dimrit ndodh grumbullimi i ajrit të ftohtë, krijimi i inversionit termik dhe formimi i reve të ulëta që në kushte sinoptike mund të qëndrojnë me ditë e javë të tëra (Pllana, 2015) . Bazuar në të dhënat e referuara deri më tani vlera mesatare e mbulimit me re e këtij pellgu është 56%, ndërsa për ditë të kthjellëta 18.3% të të gjitha ditëve të vitit, në bazë të mesatares për gjithë Kosovën.

### 5.5.5. Mjegulla

Në Podujevë më shumë mjegullat paraqiten në pjesën e fundvitit të njohura si mjegulla e radiacionit, ndërsa më së paku paraqiten në korrik. Në bazë të mesatares për të gjithë territorin e Kosovës, shfaqen rreth 26.1 ditë me mjegull gjatë vitit.

## 5.6. Veçoritë pedologjike

Toka - dheu paraqet pjesën e shkriftë sipërfaqësore të korës tokësore të krijuar si rezultat i ndikimit të përbashkët të faktorëve si: ndërtimi gjeologjik, klima, relievi, bimësia, koha, etj. (Dauti,1978). Ndërveprimi i këtyre faktorëve ka shkaktuar formimin e llojeve të ndryshme të tokave në këtë pellg, të cilat do ti përmendim më poshtë.

Në përgjithësi në territorin e zonës së mbrojtur me rrethinë "Ushton Lumi" janë të pranishme këto lloje të tokave: tokë e mesme e kuqërremtë, tokë litosale, tokë pseudoglej, tokë rankeri , tokë smonicë.

Rankeri - është tokë e cila krijohet dhe qëndron në sipërfaqe të pjerrëta kryesisht në rajonet kodrinoro – malore dhe me një erozion të theksuar përfshin pjesët verior të pellgut ne rrëzat e malit të Kopaonikut , shfrytëzohen kryesisht për livadhe dhe kullosa një pjesë edhe për kultura të lavërtarisë. Ky është lloji më i përfaqësuar i tokave në zonën e mbrojtur.

Smonica - dhe toka e mesme e kuqe përfshijnë një sipërfaqe shumë të vogël të këtij pellgu.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

<u>Rankeri dhe litosoli</u> – janë të krijuar kryesisht në rreshpe, shkëmbinj magmatik, serpentinite, etj. Kryesisht janë të mbuluara nga kullosat dhe livadhet, në disa pjesë edhe nga vegjetacioni drunor.

<u>Pseudoglej</u> - janë tokat me shtrirjen më të madhe në kuadër të këtij pellgu të cilat paraqiten në sipërfaqe të rrafshta dhe me sasi të reshjeve rreth 700 mm. Janë toka me regjim jo të mirë ajror dhe ujor.

Varësisht nga lloji i substratit në të cilin janë krijuar tokat, dallohet substrati kompakt, sedimentet liqenore të neogjenit dhe sedimentet e kuaternarit. Në tërësi, në pellgun e këtij lumi mund të ndajmë tri kategori të tokave. Në zonën e ulët të fushës kryesisht tokat humusore, në zonën kodrinore dhe paramalore tokat destruktive dhe në zonën malore tokat skeletore përkatësisht të shterpëta.




*Fig. 5. Harta e llojet e tokave në dhe përiferin e zonës Ushton lumi*


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 5.7. Veçoritë hidrografike

Faktorët kryesorë që kanë determinuar format e paraqitjes së resurseve ujore në këtë pellg janë: ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, dhe faktorë tjerë formues. Resurset ujore në pellgun ku shtrihet edhe zona Ushton lumi paraqiten në formë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Arteria kryesore hidrologjike sipërfaqësore është lumi Kaçandoll, i cili buron në lartësinë 1224 m në malet e Kopaonikut ndërsa në grykëderdhje, aty ku ndodhet edhe vendbanimi Lupç i Poshtëm ka lartësinë 556 m. Ai është përfaqësuesi kryesor hidrografik i këtij ujëmbledhësi në të cilin shkarkohen 35 degë ujore-sipërfaqesore, disa prej tyre: Leshnica, Kovaçica, Lumi i Vjetër, Prroni i Kurrizit, Prroni i Potokut, etj. Lumi i Kaçandolli është i gjatë 36 km dhe përbën degën e djatht kryesore të lumit Llap i cili poashtu paraqet degën më e rëndësishme të Sitnicës. Pellgu i lumit Kaçandoll arrin sipërfaqe prej rreth 96 km$^2$, sipërfaqe kjo e përcaktuar me anë të një analize softuerike të një baze solide tridimensionale.




*Fig. 6. Harta e lumit të Kaçandoll*

**Lumi i Kaçanollit- nivelet dhe prurjet**.

Siç shihet nga të dhënat pellgu i lumit të Kaçanollit ka formë shumë të zgjatur
Sa i përket ndërtimit tektonik, pellgu i lumit të Kaçanollit, përbëhet prej shitsteve paleozoike, (filite dhe shitste të gjelbërta), krijime nga kretaku (flish, golit – senonian), ndërsa ka edhe serpentinite dhe periodit, ndërsa diçka më të rrallë paraqiten edhe andezito – dacitet. Pothuajse i tërë pellgu i Kaçanollit shtrihet në zonën e Kopaonikut, prandaj nga të dyja anët rënia është e madhe.
Kështu nga sipërfaqja e përgjithshme e pellgut vetëm 1.4 %, apo 2.7 Km, janë në lartësinë më pak së 600 m, nga 600 – 800, 14.4%, 800 – 1000m 59.5% dhe mbi 1000 m. 24.7% apo 47.8 Km
Nga të dhënat vërejmë që pjesa më e madhe e pellgut është ndërtuar në lartësi më të madhe të terrenit, sepse rreth 84.4% e sipërfaqes ndodhet mbi 800m, ndërsa lartësia mesatare e pellgut është 904 m.
Lumi i Kaçanollit buron nga masa serpentinite, nën majën më të lartë, jo vetëm të pellgut të Llapit por edhe të Sitnices (1787 m). Lugina e sajë në disa pjesë zgjerohet dhe prapë ngushtohet, prandaj bie në kategorinë e luginave kompozite malore. Në pjesën e sipërme shtrati i lumit është i ngushtë dhe i thellë, ndërsa në rrjedhën e poshtme para futjes së tij në lumin Llap, është më i cektë dhe më i zgjeruar.

*Tabela 5. Nivelet dhe prurjet për lumin e Kaqanollit, profili Popovë**

| | H(Cm) | Q ($m^3/s$) |
|---|---|---|
| **Mes** | 0.34 | 1.03 |
| **Max** | 0.68 | 3.85 |
| **Min** | 0.20 | 0.23 |

*Prurjet e ujit në këtë profil hidrometrik, janë për periudhën 2014 – 2015, të cilat janë realizuar nga matjet hidrometrike të organizuara nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.
Seritë e matjeve janë për periudhë të shkurt kohore, prandaj nuk mund të paraqesin me saktësi situatën hidrologjike të këtij lumi, ngase duhet që të dhënat të jenë për një kohë më të gjatë kohore, por si do qoftë duke pasur parasysh që në të kaluarën nuk ka pasur monitorim të rregullt të këtij lumi në aspektin kuantitativ, pos disa të dhënave të gjetura në disa publikime në të cilat figuron që psh: gjatë periudhës 51 – 75, prurja e ujit në këtë lumë ishte 300 l/s (në bazën e të dhënave në IHMK, nuk ekzistojnë të dhënat e serive kohore të cilat i referohen periudhës sipas burimit 51/75).

Duke ju referuar të dhënave nga IHMK, prurja mesatare e lumit Kaçanollit është 1.03 $m^3/s$. Ajo maksimale 3.85 $m^3/s$ dhe minimale 0.23 $m^3/s$
Niveli mesatarë gjatë kësaj periudhe është 0.34 Cm, ai maksimal 0.68 Cm, ndërsa niveli minimal 0.20 Cm.


*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

# 6. BIODIVERSITETI

## 6.1. Flora dhe vegjetacioni i zonës

Bazuar në të dhënat nga vizitat e realizuar në terren si dhe nga literatura, në përgjithësi, zona e propozuar për mbrojtje e quajtur “Ushton lumi” në Popovë të Podujevës karakterizihet me florë dhe vegjetacion relativisht të pasur. Në të dy anët e lumit Kaçandoll, në drejtim të burimit të lumit vërehet se ka florë dhe vegjetacion fillimisht të degraduar si rezultat i veprimit të faktorit antropogjen e në zonat më të thella flora dhe vegjetacioni duket i ruajtur relativisht mirë.

## 6.2. Flora

Bazuar në ekspeditat hulumtimet që janë bërë në terren, është konstatuar se në pjesën e propozuar për mbrojtje, konkretisht tek lokacioni “Ushton lumi” janë prezente lloje të ndryshme bimore, disa prej të cilave janë me rëndësi në aspektin mjekësor. Në hapësirat përgjatë rrjedhës së lumit hasen lloje bimore të vendeve të freskëta me lagështi. Gjatë ekspeditës hulumtuese janë konstatuar llojet bimore të koncentruara në pyll, në çeltira pylli, në vende shkëmbore si dhe përgjatë rrjedhës së lumit.

Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore gjenden llojet nga familjet e ndryshme, si: *Asteraceae, Aristolochiaceae, Aspleniaceae, Aspidiaceae, Araceae, Brassicaceae, Boraginaceae, Campanulaceae, Caryophyllaceae, Dioscoraceae, Equisetacea, Euphorbiaceae, Fabaceae, Geraniaceae, Karafilore, Lamiaceae, Primulaceae, Polygonaceae, Polypodiaceae, Ranunculaceae, Rosaceae, Rabiaceae, Sarushore, Saxifragaceae, Scrophulariaceae, Urticaceae, Violaceae*.

Ndërsa llojet bimroe të cilat gjendet në këtë zonë janë: Aguliçja e vërtetë *(Primula veris),* Ajuga zvarritëse *(Ajuga reptens),* Bar peshku gjethegjatë *(Verbascum longifolium),* Bargjergji *(Lysimachia nummularia),* Dhëmbore me qepujka *(Cardamine bulbifera),* Fier guri *(Asplenium trichomanes*), Fieri i murit (*Polypodium vulgare*), Fieri mashkull (*Dryopteris filix mas*), Glekoma qimeashpër (*Glechoma hirsuta*), Grashina e kreshpët (*Vicia hirsuta),*Gjethedelli i argjendtë (*Plantago aregneta*), Hithbuta galeobdolon (*Lamiastrum galeobdolon)*, Hithbuta galeobdolon *(Lamium galeobdolon*), Hithbuta me njolla (*Lamium maculatum*), Hithra (*Urtica dioica*), Iriqëza gjetherrotullare (*Saxifrgara rotundifolia*), Jonxha e kultivuar (*Medicago sativa*), Kamarosha e ndritshme (*Geranium lucidum*), Kamarosha e purpurt (*Geranium purpureum*), Këlkaza njollosur (*Arum maculatum*), Këputja e arave (*Equisetum arvense*), Klokzëa kronike (*Silene conica)*, Kopedani (*Asarum europaeum*),



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Kufilma zhardhokore (*Symphytum tuberosum*), Kulpra e egër (*Clematis vitalba*), Lëpjatë kaçurrela (*Rumex crispus*), Lule dhënës (*Bellis perennis*), Lulekambana gjethepjeshkë (*Campanula persicifolia*), Luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), Luleshurdha (*Taraxacum officinale*), Lunaria një vjeqare (*Lunaria annua*), Llapua i bardhë (*Petasites albus)*, Malitis gjethemilce (*Melittis melissophyllum*), Manushaqja e Kitaibelit (*Viola kitaibeliana*), Manushaqja e Rivininit (*Viola riviniana*), Mendra gjethegjatë (*Mentha longifolia),* Ngjitësja erëmirë *(Galium odratum*), Njëgjira rodhe (*Galium aparine*), Pulmonaria mjekësore (*Pulmonaria officinale)*, Rylleri selvi (*Euphorbia cyparissias*), Stelaria (*Stellaria holostea*), Strajca e bariut (*Capsella bursa pastoris*), Shpendra (*Helleborusd odorus*), Trumza a rëndomtë (*Clinepodium vulgare*), Veronica dushkëvogël (*Veronica chamaedry*), Vingjera e Venedikut (*Lathyrus venetus*), Urthi (*Hedera helix*), Groshë (*Dioscorea communis*), Ngjitësja erëmirë (*Galium odoratum*), Bjelisha e qerpikët (*Melica uniflora*), Tërfili i alpeve (*Trifolium alpestre*), Zorrëca lulevogël (*Potentilla micrantha*), Latrea (*Lathraea squamaria*), (*Monotropa hipopitys*) etj.

Në vazhdim janë paraqitur disa fotografi të llojeve bimore të cilat janë marrë nga zona e propozuar për mbrojtje.



*Foto 1. Luleshurdha (Taraxacum officinale)*



*Foto 2. Luleshtrydhe (Fragaria vesca)*

Në çeltira pylli e në vende shkëmbore janë konstatuar llojet bimore: Fieri shqiponjë (*Pteridium aquilinum*), Fier guri (*Asplenium trichomanes*), Bar gjarpëri mjekësor (*Ceterach officinarum*), Rrushqyqe e athët (*Sedum acre*) etj.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë



*Foto 3. Fier shqiponjë (Pteridium aquilinum)*



*Foto 4. Fier guri (Asplenium trichomanes)*

Përgjatë rrjedhës së lumit janë konstatuar llojet bimore: Sumbullari (*Humulus lupulus*), Bargjergji (*Lysimachia nummularia*), Hithbuta me njolla (*Lamium maculatum*), Llapua (*Petasites sp.),* Gjetehdelli i madh (*Plantago major*), Tërfili i livadheve (*Trifolium pratense*), Kamarosha e ndritshme (*Geranium lucidum*), Kamarosha e Robertit (*Geranium robertianum*), Fierguri i rëndomt (*Polypodium vulgare*), Iriqëza gjetherrotullore (*Saxifraga rotundifolia*), *Sedum telephium* etj.



*Foto 5. Fierguri i rëndomtë (Polypodium vulgare)*



*Foto 6. Sedum telephium*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 6.3. Vegjetacioni

Fitodiversitet i pasur në zonën kodrinore-malore, mbulohet me pyje me numër të konsiderueshëm të llojeve bimore drunore e shkurre gjetherënëse në katet e sipërme si dhe me lloje bimore barishtore në katin poshtëm. Vegjetacioni i zonës së propozuar për mbrojtje është interesant dhe karakterizohet me domonim të vegjetacionit të pyjeve, vegjetacion ky i cili e mbulon pothuajse tërësisht zonën.

Në kuadër të vegjetacionit të zonës "Ushton lumi" është konstatuar prezenca e dy asociacioneve bimore (fitocenozave, bashkësive bimore) dominuese të cilat sipas metodologjisë për hulumtimin e vegjetacionit (Braun-Blanquet 1964, Rexhepi, F. 1994, 2007, Krasniqi, E. 2006) rangohen në klasën *Querco-Fagetea*, ndërsa u takojnë rendeve *Quercetalia pubescentis dhe Fagetalia sylvaticae*. Janë këto fitocenozat *Fagetum moesiacae montanum* dhe *Quercetum montanum*. Fitocenoza pyjore e ahut (*Fagetum moesiaca montanum*) është e zhvilluar mjaft mire si dhe është në gjendje relativisht të mirë. Fitocenoza definohet mjaft mirë përmes llojeve Fagus sylvatica (edifikator kryesor), Bungu *(Quercus petraea*), Shokza (*Carpinus betulus*), Qershia (*Prunus avium*). Përgjatë rrjedhës së lumit janë konstatuar llojet bimore: Shelgu i bardhë (*Salix alba*), Shtogu i zi (*Sambucus nigra*), Ulëza (*Acer tataricum)* etj.

Fitocenoza pyjore e Dushkut malor (*Quercetum montanum*) është më pak e shtrirë në krahasim me atë të ahut. Edhe kjo fitocenozë definohet mjaft mirë përmes llojeve *Quercus petraea* (edifikator kryesor), Qarri (*Quercus cerris*), Panja e malit (*Acer pseudoplatanus*), Shkoza (*Carpinus betulus*), Bjelisha njëlulëshe (*Melica uniflora*), Telishi (*Dactylis glomerata*) etj.



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*



*Foto 7. Ahu (Fagetum montanum) (Zona "Ushton lumi", Popovë, foto: Elez Krasniqi 01.06.2021)*

Në hapësira ku ka ndikim negative antropogjen vërejmë se në pyllin e ahut pas degradimit të tij fillon të paraqitet Plepi i egër (*Populus tremula*) dhe Lajthia (*Corylus avellana*). Për prezantim të gjendjes reale për fitodiversitetin e zonës duhet realizuar hulumtime të detajuara të florës dhe të vegjetacionit.

Në kuadër të vegjetacionit pyjor në zonën e propozuar për mbrojtje gjendet llojet nga këto familje: *Aceraceae, Betulaceae, Corylaceae, Cornaceae, Fagaceae, Rosaceae, Salicaceae, Tiliaceae.*

Në kuadër të hapësirave pyjore janë konstatuar llojet bimore: Qarri *(Quecus cerris*), Panja e malit (*Acer pseudoplatanus*), Panja (*Acer obtusatum*), Qershia (*Prunus avium*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Thanukla (*Cornus sanguinea*), Shelgu i egër (*Salix caprea*), Ahu (*Fagus sylvatica*), Dardha e Egër (*Pyrus communis*), Gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), Lajthia (*Corylus avellana*), Mështekna (*Betula verrucosa*), Shkoza e bardhë (*Carpinus betulus*), Murrizi njëbërthamësh (*Crataegus monogyna*), Shelgu i bardhë (*Salix alba*), Manaferra (*Rubus ulmifolius*), Thana


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

(*Cornus mas),* Molla a egër (*Malus sylvestris*), Kreka (*Acer campestre*), Bliri gjethegjerë (*Tilia platyphylos*), Gorrica (*Pyrus amygdalimorfis*), Bungu (*Quercus petraea*).



Foto 8. *Ahu (Fagus sylvatica)*



*Foto 9. Bungu (Quercus petraea)*



*Foto 10. Pyjet e Ahut (Fagus sylvatica) përgjatë rrjedhës lumore*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Gjendja e fitodiversitetit në zonë është relativisht e mirë. Në hapësira ku ka ndikim negative antropogjen vërejmë se në pyllin e ahut pas degradimit të tij fillon të paraqitet plepi i egër (*Populus tremula*) dhe lajthia (*Corylus avellana*).

Për prezantim të gjendjes reale për fitodiversitetin e zonës duhet realizuar hulumtime të detajuara të florës dhe të vegjetacionit.

## 6.4. Fauna

Zona që shtrihet në pjesën e "Ushto lumi" është e pasur me lloje të ndryshme shtazore ndonëse nuk është realizuar ndonjë hulumtim sistematik për inventarizim të llojeve prezente.

Konfiguracioni i veçantë i kësaj pjese ka bërë që të ofrojë një varietet të konsiderushëm habitatesh ku gjejnë strehim e kushte jetese një numur i konsiderushëm llojesh të faunës vertebrore dhe invertebrore të klasave të ndryshme si të atyre vendore ashtu dhe shtegtare. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë vizitave në teren në kuadër të Grupit punues është konstatuar se kjo zonë veçohet për praninë e llojeve të ndryshme nga të gjitha grupet sistematike. Në vazhdim do të listojmë përfaqësuesit kryesorë të të gjitha klasave të faunës vertebrore të komunës si gjitarët, shpendët, zvaranikët, amfibët dhe peshqit ndërsa nga invertebrorët do të përmëndim vetëm përfaqësuesit e klasës së insekteve, duke lënë mënjanë përfaqësuesit e klasave të tjera mbasi ato e tejkalojnë shumë sferën tone:

- Gjitarët: *K*anë një shumëllojshmëri llojesh duke filluar nga grupet e gjitarëve të vegjël që dominohen kryesisht nga brejtës dhe insektngrënës si
    - ketri (*Sciurus vulgaris*),
    - miu bishtgjatë i pyllit (*Apodemus sylvaticus*),
    - geri (*Glis glis*),
    - urithi i verbër (*Talpa europaea*),
    - lepuri (*Lepus europaeus*),
    - iriqi (*Erinaceus europaeus*),
    - ujku (*Canis lupus*)



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

- dhelpra (*Vulpes vulpes*)
- derri i egër (*Sus scrofa*), etj

- Shpendët:
  - Harabeli i fushës (*Passer montanus*)
  - Trishtili i madh (*Parus major*)
  - Trishtili i kaltër (*Cyanistes caeruleus*)
  - Trishtili bishtgjatë (*Aegithalos caudatus*)
  - Gardalina (*Carduelis carduelis*)
  - Lauresha me napkë (*Galerida cristata*)
  - Kumria (*Streptopelia decaocto*)
  - Pëllumbi i egër i shkëmbit (*Columba livia*)
  - Pëllumbi i pyllit apo Gugashi (*Columba palumbus*)
  - Grifsha (*Garrulus glandarius*)
  - Qukapiku larosh i vogël (*Dendrocopos minor*)
  - Qukapiku larosh i mesëm (*Dendrocopos medius*)
  - Qukapiku larosh i madh (*Dendrocopos major*)
  - Qukapiku i përhimtë (*Picus canus)*
  - Qukapiku i gjelbër (*Picus viridis*)
  - Bishtkuqi i mureve (*Phoenicurus phoenicurus)*
  - Gushkuqi (*Erithacus rubecula*)
  - Cerla e zakonshme (*Emberiza calandra)*
  - Cerla e malit (*Emberiza cia*)
  - Cerla verdhashe (*Emberiza citrinella*)


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

- Kërpngrënësi (*Carduelis cannabina*)
- Çeku vetullbardhë (*Saxicola rubetra*)
- Mëllenja (*Turdus merula*)
- Tusha e malit (*Turdus viscivorus*)
- Drenja e pyllit (*Anthus trivialis*)
- Bilbili (*Luscinia megarhynchos*)
- Bilbilthi kapëzi (*Sylvia atricapilla*)
- Bishtatundësi i bardhë (*Motacilla alba)*
- Mizakapësi i përhimtë (*Muscicapa striata*)
- Fishkëllyesi i vogël (*Phylloscopus collybita*)
- Zvarritësi i zakonshëm (*Sitta europaea*)
- Cërloi i zi pikalosh (*Sturnus vulgaris*)
- Dallëndyshja bishtgërshërë (*Hirundo rustica*)
- Qyqja (*Cuculus canorus*)
- Zborakësi (*Fringilla coelebs*)
- Gjelbërushja (*Chloris chloris*)
- Skifteri kthetrazi (*Falco tinnunculus*)
- Gjeraqina (*Accipiter gentilis*)
- Kukuvajka (*Athene noctua*)
- Shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*)
- Laraska (*Pica pica)*
- Gala (*Corvus monedula*)
- Korbi i përhimtë (*Corvus cornix*)


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

- Korbi (*Corvus corax*)

- Zvarranikët:
  - Breshka e pyllit (*Testudo hermani*)
  - Shigjeta e gjatë (Dolichophis caspius)
  - Bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*)
  - Hardhuca e pyllit (*Darevskia praticola*)
  - Hardhuca e mureve (*Lacerta muralis*)

- Amfibet:
  - E bukura e dheut (*Salamandra salamandra*)
  - Thithlopa (*Bufo bufo*)
- *Peshqit: p*ërfaqësohen nga lloje që jetojnë kryesisht në rrjedhën kryesore. Megjithëse nuk ka studime periodike për të konstatuar dinamikën e përbërjes llojore të faunës ujore, nga informacjonet e marra në teren rezulton se janë rreth xx lloje peshqish si:
  - Trofta e mali *(Salmo truta m.fario*),
- *Insektet*: përfaqësohen nga një numur i madh llojesh.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 7. VLERAT PEIZAZHORE TË ZONËS "USHTON LUMI"

### 7.1. Emërtimi dhe vend-ndodhja

"Ushton lumi" e quajn banorët vendas, vendin në të clilin për shekuj ata kan dëgjuar ushtimat e lumit i cili buron ne pjesën malore (në pjesn e epërme) të maleve të Kopaunikut dhe kalon pran vendbanimit të tyre, pranë shëpive e pronave të cilave më shumë iu ka sjellë të mira se sa të kqia.



*Foto 11. Pamje e lumit në fundin e pjesë së epërme të rrejdhës së tij lumore*

I ndodhur disa dhjetra metra pran fillimit të rrafshirës aluvionale (pjesë ku shënon sektorin e dytë të luginës lumore, rrjedhes ujore-sektori i mesëm i lumit), lumi ka sjellur inerte me dimensione metrike. Keto materiale së bashku edhe me shkembijet amë, qëndrueshmëria eroduese e të cilëve në disa raste ka përballur forcën gërryese të ujit kishin bërë që asesi në form miti por realisht uji të jehonte dhe që vendi i qujtur "Ushton lumi" të ketë emërtim të qëlluar (evidencë e studimeve fushore , 01.06.2021)


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Zona "Ushton lumi" ndodhet në mesin e pellgut të Kaçandollit ( 30km i gjatë ) dukë përbërë kështu një oazë të kësaj bukurie dhe resursi natyror i cili në tërsi shtrihet edhe në territorin e komunës së Mitrovicës dhe Vushtrrisë, ndërsa vetë zona "Ushton lumi" i përket komunës së Podujevës.

Përfshinë zonën ujore me vlera të shumë të veçanta natyrore, të krijuara si rezultat i veprimit të faktorit natyror dhe paraqesin vlerë të jashtëzakonshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.

Kështu, varësisht prej faktorëve që kanë ndikuar në krijimin e tyre vlerat e trashëgimisë natyrore në këtë zonë mund të ndahen në vlera të trashëgimisë me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik, biologjik, peizazhor, rekreativ, shëndetësor etj, të cilat kanë nevojë për ruajtje dhe menaxhim më të mirë me qëllim të valorizimit të tyre për qëllime të ndryshme në aspektin turistik.





*Foto 12 - 13. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*



*Foto 14 - 17. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## 7.2. Vlerat e trashëgimisë me karakter hidrologjik

Vlerat kryesore të zonës së propozuar për mbrojtje janë vlerat e karakterit hidrologjik. Këto vlera më së miri pasqyrohen nga vet emërtimi i zonës të cilin banorët e njohin me emrin "Ushton lumi".

Materiale së bashku edhe me shkembijet amë, qëndrueshmëria eroduese e të cilëve në disa raste ka përballur forcën gërryese të ujit kishin bërë që në shtratin e lumit të krijohen ujvara të shumta të madhsive dhe lartsive të ndryshme duke mundësuar kështu që uji të jehonte dhe që vendi i qujtur "Ushton lumi".

Ujvarat e shumta në formë kataraktesh shtrihen përgjat tër rrjedhës së lumit të përfshir brenda zonës së propozuar për mbrojtje por me të shprehura janë në rrjedhen e eperme te lumit në hyrje në territorin e komunës së Podujevës.

Në hyrje në territorin e komunës ndodhen edhe kompleksi i ujvarave ( tri ujvarave) më lartsi afer 15 m të cilat mes vete ndahen me liqene te vogla të formuara në shtratin e lumit. Ky segment paraqet në të njetën kohë edhe pjesen më atraktive të zonës së propozuar për mbrojtje. Megjithate duhet potencuar se ujvarat si dukuri hidrologjike shtrihen përgjat gjith rrjedhes së lumit që perfshihet brenda zonës së propozuar për mbrojtje të cilat shkaktojnë "Ushton lumi", të cilat paraqesin edhe potencialin më të madhë turistik për zonën duke mos anashkaluar edhe vlerat tjera të trashigimis natyrore e kulturore me të cilat disponon zona.





*Foto 18 - 19. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë





*Foto 20 - 21. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*





*Foto 22- 23. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*

### 7.3. Vlerat e trashëgimisë me karakter gjeomorfologjik

Vlerat e karakterit gjeomorfologjik janë të numërta , mirpo me këtë rast vlen të përmenden:

1. Gryka e lumit të Kacandolit
2. Kalaja e Popovës
3. Guri i Sokolit
4. Shkëmbi i Petritit
5. Guri i Bardhë etj.




*Foto 24- 25. Pamje e kalas dhe Guri i Sokolit*

### 7.4. Vlerat e trashëgimisë me karakter speleologjik

Në kuadër të vlerave speleologjike të zonës së propozuar për mbrojtje (studimet preliminare) mund të konstatohet që edhe përkundër shtrirjes së kufizuar të shkëbinjëve gëlqeror janë evidentuar 3 objekte speleologjike që janë:

1. Shpella ne gryken e lumit
2. Shpella e Halilit (në kalan e Popovës)
3. Shpella në Gurin e Sokolit


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Të gjitha këto vlera hyjnë në kuadër të zonës së mbrojtur duke i shtuar vlerat natyrore të zonës, të cilat do të hulumtohen në të ardhmen



*Foto 26- 27. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*

Zona e propozuar për mbrojtje “Ushton lumi”, përveç vlerave hidrologjike, gjeomorfologjike, speleologjie, biologjike, biogjeografike, gjeologjike, karakterizohet edhe me vlera të veçanta peizazhore dhe estetike.

Prandaj, kjo pjesë si e tillë paraqet vend shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe posaqërisht në sektorin e turizmit rural, si dhe ofron kushte ideale për realzimin e aktiviteteve edukative-arsimore, rekreative, sportive etj.



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave “Rilindja” kati i VI/04, 10000 Prishtinë*



*Foto 28. Peizazh malor tek zona "Ushton lumi"*

Gjatë vizitave të terrenit në kuadër të zonës së propozuar për mbrojtje "Ushton lumi", është konstatuar se deri me tani nuk ka ndonjë aktititet që ka ndikim negativ në zonën e lartpërmendur. Vetëm në një pjesë kemi vërjtur dëmtimet e vegjetacionit pyjor që janë shkaktuar nga faktori natyror dhe antropogjen.

Resurset e gërshetuara ujore dhe pyjore i shtojnë shumë bukurinë kësaj zone dhe paraqesin atraksion majft karakteritik jo vetëm në aspektin peizazhor por edhe atë turistik.

Përveq vlerave të trashëgimis natyrore, zona është e pasur edhe me vlerat të tarshëgimis kulturore të cilat e pasurojnë edhe më tepër dhe e bëjnë edhe më të rëndësishme vënjen nën mbrojtje të kësaj zone.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Foto 29- 30. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



*Foto 31. Pamje e ujvarave përgjatë lumit*



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

# 8. VEPRIMTARIA EKONOMIKE TEK ZONA "USHTON LUMI"

## 8.1. Resurset turistike, mundësit për zhvillim turistik të zonës

Lugina e lumit Kaçandoll përbën një luginë mjaft interesante e cila nuk haset mjaftë shpësh, sidomos në malet e Kosovës. Gjatësia e madhe e sajë, prej 30 km dhe gjërsia minimale që e shoqëron atë e sidomos në sektorin e epërm të lumit prej disa metrave, e bënë që ky fakt relievor të krijon predispozicion optik që për turistët paraqet një rast jo të zakonshëm dhe si i tillë është vlerësuar potencial turistik.

Ende më të veçant e bënë luginën, "qarqafi" bimor dhe shtazor i cili paraqitet i larmishëm dhe fund e kry i bujshëm, gjatë gjithë luginës dhe pellgut lumor në përgjithësi. I karakterizuar nga klimë kontinatale me një orientim morfologjik veri-jugë, mbulesa bimore karakterizohet nga ajo e ultë barishtore (dhe e kultivuar në rrafshinen luginore, ne sektorin e fundit të lumit) në shkurre, pyje të qarrit e bungut për të kaluar në ahishte dhe llojet shoqëruese të saj. Pikrisht zona Ushton Lumi është e perfaqësuar nga llojet bimore të ahut dhe shoqëruesit e saj si dhe nga lloje bimore të zhvilluara nën ndikimin e afërt të lagshtisë që e shkakton lumi dhe avullit të tij sidomos si rezultat i përplasjës së tij me shkëmbinjë dhe kaskadat e ndryshme që e shoqërojnë lumin në shratin e tij.

Zgjatja relievore në drejtimin pothuajse veri –jug eshte zgjatje e cila i konvenon turisteve dhe rekreacionisteve të kësaj zone. Pikërisht në të njëjtin drejtim janë edhe tri qytet (vendbanimet) kryesore të cilat lidhen me këtë zonë, Prishtina në jug me Podujeven në Veri, dhe Vushtërrinë e Mitrovicen në Veri perëndim.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Grafiku 3. Skema: pozitat emetive dhe pozita turistike e zonës Ushton lumi*

Me zgjatimine permendur veri- jug te lugines lumi i Kaçandollit është shoqëruar me vendbanime përgjat tij dhe natyrshëm me atë potencial hidrik që ka ai si dhe me nevojën e qytetarëve për furnizim me miell ishin ngritur me radh një numër i madh i mullinjëve dy prej të cilëve i kan rrezisuar kohës. Njëri është posht zonës Ushton Lumi, në fshatin Majac ndërsa tjeri është në hyrje të fshatit Popovë, aty ku është edhe zona Ushton lumi. Gjurmët e mullinjëve tjerë duken prezent edhe në lokacione tjera të afërta, në zonë dhe më larg saj.

Mullinjët e vjetër me të cilët bluhej gruri, misri dhe ndonjëher edhe ndonjë drith tjetër shfaqin para rekreacionistëve, vizitorëve dhe turistëve jo vetëm arkitekturën dhe mjeshtërinë e ndërtimit por ata përqojnë nivelin e zhvillimit të shoqërisë së shekujve të mëparshëm, tregojnë për banimin e atyre viseve dhe janë treguesit i vetë jetës në ato vise. Këto monumente kulture me atribute të nduarndryshme janë prezente në zonën e mbrojtur dhe rrethinën e saj dhe të njëtat meritojnë të trajtohen me dinjitet e profesionalizëm në kuadrin e zonës së mbrojtur Ushton lumi. Si potencial turistik


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

kulturor ato marrin peshen e vete të merituar vetëm kur shoqëria i trajton ashuu sic ato meriotjn dhe sic meritojnë dhe garantojn prosperitet turistik, kulturor e emancipues në të ardhemen.





*Foto 32- 33. Pamje e mulinjëve përgjat zonës- vler e trashëgimis kulturore*

Një potencial me vlera sipër të gjitha të tjerave janë vetë banorët e zonës, fatkeqësishtë të pakt në numër. Familja e pakta që jetojnë pran zonës së mbrojtur, bënë një jetë modeste në ekonomitë e veta shtëpiake të cilat ishinë mishërim i të kaluarës dhe trashëgimi shpirtrore dhe materiale. Pra me shtëpin e tijë prej balte, diku diku me çerpiq , kulmi i harrnuar nga tjegulla e llamarina, veshjet me dru të zonës të shtëpisë dhe auhrive përfundi shtëpisë paraqesin një ambint kulturor aktiv dhe me mbresa nga shekulli i kaluar dhe përtej tij.

Me zanatet prej zdrukthtarie e pylltarit ata dominoheshin nga përdorimi i drurit. Mbajtja e kuajve për nevoja familjare sfidohej nga prezenca e traktorëve prezent që kishte dhe kjo iu ejpte më shumë kuptim se kuajt mbaheshin të lirë dhe më shumë për hobi. Kjo të bënë fort të kujtosh se si ata mund të joshin turistët për kalërim dhe ecje shtigjeve të fushave, kodrave e maeve të asaj zone.



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Zona e propozuar për mbrojtje "Ushton lumi" fal resurseve ujore dhe natyralitetit të peizazhit që ka ofron kushte te mira për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë edhe ato bujqësore. Gjatë vizitave që kemi realizuar në këtë pjesë kemi vrejtur se në afërsi të lumit gjendet një shtallë në të cilat banoret lokal rrisin bagëtit për të krijuar të hyra ekonomike për familjet e tyre.

Kjo zonë ofron mundësi të ndryshme për zhvillimin e sektorit të turizmit rural, si dhe rekreacionit në pjesë të ndryshme të saj. Prandaj, me zhvillimin dhe menaxhimin e përmirësuar dhe më racional vlera e këtyre shërbimeve mund të mbahet dhe rritet në masë të konsiderueshme.



*Foto 34. Veprimtaritë ekonomike në zonën e propozuar për mbrojtje*

Aplikimi i mënyrave më të mira për zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm, mundëson që vlerat e këtyre shërbimeve të mbahen dhe të rriten në masë të madhe në harmoni me natyrën. Në të njëjtën kohë, shfrytëzimi i vlerave dhe shërbimeve të ofruara nga peizazhi përmes zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit rural mund të sjellë të mira të konsiderueshme për zonën e mbrojtur të peizazhit dhe rrethinën po ashtu.



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

## 9. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI ME ZONËN

Kryerjen e punëve administrative dhe profesionale për mbrojtjen e Peizazhit të Mbrojtur "Ushton lumi" e bënë komuna e Podujevës, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e planifikimit dhe rregullimit hapësinor.

Komuna gjatë ushtrimit të kompetencave të veta është e detyruar që të:

- Kujdeset për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet
- Shpallë zonat e mbrojtura për të cilat është kompetente
- Sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilën është kompetente
- Merre pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi
- Merre pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat është kompetente
- Kujdeset për promovimin e mbrojtjes së natyrës, jep në mbështetje dhe kujdeset për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës
- Përcjellë gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë i paraqesin raport Ministrisë dhe Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
- Mbajë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës
- Informojë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë
- Ofrojë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër komuniteteve lokale në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

- Kryejë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra prej tij

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, do të përcjellë punën dhe zbatimin e masave të mbrojtjes dhe përparimit të peizazhit, duke dhënë mendime profesionale në planet e zhvillimit dhe në të gjitha vendimet të cilat janë të lidhura me këtë objekt të mbrojtur të natyrës.

Menaxhimi me Peizazhin e Mbrojtur "Ushton lumi" bëhet në bazë të Planit të Menaxhimit, që nxirret në kohëzgjatje prej dhjetë (10-të) vite nga organi që e menaxhon këtë zonë.

Me Planin e Menaxhimit përcaktohen:

- Kahet e zhvillimit të zonës
- Mënyrat e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe menaxhimit me zonën e mbrojtur
- Kahet më të përafërta për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës në zonën e mbrojtur duke pas në konsideratë nevojat e komunitetit lokal

Menaxhmenti duhet të marrë në konsideratë diversitetin e peizazhit, ruajtjen e biodiversitetit dhe hapësirën për rekreacion, me mundësinë reale të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimin e turizmit.

Personat juridik dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtarinë e mbrojtjes të peizazhit të mbrojtur janë të detyruar t`i përmbahen planit të menaxhimit.

Pas kalimit të periudhës prej pesë (5-së) vite, bëhet analiza e zbatimit të planit të menaxhimit dhe rezultatet e arritura, si dhe sipas nevojës bëhet revidimi i planit të menaxhimit sipas mënyrës dhe procedurës të përcaktuar për nxjerrjen e tij.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

## PËRFUNDIMI

Duke marrë parasysh vlerat natyrore me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik, biologjik, peizazhor, rekreativ, shëndetësor etj, të cilat kanë nevojë për ruajtje dhe menaxhim më të mirë me qëllim të valorizimit të tyre për qëllime turistike, edukative, rekreative, shkencore si dhe ruajtjes së atributeve kulturore dhe tradicionale etj., duke u bazuar në veçorit dhe larminë peizazhore dhe biodiversitetin të zonës dhe duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03 / L-233, zona "Ushton lumi" do të duhej të shpallet Peizazh i Mbrojtur, që sipas kritereve të IUCN-së, i takon kategorisë së pestë (5-të) të zonave të mbrojtura. Mungesa e statusit të mbrojtjes dhe programeve të duhura për ruajtjen e vlerat natyrore me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe biodiversitetit tek zona "Ushton lumi", ndikon që shumë vlera natyrore dhe lloje bimore dhe shtazore të rrezikohen me zhdukje. Kështu që ky dokument do të shërbej si argument bazë për vënien e kësaj zone nën mbrojtjen ligjore.

Gjatë hartimit të Draft-dokumentit të Arsyeshmërisë profesionale të zonës "Ushton lumi", Grupi Punues ka propozuar për mbrojtje zonën me sipërfaqen prej 92 hektar. Gjatë përcaktimit të vijës kufitare, të zonë së propozuar për mbrojtje të zonës "Ushton lumi", përveç vlerave natyrore që ka qenë kriter kryesore, është marrë parasysh edhe çështja e pronësisë.

Pasi janë mbledhur të dhënat nga parcelat kadastrale janë analizuar me qëllim të gjetjes së mundësisë për vërtetimin e saktë të çështjeve që lidhen me pronësinë. Në territorin e komunës që përbënë tërësinë e zonës së propozuar për mbrojtje të gjitha parcelat kadastrale të përfshira brenda zonës së propozuar për mbrojtje janë në pronësi publike.


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë




*Fig. 7. Harta e ndarjes parciale*



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

Pas vënies nën mbrojtje të kësaj zone masat e nevojshme që duhet të ndermiren për zhvillimin dhe promovimin e mëtejmë të saj janë:

- Mbrojtja adekuate e vlerave natyrore të karakterit hidrologjik, gjeomorfologjik, peizazhor, edukativo-arsimore, kulturor, turistik etj. vegjetacionit pyjor dhe llojeve tjera në zonë
- Mbrojtja e llojeve shtazore, si dhe vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme në aspektin floristik dhe faunistik
- Hartimi i planit menaxhues për zonën e mabrojtur "Ushton lumi"
- Mbrojtja adekuate nga zjarret eventuale
- Mos ndërtimi i objekteve të paplanifikuara në zonë
- Përcaktimi dhe vënia e shenjave për kufijtë e zonës së mbrojtur të peizazhit
- Masat për pastrimin e tërësishëm nga minat
- Promovimi i vlerave natyrore, turistike dhe prodhimeve tradicionale të zonës

Në të njëjtën kohë, shfrytëzimi i vlerave dhe shërbimeve të ofruara nga peizazhi përmes zhvillimit dhe promovimi të turizmit rural mund të sjellë të mira të konsiderueshme për peizazhin ose mund t'i zvogëlojë vlerat e tij dhe rrisë kostot e menaxhimit duke ofruar vetëm disa përfitime konkrete, për drejtorinë dhe komunitetet lokale.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/ L-233 nenit 15 paragrafi 2, në Peizazhin e Mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilave është shpallur i mbrojtur. Prandaj shfrytëzimi i të mirave të natyrës në kuadër të tij përcaktohet me kushtet për mbrojtjen e natyrës, e këto janë:

- Ndalimi i ndryshimit të gjendjes së vlerave natyrore të ekosistemeve pyjore te zona "Ushton lumi"
- Ruajtjen e habitateve të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve ose karakteristikave fizike të mjedisit
- Ngritjen e zonave për edukimin mjedisor, si dhe vlerësimin e karakteristikave të habitateve për menaxhimin më të mirë të llojeve në natyrë
- Parandalimin e zhvillimit të aktiviteteve që janë në kundërshtim me qëllimet për të cilat zona merret nën mbrojtje


*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

- Lejimi i hulumtimeve shkencore si dhe aktiviteteve parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore
- Ofrimi i mundësive për popullatën lokale që të ofroj produktet (mjaltë, djathë, punë dore, etj) për sigurimin e të hyrave ekonomike për familjet e tyre

Shfrytëzimi i resurseve natyrore në përputhje me ruajtjen e natyrës është një nga qëllimet kryesore të kësaj zone. Primare për zonat që i takojnë kësaj kategori është mbrojtja e ekosistemeve natyrore dhe jo prishja e karakteristikave të saj, si dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Përveç kësaj si qëllim tjetër duhet të përfshihet edhe promovimi i përfitimeve në aspektin social dhe ekonomik, konkretisht për komunitetin lokal, si dhe sigurimin e lehtësirave për jetesën e gjeneratave të ardhshme të komunitetit në këtë pjesë.



*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net*
*Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë*

## LITERATURA


1. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, Kuvendi i Kosovës – Prishtinë, GZK (2010)
2. PZHK – Plani Zhvillimor Komunal i Podujeves 2016 – 2025
3. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012/2017, komuna e Podujevës
4. Bashkim Kastrati, "Kosova veri – lindore: Veçoritë fiziko - gjeografike dhe Vlerësimi Ekonomik i Pasurive Natyrore", Disertacion i doktoratës, Tiranë, 2014.
5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Universiteti i Prishtinës: "Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës" – Prishtinë, 2013
6. Krasniqi, E. (2006): Flora dhe vegjetacioni i Malit Drenicë. Disertacion i doktoratës. UP-FSHMN. Prishtinë.
7. Rexhepi, F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës 1. UP-FSHMN. Prishtinë.
8. Rexhepi, F. (2007): The vegetation of Kosova. UP-FNS. Prishtinë.
9. KPMM, 2006: Geological Map of Kosovo, 1:200 000.
10. KPMM, 2006 (a): Tectonic Map of Kosovo, 1:200 000.
11. Dauti, M., 1978: Pedologjia me bazat e gjeologjisë, Prishtinë.
12. Elezaj, Z., & Kodra, A., 2008: Gjeologjia e Kosovës, Prishtinë.
13. Pllana R., 2015: Klima e Kosovës, ASHAK, Prishtinë
14. Të dhëna nga interneti
15. Arkivi i IKMN-së

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Për: Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit**

**z. Muharrem Nitaj, Ministër**

**z. Fatos Qerimi, Sekretar i përgjithshëm**

**z. Ilir Morina, Drejtor Ekzekutiv i AMMK-së**

**Çështja: "Ushton Reka" në Popovë- vlerë e trashëgimisë natyrore**

Të nderuar,

Territori i Komunës së Podujevës posedon vlera të shumta të trashëgimisë natyrore dhe të biodiversitetit, ku disa prej të cilave janë marrë nën mbrojtje nga Komuna e Podujevës, ndërsa propozimi për mbrojtjen e këtyre vlerave ka ardhur në saje të bashkëpunimit të mirë ndërinstitucional ndërmjet Komunës dhe Institucioneve përgjegjëse (MMPH/AMMK).

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, neni 19, paragrafi 3, neni 20 paragrafi 1 dhe 2 dhe në dokumentet e planifikimit hapësinore dhe strategjike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës së Podujevë si dhe shfaqjes së interesimit të vazhdueshëm të komunitetit të atij lokaliteti por edhe më gjerë, që të mbrohen këto vlera të trashëgimisë natyrore dhe të shfrytëzohen për një zhvillim të qëndrueshëm, kërkojmë nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, që në bashkëpunim me Komunën e Podujevës, të formohet një grup punues i ekspertëve për hartimin e arsyeshmërisë profesionale, që lokaliteti i quajtur **"Ushton Reka" në Popovë,** e cila është një zonë e pasur me vlera të trashëgimisë natyrore (hidrologjike, gjeomorfologjike, biologjike, turistike dhe edukativo-arsimore, etj.) të shpallet zonë e mbrojtur.

Ju faleminderit paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Me respekt!

**Podujevë, 18 mars 2021**

**Kryetar i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

PRISHTINË / A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada – Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS | KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE | KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

Ref.24/AMMK/2021
Me dt 31.03.2021

Drejtori Ekzekutiv i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr. 06/l -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.7 01. Mars 2019), nenit 20 të Ligjit Nr. 03/l-233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe kërkesën e komunës se Podujevës merr:

**V E N D I M**

I. Për emërimin e Grupit Punues për përgatitjen e arsyeshmërisë/propozimit profesional, konform kërkesës se Komunës se Podujevës, për shpalljen e "Ushton Reka" në Popovë si Zonë të mbrojtur, në këtë përbërje:

1. Sami Behrami, IKMN, kryesuese,
2. Qenan Maxhuni, IKMN, zëvendës kryesuesi,
3. Nexhmije Kamberi, IKMN, anëtare,
4. Sami Sinani, DMMU, anëtar,
5. Fitim Hamolli, Universiteti i Prishtinës, anëtar,
6. Elez Krasniqi, Universiteti i Prishtinës, anëtar,
7. Rizah Mugolli, Komuna e Podujevës, anëtar,
8. Vigan Salihu, Komuna e Podujevës, anëtar,
9. Ejup Babatinca Komuna e Podujevës, anëtar.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" ish pallati i mediave "Rilindja", kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel. 038 200 33 228, Web: www.ammk-rks.net , E-mail: KEPA@rks-gov.net
Page 1 of 2


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë
AKMM




*Fig. 8. Harta e pozitës gjeografike të zonës "Ushton lumi"*


Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@ks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Në mbështetje të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja e) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafi 1.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, për mbledhjen e caktuar më 31 tetor 2022, i,

***Propozohet***

**V E N D I M**
**Për mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: "Trungu i Qarrit" (Quercus cerris ) në Fshatin Lupç i Poshtëm – Komuna e Podujevës, si Monument i Natyrës**

**Neni 1**

Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës "Trungu i Qarrit (Quercus cerris)", në fshatin Lupç i Poshtëm të Podujevës, si Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
**1.** Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse rreth projeksionit të kurorës prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej 5 ari.
**2.** Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm në territorin e Komunës së Podujevës, por edhe më gjerë.
**3.** Lartësia e kërcellit të Monumentit Natyror është rreth 25 metra, perimetri i kërcellit është 4.5 metra, diametri i kurorës 18 metra dhe vjetërsia është 400-450 vite.

**Neni 2**

Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e vjetra në lagjen Pireva, në pronë private, në parcelën nr.P-71712029-01788-0 Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, me sipërfaqe 2011 $m^2$, e regjistruar si pronë private.

**Neni 3**

Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Monument i Natyrës/Natural Monument/Natural Landmark.

**Neni 4**

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtës i shkallës së III-të të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:
**1.** Në Monumentin e Natyrës ndalohet:
- a) Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme
- b) Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur
- c) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- d) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës
- e) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera
- f) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike
- g) Ndërrimi i kulturës

**Neni 5**

**1.** Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë monumentin e natyrës.
**2.** Në Monumentin e Natyrës lejohen të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit natyror si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të monumentit natyror.

**Neni 6**

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Podujevës, përmes Drejtorisë përkatëse.
**1.** Komuna është e detyruar që:

a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes
b) Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
c) Të bëjë shënjimin e kufijve të monumentit natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura

**Neni 7**

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit natyror.

**Neni 8**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr. prot.** 01-352/04-0089593/22
**Podujevë, datë;** 20.10.2022

**Drejtori**
**Leutrim Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË/O




Harta e Monumentit Natyror "Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)*", në Lupç të poshtëm

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
**Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva**
**Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit**

# RAPORT I DISKUTIMIT PUBLIK

Diskutimi publik për arsyesëhmërin profesionale të Monumentin e natyrës "Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)*, në fshatin Lupç i Poshtëm " ka qenë i publikuar në faqen e komunës nga data 08.07.2022 -08.08.2022, si dhe më datën 26.07.2022 nga ora 11:00 është mbajtur debati publik, në sallën e kuvendit komunal të Podujevës

Debatin publik e hapi dhe e udhëhoqi z.Sami Behrami, zyrtar nga Instituti për Mbrojtje të Natyrës i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përveç zyrtarëve të komunës dhe përfaqësuesit të fshatit Popovë, qytetarë tjerë nuk kishte.

Konsatim: Nga diskutimi publik dhe debati publik nuk ka pasuar asnjë ndryshim.

Zyrtari i Mbrojtës së Mjedisit

Rizah Muçolli

Podujevë

Më: 20.10.2022

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

**MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS**
**MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE**
**MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE**

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

**INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS**

# ELABORAT:

## STUDIMI PËR ARSYESHMËRINË PROFESIONALE PËR MARRJEN NË MBROJTJE TË VLERËS SË NATYRËS: TRUNGU I QARRIT *(Quercus cerris)* NË FSHATIN LUPÇ I POSHTËM TË PODUJEVËS SI MONUMENT I NATYRËS

**Prishtinë, 2022**

## Hyrje

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është trashëgimtar i Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i themeluar me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, (GZ. 42/74) dhe ka vazhduar punën me të njëjtin emër sipas ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (GZ. 15/81).

Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë ligjin për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK"39/88), ku në nenin 78, paragrafi 2, të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89).

Pas luftës në Kosovë, në vitin 2000 ish-Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme civile të OKB-së me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës".

Nga maji i vitit 2000, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka vepruar në kuadër të Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit. Ndërsa pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës, vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

Aktualisht Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, e cila është themeluar duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (Rreg. 2003/9).

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës[1] në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre
- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve

[1] Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233

- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës
- pjesëmarrje në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës

Në vitin 2021, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në kuadër të aktiviteteve të tij ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës në territorin e komunës së Podujevës.

Në shtator të vitit 2022, Instituti i ka propozuar Kuvendit Komunal të Podujevës iniciativën për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje.

Gjatë periudhës së vitit 2021, Instituti ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien në mbrojte të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Podujevë.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si organ qendror për mbrojtjen e natyrës, ka përgatitur Elaboratin: **Studimi për arsyeshmërinë profesionale për marrjen në mbrojtje të vlerës së natyrës Trungu i Qarrit** *(Quercus cerris),* **në fshatin Lupç i poshtëm të Podujevës, si Monument i Natyrës.**

**Përmbajtja**


1. Baza profesionale dhe dokumentimi për marrjen në mbrojtje të vlerës natyrore
    1.1. Emërtimi i vlerës natyrore
    1.2. Lloji i monumentit
    1.3. Kategoria e mbrojtjes
    1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së
    1.5. Pozita
    1.6. Kufijtë
    1.7. Sipërfaqja
    1.8. Përshkrimi i vlerës natyrore
        1.8.1. Karakteristikat natyrore
        *1.8.2.* Karakteristikat biologjike të llojit *Quercus cerris*
        1.8.3. Karakteristikat tjera
        1.8.4. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore
    1.9. Shkalla e rrezikimit
    1.10. Historiku i Mbrojtjes
    1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim
    1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje
    1.13. Regjimi dhe masat mbrojtëse
    1.14. Arsyetimi i Propozimit për Kategorizim
    1.15. Propozimi i Kategorisë
2. Shtojcat
    2.1. Dokumentacioni grafik
        2.1.1. Harta e vlerës natyrore
        2.1.2. Ekstrakti nga fleteposedimi
        2.1.3. Kopja e Planit
    2.2. Dokumentacioni Fotografik

Referencat

## 1. BAZA PROFESIONALE DHE DOKUMENTIMI PËR MARRJEN NË MBROJTJE LIGJORE TË VLERËS NATYRORE



Foto 1

### 1.1. Emërtimi i vlerës natyrore

Trungu i Qarrit *(Quercu cerris)* në fshatin Lupç i poshtëm të Podujevës.

### 1.2. Lloji i monumentit

Monument Natyror me karakter botanik.
(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

### 1.3. Kategoria e mbrojtjes

Kategoria e tretë e mbrojtjes (III) – Monument i Natyrës

1. Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.
2. Monumenti i Natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik–burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

(Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233) Neni 14.

### 1.4. Klasifikimi sipas IUCN-së

Kategoria e tretë (III).
Monument Natyror (Natural Landmark/Natural Monument)
(“Korniza për klasifikimin e zonave të mbrojtura tokësore dhe detare, IUCN, 1990”).

### 1.5. Pozita

Monumenti Natyror Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* gjendet në varrezat e vjetra të fshatit Lupç i poshtëm, në pronësi private dhe është në gjendje shumë të mirë.

Sipas matjeve me GPS trungu ndodhet në koordinatat:
X = 0511845
Y = 4736521
Lartësia mbidetare = 570 metra

## 1.6. Kufijtë

Sipërfaqja ku ndodhet Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Lupç i poshtëm të komunës së Podujevës, gjendet në parcelën 01788-0, zona kadastrale Lupç i poshtëm, nr. P-71712029-01788-0, me sipërfaqe 2011 $m^2$, e regjistruar si pronë private (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, në Podujevë).

Si kufi për Monumentin e Natyrës – Trungu i Qarrit , në fshatin Lupç i poshtëm të merret diametri i rrezes rreth 12.5 metra nga kërcelli i trungut në të gjitha anët (S = 500 $m^2$).




## 1.7. Sipërfaqja

Sipërfaqja e Monumentit Natyror përfshinë hapësirën të cilën e mbulon trungu. Propozohet për mbrojtje sipërfaqja prej **5 ari**.

## 1.8. Përshkrimi i vlerave

### 1.8.1 Karakteristikat natyrore

Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* gjendet në fshatin Lupç i poshtëm dhe ka vlera natyrore e shkencore. Pamja e tij, vjetërsia dhe përmasat e kurorës janë vlera të rralla natyrore të këtij monumenti.

**Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)*** ka këto karakteristika dendrometrike:

Lartësia e kërkecllit..........................................................................25 metra
Perimetri i trungut...........................................................................4.5 metra
Diametri i kurorës..............................................................................18 metra
Vjetërisa e trungut...................................................................400 – 450 vite

Gjendja natyrore e trungut është shumë e mirë.

### 1.8.2. Karakteristikat biologjike të llojit

Karakteristikat e llojit të Qarrit *(Quercus cerris)*

Qarri *(Quercus cerris)* mund të arrijë lartësi 30 - 35 metër.
Diametër 1 - 1.5 metra, me një kurorë të gjërë dhe degë.
Preferen toka argjilore, të thella dhe të freskëta dhe zhvillohet dobët në toka të thata, shkëmbore dhe gëlqerore.
Qarri është tipik dritëdashës por toleron hijen gjatë moshës së re dhe reziston erërat, acaret dhe ndotjet poashtu.
Qarri rritet shpejtë deri në moshën 40 – 50 vjeçare.
Prodhon lëndë çdo vit apo çdo dy vite.
Zakonisht në total ka 150-250 lëndë për kilogram.
Mbishmeria e lendes mesatarisht është 60-70 %.

### 1.8.3. Karakteristikat tjera

Përveç vlerave natyrore trungu ka edhe vlera tjera të rëndësishme si: estetike, dekorative, turistike dhe edukative.
Madhësia, pamja estetike dhe dekorative e bëjnë këtë trung objekt shumë atraktiv për vizitor.

### 1.8.4. Karakteristikat bazë të vlerës së mbrojtur natyrore

Trungu i Qarrit *(Quercus cerris),* në fshatin Lupç i poshtëm është trung me vlera të rralla të këtij llojit që mund të gjenden në këtë rajon. Vjetërsia, vitaliteti si dhe përmasat e kërcellit dhe kurorës e bëjnë këtë trung monument me vlera të rralla natyrore, shkencore dhe turistike.
Duke marrë për bazë këto karakteristika ky trung propozohet për mbrojte si Monument i Natyrës me karakter botanik.

### 1.9. Shkalla e rrezikimit

Në afërsi të trungut nuk ka ndonjë burim të ndotjes që do të mund ta rrezikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë atë. Gjendja aktuale natyrore e trungut është e mirë dhe në pjesën e kurorës së trungut nuk vërehet ndonjë degë e tharë.

### 1.10. Historiku i mbrojtjes

Gjatë verës së vitit 2021, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në procesin e njohjes dhe evidentimit të vlerave natyrore në komunën e Podujevës ka evidentuar Trungun e Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Lupç i poshtëm, si monument me vlera të rralla natyrore. Trungu daton qysh nga kohërat e lashta.

Në shkurt të vitit 2022, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, i ka propozuar Kuvendit Komunal të Podujevë marrjen nën mbrojte të këtij trungu (Iniciativë për shpalljen e vlerave të natyrës nën mbrojtje).

Gjatë periudhës verore 2021, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka grumbulluar të dhënat e nevojshme për hartimin e bazës profesionale për vënien nën mbrojtje të këtij Monumenti të Natyrës.

### 1.11. Konceptet bazë për mbrojtje, zhvillim dhe rregullim

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, Neni 19, paragrafi 3, Monumentet e Natyrës i shpallë Kuvendi i Komunës në territorin e të cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

### 1.12. Organet përgjegjëse për mbrojtje

(Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës; Nenit 143 paragrafi 1)

1. Punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës i kryen Ministria, përveç atyre punëve të cilat me këtë ligj ose ligj tjetër ju kanë besuar organit kompetent drejtues, Institutit ose komunës.
2. Komunat në pajtim me këtë ligj, strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:
   2.1. kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet
   2.2. shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente
   2.3. sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura

për të cilat janë kompetente

2.4. marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi

2.5. marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente

2.6. kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës

2.7. përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport

2.8. mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës

2.9. informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë

2.10. ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë

2.11. kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij

## 1.13. Regjimi dhe masat e mbrojtjes

Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Lupç i poshtëm i takon kategorisë së tretë (III) sipas IUCN-së, si Monument i Natyrës. Për ruajtjen dhe përparimin e këtij Monumenti të Natyrës duhet respektuar këto masa mbrojtëse.

**Ndalohet**:

Bazuar në Nenin 14, paragrafi 3, të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L –233, në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristiktat dhe vlerat e tij.

Bazuar në Nenin 166, të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L –233, me gjobë, në vlerë së paku njëmijë (1000) gjerë në dhejtëmijë (10.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse: në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij kryen punë të cilat rrezikojnë veçoritë dhe vlerat e tij (Neni 14 pargarfi 3 i këtij ligji).

- Prerja e trungut, thyerja e degëve, si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen natyrore të monumentit
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit

**Lejohet:**

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

## 1.14. Arsyetimi i propozimit për kategorizim

Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të Trungut të Qarrit *(Quercus cerris)* në fshatin Lupç i poshtëm bazohet në vlerat natyrore të këtij trungu. Trungu është karakteristik për nga pamja estetike, trashësia, vjetërsia, vitaliteti dhe pozita shumë e mirë.
Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura mund të përfundojmë se Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* i plotëson kushtet të merret nën mbrojtje ligjore si Monument Natyror me karakter botanik.

## 1.15. Propozimi i kategorisë

Në bazë të nenit 19. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, **Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon që Monumenti i Natyrës i karakterit botanik** Trungu i Qarrit *(Quercus cerris)* **të merret nën mbrojtje në kategorinë e tretë (III-të), sipas IUCN-së, si zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore që posedon.**

**2. SHTOJCA**



Foto 2



Foto 3

## 2.1. Dokumentacioni Grafik

### 2.1. 1. Harta e monumentit të natyrës




Harta e Monumentit Natyror "Trungu i Qarrit", në Lupç të poshtëm

## 2.1.2. Ekstrakt nga fletë posedimi



A.2 LLOJI I SHFRYTEZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri / Broj / Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës / Vrsta korišćenja parcele / Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës / Trenutna korišćenja parcele / Parcel Current Use | Klasa / Klasa / Quality Class | Sipërfaqja (m2) / Površina (m2) / Area (m2) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | [illegible] | [illegible] | | [illegible] |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| E drejta / Pravo / Rights | Emri / Ime / Name | Nr. personal / Lični broj / ID. No. | Vendbanimi / Prebivalište / Residence | Kodi postal / Poštanski broj / Postal code | Hollësitë e adresës / Pojedinosti adrese / Address details | Pjesa e pronës / Deo svojine / Share | Përshkrimi / Opis / Description | Data e azhurnimit / Ažuriranje / Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës-Këshilli i Bashkësisë Islame-Podujevë | [illegible] | PODUJEVË/ PODUJEVO / PODUJEVA | | | 1/1 | [illegible] | [illegible] |

[illegible] Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person [illegible]

## 2.1.3. Kopje plani





## 2.2. Dokumentacioni fotografik



Foto 4. Lenda e *Quercus cerris*



Foto 5



Foto 6

## Referencat:


- Dokumentacioni nga Arkivi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233)
- Dokumentacioni nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës në komunën e Podujevës
- Libri i Kuq i Florës Vaskulare i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2013, Dr. Ferat Rexhepi, Dr. Fadil Millaku, Dr. Elez Krasniqi, Dr, Qazim Pajaziti, Mr. Xhavit Mala, Mr. Naim Berisha
- Atlasi i Bimëve të Kosovës, Dr. Ferat Rexhepi, Dr. Fadil Millaku, Mr, Xhavit Mala, Behxhet Berisha
- Harta topografike e Kosovës 1 : 25000

## Përfundim

Kjo arsyeshmëri profesionale e hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës paraqet vetëm një pjesë të punës profesionale të këtij institucioni në lëmin e mbrojtjes së natyrës.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës do të vazhdoje edhe me tutje të angazhohet në njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës dhe do të marrë nën mbrojtje vlerat e veçanta natyrore, në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së zonave të mbrojtura në territorin e komunës tuaj si dhe në dhënien e mendimeve profesionale në lëmin e mbrojtjes së natyrës.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës do të jetë gjithmonë i hapur për bashkëpunim edhe për të gjitha çështjet tjera me interes të mbrojtjes së natyrës dhe vlerave të saj.

Me kënaqësi do të pranojmë çdo sugjerim, vërejtje apo këshillë nga ana juaj lidhur me këtë elaborat duke ju sugjeruar që të merrni masa ligjore për mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore.

Ju falënderojmë sinqerisht për bashkëpunimin e ofruar gjatë realizimit të punëve në terren dhe në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me këtë çështje.

Në përgatitjen e këtij elaborati morën pjesë:

**Udhëheqës i punëve:**

Abdurrahman Verbovci – Zyrtar për Mjedis

**Hulumtimi në terren:**

Abdurrahman Verbovci – Zyrtar për Mjedis

Msc. Nexhmije Kamberi – Zyrtare për Florë

Arbe Demaj – Praktikante në IKMN

**Bashkëpunëtor i jashtëm**

Rizah Muçolli – Zyrtar për Mjedis, në DUPM, në komunën e Podujevës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Rr. Luan Haradinaj, ish Rilindja, kati XIV nr. 1403/A
10 000 Prishtine, KOSOVË
Tel. 038 200 33 236
http://ammk-rks.net

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 34 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 3 të Rregullores nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të datës 15 korrik 2022, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 29 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në propozim të datës 18.10.2022 të Drejtorisë së Administratës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

*Propozohet*

### VENDIM
### FORMIMI I KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

**Neni 1**

**1.** Për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës, formohet komisioni, në këtë përbërje:

1.1. ____________________, *anëtar/e nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
1.2. ____________________, *anëtar/e nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
1.3. ____________________, *anëtar/e nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
1.4. ____________________, *anëtar/e nga radhët e Kuvendit të Komunës,*
1.5. ____________________, *anëtar/e nga radhët e Ekzekutivit të Komunës*
1.6. ____________________; *anëtar/e nga radhët e Shoqërisë civile*
1.7. ____________________, *anëtar/e përfaqësues nga këshilli i fshatit, vendbanimit, lagjes urbane, i cili propozohet dhe zgjedhet me shumicë të votave nga të pranishmit në tubimin zgjedhor të Këshillit përkatës.*

**2.** Në aspektin teknik, administrativ dhe profesional, Komisioni Bashkëpunon me nëpunësin civil – Koordinatorin për bashkëpunim me këshillat lokale.

**3.** Kryesuesi i Komisionit, rregullat dhe mbarëvajtja e punëve dhe takimeve caktohen në takimin e parë të Komisionit, i cili ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Neni 2**

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron konform Rregullores nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi, si dhe i njëjti obligohet t'i raportoj Kuvendit të Komunës rreth rrjedhës së tubimeve, zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe çështje tjera relevante që ndërlidhen me këtë proces, pasi të ketë përfunduar i tërë aktiviteti si dhe pas çdo aktiviteti eventual që mund të paraqitet brenda mandatit.

**Neni 3**

Komisioni formohet në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e Kuvendit të Komunës, brenda të cilit i njëjti mund të plotësohet dhe ndryshohet me vendim të Kuvendit.

**Neni 4**

Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria e Administratës.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Nr.prot.**02-020/04-0088366/22
**Podujevë, datë:** 18.10.2022

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**DREJTORIA E ADMINISTRATËS**

**Për: z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**

**Lënda: Propozim për Kuvendin e Komunës**

I nderuar Kryetar,

Në bazë të Rregullores nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të datës 15 korrik 2022, ndër të tjera parashihet edhe formimi i komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë me vendim në Kuvendin e Komunës.

Drejtoria e Administratës, planifikon që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës të procedojmë këtë çështje.

Andaj bashkëngjitur gjeni propozim vendimin përkatës i cili pas nënshkrimit nga ana Juaj, do të procedohet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

*Për anëtarin nga shoqëria civile sipas nënparagrafit 1.6, Drejtoria e Administratës do të zhvilloj procedurë përmes thirrjes publike, në mënyrë që deri në shqyrtimin e kësaj çështje të sjellët edhe emri/at përkatës për shqyrtim dhe miratim nga ana e Kuvendit.*

**Me respekt**
**Podujevë, 18.10.2022**

**Drejtoresha**
**Antoneta Ejupi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KUVENDI I KOMUNËS**
**Kryesuesi i Kuvendit**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 6 paragrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, i,

*Propozohet*

**VENDIM**
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023**

**Neni 1**

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e Draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, dhe atë në këtë përbërje;

1. ____________________, kryesues i komisionit
2. ____________________, *anëtar nga radhët e Kuvendit*
3. ____________________, *anëtar nga radhët e Kuvendit*
4. ____________________, *anëtar nga radhët e Kuvendit*
5. ____________________, *anëtar nga radhët e Kuvendit*
6. ____________________, *anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
7. ____________________, *anëtar nga radhët e Ekzekutivit*
8. ____________________, *anëtar nga radhët e Ekzekutivit*

**Neni 2**

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, organizon konsultime publike si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**Neni 3**

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon me Ekzekutivin e Komunës dhe shërbimet përkatëse në kuadër të Institucionit të Komunës së Podujevës.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

**Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Nr.prot.** 01-020/04-0089381/22
**Podujevë, datë:** 19.11.2022

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVA
PODUJEVË/O

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS
## Kryesuesi i Kuvendit

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja d), 51.1 dhe 52.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 47 paragrafi 1, dhe 48 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, për mbledhjen e caktuar më 31 tetor 2022, i,

***Propozohet***

**VENDIM**

**Neni 1**

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021, dhe atë:

**z./znj.____________________**, emërohet në vend të znj.Adelinë Stublla, e cila për arsye të emërimit në funksion ekzekutiv në Komunën e Podujevës, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga Kuvendi i Komunës, respektivisht nga pozita e anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Neni 2**

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/04-0111883/21 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 30 dhjetor 2021.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Podujevë,**
**19 tetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**